

BIOGRAFI E SHKURTËR E IMAM NEVEVIUT

Imam Neveviu (1233–1277), Allahu qoftë i kënaqur me të, ishte njëri prej dijetarëve më të shquar të historisë islame, jurist i thellë dhe mjeshtër i Hadithit. I njohur për devotshmërinë, thjeshtësinë dhe përkushtimin e jashtëzakonshëm ndaj dijes dhe adhurimit, ai kaloi jetën e tij në studim të thellë, mësimdhënie dhe këshillim të njerëzve.

Që në moshë të vogël, Imam Neveviu shfaqti pasion të jashtëzakonshëm për dijen, mësoi përmendsh Kuranin dhe veprat kryesore të jurispruencës shafiite, si dhe kaloi net e ditë në studim, reflektim dhe shkrim veprash. Ai nuk kërkoi kurrë shpërblime apo lavdi, dhe përkushtimi i tij i sinqertë ndaj dijes dhe moralit e ngriti atë në një shembull të shquar për bashkëkohësit dhe brezat që do të vinin.

Ai jetonte me thjeshtësi të madhe, duke shmangur çdo luks apo shpërbllim të tepruar. Ushqimin e siguronte kryesisht nga ato pak gjëra që i sillte i ati, ndërsa pjesën më të madhe të ditës dhe natës e kalonte në studim dhe adhurim. Veshja e tij ishte e thjeshtë, ndërsa çdo veprim dhe mendim i tij reflektonte ndërgjegjësimin e vazhdueshëm ndaj Allahut. Ai gjithmonë këshillonte për të mirën, korrigjonte padrejtësitë që shihnte dhe i inkurajonte nxënësit e tij ta ndiqnin rrugën e dijes dhe të devotshmërisë. Ky përkushtim i palëkundur ndaj moralit, dijes dhe adhurimit e bëri Imam Neveviun një model të jashtëzakonshëm për bashkëkohësit dhe brezat e ardhshëm.

Vepra të tij, si “Rijadus Salihin”, “Dyzet Hadithet e Imam Neveviut”, “El Edhkar”, “Minhaxh Et Talibin” dhe “Et Tibjanu fi Adabi Hameleti El Kurani”, përbëjnë burime të paçmuara për dijetarët dhe praktikuesit e Islamit, duke përmbledhur parimet e moralit, etikës, edukatës dhe shpirtërimit. Përmes tyre ai vazhdon të frymëzojë dhe të udhëheqë breza të tërë në rrugën e dijes dhe të devotshmërisë.

Imam Neveviu ndërroi jetë në Neva, më 1277, duke lënë pas një trashëgimi intelektuale dhe shpirtërore që frymëzon myslimanët edhe sot, dhe që mbetet shembull i përkushtimit, i dijes dhe i devotshmërisë.



IMAM NEVEVI

EDUKATA e bartësve të Kuranit

الدِّبِّيَّةُ
فِي
آدَابِ حَمَلَةِ الْقُرْآنِ



IMAM NEVEVI | EDUKATA E BARTËSVE TË KURANIT - ET-TIBJANU FI ADABI HAMELETI EL-KURANI

IMAM NEVEVI
EDUKATA E BARTËSVE
TË KURANIT

IMAM NEVEVI

EDUKATA
E BARTËSVE
TË KURANIT

ET TIBJANU
FI ADABI HAMELETI EL KURANI



EDUKATA E BARTËSVE TË KURANIT

IMAM NEVEVI

Titulli original:

التَّبَيَّانُ
آدَابُ حِكْمَةِ الْقُرْآنِ

Përktheu dhe përshtati nga arabishtja në shqip:

Enes Koshi

Botues:

**Komuniteti Musliman Shqiptar në Zvicër - DAIGS
Departamenti për veprimtari botuese**

Për botuesin:

Hfz. Mehas Alija

Redaktor profesional & recensent:

Prof. Dr. Hfz. Hajredin Hoxha

Konsulentë:

Mr. Bekim Alimi

Mr. Nehat Ismaili

Redaktor letrar:

Mr. Besnik JAHA


Redaktor teknik

Mr. Bashkim MEHANI

Shtypi: >

Tirazhi: >

Prishtinë?





FJALA E PËRKTHYESIT

Duke falënderuar Allahun e Madhërishëm, lexuesve shqiptarë po u ofrohet vepra e njohur *Etika e bartësve të Kuranit*, e autorit dhe imanit të famshëm, Muhjidin bin Zekerija bin Sheref En Neveviut (Allahu e mëshiroftë!). Ai u drejtohet nxënësve të dijes, hafizëve dhe të gjithë atyre që e lexojnë dhe mësojnë Kuranin, duke i udhëzuar mbi mënyrën e duhur të sjelljes ndaj Librit të Shenjtë.

Në këtë vepër autori trajton rregullat e sjelljes gjatë leximit të Kuranit, virtytet morale që duhet të kenë bartësit e tij, si dhe mënyrën e drejtë të marrëdhënies ndërmjet mësuesit dhe nxënësit. Libri përmban gjithashtu udhëzime fetare dhe praktike lidhur me recitimin, dëgjimin dhe respektimin e Librit të Shenjtë, duke ndihmuar lexuesin të forcojë lidhjen e tij shpirtërore me të.

Imam Neveviu e shkroi këtë libër brenda një periudhe të shkurtër, rreth njëzet e një ditë, dhe arriti të përgatisë një vepër të përmbledhur dhe të dobishme. Që në fillim ai thekson se qëllimi i tij ka qenë ta bëjë librin të lehtë për t'u mësuar dhe të kuptueshëm për sa më shumë njerëz. Kjo është edhe arsyeja pse libri u përhap gjerësisht dhe u pranua me interes të madh nga lexuesit ndër breza.

Suksesi i kësaj vepre lidhet jo vetëm me përmbajtjen e saj të çmuar, por edhe me sinjeritetin dhe përkushtimin e madh të Imam Neveviut në shërbim të dijes dhe fesë.

Përkthimi i kësaj vepre në gjuhën shqipe ua mundëson besimtarëve shqipfolës të thellojnë njohuritë mbi etikën dhe vlerat që lidhen me Kuranin. Libri kontribuon në përhapjen e dijes autentike islame,

forcimin e respektit dhe të lidhjes shpirtërore me Librin e Shenjtë, si dhe në formimin fetar dhe moral të lexuesve. Gjithashtu, shërben si udhërrëfyes i rëndësishëm për ata që synojnë ta recitojnë, ta kuptojnë dhe ta zbatojnë Kuranin në jetën e përditshme.

Vërejtje: Imam Neveviu (Allahu e mëshiroftë), autori i kësaj vepre, i përkiste *medhhebit shafii*. Si rrjedhojë, çështjet juridike (meselet fik'hore) që përmenden në libër trajtohen në përputhje me parimet dhe qëndrimet e këtij medhhebi. Kjo vërejtje bëhet me qëllim të qartësimit shkencor për lexuesin.

Lexues i nderuar,

I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të) ka thënë: “*Kush nuk i falënderon njerëzit, nuk e falënderon Zotin.*” (Ahmedi).

Me këtë rast, shpreh mirënjohjen time të thellë për të gjithë ata që kontribuan në përgatitjen dhe botimin e kësaj vepre. Në veçanti, falënderoj redaktorin profesional dhe mësuesin tim të Kuranit, Prof. Dr. Hfz. Hajredin Hoxhën, për përkushtimin, kompetencën shkencore dhe kontributin e çmuar në redaktimin e tekstit. Po ashtu, shpreh falënderimet për konsulentët, Mr. Bekim Alimin dhe Mr. Nehat Ismailin, për këshillat dhe sugjerimet e tyre të dobishme. Një falënderim i veçantë i takon lektorit dhe korrektorit, Mr. Besnik Jahës, për përkujdesjen gjuhësore dhe stilistike, si dhe redaktorit teknik, Mr. Bashkim Mehanit, për realizimin teknik dhe përgatitjen profesionale të botimit. Në fund, falënderoj sinqerisht Komunitetin Musliman Shqiptar në Zvicër – DAIGS, gjegjësisht Departamentin për kulturë dhe veprimtari botuese, i cili mori përsipër botimin e kësaj vepre.

Enes Koshi

Zvicër, dhjetor 2025



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit!

Hamde i thurim Zbritësit të Kuranit!

Salavate i dërgojmë Sqaruesit të Bejanit!

Rizanë e Zotit ia urojmë lexuesit të Furkanit!

PARATHËNIE E REDAKTORIT

(Për dashamirët dhe shërbyesit e Kuranit)

Allahun (*xhel-le she'nuhu*) e falënderojmë për të mirat e Tij të pakufishme që na i ka falë! Salate dhe selame për të dashurin tonë, Muhamed Mustafanë, dërgojmë hiç pa ndalë, i cili ka thënë: “*Më i mirë dhe më i dashur tek Allahu (xhel-le she'nuhu) është ai që e mëson Kuranin, (e studion, e komenton, e mirëlexon atë) dhe ua mëson të tjerëve*”. Kënaqësia e Allahut të Lartë qoftë mbi shokët dhe familjen e tij të dashur, që flijuan jetën dhe pasurinë për Kuranin.

Allahun *Er Rrahman, Err Rrahim* e falënderojmë, i Cili e dërgoi Muhamedin (*alejhi selam*) udhëzues, përgëzues dhe qortues për tërë njerëzimin: “***Ne të kemi dërguar ty për tërë njerëzimin – përgëzues dhe paralajmërues, mirëpo shumica e njerëzve nuk e dinë***” (Sebe: 28). Allahun e falënderojmë nga thellësia e zemrës, i Cili e zbriti Kuranin dhe e bëri atë argument (burhan) dritë (nur), shërim (shifë), forcë, dinjitet, krenari (dhikër),¹ udhëzim (huda), litar i Tij i fortë për shpëtim (hablu-llahi el metin), dhe e shpalli në zemrën e Muhamedit (*alejhi selam*) nëpërmjet

¹ Te gjithë komentuesit e Kuranit e kanë komentuar kështu fjalën “dhikrukum” në ajetin: “Ne, ju shpallëm një Libër, këshillë e lavdi për ju. Vallë, a nuk po kuptoni ju?!” (el-Enbija: 10).

melekut Xhibril, për mbarë njerëzimin: **“O Pejgamber, Ne të kemi dërguar dëshmitar, përgëzues dhe paralajmërues.”** (El Ahzab: 45). Allahu e zbriti Kuranin në gjuhën arabe, të qartë e të pastër: **“Me të vërtetë, ai (Kurani) është Shpallja e Zotit të gjithësisë, atë e ka sjellë Shpirti i Besueshëm (Xhibrili), në zemrën tënde, që të bëhesh prej paralajmëruesve, në gjuhën e qartë arabe.”** (Esh Shuara: 192-195). Allahu garantoj dhe e mori përgjegjësinë e ruajtjes së tij nga ndryshimi, humbja dhe keqpërdorimi: **“Ne me të vërtetë e kemi shpallur Kuranin, dhe Ne gjithsesi do ta ruajmë atë (origjinalitetin e tij)”** (El Hixhër: 9). Pastaj, Zoti kërkoi prej Muhamedit (alejhi selam) ta lexonte me *tertil* atë, sipas leximit të melekut Xhibril: **“E, kur ta lexojë Xhibrili atë (Kuranin), përcille leximin e tij!”** (El Kijame: ١١), **“dhe lexoje Kuranin me kujdes dhe qartë!”** (El Muzzemil: 4). Pastaj kërkoi ta përcillte, ta predikonte, ta komentonte dhe t’ua kumtonte shokëve të tij të ndershëm, popullit dhe mbarë umetit: **“O Pejgamber! Tregoje atë që të është shpallur prej Zotit tënd! – Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke kryer pejgamberinë tënde.”** (El Maide: 67) Pastaj e autorizoi të Dërguarin e Tij për interpretim dhe predikim: **“Ne ta kemi dërguar ty Kuranin, që t’ua shpjegosh njerëzve dispozitat e shpalljes, dhe që të mendojnë.”** (En Nahël: 44). E, më pas Allahu kërkoi të veprohet sipas udhëzimeve dhe parimeve: **“Dhe thuaj “punoni!”, Allahu, Pejgamberi i Tij dhe besimtarët do ta shohin punën tuaj.”** (Et Tevbe: 106). Në fund, Allahu i Madhëruar kërkoi t’i referohemi atij (Kurani) dhe të jetë gjykues për ne, për shoqërinë dhe për mbarë njerëzimin, deri në Ditën e Gjykimit: **“(Ne ta dërguam Librin) Të gjykosh me atë që ta ka shpallur Allahu, e mos i ndiq dëshirat e tyre!”** (El Maideh: 49)

Ky gradualitet i zbritjes dhe i aplikimit të urdhrave kuranorë tregon metodologjinë e bashkëveprimit me Kuranin (*mësimin dhe aplikimin e tij*) në jetën e përditshme. Këtë metodologji e ndoqën edhe shokët e Muhamedit (alejhi selam), të cilët e përjetuan zbritjen e Kurani dhe e mësuan mënyrën e aplikimit të tij në jetën e përditshme. Kështu demonstruan para botës një metodologji praktike, dinamike dhe aplikative se si duhet të jetë një individ, një shoqëri dhe një umet ideal që e do Allahu dhe i Dërguari i Tij. Si rezultat i këtij mishërimi dhe integrimi të fjalës dhe veprës, sahabët u bënë referencë, dëshmi dhe model për gjeneratat e ardhshme të myslimanëve, se si të sillen, si ta kuptojnë dhe si t’i aplikojnë mësimet dhe parimet kuranore në jetën e tyre.

Sahabët ishin gjeneratë kuranore-unike dhe shumë e veçantë për njerëzinë, sepse e mësuan Kuranin teorikisht (*u bënë hafizë të denjë*) dhe

praktikisht (*punëtorë aktivë*), gjë që fatkeqësisht sot na mungon nëpër institucionet tona, si në aspektin lokal, ashtu edhe në atë rajonal dhe global.

Apelojmë që urgjentisht të rishikohet veprimtaria jonë individuale dhe kolektive, të rishikohet dhe të korrigjohet metoda e muafizëve dhe e hoxhallarëve nëpër mektebe dhe xhami, e profesorëve nëpër medrese dhe fakultete, e ustallarëve dhe e mjeshtërve të Kuranit që merren me përgatitjen e kurrikulave dhe të silabuseve, që të sigurojnë një edukim të shëndoshë, me tefsirin dhe interpretimin e tij, në mënyrë që mësimet kuranore të integrohen në sferat e jetës sonë bashkëkohore!

Kurrsesi nuk lejohet të jemi të izoluar përbrenda mureve të xhamive, mektebeve, klasave, sallave të ligjëratave, mexhliseve të dhikrit e mevludit, të kelimeit teuhidit, por duhet dalë në terren dhe në mejdan: ***“E, kush flet më bukur se ai që thërret tek Allahu, bën vepra të mira dhe thotë: “Unë, me të vërtetë, jam mysliman!”*** (Fussilet: 33)

Allahu qoftë i kënaqur me imamët, hafizët dhe kurratë (lexuesit) e Kuranit, që prej Muhamedit (alejhi selam), pastaj me sahabët e tij të ndershëm, tabiinjtë dhe të gjitha gjeneratat që erdhën pas tyre dhe që na e transmetuan Kuranin famëlartë, të pastër, të kulluar, të qartë dhe me zinxhir (sened) të artë të transmetuesve dhe të hafizëve profesionistë, ashtu siç ka zbritur me texhvid (*drejtlexim*) dhe me kiraete të ndryshme (*shtatë dhe dhjetë leximet e Kuranit*), me versione të ndryshme të leximit, të cilat i ka shënuar Imam Shatibiu, Imam Ibën El Xhezeriu, Imam El Dani etj. Hamdi i qoftë Allahut për këtë dhunti (*nimet*) që na e dhuroi dhe që na dalloi si umet-popull karshi të tjerëve, ashtu që të jemi dëshmitarë të kësaj feje dhe të këtij Libri (Kuranit), në këtë jetë dhe në Ahiret. Këtë realitet e konfirmon Allahu (xhel-le she’nuhu), kur thotë: ***“Ju myslimanët ishit populli më i mirë dhe më i përsosur që Allahu përgatiti dhe krijoi për njerëzimin, për të urdhëruar në të mirë, për të ndaluar nga e keqja dhe për të besuar në Allahun.”*** (Ali Imran: 110)

Ky Kuran i bereqetshëm, i mrekullueshëm dhe me shumë sekrete, u dallua nga librat e tjerë që zbritën para tij (*Tevrati, Zeburi, Inxhili, suhufet e Ibrahimit dhe të Musait, a.s., etj.*), e në veçanti përsosmëria dhe origjinaliteti i tekstit të shenjtë të shpallur prej Allahut (xhel-le xhe’nuhu), dhe është përplot me tematika, parime, legjislacione, mesazhe universale, urdhra dhe me thirrje universale, jo me thirrje të kufizuara në vend dhe në kohë, siç kanë qenë librat e mëparshëm.

Po ashtu, Kuranin e bën të veçantë mrekullia e tekstit kuranor, që është ruajtur në origjinal prej Allahut (xhel-le she'nuhu), është nxënë në zemrat dhe në kokat e hafizëve, të kurrave dhe të lexueseve anembanë botës, që nga koha e shpalljes e gjer më sot, dhe atë me tekst arkivor të saktë dhe të ruajtur 100%. Ky proces i ruajtjes do të vazhdojë kështu deri në ditën e fundit të kësaj jete. Kurani do të vazhdojë të mbetet muxhize-mrekulli, i paimitueshëm, libër hyjnor dhe udhëzues për tërë njerëzinë dhe për çdo kohë. Allahu i Madhëruar e ka bekuar këtë Libër, e ka bërë të bereqetshëm dhe e ka pajisur strukturën e teksteve kuranore me kuptime dhe me mësim të përhershme, nga burojnë kuptime të reja, dhe së këndejmi vazhdon të jetë kështu, ku çdo gjeneratë do të gjejë kuptime të reja e të pashtershme. Kurani e ka ruajtur dhe akoma e ruan në brendinë dhe strukturën e tij sekretin kuptimor për çdo gjeneratë: **“(Ky) Është një libër (Kurani) që ta kemi zbritur ty, libër i bekuar, për t’i studiuar argumentet e tij dhe për t’u këshilluar mendimtarët me të.”** (Sad: 29).

Mesazhi kuranor ka qenë, është dhe do të jetë gjithmonë me karakter universal dhe global, ku raca, ngjyra dhe pozita gjeografike shkrihen në mëshirën e këtyre parimeve hyjnore dhe në drejtësinë e barazisë njerëzore, ndërsa më i dalluari dhe më i çmuari është më i devotshmi, më punëtori, më i sinqerti dhe më modesti: **“O njerëz! Ne me të vërtetë ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre, dhe ju bëmë popuj dhe fise, për t’u njohur (me njëri-tjetrin). Më fisniku tek Allahu është më i devotshmi prej jush. Me të vërtetë Allahu është i Gjithëdijshtëm, dhe asgjë nuk i fshihet Atij.”** (El Huxhurat: 13)

Me këtë veçori Kurani e dëshmon universalitetin, përsosmërinë dhe qenien e tij si shpallje përmbyllëse e gjithë librave të shpallur, duke e pëlqyer dhe përzgjedhur Islamin si fe, sistem dhe program të jetës, të vetëm të pranuar tek Allahu (xhel-le she'nuhu) për mbarë njerëzimin. Me këtë fakt kuranor bie poshtë fraza *religjionet qiellore*; madje, nuk ka pasur dhe as që do të ketë religjione qiellore. Frazën *religjione qiellore* e kanë trilluar hebrenjtë, të krishterët, orientalistët dhe shekullaristët. Pra, feja ka qenë, është dhe do të mbetet një dhe e vetme (*Islami*), por me sheriate (legjislacione) të ndryshme për çdo popull dhe çdo kohë. Ky realitet nuk duhet harruar kurrë, sepse Kurani fisnik e konfirmon këtë në shumë ajete, e sidomos në suren El Bekare, në ajetet 127, 133, 135, 136, 137, 138, 140; në suren Ali Imran, në ajetet 52, 64, 67, 80, 84, 102; në suren El Maide, në ajetet 3, 111; El Enam 163; El Araf: 126; Junus: 84; El Hixhër: 2; En

Nahël: 89, 102; El Haxh: 78... Në këto ajete është vula ku Allahu na ka quajtur myslimanë. Libër tjetër të shpallur me këto veçori dhe specifika nuk do të ketë gjersa të ekzistojë jeta në këtë botë.

Çka nuk duhet harruar kurrë është edhe kjo: ne, myslimanët, ndaj këtij libri madhështor (Kuranit) kemi shtatë obligime individuale, shoqërore, institucionale dhe shtetërore. Këto detyrime mund të klasifikohen në katër nivele edukative:

- Niveli i parë: *detyrimi për ta lexuar dhe për ta nxënë përmendsh.*
- Niveli i dytë: *detyrimi për të medituar rreth tij dhe për ta interpretuar.*
- Niveli i tretë: *detyrimi për të vepruar sipas parimeve dhe urdhrave të tij, dhe për t'i thirrur njerëzit në të.*
- Niveli i katërt: *detyrimi për ta dashur sinqerisht atë.*

Në trojet tona ballkanike dhe në shumë vende islame, eksperiencia jonë akademike dhe edukativo-arsimore për tri dekada dhe gjer më sot ka dëshmuar se shoqëritë islame, në krye me disa institucione akademike dhe fetare, disa studentë, hoxhallarë, profesorë dhe hafizë, mjerisht ende janë në nivelin e parë, pra, ende nuk e zotërojnë mirëfilli leximin e Kuranit, nuk janë të trajnuar siç duhet dhe nuk i praktikojnë rregullat e texhvidit/drejtleximit/mirëleximit të Kuranit dhe, si pasojë e kësaj gjendjeje, populli dhe xhemati nuk janë familjarizuar ende me artin e leximit dhe të këndimit të Kuranit, si dhe as me etiketën e bartjes së Kuranit. Ky konstatim nuk duhet kuptuar si demotivim, por si motivim dhe si ripërtëritje e forcave dhe e potencialeve tona për të bërë përpjekje maksimale që të dalim nga kjo gjendje dhe të kalojmë në nivelin e dytë, e më pas në të tretin e në të katërtin.

Për të kaluar në nivelet e lartpërmendura, patjetër duhet të përmbushet niveli i parë, përndryshe, sistematikisht, akademikisht dhe logjikisht nuk mund të arrihen qëllimet e shenjta të niveleve vijuese. Në Ballkan myslimanët shqiptarë, turq, boshnjakë dhe të tjerë, në krahasim me popujt e disa vendeve aziatike (si Malajzia, Indonezia, Brunei, Turqia etj.), akoma janë shumë prapa, dhe atë shkaku i sistemeve edukative-arsimore laike dhe kurrikulave shekullare që nuk e kanë integruar edukatën fetare në programet shkollore. Për këtë arsye populli, xhemati dhe masa e thjeshtë nuk e zotërojnë leximin e Kuranit në gjuhën arabe dhe nuk posedojnë etiketë të duhur për mësimin, implementimin dhe integrimin e Kuranit në

jetën e tyre të përditshme, dhe kjo krizë shpërfaq gjendjen tonë faktike dhe të mjerueshme.

Për të dalë nga kjo gjendje dhe nga niveli i parë, na duhet një katalog udhëzues, një libër sqarues dhe një skicë e qartë për ta mësuar drejtëleximin e Kuranit sipas rregullave të duhura, për t'u njohur me shkencën e texhvidit dhe për ta lexuar atë siç e ka lexuar Muhamedi (alejhi selam) dhe shokët e tij. Pra, na duhet një katalog i detajuar udhëzues shpirtëror dhe moral mbi etikën, edukatën dhe të kulturën a atij që e mëson Kuranin dhe atë ua mëson të tjerëve (*Hafizit dhe Muhafizit*). Gjithashtu, ky udhëzues na duhet për t'i mësuar sekretet e shkronjave arabe, cilësitë, vendartikulimet dhe vendformimet e tyre, rregullat e zgjatjeve, shkrirjet, dyfishimet dhe shumë rregulla të tjera.

Për këtë qëllim të shenjtë dhe fisnik Allahu (xhel-le she'nuhu), gjatë historisë njerëzore, përzgjedh prej robërve të Vet shërbyes dhe studiues të sinqertë të Kuranit, me të cilët e realizon dhe e përmbush këtë nivel të rëndësishëm në drejtëleximin, drejtkuptimin, drejtinterpretimin dhe drejtimplementimin e Kuranit. Ndër studiuesit e sinqertët, punëtorët e palodhur, dashamirët e dijes dhe të dijetareve, të cilët e kanë bërë veten kurban dhe vakëf në shërbim të Kuranit (me lexim, mësim, studim, përkthim, komentim, publikim etj.), është edhe Imami ynë madhështor, me famë botërore, referencë në shkencat kuranore dhe të jurisprudence islame, e në veçanti të medh'hebit shafii, Imam Muhjidin Ebu Zekerija Jahja bin Sheref En Nevevi (631-676 h.).

Libri në fjalë i Imam Neveviut është një ndër librat bazë në fushën e shkencave kuranore. Për rëndësinë tematike dhe profesionale, si dhe sekretin e sinqeritetit të autorit të kësaj vepre, ky libër gëzoi autoritet dhe pranim në zemrat e studentëve dhe të kërkuesve të diturisë dhe të atyre që punojnë në këtë fushë, që nga koha e autorit e gjer në këto momente kur po shkruhen këta rreshta, Allahu na bëftë si autori, dhe veprat tona i bëftë të pranuar si veprat e autorit! Rekomandoj fuqishëm që ky libër të jetë referencë për profesorët dhe studentët e lëndës së Kuranit dhe Texhvidit, për hafizët dhe muhafizët tanë nëpër institute anembanë globit, e sidomos në Ballkan dhe në Diasporë.

Vëllai, kolegu, imami, hoxha, lexuesi profesional i Kuranit, studenti ynë i dashur, Mr. Enes ef. Koshi, imam në Qendrën Islame Shqiptare në qytetin Wil, në Zvicër, Allahu e bekoftë me të mirat e Tij, sot po del para publikut dhe para lexuesve me këtë vepër, punim dhe katalog madhështor,

të titulluar **“Edukata e bartësve të Kuranit”, (Et Tibjan fi Adabi Hameletil Kuran), të Imam Neveviut**, ndërsa ne e urojmë nga zemra për këtë sukses profesional dhe fetar, duke iu lutur Allahut, xh.sh., që mundin e tij ta shpërblejë shumëfish, dhe që ky libër të jetë i pranuar në zemrat e lexuesve dhe të mësuesve të Kuranit! Ne patëm nderin dhe ishim tejet të privilegjuar që e redaktuam, e recensuam e korrigjuam, dhe që sugjeruam mendime të dobishme në këtë vepër madhështore të kolegut dhe të vëllait tonë. Libri në fjalë është një vepër serioze, sistematike, akademike dhe me standarde e kritere ndërkombëtare. Temat dhe njësitë që trajton ky libër janë shumë (çdo gjë që ka nevojë studiuesi dhe mësuesi i Kuranit mësohet dhe studiohet nëpër fakultete dhe shkolla të mesme e fillore islame të nivelit ndërkombëtar në botën arabe dhe në atë aziatike). Vepra është e përkthyer nga arabishtja me një mjeshtëri profesionale, me një gjuhë të lehtë dhe të mirë, të shkëlqyeshme dhe jo të vështirë. Ky libër madhështor meriton respekt të veçantë, prandaj duhet të vendoset nëpër kurrikulat e medreseve dhe të fakulteteve tona islame, përndryshe, të gjithë do të jemi mëkatarë për shpërfilljen e mësimëve dhe të udhëzimeve të këtij libri në procesin e edukimit të gjeneratës sonë në leximin e Kuranit.

I lutem Allahut (xhel-le she’nuhu) që ta shpërblejë vëllanë, kolegun dhe hoxhën tonë me Xhenet për mundin e dhënë dhe për kontributin e çmueshëm akademik, fetar, edukativ e arsimor! Gjithashtu, bëjmë dua që Allahu t’ia pranojë këtë vepër, t’ia bëjë të pranueshme dhe të dobishme për umetin islam dhe për gjeneratat e ardhshme që do ta mësojnë leximin e Kuranit!

Amin, amin, amin! Vel hamdu lil-lahi Rabil alemin!

(Këto fjalë, për hir të Allahut, i shkroi shërbyesi i Kuranit dhe i myslimanëve, Allahu ia faltë gabimet dhe e bashkoi në Xhenet me të dashurin e Tij, Muhamedin, a.s., dhe shokët e tij! Amin!)

Prof. dr. hfz. Hajredin Hoxha,

Doha, Katar,

17.12.2023



BIOGRAFIA E IMAM NEVEVIUT (1233-1277)¹

(ALLAHU QOFTË I KËNAQUR ME TË!)

EMRI, LINDJA DHE FORMIMI I HERSHËM

Emri i tij i plotë është Muhjidin Ebu Zekerija Jahja bin Sheref bin Murij bin Hasan bin Husejn bin Muhamed bin Xhumua bin Hizam, i njohur si El Hizami En Nevevij (631-676 h.). Ai ishte njëri prej dijetarëve më të shquar të historisë islame, jurist i spikatur (fakih), mjeshtër i Hadithit (muhadith), asket i përkushtuar (zahid), dhe Shejhulislam i kohës së tij dhe i epokave që pasuan.

Ai ishte dijetar që vepronte sipas dijes së tij, imam i qëndrueshëm në shkencat islame, rob i sinqertë i Allahut (velij), njohës i thellë i realitetit hyjnor (arif) dhe figurë e dalluar për përkushtimin, thjeshtësinë dhe devotshmërinë e tij të jashtëzakonshme.

Imami i nderuar u shqua për një nivel shumë të lartë devotshmërie, i cili rrallë ishte parë, jo vetëm nga bashkëkohësit e tij, por edhe nga shumë prej dijetarëve të brezave të mëparshëm. Një nga shembujt më të njohur të kujdesit të tij për pastërtinë e burimeve hallall është fakti

¹ Kjo biografi është përgatitur me disa përshtatje nga dorëshkrimi i veprës *El Maṭalib El Ulja fi Ṭabekat Esh Shafiije* i Sherif Muhamed bin Hasan El Vasitiut (v. 776 h.), dhe është plotësuar me informacione nga burime të tjera si: *Tarih El Islam* i Dhehebiut, *Ṭabekat Esh Shafiije El Kubra* i Subkiut, *Ṭabekat Esh Shafiije* i Ibën Kadi Shehbeh, *Minhaxh Es Sevij* i Sujutiut, *Shedherat Edh Dheheb* i Ibën El Imadit, si dhe *Jeta e Imam Neveviut* prej Sehaviut.

se ai nuk hante nga frutat e Damaskut, për shkak të dyshimeve rreth pronësisë së kopshteve, çështje që ai vetë e kishte shpjeguar haptazi. Allahu qoftë i kënaqur me të.

Ai nuk kishte hyrë kurrë në hamam (banjë publike) dhe zakonisht hante vetëm një vakt në ditë, pas namazit të jacisë. Para agimit pinte vetëm një gllënjë ujë, të cilën e konsideronte si syfyr. Ishte jashtë-zakonisht i përmbajtur në ushqim, veshje dhe në të gjitha aspektet e jetës së tij. Jetonte me një thjeshtësi të madhe dhe, me durim të admirueshëm, përballonte ashpërsinë e jetesës.

Imam Nevevi u emërua në krye të shkollës Dar El Hadith El Eshrefije, por nuk pranoi kurrë asnjë shpërblim për këtë detyrë fisnike. Ai refuzonte çdo dhuratë që i ofrohej, nga çfarëdo personi qoftë. Ushqimin e siguronte vetëm nga ato pak gjëra që i sillte i ati nga vendlindja e tij, Neva – zakonisht bukë e thatë dhe fiq. Rrinte shpesh pa gjumë duke adhuruar Allahun dhe duke shkruar libra. Vishte rroba shumë të thjeshta. Kishte vetëm një këmishë të gjatë dhe një çallmë të vogël.

Ishte gjithmonë i kujdesshëm që asnjë çast i jetës së tij të mos shkonte dëm në gjëra që nuk ishin adhurim apo bindje ndaj Allahut. Kur dikush e vizitonte, ai mjaftohej me përshëndetjen islame dhe u përgjigjej vetëm pyetjeve të domosdoshme që kishin të bënin me dijen. Nëse vizitori qëndronte më gjatë, Imami i jepte një libër që të merrej me të, në mënyrë që të mos e pengonte nga përkushtimi i tij ndaj diturisë dhe adhurimit.

Ai jetonte gjithmonë nën vëzhgimin e pandërprerë të Allahut të Plotfuqishëm (murakabe), në çdo lëvizje e qëndrim, në çdo hap që hidhte dhe në çdo mendim që i shfaqej në zemër. Gjithmonë urdhëronte për punë të mira dhe mundohej të ndryshonte çdo të keqe që shihte. Më shumë se një herë e kishte qortuar mbretin e fuqishëm memluk, Dhahir Bejbersin, për padrejtësi apo shkelje, saqë vetë ai kishte thënë: “Unë nuk i frikësohem askujt përveç këtij Neveviut.” Dhe çdo këshillë a urdhër që i jepte Imami, ai e zbatonte.

E gjithë kjo ishte fryt i sinqeritetit të thellë, përkushtimit të pandërprerë dhe synimit të palëkundur të tij për të arritur afërsinë dhe kënaqësinë e Allahut, si në dije, ashtu edhe në vepra. Lum ai, dhe

Allahu qoftë i kënaqur me të. I Lartë dhe i lavdëruar qoftë Ai që i dhuroi këtë mirësi dhe e përfshiu me begatitë dhe bujarinë e Tij të pakufishme. Vërtet, Allahu është Zotërues i mirësisë së pafundme.

Virtytet dhe meritat e tij janë pothuajse të panumërta. Nxënësi i tij i afërt, shejhu Alaudin bin El Attar, i ka kushtuar atyre një vepër të veçantë, në të cilën ka përmbledhur shumicën e cilësive të tij të lavdëruara dhe gjendjeve të larta shpirtërore.

Në mënyrë të përmbledhur, sipas burimeve monografike, mund të thuhet se ai lindi në muajin Muharrem të vitit 631 hixhrij (1233 e.r.), dhe u rrit në vendlindjen e tij, në Neva.¹ Që në moshë të vogël shfaqti shenja të shquara zgjuarsie dhe devotshmërie, duke u dalluar ndër bashkëmoshatarët për sjellje të mirë dhe prirje të theksuara në dituri. Pikërisht atje mësoi përmendsh Kuranin famëlartë dhe hodhi hapat e parë në formimin e tij fetar.

Imam Neveviu, *Allahu e mëshiroftë*, mbërriti në Damask në vitin 649 hixhrij. Aty tregoi përkushtim të jashtëzakonshëm në kërkimin e dijes. Brenda vetëm katër muajve e gjysmë, ai mësoi përmendsh veprën e famshme në fikhun shafiit të imam Ebu Is'hak Shirazit, të titulluar *Et Tenbih*. Pjesën tjetër të vitit e kaloi duke mësuar përmendsh një të katërtën e veprës madhështore *El Muhedhdheb fi El Medhheeb*, nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e shejhut të tij të nderuar, Is'hak bin Ahmed El Magribi.

Gjatë kësaj kohe të bekuar, ai qëndroi rreth dy vite pa e shtrirë kurrizin në tokë, nga përkushtimi dhe përlësia e tij në kërkimin e dijes, duke e kaluar ditën dhe natën në studim e adhurim në medresenë Ravahije, deri në vitin 651 hixhrij.

Pas kësaj, ai u nis për Haxh së bashku me të atin. Që në natën e parë të udhëtimit, sapo dolën nga Neva-ja, ai u sëmur dhe vazhdoi në atë gjendje deri në ditën e Arafatit. Babai i tij rrëfen: “As nuk u ankua, as nuk e komentoj sëmundjen dhe as nuk tregoi shenjë padurimi.”.

Më pas u kthye në Damask dhe iu përkushtua me seriozitet të plotë kërkimit të dijes, nën udhëheqjen e shejhut të tij, Kemaludinit.

¹ **Neva** – një qytet (dikur fshat) në Siri, i cili ndodhet 85 km larg kryeqytetit Damask, 40 km nga qyteti i Deraas, dhe vetëm 10 km nga kufiri siriano-palestinez.

PROGRAMI MËSIMOR DHE RUTINA DITORE

Nxënësi i afërt i Imam Neveviut, Alaudin El Attar, ka treguar se imami, *Allahu e mëshiroftë*, kishte një program të përditshëm të jashtë-zakonshëm në kërkimin e dijes. Çdo ditë ai lexonte dhe studionte para mësuesve të tij si më poshtë:

- Dy leksione nga *El Vesit-i* i Imam Gazaliut (në fikhun shafiit);
- Një leksion nga *El Muhedhdheb-i* i Ebu Is'hak Shirazit (po ashtu në fikhun shafiit);
- Një leksion nga *El Lum'a-i* i Ibën El Xhinit, në gramatikë;
- Një leksion nga *El Xhem'u bejne Es Sahihajn-i* në Hadith;
- Një leksion nga *Sahihu El Muslim*;
- Një leksion nga *El Lum'a-i* i Ebu Is'hakut dhe *El Muntehab-i* i Fahrudin Raziut në Usul;
- Një leksion nga *Islah El Mentik-u* i Ibën Es Sikitit në logjikë;
- Një leksion në morfologji (sarf);
- Një leksion në parimet e jurisprudencës islame (Usul El Fikh);
- Një leksion në kritikën e transmetuesve të hadithit (El Xherhu ve Et Taëdilu);
- Dhe një leksion në teologjinë islame (Akaid).

Në fillimet e studimeve të tij, Imami rrëfen: “Njëherë vendosa të merresha me mjekësinë, dhe bleva librin *El Kanun* të Ibën Sinasë. Mirëpo menjëherë pas kësaj, zemra m'u errësua dhe, për disa ditë nuk isha në gjendje të bëja asgjë. Pastaj erdha në vete dhe e shita *Kanunin*, dhe zemra ime u mbush me dritën e kuptimi të thellë (*besira*).”¹.

¹ Ky citim është një pasqyrim i sinqertë i lidhjes së Imam Neveviut me dijen fetare, dhe tregon se zemra e tij ishte e lidhur fort me diturinë e fesë, prandaj çdo gjë që e largonte prej saj e ndiente si një pengesë shpirtërore.

MËSUESIT E TIJ

Imami i nderuar, *Allahu e mëshiroftë*, e mori diturinë prej një numri të madh mësuesish dhe dijetarësh të shquar të kohës së tij. Ndër ta mund t'i përmendim:

- Imam Kemaludin Is'hak bin Ahmed bin Othman El Magribi (v. 650 hixhrij);
- Imam Kemaludin Selar bin El Hasan bin Omer El Irbili (v. 670 hixhrij);
- Imam Shemsudin Abdurrahman bin Nuh bin Muhamed El Makdesi (v. 654 hixhrij);
- Shejh Izudin Omer bin Esad bin Ebi Galib Er Reb'i El Irbili (v. 675 hixhrij);
- Kadi Omer bin Bendar bin Omer Et Teflisi (v. 672 hixhrij);
- Shejh Ibrahim bin Isa El Muradi (v. 668 hixhrij);
- Shejh Radijudin Ibrahim bin Omer bin Mudar El Misri El Vasiti (v. 664 hixhrij);
- Imam Shemsudin Abdurrahman bin Muhamed bin Kudama El Makdisi (v. 882 hixhrij);
- Shejh Imadudin El Ensari Ed Dimeshki bin El Hirstani (v. 662 hixhrij);
- Imam Taxhudin Abdurrahman bin Ibrahim bin Dija El Fizari bin Ferkah (v. 690 hixhrij);
- Imam Shihabudin Abdurrahman bin Ismail Ed Dimeshki Ebi Shameh (v. 665 hixhrij);
- Imam Xhemaludin Ebu Abdullah Muhamed bin Abdullah bin Malik (v. 672 hixhrij);
- Imam Ahmed bin Salim El Misri (v. 664 hixhrij);
- Imam Halid bin Jusuf bin Sead En Nabulsi (v. 663 hixhrij);
- Shejh Ibrahim bin Ali bin Ahmed bin Fadl El Vasiti (v. 692 hixhrij);

- Imam Ahmed bin Abdud Daim El Makdisi (v. 668 hixhrij);
- Imam Ismail bin Ibrahim bin Ebi El Jusr Et Tenuhi (v. 672 hixhrij);
- Imam Abdulaziz bin Muhamed bin Abdulmuhsin El Ensari (v. 662 hixhrij);
- Imam Xhemaludin Jahja bin Ebi Mensur El Hirani Es Sajrefi (v. 678 hixhrij).

Allahu i Lartë qoftë i kënaqur me të gjithë! Allahu vërtet i dhuroi Imam Neveviut bereqet në kohën dhe në jetën e tij, e udhëzoi në dijen e dobishme dhe ia hapi zemrën për kuptimin e thellë të Librit të Tij dhe të Sunetit të të Dërguarit të Tij, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*.

NXËNËSIT E TIJ

Prej Imam Neveviut, *Allahu e mëshiroftë*, kanë marrë dije shumë dijetarë të shquar dhe ruajtës të Hadithit, të cilët më pas e përhapën diturinë e tij në brezat pasues. Ndër nxënësit më të njohur të tij përmenden:

- Kadi Sadrudin Sulejman bin Hilal bin Shibl Ed Darani (v. 725 hixhrij);
- Imam Alaudin Ali bin Ibrahim El Attar (v. 724 hixhrij);
- Imam Xhemaludin Jusuf bin Abdurrahman bin Jusuf El Mizzii (v. 742 hixhrij);
- Kadi Muhamed bin Ebi Bekër bin En Nekib (v. 745 hixhrij);
- Imam Bedrudin Muhamed bin Ibrahim bin Sadullah bin Xhemaah (v. 733 hixhrij);
- Shejh Eminudin Salim bin Ebi Ed Durr (v. 726 hixhrij);
- Imam Shihabudin Ahmed bin Muhamed bin Abas bin Xhavan (v. 682 hixhrij);
- Imam Shemsudin Muhamed bin Ebi El Fet'h El Hanbel (v. 709 hixhrij);

- Shejh Shihabudin Ahmed bin Fereh El Ishbili (v. 699 hixhrij);
- Imam Rashid bin El Mualim El Hanefi (v. 714 hixhrij);
- Imam Alauddin Ali bin Ejub bin Mensur El Makdisi (v. 748 hixhrij);
- Shejh Hibetullah bin Abdurrahim bin Ibrahim bin El Barizi (v. 738 hixhrij).

VEPRAT DHE SHKRIMET E TIJ

Gjatë jetës së tij të shkurtër, por të mbushur me bereqet, Imam Neveviu, *Allahu e mëshiroftë*, arriti të shkruajë rreth pesëdhjetë vepra. Këto vepra, ashtu si vetë autori i tyre, janë ndër thesaret më të çmuara të trashëgimisë islame, si dhe mbartin në vete një begati të dukshme nga ana e Allahut të Madhëruar.

Ato dallohen për thellësinë shkencore, saktësinë metodologjike dhe përkushtimin e singertë në shërbim të dijes islame. Vepra të tilla janë bërë burime themelore për studentët, dijetarët dhe kërkuesit e dijes, veçanërisht në fushat e jurisprudencës (fikhut) dhe të hadithit, ku ndikimi i tij mbetet i gjallë deri në ditët tona.

Më poshtë janë disa nga veprat më të njohura të tij:

1. *El Erbeunen Nevevije* (Dyzet Hadithet e Imam Neveviut)

Një nga përmbledhjet më të njohura të haditheve në botën islame, e përbërë nga dyzet hadithe të shkurtra, por me përmbajtje të thellë, që trajtojnë bazat e fesë islame dhe parimet morale e shpirtërore të jetës së myslimanit. E ndërtuar mbi një traditë pejgamberike, kjo vepër ka fituar pranim të gjerë në të gjithë botën islame për mbi shtatë shekuj, dhe mbetet një pikënisje e vlefshme për kërkuesit e dijes dhe praktikuesit e Islamit.

2. *Rijadus Salihin* (Kopshtet e të mirëve - të singertëve)

Kjo është një nga veprat më të njohura të Imam Neveviut, që përmbledh ajete dhe hadithe autentike mbi moralin islam, jetën shpirtërore dhe sjelljen etike. Përbëhet nga 372 kapituj, të ndarë në 19 libra tematikë. Vepra u përfundua në Ramazan të vitit 670 hixhrij, dhe është ndër më të lexuarat në botën islame deri sot.

3. *El Edhkar* (Lutjet dhe dhikri)

Vepër e jashtëzakonshme, e cila përmbledh 349 kapituj me lutje pejgamberike për çdo gjendje të jetës personale dhe shoqërore të një myslimani. Çdo lutje shoqërohet me zinxhirin e saj të transmetimit, duke përfshirë hadithe sahih, hasen dhe daif. Kjo vepër është unike në llojin e saj, dhe ka mbetur referencë themelore në fushën e adhurimeve dhe të etikës islame.

4. *Sherh Sahih Muslim* (Komentim i Sahihut të Imam Muslimit)

Kjo është një nga komentet më të rëndësishme dhe më të besueshme mbi përmbledhjen e haditheve të Imam Muslimit. E konsideruar si një nga kryeveprat e letërsisë islame, ajo ndërtohet mbi punimet e mëherëshme të dijetarëve si Kadi Ijad dhe El Maziri. Në botimet bashkëkohore, kjo vepër përfshin rreth njëzet vëllime.

5. *El Mexhmuë Sherh El Muhedhdheb* (Komentim i veprës ekciklopedike El Muhedhdheb)

Kjo është kryevepra e papërfunduar e Imam Neveviut në fikhun shafiit. Ibën Kethiri ka thënë: “Nuk njoh ndonjë libër, në të gjithë literaturën e fikhut, që ta tejkalojë këtë.”. Imami ndërroi jetë kur kishte arritur të kapitujt mbi kamatën. Më vonë veprën e vazhdoi Shejhulislami Es Subkiu, dhe sot ajo përfshin rreth tetëmbëdhjetë vëllime.

6. *Minhaxh Et Talibin* (Rruga e kërkuesve të dijes)

Manual klasik i jurisprudencës (*fikhut*), sipas shkollës shafiite, i cili përmbledh me qartësi dhe saktësi mendimet juridike më të forta të kësaj shkolle. Kjo vepër është përdorur për shekuj me radhë si tekst bazë në medresetë shafiite, dhe ka shërbyer si pikë reference për dijetarët e kësaj shkolle.

7. *Bustanu El Arifin* (Kopshti i njohësve të Allahut)

Kjo është një vepër e përkushtuar ndaj dijetarëve, zahidëve dhe njerëzve të devotshëm, ku trajtohen çështje të moralit, vetëpërmirësimit dhe të jetës shpirtërore islame. Imam Neveviu në këtë libër përmbledh fjalë të urta, hadithe dhe mësimet të thella, që synojnë pastrimin e zemrës dhe afrimin me Allahun. Libri mbetet një udhërrëfyes i çmuar për ata që kërkojnë të ecin në rrugën e sinqeritetit dhe të devotshmërisë.

8. *Tehdhibu El Esmā ve El Lughat* (Përpunimi i emrave dhe i dialekteve)

Kjo vepër është një manual referues në katër vëllime, i cili manual përfshin një biografi të shkurtër të Pejgamberit, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, si dhe biografi të shumë personaliteteve nga tre shekujt e parë, përfshirë katër imamët e mëdhenj të medhhebeve. Vepra përmban gjithashtu informacione gjuhësore, leksikore dhe gjeografike.

9. *Et Tibjanu fi Adabi Hameleti El Kurani* (Edukata e bartësve të Kuranit)¹

Ky është një libër i rëndësishëm i Imam Neveviut, i cili trajton me përkushtim adabin (etikën, sjelljen dhe moralin) që duhet të kenë hafizët (ata që e mësojnë përmendsh, e ruajnë dhe e lexojnë Kuranin), nxënësit, studentët dhe mësimdhënësit. Ai përmban udhëzime të hollësishme për respektin ndaj Kuranit, mënyrën e leximit, sjelljen në mjediset e dijes dhe detyrimet morale të bartësve të Librit të Shenjtë.

VDEKJA E IMAM NEVEVIUT

Pas vizitës në Kudsi Sherif dhe në qytetin e Ibrahimit, *paqja qoftë mbi të*, El Khalil në Palestinë, Imam Neveviu u kthye në vendlindjen e tij, në Neva. Atje u sëmur pranë të atit, dhe ndërroi jetë në natën e së mërkurës, më 24 Rexhep të vitit 676 hixhrij (1277 e.s.). U varros në Neva, *Allahu e mëshiroftë*. Varri i tij është i njohur, dhe vizitohet edhe sot e kësaj dite.

Allahu e shpërbleftë Imam Neveviun me shpërblimin më të mirë, dhe na bashkoftë me të, me të dashurit tanë dhe me njerëzit e drejtë në vendbanimin e mirësive. Amin!

¹ Dhe ky është libri që keni në duar.



HYRJE (NGA AUTORI)

Shejhu i nderuar, imami i ditur, dijetari i madh, asketi i përkushtuar dhe i ndershëm, ai që vepronte me përpikëri dhe mjeshtëri, hulumtuesi i palodhur dhe i sinqertë, Muhjedin Ebu Zekerija Jahja bin Sheref bin Murri En Nevevi, *Allahu i Lartë e mëshiroftë*, ka thënë: Falënderimi i qoftë Allahut, Bujarit dhe Fisnikut, Bamirësit të Pafund dhe Zotëruesit të të gjitha mirësive, i Cili na udhëzoi drejt besimit të drejtë dhe e bëri fenë tonë triumfuese mbi të gjitha fetë e tjera! Ai na nderoi duke na e dërguar krijesën më fisnike dhe më të dashur për Të, të përzgjedhurin dhe mikun e Tij, robin dhe të Dërguarin e Tij, Muhamedin, *paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*, përmes të cilit zhduku adhurimin e idhujve dhe ndriçoi rrugën e së vërtetës.

Allahu e nderoi të Dërguarin e Tij, *paqja qoftë mbi të*, me Kuranin famëlartë, një mrekulli e përhershme për çdo kohë dhe brez. Përmes tij Ai i sfidoi të gjithë njerëzit dhe xhindet, dhe e mposhti çdo kundërshtar që devijoi nga udha e drejtë dhe veproi padrejtësisht. Kuranin e bëri pranverë për zemrat e atyre që kanë mendje të ndriçuar dhe zemra të hapura ndaj së vërtetës. Pavarësisht ndryshimeve të kohëve dhe të lëkundjeve të botës, madhështia dhe ëmbëlsia e tij nuk zbehen. Allahu e bëri të lehtë për t'u mësuar përmendsh, aq sa edhe fëmijët e vegjël arrijnë ta mësojnë me lehtësi. Zoti garantoi mbrojtjen e tij nga çdo ndryshim, shtesë apo risi e dëmshme, duke e ruajtur atë të pastër dhe të paprekur për sa kohë do të ekzistojnë dita dhe nata. Allahu zgjodhi prej njerëzve më të zotët, më të devotshmit dhe më të përpiktët për t'u kujdesur për dijet që lidhen me Kuranin. Ata, me përkushtim të jashtëzakonshëm, mblodhën nga çdo fushë të dijes gjithçka që

ushqen zemrat dhe që kënaq shpirtrat e atyre që janë të përkushtuar në kërkimin dhe ruajtjen e diturisë.

Allahun e lavdëroj për këtë dhunti dhe për të gjitha mirësitë e Tij të panumërta, veçanërisht për mirësinë më të madhe: atë të besimit! Gjithashtu, kërkoj prej Tij begati e mëshirë për veten time, për të dashurit e mi dhe për të gjithë myslimanët anembanë botës!

Dëshmoj se nuk ka zot tjetër që meriton adhurim përveç Allahut, që është Një dhe pa ortak.

Kjo është një dëshmi që sjell falje, që e shpëton nga Zjarri këdo që e shpall me zemër të sinqertë dhe që secilin e udhëzon drejt banimit të përhershëm në Xhenet.

Po ashtu dëshmoj se Muhamedi, *paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*, është robi dhe i Dërguari i Allahut, Thirrësi i së Vërtetës dhe udhërrëfyes drejt besimit. Allahu e bekoftë dhe i dhëntë paqe atij, familjes së tij të pastër, shokëve të tij fisnikë, si dhe i nderoftë e i lartësoftë ata përjetësisht!

Le të kalojmë në çështjen thelbësore: Allahu i Madhëruar e ka nderuar këtë umet, *lavdia dhe nderimi i Tij qoftë gjithnjë mbi të*, me fenë që Ai e ka zgjedhur dhe e ka pëlqyer për ta: fenë islame. Ai, xh. sh., e nderoi duke e dërguar te ta Muhamedin, më të dashurin dhe më të zgjedhurin nga të gjitha krijesat e Tij, *paqja, bekimet dhe përshëndetjet më të mira qofshin mbi të*.

I Lartmadhërishmi e nderoi atë me Librin e Tij, fjalën më të mirë, dhe në të përmbloodhi gjithçka që njeriut i nevojitet: tregime për të kaluarit dhe për brezat që do të vijnë, këshilla shpirtërore, shembuj krahasimorë, parime morale, dispozita ligjore, si edhe argumente të qarta e të padiskutueshme që dëshmojnë Njëshmërinë e Tij.

Përveç këtyre, Kurani përmban gjithashtu edhe atë që sollën të dërguarit e Tij, *paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi ta*, si prova të fuqishme kundër mohuesve dhe të devijuarve.

Allahu e ka shumëfishuar shpërblimin për recitimin e Kuranit, na ka urdhëruar t'i kushtojmë vëmendje të veçantë, ta nderojmë dhe ta vlerësojmë me madhështi, të sillemi me edukatë e me përvulësi ndaj tij dhe të përpiqemi me përkushtim për ta lartësuar e për ta nderuar atë.

Rreth vlerës së recitimit të Kuranit, dijetarët më të devotshëm dhe më të shquar kanë shkruar vepra të çmuara, të cilat janë të njohura për njerëzit e ditur dhe për ata me kuptim të thellë. Megjithatë, zelli për t'i ruajtur, madje edhe për t'i lexuar ato, është zbehur, kështu që vetëm ndonjë i kuptueshëm i rrallë përfiton prej tyre.

Unë kam vërejtur se shumë prej banorëve të qytetit tonë, Damaskut, *Allahu i Lartë e mbrojtë dhe e ruajttë atë, ashtu si edhe të gjitha vendet islame*, i kushtojnë vëmendje të veçantë recitimit të Kuranit fisnik. Ata e mësojnë dhe ua mësojnë të tjerëve, e lexojnë dhe e studiojnë, si në mënyrë kolektive, ashtu edhe individualisht. Me përkushtim të vazhdueshëm, ditë e natë, angazhohen në këtë veprim madhështor. *Allahu ua shtoftë dëshirën për këtë dhe për çdo lloj adhurimi të singertë*, duke synuar përmes kësaj kënaqësinë dhe afërsinë e Allahut *dhul xhelal*.

Kjo më shtyu që të përpiloj një trajtesë të shkurtër mbi edukatën (etikën) e duhur që duhet të ndjekin bartësit e Kuranit, si dhe mbi cilësitë që duhet të kenë ata që e mësojnë përmendsh dhe që e studiojnë këtë Libër të shenjtë. Allahu i Lartë e ka bërë të detyrueshëm sinqeritetin ndaj Librit të Tij, dhe një pjesë e këtij sinqeriteti është sqarimi i rregullave të sjelljes për ata që merren me të dhe e studiojnë atë, udhëzimi i tyre në rrugën e drejtë dhe tërheqja e vëmendjes ndaj këtyre normave të larta.

Këtu i jap përparësi përmbledhjes së shkurtër, dhe ruhem nga zgjatja e tepruar. Në çdo kapitull kufizohem në një temë të vetme, që ka të bëjë me etikën, dhe për secilën temë përmend disa nga degët e saj. Shumicën e transmetimeve i përmend pa zinxhirin e plotë të transmetuesve, edhe pse, falë Zotit, i kam në dispozicion. Synimi kryesor është të orientohej lexuesi drejt burimit, dhe përmes asaj që përmendet të nënkuptohet edhe ajo që është lënë pa u përmendur.

Arsyeja e dhënies përparësi ndaj përmbledhjes së shkurtër qëndron në lehtësimin e të mësuarit, përfitimin më të madh nga përmbajtja dhe përhapjen më të gjerë të saj. Emrat e huaj dhe termat e rrallë që shfaqen në kapituj të ndryshëm janë shpjeguar në mënyrë të përmbledhur në kapitullin përfundimtar të librit, i cili është strukturuar sipas renditjes

së tyre në tekst, me pikëzime dhe korrigjime drejtshkrimore. Kjo ua mundëson lexuesve përvetësimin e plotë të librit dhe eliminimin e çdo dyshimi. Përveç kësaj, në atë kapitull¹ përfshihen disa rregulla të rëndësishme dhe shënime të rralla, e të cilat janë edhe në kapitujt përkatës.

Gjithashtu kam treguar se cilat hadithe janë të sakta (sahih) dhe cilat të dobëta (daif), duke përmendur emrat e dijetarëve të besueshëm dhe të njohur që i kanë transmetuar ato. Megjithatë, në disa raste mund të jetë lënë pa u përmendur ndonjë burim, për shkak të harresës apo për shkak të shkurtësisë së qëllimshme në përmbajtje.

Dije se dijetarët e Hadithit dhe të tjerë kanë lejuar përdorimin e haditheve të dobëta në çështjet që lidhen me veprat e mira dhe të virtytshme!² Megjithatë, unë kufizohem vetëm te transmetimet e forta dhe të verifikuara, pa përmendur hadithe të dobëta, përveç në disa raste të veçanta.

Mbështetja dhe besimi im i plotë janë tek Allahu, Bujari dhe i Madhëruari. Atij ia dorëzoj veten time, dhe vetëm tek Ai mbështetem me gjithë qenien time. Vetëm Atë e lus të më udhëzojë në rrugën e drejtë, të më mbrojë prej atyre që kanë devijuar dhe janë kryeneçë, si dhe të më dhurojë vazhdimësinë dhe shtimin e mirësive të Tij!

Me përulësi i lutem Allahut, të Lartit, që të më japë sukses në arritjen e kënaqësisë së Tij; të më bëjë prej atyre që e kanë frikë sinqerisht dhe që e nderojnë ashtu siç i takon Atij; të më drejtojë kah qëllime të pastra

1 Ky kapitull nuk është përkthyer, pasi fokusohet kryesisht në elementë teknikë të drejtshkrimit dhe të vokalizimit të emrave në gjuhën arabe, të cilët nuk kanë aplikim të drejtpërdrejtë në gjuhën shqipe. (Sqarim i përkthyesit)

2 Autori, Allahu e mëshiroftë, ka thënë në librin e tij *El Edhkar* (f. 36): “Dijetarët e Hadithit (muhadithët), juristët (fukahatë) dhe të tjerë kanë thënë se, në çështjet e virtyteve, nxitjes dhe frikësimit, që do të thotë inkurajimi për vepra të mira dhe largimi nga të këqijat, lejohet dhe është e preferuar të veprohet edhe me hadithe të dobëta, përderisa ato nuk janë të shpikura (të trilluara). Ndërsa sa i përket dispozitave fetare, si e lejuara dhe e ndaluara, shitblerja, martesja, divorci dhe çështje të ngjashme, nuk veprohet sipas hadithit, përveç nëse ai është i saktë (sahih) ose i mirë (hasen). Përjashtim bëhet në rastet kur kemi të bëjmë me masë paraprake (ihtijat), me kujdes të veçantë; për shembull, kur vjen një hadith i dobët që tregon se një lloj shitjeje apo martese është e urryer. Atëherë është e preferuar të largohet prej saj, por nuk është obligim.”.

dhe të sinqerta; të ma lehtësojë çdo rrugë të hairit; të më ndihmojë në fitimin e virtyteve të larta dhe të moralit fisni; dhe të ma mundësojë të qëndroj në këtë gjendje deri në çastin e fundit të jetës.


Gjithashtu e lus që këto mirësi t'ua dhurojë edhe të afërmeve të mi, si dhe të gjithë myslimanëve e myslimaneve.

Allahu na mjafton, dhe sa Mbështetës i shkëlqyeshëm është Ai. Nuk ka forcë e as fuqi, përveçse me ndihmën e Allahut, të Lartit, të Plotfuqishmit.


Ky libër përmban kapitujt në vijim:

1. Virtytet e leximit të Kuranit dhe të atyre që e mësojnë atë;
2. Përparësia e leximit të Kuranit dhe vlerësimi i lexuesve të tij;
3. Respektimit i lexuesve të Kuranit dhe ndalimi i ofendimit të tyre;
4. Sjellja e mësuesit dhe e nxënësit të Kuranit;
5. Rregulla etike për nxënësin;
6. Etika e leximit të Kuranit;
7. Etika e të gjithë njerëzve në raport me Kuranin;
8. Kohët dhe situatat e rekomanduara për recitimin e Kuranit;
9. Shkrimi i Kuranit dhe respekti ndaj mus'hafit.

Nga arabishtja: Enes Koshi



KAPITULLI I PARË





VIRTYTET E LEXIMIT TË KURANIT DHE TË ATYRE QË E MËSOJNË ATË

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Pa dyshim se ata që e lexojnë Librin e Allahut, e falin namazin dhe japin fshehtazi apo haptazi nga ajo që ua kemi dhënë Ne, mund të shpresojnë në një fitim që nuk do të humbë. Allahu do t’ua plotësojë atyre shpërblimin, dhe do t’ua shtojë nga dhuntitë e Tij. Me të vërtetë, Ai është Falës dhe Falënderues.”* (El Fatir, 29-30)

Prej Othman bin Afanit, *radijallahu anhu*, transmetohet se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: *“Më i miri prej jush është ai që e mëson Kuranin dhe atë ua mëson të tjerëve.”*¹

Zonja Aishe, *radijallahu anha*, transmeton se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: *“Ai që e lexon Kuranin rrjedhshëm do jetë në shoqërinë e melekëve të nderuar; ndërsa ai që e lexon me vështirësi (sepse nuk i zotëron mirë rregullat) do të ketë dy shpërblime.”*²

Ebu Musa El Esharij, *radijallahu anhu*, transmeton se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: *“Shembulli i besimtarit që e lexon Kuranin është si limoni i madh (Citrus Medica) me aromë dhe shije të mirë, ndërsa besimtarit që nuk e lexon (Kuranin) është si hurma që ka shije të mirë, mirëpo nuk ka aromë. Hipokriti (mynafiku) që e lexon Kuranin është si borziloku që ka aromë të mirë por shije të hidhur, ndërsa hipokriti që nuk e lexon është si kungulli i egër, pa aromë dhe me shije të hidhur.”*³

1 Këtë hadith e ka shënuar Imam Ebu Abdullah Muhamed bin Ismail bin Ibrahim El Buhari, në Sahihun e tij, i cili konsiderohet libri më autentik pas Kuranit famëlartë.

2 Transmetuar prej Buhariut dhe Muslimit.

3 Transmetuar prej Buhariut dhe Muslimit.

Omer bin Hattabi, *radijallahu anhu*, transmeton se Pejgamberi, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Me këtë Kuran Allahu i Madhëruar disa popuj i ngrit, dhe disa i ul (i poshtëron).*”¹

Ebu Uname El Bahili, *radijallahu anhu*, ka thënë se e ka dëgjuar Pejgamberin, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, të thotë: “*Lexojeni Kuranin, sepse ai do të jetë ndërmjetësues për falje në Ditën e Gjykimit për ata që e kanë lexuar!*”²

Abdullah bin Omeri, *radijallahu anhu*, transmeton se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Zilia (e lejuar) ekziston vetëm ndaj dy personave: ndaj atij që Allahu i ka dhënë Kuran dhe ai e lexon ditë e natë; dhe, ndaj atij që Allahu i ka dhënë pasuri dhe ai e shpenzon ditë e natë në rrugën e Allahut.*”³

Në një tjetër version, që transmetohet prej Abdullah bin Mesudit, *radijallahu anhu*, thuhet: “*Zilia lejohet vetëm ndaj dy personave: ndaj atij që Allahu i ka dhënë pasuri dhe ai e shpenzon në rrugën e Allahut; dhe, ndaj atij që Allahu i ka dhënë urtësi (dituri), me të cilën gjykon dhe ua mëson të tjerëve.*”

Gjithashtu, Abdullah bin Mesudi, *radijallahu anhu*, transmeton se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Kush e lexon një shkronjë nga Libri i Allahut, për çdo shkronjë i shkruhet një e mirë (sevap), dhe çdo e mirë shpërblehet dhjetëfish; nuk them se Elif-Lam-Mim është një shkronjë, por Elifi është një shkronjë, Lami është një shkronjë dhe Mimi është një shkronjë.*”⁴

Ebu Seid El Hudrij, *radijallahu anhu*, transmeton se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Zoti i Lartmadhëruar thotë: “Nëse dikujt i largohet përqëndrimi në lutje për shkak të angazhimit me Kuranin dhe përmendjes Sime (dhikrit), Unë do t’i jap më mirë se ajo çfarë u jap atyre që më lusin. Vlera e Kuranit, në krahasim me fjalët e krijesave të tjera, është si vlera e Allahut krahasuar me krijesat e Tij.*”⁵

1 Transmetuar prej Muslimit.

2 Transmetuar prej Muslimit.

3 Transmetuar prej Buhariut dhe Muslimit.

4 Transmetuar prej Tirmidhiut, i cili e ka cilësuar si hadith hasen sahih.

5 Transmetuar prej Tirmidhiut, i cili thotë se është hadith hasen.

Ibën Abbasi, *radijallahu anhu*, transmeton se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “Ai që në zemrën e tij nuk ka asgjë nga Kurani, ai me të vërtetë është si një shtëpi e rrënuar.”¹

Abdullah bin Amër bin Asi, *radijallahu anhu*, transmeton se Pejgamberi, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “I thuhet lexuesit të Kuranit: lexo dhe ngjitu (në shkallët e Xhenetit), lexo siç lexoje në dynja, sepse pozita jote (në Xhenet) do të jetë tek ajeti i fundit që lexon!”²

Muadh bin Enesi, *radijallahu anhu*, transmeton se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “Kush e lexon Kuranin dhe punon sipas tij, prindërve të tij Allahu do t’ua vendosë një kurorë në Ditën e Gjykimit, drita e së cilës është më e bukur se drita e diellit në dynja. E, si do të jetë shpërblimi i atij që vetë ka vepruar me të?!”³

Abdullah bin Mesudi, *radijallahu anhu*, sipas transmetimit të Darimiut, ka thënë se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “Lexojeni Kuranin, sepse Allahu i Madhërishëm nuk e dënon një zemër që është bartëse e Kuranit! Me të vërtetë, Kurani është gostia e Allahut. Kush hyn në të, është i sigurt, dhe kush e do Kuranin, le të gëzohet!”⁴

Abdulhamid Hamani tregon: “Sufjan Thevriun e kam pyetur: “Kush është më i dashur për ty: ai që lufton në rrugë të Allahut, apo ai që lexon Kuran?” Ai u përgjigj: “Ai që lexon Kuran, sepse Pejgamberi, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “Më i miri prej jush është ai që e mëson Kuranin, dhe atë ua mëson të tjerëve.”⁵


1 Transmetuar prej Tirmidhiut, i cili e ka vlerësuar si hadith hasen sahih.

2 Transmetuar prej Ebu Davudit, Tirmidhiut dhe Nesaiut. Tirmidhiu e cilëson si hadith hasen sahih.


3 Transmetuar prej Ebu Davudit.

4 Transmetuar prej Darimiut, në “Musned”, me nr: 3363.

5 Transmetuar prej Buhariut.



KAPITULLI I DYTË





PËRPARËSIA E LEXIMIT TË KURANIT DHE VLERËSIMI I LEXUESVE TË TIJ

Prej Ebu Mesud El Ensari El Bedrijut, *radijallahu anhu*, transmetohet se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Në namaz duhet të prijë ai që e lexon dhe e njeh më së miri Librin e Allahut të Madhëruar.*”¹

Ndërsa, Ibën Abbasi, *radijallahu anhu*, tregon: “Ekspertët e Kuranit (kurratë),²qofshin të moshuar apo të rinj, ishin bashkëbiseduesit dhe këshilltarët e Omerit, *radijallahu anhu*, në mbledhjet e tij.”³

Kjo tregon vlerësimin e lartë që shoqëria islame u jepte bartësve (hafizëve) të Kuranit, si dhe rolin e tyre si udhëheqës në jetën shpirtërore e shoqërore.


Dijetarët kanë rënë dakord se leximi i Kuranit zë një vend më të lartë në adhurim se format e tjera të përmendjes së Allahut, siç janë tesbihi (Subhanallah), tehlili (La ilahe il-Allah) dhe llojet e tjera të dhikrit. Ky qëndrim mbështetet në argumente të qarta nga Kurani dhe Suneti, dhe është më i përzgjedhuri ndër mendimet e dijetarëve të umetit.

Dhe Allahu e di më së miri.


1 Transmetuar prej Muslimit.

2 Me “ekspertët e Kuranit (kurratë)” nënkuptohen ata persona që e lexojnë Kuranin në mënyrë të bukur dhe të saktë, që i njohin mirë rregullat e leximit (texhvidin), kuptimet dhe dispozitat e tij. Ata janë të pajisur me dije, përkushtim dhe respekt të thellë ndaj fjalës së Allahut. (Sqarim i përkthyesit)

3 Transmetuar prej Buhariut.



KAPITULLI I TRETË





RESPEKTIMI I LEXUESVE TË KURANIT DHE NDALIMI I OFENDIMIT TË TYRE

Allahu i Madhërishëm, në Librin e Tij të Shenjtë, na urdhëron që të tregojmë respekt dhe nderim për shenjat e fesë dhe për ata që janë të lidhur me to. Ai thotë: **“Kush i madhëron shenjat e Allahut, kjo është nga devotshmëria e zemrës.”** (El Haxh, 32)

Gjithashtu, Zoti i Lartë thotë: **“Kush i madhëron ritet e shenjta të Allahut, kjo është më e mira për të te Zoti i tij.”** (El Haxh, 30).

Në një tjetër ajet, Allahu i drejtohet të Dërguarit të Tij, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, me këto fjalë: **“Me besimtarët të jesh modest...!”** (El Hixhër, 88)

Ndërsa, për ndalimin e fyerjes dhe ofendimit të besimtarëve, Zoti i Madhëruar paralajmëron: **“Ata që i lëndojnë besimtarët dhe besimtarët, duke i akuzuar për atë që nuk e kanë bërë, ata kanë marrë mbi vete një shpifje dhe një mëkat të madh.”** (El Ahzab, 58)

Transmetimet e Ibën Mesud Ensariut dhe Ibën Abbasit, *radijallahu anhum*, në lidhje me këtë temë, i kemi përmendur në kapitullin e dytë.

Ndërsa, Ebu Musa El Eshariu, *radijallahu anhu*, transmeton se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: *“Pjesë e madhërimit të Allahut është të tregosh respekt ndaj një myslimani të moshuar, ndaj bartësit të Kuranit që nuk e tepron e as nuk e lë pas dore (pra, i përmbahet Kuranit me maturi), dhe ndaj udhëheqësit të drejtë.”*¹

1 Transmetuar prej Ebu Davudit; hadith hasen.

Po ashtu, zonja Aishe, *radijallahu anha*, ka thënë: “I Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, na ka urdhëruar që t’ua japim njerëzve vendin që u takon.”¹

Xhabir bin Abdullahu, *radijallahu anhu*, tregon: “Në ditën e Uhudit, kur po i varrosnin dëshmorët nga dy ose më shumë në një varr të përbashkët, i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, pyeste: “*Cili prej tyre e dinte më shumë Kuranin?*” Kur ia tregonin, atë e vendoste të parin në varr.”²

Gjithashtu, Ebu Hurejra, *radijallahu anhu*, transmeton se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë, se Allahu i Madhërishëm ka thënë: “***Unë i kam shpallur luftë atij që e armiqëson ndonjë mik Timin.***”³

Pejgamberi, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Kush e fal namazin e sabahut, është nën mbrojtjen e Allahut. Mos le të guxojë askush ta cenojë këtë mbrojtje (duke i bërë keq atij njeriu), sepse kush guxon ta shkel atë, Allahu do t’i këkojë llogari dhe do ta hedhë me fytyrë në zjarrin e Xhehenemit!*”⁴

Dy imamët e mëdhenj, Ebu Hanifja dhe Imam Shafi'u, *Allahu i mëshioftë*, kanë thënë: “Nëse dijetarët nuk janë evlijatë (të dashurit) e Allahut, atëherë Allahu nuk ka evlija.”

Ndërsa, Imam El Hafidh Ebu El Kasim bin Asakiri, *Allahu e mëshiroftë*, ka thënë: “Dije, o vëllai im, *Allahu ty dhe mua na dhëntë sukses në arritjen e kënaqësisë së Tij dhe na bëftë prej atyre që i frikësohen Atij me të drejtë, se mishi i dijetarëve (ulemave) është i helmuar, dhe është ligj i Allahut që t’i shqyejë perdet e atyre që i përbuzin (dijetarët), dhe kjo është e ditur. Kush guxon t’i përgojë apo t’i nënçmojë dijetarët, Allahu e turpëron dhe e ndëshkon me ngurtësimin e zemrës para se të vdesë.”*


Allahu i Madhërishëm thotë në Kuran: “***Le të ruhen ata që e kundërshtojnë urdhrin e tij (të Pejgamberit), që mos t’i godasë ndonjë sprovë ose ndonjë dënim i dhembshëm!***” (En Nur, 63)

1 Ebu Davudi e përcjell në *Sunenin* e tij, si dhe Bezzari në *Musnedin* e tij. Hakim bin Abdullah, në veprën *Ulumu El Hadith*, e vlerëson si hadith sahih.


2 Transmetuar prej Buhariut.

3 Transmetuar prej Buhariut.

4 Transmetuar prej Muslimit.



KAPITULLI I KATËRT





SJELLJA E MËSUESIT DHE E NXËNËSIT TË KURANIT

Ky kapitull, së bashku me dy pasuesit, përbëjnë thelbin dhe qëllimin kryesor të këtij libri. Për shkak të gjatësisë dhe gjerësisë së temës, e kam përmbledhur dhe ndarë në nënkapituj të vegjël, në mënyrë që të jetë më i lehtë për lexim, mësim dhe memorizim.

Gjëja e parë dhe më e rëndësishme që duhet të ketë parasysh, si mësuesi ashtu edhe nxënësi i Kuranit, është që ta mësojnë dhe ta studiojnë atë vetëm për hir të kënaqësisë së Allahut të Madhëruar, dhe jo për famë, pozitë apo përfitime materiale.

Allahu i Lartë thotë në Kuranin famëlartë: ***“E, megjithatë atyre u ishte urdhëruar vetëm që ta adhurojnë Allahun sinqerisht, duke qenë të përkushtuar ndaj Tij në fenë e pastër (të Ibrahimit), të falin namazin dhe të japin zekatin. Kjo është feja e drejtë.”*** (El Bejjine, 5)

I Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: *“Veprat vlejné sipas qëllimit, dhe secilit njeri i takon ajo që ka pasur për qëllim.”*¹

Ky hadith përmban një nga themelet kryesore të fesë islame, e ky është sinqeriteti.

Prej Ibën Abbasit, *radijallahu anhum*a, transmetohet se ka thënë: “Njeriu mbrohet (nga ana e melekëve) aq sa e ka të pastër qëllimin e tij.”

Dikush tjetër ka thënë: “Mirësitë u jepen njerëzve sipas pastërtisë dhe madhështisë së qëllimeve të tyre.”

¹ Transmetuar prej Buhariut dhe Muslimit.

Prej Ebu El Kasim El Kushejriut¹, *Allahu e mëshiroftë*, është përcjellë: “Sinqeriteti është njësimi i Allahut të Lartë në bindje, duke kërkuar me veprën tënde vetëm afërsinë dhe kënaqësinë e Tij, e jo lavdërimin e njerëzve apo ndonjë përfitim tjetër.”

Ai gjithashtu ka thënë: “Sinqeriteti është pastrimi i veprës nga vështirimet e njerëzve.”

Hudhejfe El Merashi², *Allahu e mëshiroftë*, ka thënë: “Njeri i sinqertë është ai që veprat e tij janë të njëjta si në publik, ashtu edhe në vetmi.”

Dhennun El Misri³, *Allahu e mëshiroftë*, ka thënë: “Shenjat e sinqeritetit janë tri:

1. Të jenë njësoj për ty lëvdata dhe qortimi prej njerëzve;
2. Të harrosh veprën e mirë që ke bërë dhe mos të mendosh për shpërblimin që të takon në ahiret;
3. Të përkushtohesh vazhdimisht në vepra të mira, duke qenë i bindur se Allahu nuk do ta humbë shpërblimin e askujt në botën tjetër.”

Fudajl bin Ijadi⁴, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ka thënë: “Të heqësh dorë nga një vepër për shkak të njerëzve është syfaqësi (rija), ta veprosh për hatër të njerëzve është idhujtari (shirk), ndërsa sinqeriteti është kur Allahu të ruan prej të dyjave.”

1 Ebu El Kasim El Kushejri ishte një ndër dijetarët më të shquar të Horasanit në kohën e tij. Ai ishte jurist sipas medhhebit shafi, sufi i njohur, komentues i Kuranit (mufessir), teolog (mutekelim) dhe vaiz. Ai ka lindur në vitin 376 hixhrij, ndërsa ka ndërruar jetë në vitin 465 hixhrij, në qytetin Nejsabur.

2 Hudhejfe bin Katade El Merashi ishte njëri prej nxënësve dhe shoqëruesve të ngushtë të dijetarit të madh Sufjan Thevriut, prej të cilit ka transmetuar shumë thënie.

3 Emri i tij i plotë është: *Theuban bin Ibrahim El Ihmimi El Misri*, i njohur edhe si Ebu El Fejjad. Ky ka qenë një abid (adhurues) dhe zahid (asket) i njohur i kohës së tij, ndërsa ka ndërruar jetë në Gizë të Egjiptit, në vitin 245 hixhrij.

4 Emri i tij i plotë është: *Fudajl bin Ijad bin Mesud Et Temimi El Xherbui El Horasani*, i njohur gjithashtu si Ebu Ali. Ai ka lindur në Samarkand, në vitin 105 hixhrij, ndërsa ka qenë një dijetar i njohur për devotshmërinë dhe përkushtimin e tij, si dhe një transmetues i besueshëm i haditheve. Ndër dijetarët që kanë marrë dije prej tij është edhe Imam Shafiu, *Allahu e mëshiroftë*.

Sehl Et Tusteri¹, *Allahu e mëshiroftë*, ka thënë: “Të mençurit janë përpjekur ta shpjegojnë singeritetin dhe nuk kanë gjetur përkufizim më të plotë se ky: “Që lëvizjet dhe veprimet e njeriut, si në vetmi ashtu edhe në prani të të tjerëve, të jenë vetëm për Allahun e Plotfuqishëm, pa ndërhyrë në to epshi, lakmia apo dynjaja.”

Serrij², *Allahu e mëshiroftë*, ka thënë: “Mos bëj asgjë për hatër të njerëzve, mos lër asgjë për hatër të tyre, dhe as mos fshih apo zbulo diçka për shkak të tyre!”

Imam El Kushejri, *Allahu e mëshiroftë*, ka thënë: “Shkalla më e ulët e singeritetit është kur veprat e tua në fshehtësi dhe në publik janë të njëjta.”

Harith El Muhasibiu, *Allahu e mëshiroftë*, ka thënë: “I sinqertë është ai që nuk dëshiron që njerëzit t’i shohin veprat e tij të mira dhe që nuk shqetësohet kur zbulohet ndonjë e metë në to. Nëse shqetësohet, kjo është shenjë se ai po përpiqet më shumë për kënaqësinë e njerëzve sesa për kënaqësinë e Allahut, e kjo nuk është morali i të sinqertëve.”

Disa kanë thënë: “Nëse ia kërkon Allahut singeritetin, Ai do të ta dhurojë një pasqyrë përmes së cilës do të mund t’i shohësh mrekullitë e kësaj bote dhe të botës tjetër.”

Thëniet e dijetarëve të gjeneratës së parë (selefëve) rreth kësaj teme janë të shumta dhe me vlerë të madhe për çdo mësues dhe nxënës të Kuranit. Disa prej tyre i kemi përmendur dhe shpjeguar më gjërësisht në veprën *Sherhu El Muhedheb*.

Me leximin dhe studimin e Kuranit nuk është e denjë të synohen përfitime të kësaj bote, si: pasuria, pozitat drejtuese, prestigji shoqëror, ngritja mbi të tjerët, kërkimi i lavdërimeve apo tërheqja e vëmendjes

1 Emri i tij i plotë është Sehl bin Abdullah bin Junus bin Isa Et Tusteri. Ai ishte një dijetar i shquar, sufi dhe mutekelim (teolog). Ka lindur në qytetin Tuster në vitin 203 hixhrij dhe ka ndërruar jetë në Basra në vitin 283 hixhrij.

2 Emri i tij i plotë është Serrij bin Mugalis Es Sekati, i njohur me nofkën Ebu El Hasan. Ai ishte një nga sufijtë më të shquar të kohës së tij, i njohur për devotshmërinë, diturinë dhe përkushtimin shpirtëror. Ka lindur dhe ka ndërruar jetë në Bagdad. Ai ishte gjithashtu daja dhe mësuesi i njohur i Xhunejd El Bagdadiut, një prej figurave më të mëdha të sufizmit klasik, dhe ka pasur ndikim të madh në formimin e tij shpirtëror.

së njerëzve. Lexuesi i Kuranit duhet të jetë larg çdo lloj lakmie. Nuk i lejohet që, për shkak të leximit të tij, të kërkojë shpërblim material, favore, dhurata apo ndonjë përfitim tjetër që nuk do t'i ishte dhënë po që se nuk do të ishte për leximin e Kuranit. Qëllimi i tij duhet të jetë vetëm kënaqësia e Allahut dhe kërkimi i afërsisë me Të. Kjo është shenja e sinjeritetit të vërtetë dhe nderimi i vërtetë ndaj fjalës së Zotit.

Allahu i Madhërishëm thotë në Librin e Tij të lartë: ***“Atij që dëshiron vetëm shpërblimin e kësaj jete, Ne do t’i japim një pjesë nga ajo, por ai nuk do të ketë pjesë në botën tjetër.”*** (Esh Shura, 20)

Dhe thotë: ***“Atij që e dëshiron vetëm këtë jetë, Ne do t’i japim prej saj sa të duam dhe kujt të duam.”*** (El Isra, 18)

Ebu Hurejra, *radijallahu anhu*, përcjell se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: *“Kush e mëson një dituri që zakonisht mësohet për të kërkuar kënaqësinë e Allahut, mirëpo ai e mëson për të arritur ndonjë qëllim të kësaj bote, nuk do ta ndiejë aromën e Xhenetit në Ditën e Kijametit.”*¹

Hadithe me përmbajtje të ngjashme janë të shumta.

Enesi, Hudhejfe dhe Kab bin Maliku, *radijallahu anhum*, përcjellin se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: *“Kush kërkon dituri me qëllim që të debatojë me mendjelehtët, të garojë me dijetarët, apo të tërheqë vëmendjen ndaj vetes, le ta përgatitë vendin e tij në Zjarr!”*²

Në një transmetim tjetër të Kab bin Malikut thuhet: *“Allahu do ta futë në Zjarr.”*

Këto paralajmërime të rënda janë një kujtesë serioze për çdo mësues të dijes, në veçanti për ata që e mësojnë Kuranin. Ata duhet ta kenë qëllimin të pastër dhe të jenë sinjerisht të drejtuar drejt kënaqësisë së Allahut. Mësuesi nuk duhet të kërkojë famë, të mburret me numrin e madh të nxënësve që e ndjekin apo të ketë zili për ata që mësojnë edhe te dijetarët e tjerë. Fatkeqësisht, disa prej atyre që nuk kanë njohuri të thellë dhe janë të cekët në besim, sprovohen pikërisht me

1 Transmetuar prej Ebu Davudit, me zinxhir të saktë.

2 Transmetuar prej Tirmidhiut.

këtë sëmundje të zemrës, e cila është tregues i qartë i prishjes së nijetit (qëllimit). Po të kishte qenë qëllimi i tyre kënaqësia e Allahut, ata kurrë nuk do të ndienin smirë, përkundrazi, do të gëzoheshin për çdo të mirë që përhapet, qoftë edhe përmes të tjerëve.

Imam Darimiu, *Allahu e mëshiroftë*, transmeton në *Musnedin* e tij, prej Ali bin Ebi Talibit, *radijallahu anhu*, i cili ka thënë: “O bartës të Kuranit (ose ka thënë: O bartës të dijes), veproni sipas dijes suaj, sepse dituria e vërtetë është ajo që shoqërohet me vepra, dhe vepra e drejtë është ajo që buron nga dituria! Së shpejti do të shfaqen njerëz, dituria e të cilëve nuk do të kalojë përtej fytit të tyre (nuk do të depërtojnë në zemrat e tyre). Veprat e tyre nuk do të përputhen me atë që dinë, ndërsa çfarë fshehin në brendësi do të jetë ndryshe nga ajo që shfaqin në publik. Ata do të ndahen në grupe, duke u lavdëruar mes vete, aq sa ndonjërit prej tyre nuk do t’i pëlqejë që shoku i tij të ndjekë dikë tjetër përveç tij. Këta njerëz janë ata që veprat e tyre nuk do të ngjiten nga ato mexhlise drejt Allahut.”

Prej Imam Shafiut, *Allahu e mëshiroftë*, është transmetuar saktësisht se ka thënë: “Sa shumë do të dëshiroja që njerëzit ta mësonin këtë dituri, pa mu atribuuar mua asgjë prej saj!”

Kjo thënie pasqyron thellësinë e sinqeritetit që duhet të ketë çdo mësues i dijes fetare, veçanërisht ai që e mëson Kuranin.

Mësuesi duhet të jetë i pajisur me cilësi të larta morale dhe virtyte të lavdëruara, të cilat feja i nxit dhe i çmon, si:

- largimi nga dynjaja dhe moslakmia ndaj pasurive të kësaj bote,
- bujaria, fisnikëria, zemërgjerësia,
- sjellja e përmbajtur dhe qëndrueshmëria në karakter,
- devotshmëria, përvullësia dhe modestia,
- buzëqeshja e vazhdueshme, butësia dhe durim ndaj nxënësve dhe njerëzve në përgjithësi.

Ai duhet t’i shmanget të qeshurës së tepërt dhe shakave të panevojshme, të cilat mund të ndikojnë në madhështinë e dijes që përfaqëson. Gjithashtu, mësuesi duhet të jetë shembull në pastërtinë fizike dhe shpirtërore, duke përfshirë:

- shkurtimin e mustaqeve,
- prerjen e thonjve,
- kujdesin ndaj mjekrës (nëse ka),
- përdorimin e aromave të këndshme dhe shmangien e erërave të pakëndshme apo të veshjeve të papastra.

Mësuesi duhet të jetë i vëmendshëm ndaj sëmundjeve të zemrës, si:

- smira,
- syfaqësia, vetëpëlqimi
- dhe, nënçmimi i të tjerëve, qofshin ata edhe më pak të ditur apo me pozitë më të ulët se ai.

Prej mësuesit kërkohet që të jetë i pëkushtuar në adhurime, si:

- tesbihi,
- tehlili,
- lutjet dhe përmendja e Allahut,
- ruajtja nga mëkatet në fshehtësi dhe në publik,
- dhe, në çdo çështje të mbështetet vetëm tek Allahu i Lartë.

Mësuesi duhet të jetë i sjellshëm, i dashur dhe i butë me nxënësit e tij. Prej Ebu Harun El Abdij transmetohet se ka thënë: “Kur e vizitonim Ebu Seid El Hudriun, ai na priste duke thënë: “Mirë se erdhët! Do t’jua tregoj porosinë e të Dërguarit të Allahut *sal-lAllahu alejhi ve selem*. Ai ka thënë: “Njerëzit vërtet do t’ju pasojnë ju. E, kur ata të vijnë nga anë të ndryshme të botës për ta mësuar fenë, silluni me ta me mirësjellje dhe dashuri!” Ngjashëm transmetohet edhe prej Ebu Derdasë, *radijallahu anhu*, në Musnedin e Darimiut.

Mësuesi duhet të jetë gjithmonë i gatshëm t’u japë këshilla nxënësve të tij, sepse i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Feja është këshillë: për Allahun, për Librin e Tij, për të Dërguarin e Tij, për udhëheqësit e myslimanëve dhe për masën e gjerë të tyre.*”¹

Këshillimi për Allahun dhe Librin e Tij përfshin gjithashtu edhe respektimin e lexuesit dhe të studiuesit të Kuranit. Mësuesi duhet ta

¹ Transmetuar prej Muslimit.

udhëzotë nxënësin drejt veprave të mira, të sillet me butësi dhe dashamirësi ndaj tij, të ofrojë ndihmë sipas mundësive dhe të përpiqet të fitojë zemrën e tij. Ai duhet të jetë i duruar dhe i kujdesshëm gjatë mësimdhënies, të inkurajojë nxënësin për mësim dhe ta motivojë për të ecur përpara në rrugën e dijes. Herë pas here, mësuesi duhet t'ia përkujtojë rëndësinë dhe vlerën e diturisë, në mënyrë që të zgjojë te nxënësi dëshirën dhe vullnetin për të mësuar. Duhet ta këshillojë që mos ta lidhë zemrën me dynjanë, por që të largohet nga çdo gjë e pavlerë dhe e padobishme, e cila mund ta shpërqëndrojë nga mësimi, leximi dhe përkushtimi ndaj diturisë.

Mësuesi gjithashtu duhet t'ia përkujtojë nxënësit se angazhimi me mësimin e Kuranit dhe shkencave fetare është ndër veprat më fisnike dhe ndër rrugët më të ndritshme që mund të ndjekë njeriu. Kjo është rruga e njerëzve të mirë, shkalla e dijetarëve dhe grada e pejgamberëve të Allahut, *paqja qoftë mbi ta*.

Mësuesi duhet të tregojë dhembshuri dhe mëshirë ndaj nxënësve të tij, ashtu siç sillet me fëmijët e vet. Ai duhet të kujdeset për përmirësimin e gjendjes së tyre, sikurse kujdeset për veten dhe për familjen e vet. Duhet të jetë i durueshëm ndaj sjelljeve të pahijshme apo gabimeve të nxënësve dhe, herë pas here, ta arsyetojë mungesën e edukatës së tyre, duke kuptuar se çdo njeri gabon, ka mangësi dhe të meta, e sidomos të rinjtë, të cilët janë në fazën e formimit dhe të zhvillimit të karakterit. Mësuesi duhet t'i dëshirojë nxënësit të tij atë që ia dëshiron vetes, dhe mos të pajtohet për të për diçka që nuk do ta pranonte për veten. Në këtë frymë, Imam Buhariu dhe Muslimi transmetojnë se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Askush prej jush nuk e ka plotësuar besimin derisa ta dojë për vëllanë e vet atë që e do për veten.*”

Ky parim i lartë etik e obligon mësuesin të jetë jo vetëm udhëheqës i dijes, por edhe shembull i dashurisë, i durimit dhe i edukimit të zemrës.

Prej Abdullah bin Abbasit, *radijallahu anhu*, transmetohet se ka thënë: “Njeriu (nxënësi) më i dashur për mua është ai që i tejkalon të tjerët për të ardhur e për t'u ulur pranë meje. Po të kisha mundësi ta mbroja edhe nga mizat që e shqetësojnë, do ta bëja.”

Në një transmetim tjetër thuhet: “Nëse mizat do të ndaleshin tek ai, do të më shqetësonin!”

Kjo tregon dashurinë dhe përkujdesjen e veçantë që dijetarët dhe mësuesit e vërtetë kanë pasur për nxënësit e tyre.

Prandaj, mësuesi nuk duhet të sillet me mendjemadhësi e arrogancë ndaj nxënësve, por të qëndrojë i thjeshtë, i përlur e modest. Për vlerën e kësaj cilësie janë transmetuar shumë thënie të sakta, të rrënjësura thellë në traditën islame. E si të mos jetë modest mësuesi para nxënësve të vet, kur ata, në thelb, janë në pozitën e fëmijëve të tij?

Pejgamberi, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Jini të butë me ata që i mësoni dhe me ata prej të cilëve mësoni!*”¹

Kjo porosi pejgamberike është udhërrëfyes për të gjithë ata që janë në fushën e dijes dhe të edukimit, që të kultivojnë butësinë, respektin dhe dashurinë në raportin mësues-nxënës.

Ejub Sehtijaniu, *Allahu e mëshiroftë*, ka thënë: “Dijetari duhet të vendosë dhe mbi kokën e tij, në shenjë përlulësie dhe modestie ndaj Allahut të Madhëruar!”

Mësuesi e ka për detyrë ta edukojë nxënësin me një edukatë të bukur dhe të qëndrueshme, në mënyrë graduale dhe të mençur. Ai duhet t’ia mësojë virtytet e larta dhe cilësitë e mira, ta këshillojë që të vëzhgojë dhe t’i përmirësojë si sjelljet e jashtme, ashtu edhe gjendjen e brendshme.

Mësuesi duhet ta nxitë nxënësin të jetë i sinqertë në fjalë dhe në vepra, duke ia përkujtuar gjithmonë se Allahu i Madhëruar e vëzhgon në çdo çast. Duhet t’ia bëjë të qartë se përmes dijes do t’i hapen dyert e njohurive, do t’i zgjerohet gjoksi, dhe prej zemrës së tij do të burojnë urtësia dhe dituria. Në këtë mënyrë ai do ta shijojë bereqetin e dijes dhe përmirësimin e gjendjes së tij shpirtërore, si dhe do të ketë sukses në fjalë dhe në vepra.

Edukimi dhe arsimimi i nxënësve është obligim kolektiv (*farz kifaje*). Nëse askush nuk e merr përsipër këtë detyrë, të gjithë janë

1 Këtë transmetim e kanë përmendur Hatib El Bagdadi, në veprën e tij *El Fikhu ve El Mutefekih*, dhe Dejemliu, në *El Firdevs*.

përgjegjës dhe mëkatarë. Mirëpo, nëse një pjesë e mjaftueshme e njerëzve e kryejnë këtë detyrë, atëherë përgjegjësia bie prej të tjerëve.

Nëse dikujt i kërkohet të angazhohet në mësimdhënie dhe ai e refuzon, nuk është mëkatar, por një veprim i tillë është i urryer (*mekruh*), përveç nëse ka arsye të justifikueshme.

Për mësuesin preferohet që t'i favorizojë nxënësit dhe mësimin e tyre ndaj interesave të tij të dynjasë, të cilat nuk i ka të domosdoshme. Gjatë orëve të mësimi ai duhet të mbetet i fokusuar dhe i distancuar nga çdo gjë që ia shpërqëndron vëmendjen nga mësimi. Njohuritë duhet t'ua transmetojë nxënësve sipas kapaciteteve të tyre: ata që kanë vështirësi të kuptojnë, nuk duhet të ngarkohen shumë, ndërsa ata që kanë potencial të lartë për të mësuar, nuk bënë t'i lërë me pak. Gjithashtu, është e rëndësishme që, kohë pas kohe, mësuesi të bëjë përsëritje, për të verifikuar nëse nxënësit e mbajnë mend dhe e kuptojnë mësimin që kanë marrë më herët.

Nxënësin e talentuar dhe të suksesshëm duhet ta lavdërojë, por vetëm nëse mësuesi është i sigurtë se kjo lëvdatë nuk shkakton tek ai shenja të mendjemadhësisë. Ndërsa nxënësi që tregon rezultate më të dobëta duhet të qortohet, por jo në mënyrë të ashpër, sepse një reagim i tillë mund të çojë në largimin dhe humbjen e interesit të tij për mësimin. Mësuesi nuk duhet të ndiejë zili ndaj nxënësve të tij, edhe nëse ata tregojnë aftësi dhe zgjuarsiri të jashtëzakonshme. Nëse zilia ndalohet rreptësisht ndaj të huajve, si mund të lejohet ajo ndaj nxënësve, për të cilët mësuesi është, në njëfarë mënyre, si prindi i dytë? Gjithashtu, si mund të ketë smirë ndaj nxënësit, kur mësuesi, për shkak të mësimi dhe edukimit që ofron, meriton shpërblim në ahiret dhe falënderimin dhe respektin në këtë botë?

Gjatë mësimi, mësuesi duhet t'i japë përparësi nxënësit që ka ardhur më herët, dhe jo atij që ka mbërritur më vonë, përveç në rastin kur nxënësi që ka ardhur i pari vendos të japë përparësi atij që është vonuar. Mësuesi duhet të shfaqet para nxënësve me një fytyrë të qeshur dhe miqësore, të tregojë vëmendje dhe interes për ta, dhe t'i pyesë ata kur mungojnë nga mësimi.

Dijetarët thonë: “Nuk duhet të pengohet nga mësimi ai që nuk e ka nijetin (qëllimin) e mirë!” Sufjan Thevriu dhe të tjerë kanë theksuar: “Vetëm përpjekja e tyre për të kërkuar dituri konsiderohet nijet.” Disa

dijetarë kanë thënë: “E kërkuam diturinë jo për hir të Allahut, por dija nuk pranoi të kërkohej përveçse për hir të Allahut!” Kjo tregon se, edhe nëse në fillim kërkuesi i diturisë nuk kishte një nijet të pastër, më vonë ai arriti që ta shndërrojë atë në një nijet të pastër dhe të sinqertë.

Gjatë mësimdhënies, mësuesi duhet të ketë kujdes ndaj disa aspekteve të rëndësishme:

- Mos të luajë shumë me duar,
- Mos të shikojë rreth e rrotull pa nevojë,
- Të jetë me abdes dhe i orientuar drejt Kibles,
- Të ulet në mënyrë të hijshme dhe me edep (edukatë),
- Të ketë veshje të pastra dhe të bardha,¹
- Kur të arrijë në vendin e mësimdhënies,² t’i falë dy rekate namaz nafile para se të ulet, pasi është mekruh të ulet para se t’i falë dy rekate namaz,
- Të ulet siç i ka hije, mundësisht këmbëkryq, por mund ta bëjë si të dëshirojë.

Prej Ebu Bekër bin Ebi Davud Sexhistani transmetohet se Abdullah bin Mesudi, *radijallahu anhu*, ligjëronte në xhami duke qenë në gjunjë.

Po ashtu, një pjesë e edukatës së mësuesit është që të mos nënçmojë diturinë duke shkuar nëpër shtëpitë e njerëzve për t’u mësuar atyre, madje edhe nëse ai që e fton është kalif apo dikush që ndodhet në një pozitë të lartë. Mësuesi duhet ta ruajë dijen dhe autoritetin e saj, ashtu siç e ruajtën të parët tanë, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*. Tregimet e tyre për këtë janë të shumta dhe të njohura.

Po ashtu, hapësira ku zhvillohet mësimi (klasa, xhamia, dhoma etj.) duhet të jetë e mjaftueshme për t’i strehuar të gjithë nxënësit. Në një hadith, Pejgamberi, *sal-la-llahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Mexhliet më të mira janë ato më të gjërat.*”³

1 Veshje që ju kanë hije burrave, që nuk kanë ngjashmëri me ato të femrave, jo të shkurta, as të ngushta, por as me veshje të gjumit apo të pishinës – plotësim i redaktorit.

2 Autori i referohet xhamisë, pasi në të kaluarën mësimi shpesh është zhvilluar nëpër xhami - sqarim i përkthyesit.

3 Ebu Davudi e shënon, me sened autentik, sipas transmetimit të Ebu Seid El Hudriut,



RREGULLA ETIKE PËR NXËNËSIN

Çdo rregull që kemi përmendur për mësuesin në fillim të kapitullit të kaluar, vlen gjithashtu edhe për nxënësin. Nga rregullat e kodit të etikës që duhet t'i kushtojë rëndësi nxënësi janë këto:

- Të shmangët nga çdo gjë që mund ta largojë nga mësimi, përveç kur ka arsye të forta dhe të domosdoshme.
- Ta pastrojë zemrën nga papastërtitë, në mënyrë që të jetë i gatshëm për ta pranuar Kuranin, për ta memorizuar atë dhe për t'i kuptuar domethëniet dhe mësimet e tij.

I Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, është vërtetuar se ka thënë: “*Vini re, në trup është një copë mishi, e cila po që e shëndoshë, i shëndoshë është i gjithë trupi, dhe nëse priset, priset i gjithë trupi; ajo është zemra.*”¹

Sa bukur ka thënë dikush: “Zemra përgatitet për dituri ashtu sikurse toka që përgatitet për mbjellje.”

- Nxënësi duhet të tregojë modesti, sjellje të mirë dhe edukatë të duhur ndaj mësuesit të tij, edhe nëse mësuesi është më i ri në moshë ose ka më pak famë se ai dhe familja e tij. Ai duhet të sillet me thjeshtësi dhe respekt ndaj ditorisë dhe dijetarit, sepse kushdo që është i thjeshtë, do të mund të përfitojë nga dituria. Ka një thënie që thotë: “Dituria është shkatërrim për djaloshin kryelartë, ashtu sikurse përmbytjet që e shkatërrojnë një vend të lartë.”

radijallahu anhu.

¹ Transmetuar prej Buhariut dhe Muslimit.

- Nxënësi duhet ta kuptojë njëherë e përgjithmonë se diturinë do ta përvetësojë vetëm atëherë kur të tregohet i përlurur dhe i respektueshëm ndaj mësuesit të tij. Ai duhet t'i nënshtrohet mësuesit, të konsultohet me të për çdo çështje dhe ta pranojë mendimin e tij, ashtu sikurse një i sëmurë që e pranon këshillën e mjekut.
- Nxënësi duhet të zgjedhë për mësues vetëm atë që është i pjekur dhe i kompletuar, i njohur për devotshmërinë dhe moralin e tij të lartë. Siç kanë thënë Muhamed bin Sirini, Malik bin Enesi dhe disa prej të parëve tanë: “Dituria vërtet është fe, prandaj tregoni kujdes nga kush e merrni fenë tuaj!”
- Nga edukata e studentit me mësuesin e tij është ta shikojë atë me respekt dhe të besojë se ai është i denjë për pozitën që mban, se është më i miri ndër bashkëkohësit e tij dhe se është njeriu i duhur prej të cilit duhet të përfitojë dije. Ndër të parët ka pasur të atillë që, para se të shkonin në mësim te mësuesi i tyre, ndanin sadaka dhe thoshin: “O Zoti im, mbulo të metat e mësuesit tonë, dhe mos e ndalo bereqetin e dijes së tij ndaj nesh!”
- Rebiu, nxënësi i Imam Shafiut, ka thënë: “Pasha Allahun, nuk kam guxuar asnjëherë të pi ujë ndërkohë që Imam Shafiu më shikonte, për shkak të autoritetit të madh që ai kishte.”
- Prej prijësit të besimtarëve, Ali bin Ebi Talibi, *radijallahu anhu*, na është përcjellë se ka thënë: “Nga të drejtat e mësuesit që e viziton është që, pasi të japësh selam, ta përshëndetësh në mënyrë të veçantë, të ulesh përballë tij, mos t'i bësh shenja me dorë, mos t'i bësh shenja me sy apo me ndonjë mënyrë tjetër, dhe mos të thuash në prani të tij se dikush ka thënë ndryshe nga ai. Mos e përgojo askënd në praninë e tij, mos u konsulto me shokun që ke pranë, mos e tërhiq për rroba kur ai dëshiron të shkojë, mos e mundo me pyetje të shumta dhe mos u ngop së qëndruari me të...”
- Nxënësi duhet të pajiset me këto virtyte të larta dhe, po ashtu, nuk duhet të lejojë përgojimin e mësuesit të tij në ndonjë mexhlis. Nëse nuk ka mundësi ta ndalojë përgojimin, duhet të largohet nga ai mexhlis.

- Nxënësi apo studenti (talebja), kur shfaqet para mësuesit, duhet të jetë i pastër, me dhëmbë të larë, dhe mos të merret me çështje të padobishme. Ai nuk duhet të hyjë te mësuesi pa leje në ato vende ku kërkohet leje për të hyrë. Kur hyn në mexhlis (klasë), ai duhet t'i përshëndetë të pranishmit me selam, dhe ta përshëndesë mësuesin në mënyrë të veçantë. Kur largohet nga mësimi, i jep selam mësuesit dhe të tjerëve, ashtu siç ka ardhur në hadithin: *“Nuk është i pari më me vlerë se i dyti.”*¹
- Nxënësi nuk duhet të hyjë në mexhlis duke shkelur mbi të tjerët, por duhet të ulet aty ku gjen vend, përveç nëse mësuesi e thërret të ulet përpara apo nëse është e qartë që nxënësit e tjerë janë dakord për një gjë të tillë. Po ashtu, ai nuk duhet ta çojë askënd nga vendi, përveç nëse e thërrasin apo nëse dalja e tij përpara ka dobi për të tjerët, duke vepruar ashtu siç ka vepruar Abdullah bin Omeri, *radijallahu anhu*. Nuk është e përshtatshme ulja në mes të mexhlisit, përveçse kur është e domosdoshme, dhe as nuk duhet ulur midis dy shokëve, përveç nëse ata e lejojnë.
- Nxënësi duhet të jetë i sjellshëm me shokët dhe të pranishmit në mexhlis, pasi kjo tregon edukatën e tij, respektin ndaj mësuesit dhe kontribuon në ruajtjen e imazhit të mexhlisit. Ai qëndron para mësuesit me respekt dhe edukatë të lartë, ashtu siç i ka hije një nxënësi. Nuk e ngre zërin, nuk qeshë, dhe nuk flet pa nevojë. Po ashtu, ai nuk luan me gishta² dhe nuk e kthen kokën majtas e djathtas pa arsye, por kthehet kah mësuesi dhe e dëgjon me vëmendje ligjërimin e tij.
- Nxënësi duhet të jetë i kujdesshëm dhe nuk duhet të lexojë para mësuesit kur ai ndihet i lodhur, i pikëlluar, i shqetësuar, i uritur, i etur ose i preokupuar me diçka. Përkundrazi, nxënësi duhet ta shfrytëzojë kohën kur mësuesi është i disponuar dhe në gjendje të plotë për të dhënë mësim.
- Nxënësi duhet të tregojë durim edhe ndaj ndonjë sjelljeje të pa-

1 Transmetuar prej Ibën Hibanit, Tirmidhiut, Ebu Davudit dhe Ahmedit, prej Ebu Hurejres, r.a.

2 As me laps, telefon, laptop e të ngjashme. (Plotësim i redaktorit).

përshtatshme të mundshme nga ana e mësuesit. Madje, edhe fjalët apo veprimet që në pamje të parë mund të duken fyese apo të gabuara, ai duhet të përpiqet t'i kuptojë në mënyrë pozitive. Nëse ndodh që mësuesi të gabojë, nxënësi nuk duhet të nxitojë në gjykim, por duhet ta shohë veten dhe të kërkojë falje, sikur faji i takon atij vetë, dhe jo mësuesit. Kjo qasje është më e dobishme për të, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër.

Të parët kanë thënë me urtësi: “Kush nuk e duron përçmimin që sjell ndonjëherë procesi i mësimit, do të mbetet në errësirën e injorancës për gjithë jetën; ndërsa ai që e përballon me durim, i hap vetes rrugën drejt krenarisë në këtë botë dhe në ahiret.”

Ibën Abbasi, *radijallahu anhu*, ka thënë një fjalë të mençur që është bërë e njohur: “Kam qenë i përulur si kërkues i diturisë, ndërsa u bëra i kërkuar për dituri dhe i respektuar prej të tjerëve!” Po aq bukur është thënë edhe kjo: “Kush nuk duron përçmimin e një çasti, do të mbetet i përçmuar gjithë jetën!”

Nxënësi duhet të ketë vullnet të fortë për të mësuar, dhe të përpiqet ta shfrytëzojë çdo çast për të fituar dituri. Nuk është e drejtë që ai të kënaqet me pak, kur ka mundësi për më shumë, por njëkohësisht duhet të jetë i kujdesshëm që mos ta ngarkojë veten përtej kufijve të durimit dhe kapaciteteve të tij. Një mbingarkesë e tillë mund të çojë në lodhje, monotoni, dhe në fund të rrezikojë gjithçka që është arritur deri atëherë. Megjithatë, kjo varet nga natyra dhe mundësitë e secilit individ, prandaj çdo nxënës duhet ta njohë mirë veten dhe të gjejë një ekuilibër të shëndetshëm në rrugën e dijes.


- Nëse nxënësi shkon në mexhlis dhe aty nuk e gjen mësuesin, ai duhet të presë me durim pranë derës deri kur të vijë mësuesi. Në rast se e gjen duke fjetur apo të zënë me ndonjë punë, nuk është e udhës të kërkojë leje për të hyrë menjëherë, por duhet të tregojë durim derisa mësuesi të zgjohet ose të lirohet nga angazhimi. Edhe pse mund të kthehet, më e vlefshme është të qëndrojë me durim, ashtu siç kanë vepruar Ibën Abbasi, *radijallahu anhu*, dhe sahabët e tjerë të ndershëm.
- Nxënësi duhet të japë maksimumin e përkushtimit dhe të energjisë së tij në kohën kur është i lirë dhe i motivuar, para se

të angazhohet me punë ose të arrijë në një pozitë që mund ta kufizojë. Prijësi i besimtarëve, Omer bin Hattabi, *radijallahu anhu*, ka thënë: “Mësoni dhe studioni para se të bëheni udhëheqës!” Sepse, kur e merr një pozitë të tillë, angazhimet dhe përgjegjësitë do ta pengojnë nxënësin nga studimi dhe leximi. Ky është edhe thelbi i fjalëve të Imam Shafiut, *Allahu e mëshiroftë*, i cili ka thënë: “Mëso para se të bëhesh prijës, sepse më pas nuk do të kesh më kohë për të mësuar!”


- E lavdërueshme është që nxënësi të shkojë herët në mësim, sidomos në orët e para të mëngjesit. Për këtë mbështetemi në fjalët e bekuara të Pejgamberit, *sal-lAllahu alejhi ve selem*: “O Allah, bekoje umetin tim kur e nisin një punë herët!”
- Për të përfituar sa më shumë nga dituria, nxënësi duhet t’i përsërisë rregullisht mësimet që ka mësuar përmendsh. Përsëritja e vazhdueshme është çelësi i ruajtjes dhe i thellimit në dije. Ai nuk duhet të heqë dorë nga radha e tij për të lexuar apo për të mësuar para mësuesit, duke ia lënë atë dikujt tjetër, sepse në fushën e adhurimeve, përfshirë kërkimin e dijes, nuk është e pëlqyeshme që dikush t’ia japë përparësinë një tjetri, ndryshe nga sjelljet e zakonshme të kësaj bote, kur një gjest i tillë mund të konsiderohet mirësjellje.
- Megjithatë, nëse mësuesi e sheh të arsyeshme dhe të dobishme që radha e nxënësit për të mësuar t’i kalojë përkohësisht dikujt tjetër, atëherë nxënësi duhet ta pranojë këtë me respekt dhe bindje, duke i dhënë përparësi urtësisë dhe gjykimit të mësuesit.
- Gjithashtu, nxënësi nuk duhet të ndiejë zili ndaj shokëve të tij, nëse ndonjëri prej tyre është begatuar prej Allahut me ndonjë dhunti apo aftësi të veçantë. Po ashtu, nuk duhet ta mashtrojë veten dhe t’i rritet mendja për cilësitë apo arritjet me të cilat Allahu e ka dalluar atë prej të tjerëve.

Mënyra më e mirë për ta luftuar vetëkënaqësinë, mendjemadhësinë dhe arrogancën është që njeriu të kujtojë se çdo dituri apo e mirë që posedon, është në të vërtetë një dhuratë prej Allahut. Ndërsa, zilinë mund ta largojë duke u bindur thellë se është urtësia hyjnore ajo që ka përcaktuar që një cilësi apo begati t’i jepet dikujt dhe jo dikujt tjetër.

Dhe, Allahu e di më së miri.



KAPITULLI I PESTË





ETIKA E BARTËSIT TË KURANIT

- Nxënësi duhet të jetë në gjendjen shpirtërore më të mirë dhe në nivelin më të lartë të moralit. Ai duhet t'i largohet me përkushtim çdo ndalese që përmendet në Kuran, si shprehje e respektit të tij për Fjalën e Allahut - Kuranin famëlartë.
- Duhet të ketë kujdes që pasuria e tij të fitohet vetëm në mënyrë të lejuar (hallall), të jetë zemërgjerë në sjellje, i palëkundur dhe krenar përballë arrogancës së mendjemëdhenjve, ndërsa i përulur dhe modest me njerëzit e devotshëm dhe me ata që janë në vështirësi.
- Karakteri i nxënësit duhet të përshkohet nga qetësia, qëndrueshmëria dhe maturia në fjalë e vepra.

Për Omer bin Hattabin, *radijallahu anhu*, transmetohet se ka thënë: “O ju që e keni mësuar Kuranin përmendsh, ngrini kokat lart me krenari! Juve ju është ndriçuar rruga e vërtetë. Bëni gara në punë të mira, dhe mos u bëni të varur prej njerëzve!”

Abdullah bin Mesudi, *radijallahu anhu*, ka thënë: “Bartësi i Kuranit duhet të dallohet prej të tjerëve: duke qenë zgjuar natën, kur njerëzit flenë, duke qenë i përmbajtur gjatë ditës, kur ata hanë dhe kënaqen. Duhet të dallohet me pikëllimin e tij, kur të tjerët gëzohen, me qarjen e tij, kur ata qeshin, me heshtjen e tij në mesin e bisedave të kota dhe me përuljen e tij kur të tjerët tregojnë mendjemadhësi.”


Po ashtu, Hasani, *Allahu e mëshiroftë*, ka thënë: “Ata që ishin para jush e shihnin Kuranin si një mesazh serioz dhe madhështor prej Zotit të tyre. Prandaj, natën e kalonin duke e lexuar dhe duke medituar për të, ndërsa ditën e jetësonin duke e zbatuar.”

Fudajl bin Ijadi, *Allahu e mëshiroftë*, ka thënë: “Bartësi i Kuranit nuk duhet të ketë nevojë për askënd, as për kalifin (sulltanin), e lëre më për ata në pozita më të ulëta.”¹


Kjo është shprehje e dinjitetit dhe e mbështetjes që ai duhet ta ketë vetëm tek Allahu.

Ai gjithashtu ka thënë: “Bartësi i Kuranit është mbajtës i flamurit të Islamit. Prandaj, atij nuk i takon të luajë dhe të dëfrehet kot me ata që luajnë, as të sillet i shkujdesur si të shkujdesurit, si dhe as të flasë mbarë e mbrapsht. Të gjitha këto janë të papërshtatshme për të, për shkak të respektit që i takon Kuranit.”

1 Në këtë kuptim, kjo thënie është një thirrje për ta ruajtur pastërtinë e dijes fetare, për të mos e përdorur atë si mjet për interesa personale apo për t’u afruar me pushtetin. (Sqarim i redaktorit.)



Nënkapitull





QORTIM PËR ATA QË E PËRDORIN KURANIN SI MJET JETESE DHE DISPOZITA E MARRJES SË SHPËRBLIMIT PËR MËSIMDHËNIEN E TIJ

Një nga çështjet më të rëndësishme që i kërkohet bartësit të Kuranit është që të jetë tepër i kujdesshëm dhe i vetëdijshëm, ashtu që mos ta shndërrojë Kuranin në mjet përfitimi material. Nuk i takon një njeriu që mban në zemër Fjalën e Allahut ta përdorë atë për të siguruar mjete jetese apo për të fituar pozitë, famë ose pasuri.

Kjo nuk do të thotë se mësuesit e Kuranit nuk mund të marrin ndihmë apo shpërblim për kohën dhe mundin e tyre, por qëllimi i tyre nuk duhet të jetë përfitimi personal, por shërbimi ndaj fesë dhe përhapja e diturisë. Ka dallim të madh midis atij që mëson Kuranin për hir të Allahut dhe, për nevojë, pranon ndihmë, dhe atij që e mëson Kuranin si profesion thjesht për të përfituar prej tij.

Kështu, bartësi i Kuranit duhet të qëndrojë larg çdo qëllimi të ulët që lidhet me përfitime të kësaj bote, dhe ta ruajë pastërtinë e qëllimit të tij: kërkimin e kënaqësisë së Allahut dhe ndriçimin e zemrave me dritën e Tij.

VËREJTJA E PEJGAMBERIT, SAL-LALLAHU ALEJHI VE SELEM KUNDËR SHFRYTËZIMIT TË KURANIT PËR PËRFITIME MATERIALE

Prej Abdurrahman bin Shibl, *radijallahu anhu*, transmetohet se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Lexojeni Kuranin, mirëpo mos përfitonin nga ai në mënyrë materiale, mos u largoni nga ai dhe mos e teproni në leximin e tij!*”¹

Ky hadith përmban një udhëzim të qartë për të qëndruar pranë Kuranit me qëllim të pastër dhe për të mos e përdorur atë si mjet përfitimi në këtë botë, qoftë për pasuri, pozitë apo lavdi.

Po ashtu, prej Xhabir bin Abdullahut, *radijallahu anhu*, transmetohet se Pejgamberi, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Lexojeni Kuranin para se të vijë një popull që do ta lexojnë me shumë përpjekje, duke e tepruar në shqiptimin e tij dhe në përpikëri të rregullave të leximit, ashtu siç përgatitet me kujdes një shigjetë përpara se të përdoret. Ata do ta recitojnë Kuranin, mirëpo me qëllim që të fitojnë përfitime në këtë botë, dhe jo shpërblimin e botës tjetër.*”²

Fraza “*kërkojnë shpërblimin në këtë botë*” nënkupton dëshirën për pasuri, lavdi, pozitë ose favore të tjera materiale përmes leximit dhe mësimdhënies së Kuranit. Ky është një devijim nga qëllimi fisnik i recitimit të Kuranit, i cili duhet të jetë vetëm për ta fituar kënaqësinë e Allahut dhe shpërblimin në botën tjetër.

Këto hadithe janë një kujtesë serioze për të gjithë bartësit e Kuranit, që ta ruajnë pastërtinë e qëllimit dhe mos ta shndërrojnë lidhjen e tyre me Librin e Allahut në një rrugë për përfitim tokësor. Kjo nuk përjashton mundësinë e shpërblimit për përpjekjen dhe kohën e mësuesit, por qëllimi kryesor duhet të mbetet gjithnjë përhapja e diturisë dhe shërbimi ndaj fesë.

Prej Fudajl bin Amrit, *Allahu e mëshiroftë*, transmetohet se ka thënë: “*Dy burra prej sahabëve të Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve selem, hynë në xhami. Pasi imami dha selam dhe namazi përfundoi,*

1 Transmeton Ahmedi dhe të tjerë.

2 Transmetojnë Ahmedi, Ebu Davudi, Ebu Ja’la dhe Bejhekiu.

një njeri u ngrit, lexoi disa ajete nga Kurani, dhe më pas kërkoi që t'i jepej ndonjë ndihmë materiale. Njëri prej atyre sahabëve tha: “Ne jemi të Allahut, dhe tek Ai do të kthehemi! Unë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, duke thënë: “*Do të vijë një popull që do të kërkojë shpërblim për leximin e Kuranit. Prandaj, kush kërkon kompensim për leximin e tij, mos i jepni asgjë!*”.

Duhet theksuar se zinxhiri i transmetimit të këtij hadithi është i ndërprerë (munkati), pasi Fudajl bin Amri nuk e ka dëgjuar drejtpërdrejt këtë rrëfim prej sahabëve.

MENDIMET E DIJETARËVE RRETH LEJUESHMËRISË SË MARRJES SË SHPËRBLIMIT PËR MËSIMIN E KURANIT

Sa i përket çështjes së marrjes së shpërblimit (pagesës) për mësimdhënien e Kuranit, dijetarët kanë pasur mendime të ndryshme.

Imam Ebu Sulejman El Hattabi ka transmetuar se një grup dijetarësh, në mesin e të cilëve ishin Imam Zuhriu dhe Ebu Hanife,¹ e kanë konsideruar të ndaluar (haram) marrjen e të hollave për mësimin e Kuranit. Ata e kanë parë këtë si një praktikë që bie ndesh me qëllimin e lartë të përhapjes së diturisë hyjnore.

1 Ky ka qenë qëndrimi i Imam Ebu Hanifes, Allahu e mëshiroftë, si edhe i disa dijetarëve të hershëm të medhhebit hanefi, të cilët e ndalonin marrjen e shpërblimit për mësimdhënien e Kuranit. Sipas tyre, mësimi i Librit të Allahut duhej të bëhej krejtësisht për hir të Tij, pa u shoqëruar me përfitime materiale. Megjithatë, dijetarët e mëvonshëm hanefij ndoqën një qasje më të balancuar dhe më realiste lidhur me këtë çështje. Ata e konsideruan të lejueshme marrjen e një pagese për mësimin e Kuranit dhe të shkencave të tjera islame, duke marrë parasysh rrethanat e ndryshuara shoqërore dhe fetare. Imami i njohur hanefij, Ebu Bekër El Merginani, në veprën e tij të famshme *El Hidaje*, pohon: “Disa prej dijetarëve tanë në këtë kohë jo vetëm që e lejojnë marrjen e shpërblimit për mësimin e Kuranit, por madje e shohin të lavdërueshme dhe të këshillueshme një gjë të tillë. Kjo për arsye se, nëse mësuesit e Kuranit (dhe imamët) nuk do të paguheshin, kjo do të shkaktonte dobësim dhe ngecje në zhvillimin e jetës fetare. Si pasojë, do të pakësohej numri i hafizëve dhe do të rrezikohej ruajtja e Kuranit famëlartë në zemrat e besimtarëve.”. Ky interpretim pasqyron një kujdes të veçantë për ruajtjen e trashëgimisë shpirtërore dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të institucionit të mësimin fetar. Ai vendos një ekuilibër mes idealit të pastërtisë së qëllimit dhe nevojës reale për t'i mbështetur ata që i shërbejnë fesë me përkushtim. (Plotësim i përkthyesit.)

Ndërkaq, një grup tjetër dijetarësh e kanë lejuar marrjen e shpërblimit, me kusht që mos të kërkohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Këtë qëndrim e kanë mbështetur figura të njohura si Hasan El Basriu, Shaabiu dhe Ibën Sirini.

Ndërsa, dijetarë të tjerë, si Atai, Imam Maliku, Imam Shafiu, po edhe të tjerë pas tyre, kanë qenë të mendimit se pagesa lejohet, edhe nëse mësuesi e kërkon, për aq kohë sa qëllimi nuk është thjesht përfitimi material, por përpjekja dhe shërbimi ndaj dijes. Ky qëndrim është mbështetur edhe nga disa hadithe autentike që tregojnë për lejimin e kësaj praktike në rrethana të caktuara.

ARGUMENTET E ATYRE QË E NDALOJNË MARRJEN E SHPËRBLIMIT PËR MËSIMIN E KURANIT

Ata dijetarë që e ndalojnë marrjen e shpërblimit për mësimin e Kuranit, mbështeten në disa transmetime pejgamberike dhe qëndrime të hershme të selefit (gjeneratës së parë të myslimanëve). Ndër to veçohet hadithi i transmetuar prej Ubade bin Samit, *radijallahu anhu*, i cili ka thënë: “Një burrë nga banorët e Suffes ia kishte mësuar një tjetër njeriu leximin e Kuranit. Ky i fundit, në shenjë falënderimi, i dhuroi një hark. Kur e mori vesh këtë i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ve selem*, i tha: “Nëse dëshiron që kjo dhuratë të të lidhet në qafë me një litar zjarri, atëherë pranoje!”¹.

Ky hadith ka qenë argument i fortë për ata që e ndalojnë përfitimin material nga mësimdhënia e Kuranit, duke e parë këtë si një devijim nga sinqeriteti që kërkohet në mësimin e fjalës së Allahut. Po ashtu, ata mbështeten edhe në transmetime të tjera të ngjashme nga selefi, që theksojnë pastërtinë e qëllimit dhe distancimin nga çdo interes vetjak në çështje të shenjta.

PËRGJIGJJA E ATYRE QË E LEJOJNË

Ndërkaq, ata dijetarë që e lejojnë marrjen e shpërblimit për mësimin e Kuranit, janë ata që japin dy sqarime në lidhje me hadithin e sipërpërmendur:

1 Hadith i transmetuar prej Ebu Davudit dhe të tjerëve.

Së pari, senedi i tij ka dobësi dhe, për rrjedhojë, nuk mund të merret si argument i prerë në çështje kaq madhore.

Së dyti, rasti në fjalë nuk përfshin një marrëveshje të paracaktuar, por një dhuratë të dhënë pas mësimit dhe në shenjë mirënjohjeje. Prandaj, ky rast nuk është i barasvlershëm me rastin kur ka një marrëveshje pune apo një shpërblim të përcaktuar që në fillim. Kjo bën që çështja të marrë një tjetër trajtim juridik.

Në këtë mënyrë, ata e konsiderojnë të lejuar marrjen e shpërblimit për mësimdhënien e Kuranit, sidomos kur kjo është nevojë reale për mbështetjen e mësuesve dhe ruajtjen e institucionit të dijes në shoqëri.

Dhe, Allahu e di më së miri.¹

SA KOHË DUHET PËR TA PËRFUNDUAR LEXIMIN E PLOTË TË KURANIT?

Bartësi i Kuranit e ka për obligim jo vetëm ta ruajë përmendsh atë që e ka mësuar, por edhe ta përsëritë shpesh dhe ta lexojë sa më shumë. Gjeneratat e para të myslimanëve, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*, kishin praktika të ndryshme sa i përket kohëzgjatjes së përfundimit të leximit të plotë të Kuranit (hatmes).

1 Imam Sujutiu në veprën e tij të njohur *El Itkan*, si dhe Ebu El Lejthi në librin *El Bustan*, kanë përmendur se mësimdhënia ndahet në tri lloje:

Mësimdhënia pa pagesë, kur mësuesi nuk kërkon dhe nuk pranon asnjë lloj shpërblimi material. Ai e jep diturinë vetëm për hir të Allahut dhe shpreson në shpërblimin hyjnor. Në këtë kategori bëjnë pjesë pejgamberët, *paqja qoftë mbi ta*, të cilët ua përcillnin njerëzve shpalljen hyjnore pa pritur asgjë në këmbim.

Mësimdhënia me pagesë të caktuar, për të cilën ka mospajtime ndërmjet dijetarëve. Megjithatë, mendimi më i saktë dhe më i pranuar është se kjo formë është e lejuar, sidomos kur pagesa ia mundëson mësuesit përkushtimin dhe vazhdimësinë në misionin e tij edukues.

Mësimdhënia pa kusht për pagesë, por nëse mësuesi merr dhurata apo shpërblime prej nxënësve apo komunitetit, ai i pranon ato. Ky lloj është lejuar unanimisht nga ana e të gjithë dijetarëve, sepse edhe i Dërguari i Allahut, *paqja qoftë mbi të*, i cili ishte mësuesi më i madh i njerëzimit, ka pranuar dhurata (hedije), megjithëse kurrë nuk ka kërkuar asgjë në këmbim për shpalljen dhe mësimin që jepte. Ky klasifikim pasqyron qartë qasjen e balancuar të dijetarëve islamë ndaj çështjes së mësimdhënies, duke bërë ndarjen mes idealit të shpërblimit hyjnor dhe realitetit të nevojave jetësore të atyre që u shërbejnë dijes dhe komunitetit.

Ibën Ebi Davudi transmeton prej njërit prej selefëve, se disa e përfundonin hatmen çdo dy muaj, disa çdo muaj, ca të tjerë çdo dhjetë net apo çdo tetë net, ndërsa shumica e tyre e përfundonin leximin e Kuranit çdo shtatë net.

Disa e bënë hatmen çdo gjashtë, pesë apo katër net, ndërsa shumë prej tyre çdo tri net. Kishte edhe prej atyre që e përfundonin hatmen çdo dy ditë. Disa prej të devotshmëve e lexonin Kuranin të plotë çdo ditë, madje kishte edhe prej atyre që i përfundonin dy hatme në një ditë, e disa tri herë në ditë, e madje janë përmendur raste kur bëheshin edhe tetë hatme në ditë, katër gjatë natës, dhe katër gjatë ditës.¹

SHEMBUJ TË SELEFËVE QË E PËRFUNDONIN HATMEN BRENDË NJË DITE DHE NATE

Ndër personalitetet e shquara të gjeneratave të para që e përfundonin leximin e plotë të Kuranit (hatmen) brenda një dite dhe nate, përmenden: Othman bin Affani, Temim Ed Dari, Seid bin Xhubejri, Muxhahidi, Shafiu dhe të tjerë, *Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata*.

¹ Disa dijetarë bashkëkohorë, siç është Imam Jusuf El Karadavi, në librin e tij *“Kejfe Neteamelu mea El Kuran”* (Si të sillemi me Kuranin), kanë theksuar se në transmetime të tilla rreth numrit të hatmeve që bëheshin në një ditë, duhet pasur kujdes dhe maturi, sepse ka mundësi të ketë ekzagjërime apo interpretim të gabuar nga ana e transmetuesve.

Nëse bëjmë një analizë realiste dhe bashkëkohore, pra, se sa kohë kërkon leximi i një xhuzi, sipas niveleve të leximit si:

- **Tertil** (lexim i ngadalshëm dhe i qartë),
- **Tedvir** (mesatar),
- **Hadër** (i shpejtë), apo
- **Mualim** (për mësim),

do të vërejmë se çdo nivel kërkon kohë të ndryshme, dhe leximi i një xhuzi mund të zgjasë nga 20 minuta deri në më shumë se 1 orë. Kjo vetëm për një xhuz; atëherë, le të imagjinojmë leximin e tërë Kuranit me përkushtim dhe përqendrim të duhur, brenda një dite ose disa herë në ditë!

Nga përvoja personale, edhe unë pajtohem me këtë vlerësim kritik: është shumë e vështirë, në mos e pamundur, të bëhen kaq shumë hatme brenda një dite dhe ato të jenë të lexuara siç i ka hije Kuranit, pa rënë në lexim mekanik, pa kuptim dhe pa marrë parasysh lodhjen psikike e fizike të njeriut.

Mos le të harrojmë se qëllimi i leximit të Kuranit nuk është vetëm sasia, por cilësia, përqendrimi, reflektimi (tedeburi) dhe zbatimi! Allahu e di më së miri, dhe Ai i shpërbën njerëzit sipas qëllimeve dhe përpjekjeve të tyre, jo vetëm sipas numrave. (Sqarim i redaktorit, hfz. Hajredin Hoxha).

Ndërkaq, prej atyre që i përfundonin tri hatme brenda një dite dhe nate, ishte Sulejm bin Itër, *radijallahu anhu*, i cili shërbente si kadi i Egjiptit në kohën e kalifatit të Muaviut, *radijallahu anhu*. Ebu Bekër bin Ebi Davudi transmeton se Sulejmi e përfundonte tri herë Kuranin brenda natës. Po ashtu, Ebu Omer El Kindi, në veprën e tij *Kaditë e Egjiptit*, përmend se ai bënte deri në katër hatme gjatë natës.

SHEMBUJ TË JASHTËZAKONSHËM TË LEXIMIT TË KURANIT PREJ DIJETARËVE DHE ADHURUESVE TË HERSHËM

Dijetari dhe imami i nderuar Ebu Abdurrahman Es Sulemi, *radijallahu anhu*, rrëfen: “Dijetarin Ebu Othman El Magribi e kam dëgjuar duke thënë: “Ibën El Katibi, *radijallahu anhu*, i bënte katër hatme gjatë ditës dhe katër hatme gjatë natës.” Ky është ndër rastet më të shquara të përfundimit të shumtë të Kuranit brenda një dite dhe nate.”

Sejidi i nderuar Ahmed Devrekiu na përcjell, me zinxhir të saktë transmetimi, prej Mensur bin Zadhanit, njërit prej adhuruesve të mëdhenj të gjeneratës së tabiinjeve, *radijallahu anhum*, se ai zakonisht e përfundonte një hatme të plotë ndërmjet drekës dhe ikindisë, dhe një tjetër ndërmjet akshamit dhe jaciesë. Gjatë muajit Ramazanit, ndërmjet akshamit dhe jaciesë ai arrinte t’i përfundonte dy hatme apo më shumë. Duhet theksuar se në atë kohë namazi i jaciesë në Ramazan shtyhej deri vonë.

Ebu Davudi transmeton, me varg të saktë, se Muxhahidi e përfundonte hatmen e Kuranit në Ramazan ndërmjet akshamit dhe jaciesë.

Gjithashtu, Mensuri rrëfen se Ali El Ezdi, çdo natë gjatë Ramazanit, ndërmjet akshamit dhe jaciesë, e përfundonte një hatme të plotë.

SHEMBUJ TË JASHTËZAKONSHËM TË PËRKUSHTIMIT NË LEXIMIN DHE PËRFUNDIMIN E KURANIT

Ibrahim bin Sadi rrëfen: “Babai im ulej këmbëkryq dhe nuk lëvizte derisa e përfundonte tërë leximin e Kuranit.”.

Numri i atyre që e bënin hatmen në një rekat të vetëm gjatë namazit ishte aq i madh, saqë nuk mund të numërohen. Prej të parëve përmenden: Othman bin Afani, Temim Ed Dari dhe Seid bin Xhubejri, i cili e përfundonte një hatme të plotë në një rekatë brenda Qabesë.

Gjithashtu, kishte shumë prej selefëve që e përfundonin Kuranin një herë në javë, duke lexuar nga pesë xhuze çdo ditë. Prej sahabëve që e ndiqnin këtë praktikë përmenden: Othman bin Afani, Abdullah bin Mesudi, Zejd bin Thabiti dhe Ubej bin Kabi, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*. Ndërsa, prej tabiinjeve përmenden: Abdurrahman bin Zejdi, Alkameh dhe Ibrahim, *Allahu i mëshiroftë*.

CILA ËSHTË MËNYRA MË E MIRË PËR LEXIMIN E KURANIT?

Zgjedhja më e mirë në lidhje me kohëzgjatjen dhe sasinë e leximit të Kuranit nuk është e njëjtë për të gjithë. Kjo varet nga gjendja shpirtërore, angazhimet dhe qëllimet e secilit individ. Prandaj, në këtë çështje janë vërejtur dallime mes lexuesve të Kuranit.

Ai që synon të thellohet në meditim dhe reflektim mbi kuptimet dhe urtësitë e ajeteve, le ta reduktojë sasinë e leximit, në mënyrë që të kuptojë më mirë dhe të përfitojë më shumë nga ajo që lexon.

Ndërsa, ai që është i angazhuar me përhapjen e diturisë dhe në çështjet e fesë në shërbim të myslimanëve, le të lexojë në masë më të kufizuar, që të ketë kohë për ta realizuar misionin dhe për t'i kryer përgjegjësitë e tij ndaj të tjerëve.

Mirëpo, për atë që nuk bën pjesë në këto kategori, le të lexojë sa më shumë që mundet, me kusht që leximi mos të kthehet në monotoni dhe mos të bëhet aq i shpejtë sa të humbë qartësia në shqiptim dhe përkushtim me zemër.

A ËSHTË E PËLQYESHME TË PËRFUNDOHET HATMEJA BRENDA NJË DITE?

Disa dijetarë e kanë konsideruar të papëlqyer përfundimin e hatmes së Kuranit brenda një dite dhe nate. Ata e bazojnë këtë mendim në hadithin autentik që transmetohet prej Abdullah bin Amër bin Asit, *radijallahu anhu*, i cili ka thënë: *“Ai që e lexon Kuranin (e bën hatme) në më pak se tri ditë, nuk ka kuptuar asgjë.”*¹

1 Hadithin e transmetojnë Ebu Davudi, Tirmidhiu, Nesaiu dhe të tjerë. Tirmidhiu e

Ky hadith vë theksin në rëndësinë e përqendrimit dhe të të kuptuarit gjatë leximit të Kuranit, duke shmangur një lexim të nxituar e që nuk sjell përfitim të thellë shpirtëror. Dhe, Allahu e di më së miri.

KUR DUHET FILLUAR DHE PËRFUNDUAR HATMEJA JAVORE?

Sa i përket kohës së fillimit dhe përfundimit të hatmes, për ata që e lexojnë Kuranin një herë në javë, ekzistojnë mendime të ndryshme. Sipas një transmetimi të Ibën Ebi Davudit, Othman bin Afani, *radijallahu anhu*, e fillonte hatmen natën e xhuma, dhe e përfundonte në natën e enjte.

RREGULLAT DHE KOHËT MË TË MIRA PËR PËRFUNDIMIN E HATMES, SIPAS IMAM GAZALIUT

Imam Ebu Hamid El Gazali, *Allahu e mëshiroftë*, në veprën e tij madhështore *Ihjaw Ulumid din*, jep udhëzime të hollësishme për kohët më të mira për përfundimin e hatmes së Kuranit.

Ai thotë: “Më së miri është që një hatme të përfundohet gjatë natës, dhe një tjetër gjatë ditës. Nëse hatmeja përfundon gjatë ditës, koha më e vlefshme është që të mbyllet të hënën në namazin e sabahut, në dy rekatet sunet, ose pas tyre. Ndërsa, nëse përfundimi i hatmes bëhet gjatë natës, atëherë koha më e vlefshme është në natën e xhuma, në namazin e akshamit, në dy rekatet sunet, ose pas tyre, në mënyrë që të përfshihet në këtë akt të lavdishëm edhe nata, edhe dita.”

Ky udhëzim i Imam Gazaliut synon të harmonizojë përkushtimin shpirtëror me kohët më të begata të javës, duke përfituar sa më shumë nga atmosfera e natës dhe e ditës së xhuma.

KOHËT MË TË VLEFSHME PËR PËRFUNDIMIN E HATMES SË KURANIT

Ibën Ebi Davudi transmeton prej Amër bin Murre Et Tabiit, i cili ka thënë: “Gjeneratat e para (sahabët dhe tabiinjtë) e pëlqenin ta përfundonin leximin e Kuranit (hatmen) në fillim të ditës ose në fillim të natës.”

konsideron hadithin hasen sahih.

Talha bin Musarraf, njëri prej dijetarëve të gjeneratës së tabiinjeve, thotë: “Kush e përfundon leximin e Kuranit gjatë ditës, në cilëndo orë, për të luten melekët deri në mbrëmje (aksham); e kush e përfundon gjatë natës, për të luten melekët deri në mëngjes.”

Ky qëndrim është përkrahur edhe prej Muxhahidit dhe dijetarëve të tjerë.

Prej Sead bin Ebi Vekkasit, *radijallahu anhu*, përmes Musnedit të Darimiut, transmetohet se ai ka thënë: “Nëse hatmeja përfundon në fillim të natës, melekët luten për të deri në mëngjes. E nëse përfundon në fund të natës, melekët luten për të deri në mbrëmje.” Darimiu e vlerëson këtë zinxhir transmetimi si të mirë (*hasen*).

Gjithashtu, prej Ibën Ebi Davudit dhe Imam Ahmedit, *Allahu i mëshiroftë*, është transmetuar se dijetari i madh Habib bin Ebi Thabit, nga gjenerata e tabiinjeve, e përfundonte hatmen e tij para se të shkonte në ruku, duke nënkuptuar se e mbyllte leximin e Kuranit brenda rekatit.

LUTJET E MELEKËVE PËR ATA QË E PËRFUNDOJNË HATMEN

Darimiu, në *Musnedin* e tij, transmeton prej Sead bin Ebi Vekkasit (*Allahu qoftë i kënaqur me të*) se ka thënë: “Nëse përfundimi i leximit të Kuranit ndodh në fillim të natës, melekët luten për të deri në mëngjes. E nëse përfundimi bëhet në fund të natës, melekët luten për të deri në mbrëmje.”

Darimiu e vlerëson këtë zinxhir transmetimi si të mirë (*hasen*).

Gjithashtu, Ibën Ebi Davudi dhe Imam Ahmedi, *Allahu i mëshiroftë*, transmetojnë se dijetari i njohur i tabiinjeve, Habib bin Ebi Thabit, e përfundonte hatmen e tij para se të shkonte në ruku, duke dëshmuar kështu për praktikën e mbylljes së hatmes brenda rekatit të namazit.

Më tepër për këtë temë do të flitet në kapitullin vijues, inshaAllah.

LEXIMI I KURANIT GJATË NATËS

Nxënësi i diturisë islame¹ duhet t'i kushtojë një kujdes të veçantë leximit të Kuranit gjatë natës, veçanërisht në namazin e natës. Kjo kohë e bekuar është e përmendur në shumë ajete dhe hadithe si moment i veçantë për afrim me Allahun.

Allahu i Lartë thotë: ***“Disa prej ithtarëve të Librit janë në rrugën e drejtë: në orët e natës lexojnë vargjet e Librit të Allahut dhe falin namaz. Ata e besojnë Allahun dhe Ditën e Kiametit, urdhërojnë në të mirën, ndalojnë nga e keqja dhe nxitohen në punë të mira. Këta janë prej të drejtëve.”*** (Ali Imran, 113–114)

Në një hadith të transmetuar prej Buhariut dhe Muslimit, i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë për Abdullah bin Omerin, *radijallahu anhu*: *“Sa njeri i mirë është Abdullahu, sikur të falej edhe natën!”*

Në një hadith tjetër autentik, i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, i drejtohet Abdullah bin Omerit, *radijallahu anhu*: *“Abdullah, mos u bëj si filani, i cili ngrihej për të falur namazin e natës, e më pas e ndërpreu atë.”*

Taberaniu dhe të tjerë transmetojnë prej Sehël bin Sadit, *radijallahu anhu*, se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: *“Nderi i besimtarit është në namazin e natës.”*

Namazi dhe leximi i Kuranit gjatë natës janë burim nderi, afërsie me Zotin dhe dritë për zemrën. Shumë hadithe dhe thënie të urta theksojnë vlerën e këtij adhurimi, duke e paraqitur si një nga veprat më të dashura tek Allahu dhe më të dobishmet për shpirtin.

1 Me nxënës të diturisë islame nuk nënkuptojmë vetëm studentin e medresesë apo të fakultetit, por çdo person që është i përfshirë në mësimin, kërkimin ose përhapjen e dijes islame, si: hoxhallarët, imamët, hatibët, profesorët, hafizët, madje edhe haxhilerët që e ruajnë dhe e përçojnë këtë dituri. (Sqarim i redaktorit).

SHEMBUJ FRYMËZUES PREJ TË DEVOTSHMËVE PËR LEXIMIN E KURANIT NATËN

Prej Ebi Ahves El Xhushemi është transmetuar se ka thënë: “Një burrë erdhi natën në shtëpi dhe, para se të trokiste në derë, dëgjoi një zë të ngjashëm me gumëzhitjen e bletëve, prej leximit të Kuranit nga ana e familjarëve. Atëherë tha: “Çfarë është puna me ata që janë të mbrojtur nga ajo që të tjerët kanë frikë?”

Kjo tregon për paqen dhe sigurinë që gëzojnë ata që e mbushin shtëpinë dhe jetën e tyre me Kuran, sidomos gjatë natës.

Ibrahim En Nehaiu ka thënë: “Lexoni Kuran gjatë natës, qoftë edhe për një kohë të shkurtër, mjafton aq sa duhet për të mjelë një dele.”

Prej Jezid Er Rekkashit përcillet: “Nëse fle në fillim të natës, e pastaj zgjohem (kah mesi apo fundi i natës), e më pas fle sërish, mos qofshin mbyllur sytë e mi (nëse nuk i kam falur disa rekate)!”

Unp them se namazi i natës dhe leximi i Kuranit gjatë natës janë më të vlefshëm se ato të ditës. Kjo sepse zemra e njeriut gjatë natës është më e qetë, më e pastër nga zhurmat e ditës dhe më e lirë nga angazhimet dhe preokupimet e përditshme. Natën ibadeti është më i sinqertë dhe më i mbrojtur nga syfaqësia dhe sëmundjet e fshehta të zemrës, të cilat mund ta shkatërrojnë shpërblimin e veprave.

Vetë fakti që ngjarja madhështore e Israsë dhe Miraxhit (udhëtimi i natës i të Dërguarit të Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*), është dëshmi e statusit të veçantë që ka kjo kohë tek Allahu.

Po ashtu, në një hadith autentik, që e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi, Pejgamberi, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, thotë: “Zoti juaj zbrit çdo natë në qiellin e dynjasë, në një të tretën e fundit të saj, dhe thotë: “A ka ndonjë që më lutet, që t’i përgjigjem? A ka ndonjë që kërkon falje, që ta fal? A ka ndonjë që kërkon, që t’i jap?!”

Në një hadith tjetër autentik, i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “Gjatë natës ka një çast (kohë, moment) në të cilin pranohet lutja, dhe kjo ndodh çdo natë.”

Dije se vlera e namazit të natës dhe e leximit të Kuranit gjatë saj arrihet qoftë edhe me pak; mjafton të jetë me sinqeritet dhe përkushtim.

Sigurisht, sa më shumë të falet dhe të lexohet, aq më mirë dhe më e pëlqyeshme është. Mirëpo, gjithmonë duhet ruajtur ekuilibri.

Prej sunetit nuk është që të kalohet gjithë nata në ibadet, në mënyrë të vazhdueshme, sepse kjo është e urryer (mekruh), dhe sepse mund t'i shkaktohen dëme vetes, fizikisht apo emocionalisht. Feja jonë është fe mesatare, dhe qëndrueshmëria në adhurim është më e dashur për Allahun sesa teprimi që çon në lodhje dhe braktisje.

EDHE PAK ADHURIM KA SHPËRBLIM TË MADH

Argument i qartë për vlerën e ibadetit të natës, qoftë edhe në sasi të vogël, është hadithi i transmetuar prej Abdullah bin Amër bin Asit, *radijallahu anhu*, në të cilin i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Ai që falet natën me dhjetë ajete nuk shkruhet ndër të pakujdesshmit (gafilët); ai që falet me njëqind ajete shkruhet ndër të devotshmit (el-kanitinë); ndërsa ai që falet me një mijë ajete shkruhet ndër ata që kanë arritur shpërblim të madh.*”¹

Gjithashtu, Thalebiu transmeton prej Ibën Abbasit, *radijallahu anhu*, se ka thënë: “*Kush fal natën vetëm dy rekate namaz nafile, i shkruhet sikur ta ketë kaluar tërë natën në kijam dhe sexhde.*”

DOMOSDOSHMERIA E PËRSËRITJES

SË KURANIT DHE RREZIKU I HARRESËS SË TIJ

Ebu Musa El Eshariu, *radijallahu anhu*, transmeton se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Lexojeni dhe përsëriteni rregullisht Kuranin, sepse, pasha Atë në Dorën e të Cilit është jeta e Muhamedit, ai ikën (harrohet) më shpejt sesa devetë kur ikin, kur u zgjidhen (lirohen) litarët!*”²

Po ashtu, Ibën Omeri, *radijallahu anhu*, rrëfen se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Shembulli i atij që e ka mësuar Kuranin përmendsh është si shembulli i njeriut që ka deve të lidhura; nëse i mban të lidhura, i ka nën kontroll, e nëse i lëshon, ato do të ikin.*”³

1 Transmetuar prej Ebu Davudit dhe të tjerëve.

2 Transmetuar prej Buhariut dhe Muslimit.

3 Transmetuar prej Buhariut dhe Muslimit.

RËNDËSIA E RUAJTJES SË KURANIT DHE TËRHEQJA E VËREJTJES PËR HUMBEN E TIJ

Enes bin Maliku, *radijallahu anhu*, rrrëfen se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Mua më janë paraqitur veprat (shpërblimet) e umetit tim, madje edhe pengesat që i largojnë njerëzit nga xhamia. Po ashtu më janë paraqitur mëkatet e tyre, dhe nuk kam parë mëkat më të madh sesa kur dikush mëson një sure apo një ajet nga Kurani, dhe më pas e harron atë.*”¹

Gjithashtu, Sad bin Ubade, *radijallahu anhu*, tregon se Pejgamberi, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Ai që e mëson Kurandin dhe më pas e harron, në Ditën e Gjykimit do të vijë me duar të prera.*”²

Prej Omer bin Hattabit, *radijallahu anhu*, përcillet se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve selem*, ka thënë: “*Kush e ka zakon të lexojë një pjesë të caktuar të Kuranit (virdin) çdo natë, por fle pa e lexuar; e në mëngjes e lexon ndërmjet namazit të sabahut dhe atij të drekës, atij i shkruhet sevapi sikur ta kishte lexuar natën.*”³

Prej Sulejman bin Jesarit përcillet se Ebu Usejdi⁴ ka thënë: “*Një natë më zuri gjumi pa e lexuar virdin tim. Kur u zgjova në mëngjes, ndjeva keqardhje. Virdi im ishte leximi i sures El Bekare. Atë natë pashë në ëndërr një dem (ka) që më godiste me brirët e tij.*”⁵

Ibën Ebi Ed Dunja përcjell prej një hafizi të Kuranit, i cili tregon: “*Një natë më zuri gjumi pa e lexuar virdin. Në ëndërr më doli dikush dhe më tha:*

*Habitem me një trup të shëndetshëm,
me një djalë të ri që fle deri në mëngjes.
Njeriu nuk ka garanci nga vdekja,
as në errësirën e natës kur pushon.*”


1 Transmetuar prej Ebu Davudit dhe Tirmidhiut; ky i fundit e cilëson hadithin si garib – të dobët.

2 Transmetuar prej Ebu Davudit dhe Darimiut.


3 Transmetuar prej Muslimit.

4 Sahab i nderuar. Emri i tij i plotë është Malik bin Rebiah, ndërsa ka marrë pjesë në betejën e Bedrit; *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

5 Transmetuar prej Ebu Davudit.



KAPITULLI I GJASHTË





ETIKA E LEXIMIT TË KURANIT

Ky kapitull përfaqëson thelbin dhe nyjën qendrore të këtij libri, duke pasur një shtrirje të gjerë në përmbajtje dhe rëndësi. Edhe pse nuk i parapëlqej shpjegimet e gjata, për të mos e lodhur lexuesin, këtu aludoj shkurtimisht në objektivat kryesore të këtij kapitulli.

Gjëja e parë dhe më e domosdoshme për çdo lexues të Kuranit është:

- Singëriteti, siç është përmendur edhe më herët.
- Si dhe ruajtja e sjelljes së duhur dhe e mirësjelljes së thellë përpara Fjalës së Allahut.
- Njeriu duhet të ketë në mendje se, në momentin që e lexon Kuranin, ai është në një dialog të drejtpërdrejtë me Allahun e Madhëruar.
- Prandaj, duhet ta lexojë me përkushtim të tillë sikur ta shihte Vetë Atë; pasi, edhe nëse nuk e sheh, me siguri Allahu e sheh atë.

PËRDORIMI I MISVAKUT¹

Kur dikush dëshiron të lexojë Kuranin, është e pëlqyeshme që:

- Së pari të pastrojë gojën, dhe mënyra më e mirë për ta bërë këtë është përmes përdorimit të misvakut. Misvaku më i rekomanduar është ai që merret nga dega e pemës *erak*, mirëpo lejohen edhe degë

¹ **Misvaku** është një degë e hollë që përdorej nga Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) për pastrimin e gojës para adhurimeve. Ai rekomandohet veçanërisht para leximit të Kuranit, si shenjë respekti ndaj fjalës së Allahut. (Sqarim i përkthyesit).

të tjera, ose çdo mjet tjetër që e pastron mirë gojën, sikurse janë, për shembull, ndonjë leckë e trashë, likeni¹ apo të ngjashme.²

Sa i përket përdorimit të gishtit për këtë qëllim, dijetarët e medhhebit shafi kanë dhënë tri alternativa:

- Më i njohuri ndër to është se përdorimi i gishtit nuk e përmbush funksionin e misvakut.
- Një mendim tjetër thotë se e përmbush.
- Ndërsa, sipas mendimit të tretë, kjo është e pranueshme vetëm në mungesë të mjeteve të tjera, mirëpo jo kur ekziston ndonjë alternativë më e përshtatshme.

Misvaku duhet përdorur duke filluar nga ana e djathtë e gojës, duke pasur qëllimin (nijetin) për të kryer një veprim sunet. Gjatë përdorimit të tij është e këshillueshme të thuhet: *“O Allah, më beko në këtë (veprim), o Mëshiruesi më i Madh!”*

El Maverdiu, njëri prej dijetarëve të shquar, dhe ndjekësit e mëvonshëm të Imam Shafiut, thonë: “Përdorimi i misvakut është i rekomanduar si në sipërfaqen e jashtme, ashtu edhe në atë të brendshme të dhëmbëve. Ai duhet të kalohet butësisht mbi skajet e dhëmbëve, mbi dhëmballët dhe në pjesën e sipërme të gojës, në qiellzë.”

E pëlqyeshme shumë është që misvaku të jetë me përbërje të mesme, as shumë i thatë dhe as shumë i lagësht. Nëse është i thatë, rekomandohet të zbutet me pak ujë para përdorimit, për të qenë më efektiv dhe më i këndshëm për përdoruesin.

Në rast se goja është e ndotur, për shembull nga gjaku apo ndonjë papastërti tjetër e ngjashme, atëherë është **mekruh** (e papëlqyer) të

1 **Liken** – Bimë e ulët që përbëhet nga një bashkëjetesë simbiotike mes një kërpudhe dhe një alge. Këto dy organizma jetojnë së bashku dhe formojnë një njësi të vetme biologjike. Likenet rriten zakonisht mbi lëkurat e drurëve, mbi gurë, shkëmbinj, mure dhe sipërfaqe të tjera, ku shpesh shërbejnë si indikatorë të pastërtisë së ajrit. (Sqarim i përkthyesit).

2 Përveç misvakut tradicional, në ditët e sotme në këtë rregull përfshihen edhe mjetet bashkëkohore të pastrimit të gojës, si: furça e dhëmbëve, pasta (kalladonti), lëngjet dezinfektuese me aromë të këndshme për shpëlarjen e gojës (mouthwash), si edhe çdo mjet tjetër që siguron pastërti dhe freski para leximit të Kuranit. (Plotësim i redaktorit).

lexohet Kurani para se të pastrohet ajo ndotje me shpëlarje. Mirëpo, a mund të konsiderohet kjo si e ndaluar (**haram**)?

Për këtë çështje, dijetari Er Rejjani, njëri prej ndjekësve të medhhebit shafii, na transmeton prej babait të tij se ekzistojnë dy mendime në lidhje me këtë mesele.¹

LEXIMI I KURANIT PA ABDES

PAPASTËRTIA E VOGËL – HADETHI

Gjithsesi se është e rekomanduar që njeriu të jetë në gjendje të pastër (me abdes) gjatë leximit të Kuranit, si shenjë nderimi dhe respekti ndaj Fjalës së Allahut. Megjithatë, Kurani lejohet të recitohet edhe në gjendje papastërtie të vogël, pra pa abdes, dhe kjo është e njohur me konsensusin e dijetarëve myslimanë (ixhma). Hadithet që e mbështesin këtë çështje janë të shumta dhe të njohura.

Imam El Haramejni, El Xhujejni, *Allahu e mëshiroftë*, ka thënë: “Nuk është e drejtë të thuhet se ai që e reciton Kuranin pa abdes ka bërë diçka të papëlqyer (mekruh), por se ai e ka lënë atë që është më e mira.”

Nëse një person nuk gjen ujë për t’u pastruar, atëherë mund të marrë tejemum (pastrim simbolik - me dhé).

Po ashtu, femra që vuan nga istihada (gjakderdhje jashtë ciklit menstrual) konsiderohet si e pastër dhe mund ta lexojë Kuranin (pa e prekur atë), edhe pse është pa abdes.

PAPASTËRTIA E MADHE – XHENABETI

Personit që është në gjendje xhunubllëku (papastërti të madhe), si dhe gruas që është me menstruacione (hajz), u ndalohet ta lexojnë Kuranin me gojë, qoftë edhe një ajet apo një pjesë të tij. Megjithatë, për ta lejohet që ta lexojnë Kuranin me zemër, pa e shqiptuar me gjuhë.

Po ashtu, është e lejuar për xhunubin që të shikojë në mus’haf (pa e prekur me dorë), dhe ta kalojë tekstin në mendje, pa shqiptim.

¹ Pra, njëri mendim është se nuk lejohet, kurse tjetri se lejohet, mirëpo është i papëlqyeshëm (mekruh).

Sipas ixhmait (konsensusit) të dijetarëve myslimanë, është e lejuar për personin në gjendje xhunubllëku dhe për gruan me menstruacione që të përkujtojnë Allahun (të bëjë dhikr) në forma të ndryshme, si:

- **Tesbih** – Subhanallah
- **Tehlil** – La ilahe il-Allah
- **Tahmid** – Elhamdulillah
- **Tekbir** – Allahu Ekber
- **Dërgimi i salavateve** mbi pejgamberin Muhamed, *paqja qoftë mbi të*.

Gjithashtu, lejohen për ta të gjitha format e tjera të përkujtimit (dhikrit) që nuk përfshijnë recitim të Kuranit.

Dijetarët e medhhebit shafii kanë sqaruar se, nëse dikush thotë një frazë që përkon me tekst kuranor, mirëpo pa qëllimin e recitimit, sikurse, për shembull: **“O Jahja! Kapu fort pas Librit”** (Kuran, 19:12), atëherë kjo lejohet. Po ashtu lejohet edhe të thuhet: **“Të Allahut jemi, dhe tek Ai do të kthehemi”** (Kuran, 2:156), si reagim ndaj një fatkeqësie, për sa kohë nuk synohet recitimi si ibadet, por vetëm thënia e saj si shprehje e zakonshme e besimit.

Dijetarët tanë nga Horasani kanë thënë se është e lejuar për personin në gjendje xhunubllëku dhe për gruan me hajz (menstruacione) që të thonë lutje të përfshira në Kuran, për sa kohë nuk synohet recitimi i Kuranit si akt adhurimi, por vetëm si lutje (dua), apo përkujtim i Allahut. Ndër lutjet e lejuara përmenden: **“Falënderuar qoftë Ai që i nënshtroi këto për ne, sepse ne nuk do të kishim mundësi ta bënim këtë!”** (Kuran, 43:13 – lutja e udhëtimit), si dhe lutja: **“Zot, na jep të mira në këtë botë dhe të mira në botën tjetër, dhe na ruaj nga dënimi me Zjarr!”** (Kuran, 2:201)

Në të njëjtën frymë, Imam El Haramejni ka thënë: “Nëse një person që është xhunub thotë **“Bismilah”** ose **“Elhamdulillah”** me qëllimin për të recituar Kuranin, atëherë kjo është gjynah. Mirëpo, nëse e thotë me qëllim përkujtimin e Zotit (dhikrin), ose pa ndonjë qëllim specifik, nuk ka gjynah.”

Ky qëndrim thekson dallimin e rëndësishëm midis recitimit të Kuranit si ibadet (që kërkon pastërti) dhe përdorimit të ajeteve si lutje apo fjalë të zakonshme të devocionit, të cilat është e lejuar të thuhën edhe pa abdes të plotë.

TEJEMUMI NË MUNGESË TË UJIT

Kur personi që është xhunub, apo gruaja pas mbarimit të hajzit, dhe nuk gjejnë ujë për t'u pastruar, atëherë ata marrin tejemum (pas-trim simbolik me dhe apo me pluhur të pastër). Me këtë veprim u lejo-het t'i kryejnë veprat e adhurimit si: leximi i Kuranit, falja e namazit, qëndrimi në xhami dhe të tjera.

Nëse më pas ata kryejnë ndonjë veprim që e prish abdesin (si, p.sh.: dalja e gazrave, urinimi, etj.), atëherë nuk u lejohet më të falin namaz pa marrë tejemum të ri. Megjithatë, leximi i Kuranit, qëndrimi në xhami dhe të gjitha veprimet që lejohen për një person pa abdes, pra, vazhdojnë të jenë të lejuara për ta.

Ky rregull vlen edhe për personin që ka marrë gusul dhe më pas i prishet abdesi: nuk mund të falë namaz pa abdes, por mund të bëjë gjithçka tjetër që është e lejuar për një njeri që nuk është në gjendje papastërtie të madhe.

TEJEMUMI I XHUNUBIT

– NË UDHËTIM APO NË VENDBANIM

Nuk ka asnjë dallim në mes të tejemumit të një personi që është xhunub, qoftë ai në vendbanimin e tij apo në udhëtim. Disa prej dije-tarëve të medhhebit shafii u është atribuuar mendimi se, nëse dikush merr tejemum në vendin e vet, i lejohet falja e namazit, mirëpo jo leximi i Kuranit jashtë namazit, si dhe as qëndrimi në xhami.

Megjithatë, mendimi më i saktë dhe më i pranuar është se lejo-hen të gjitha këto veprime, ashtu siç është përmendur më herët:

- Leximi i Kuranit;
- Falja e namazit;
- Qëndrimi në xhami, dhe;
- Veprat e tjera që i lejohen një personi pas marrjes së tejemumit.

Ky qëndrim bazohet në kuptimin e drejtë të rregullave të tejemumit, si zëvendësim i përkohshëm i pastrimit me ujë, kur uji mungon ose nuk mund të përdoret.

TEJEMUMI DHE RIKTHIMI I DETYRIMIT PËR GUSUL

Nëse një person në gjendje xhunubllëku (ose pas hajzit) merr tejemum për mungesë uji, dhe me këtë tejemum falet dhe lexon Kuran, mirëpo më pas sheh ujin apo i bëhet i mundur përdorimi i tij, atëherë obligohet të marrë gusul menjëherë. Nëse nuk e bën këtë, atëherë i ndalohej leximi i Kuranit dhe të gjitha veprimet që janë të ndaluara për një person në gjendje xhunubllëku, derisa të pastrohet me ujë.

Nga ana tjetër, nëse pas tejemumit dhe faljes së namazit apo leximit të Kuranit personi kryen një veprim që e prish abdesin (siç është dalja e erës, urinimi etj.), dhe përsëri merr tejemum, atëherë, sipas mendimit më të saktë dhe më të zgjedhur në medhhebin shafii, nuk i ndalohej leximi i Kuranit, qëndrimi në xhami dhe veprat e tjera që i lejohen një personi me tejemum.

Ky mendim bazohet në parimin se tejemumi është zëvendësim i plotë dhe i vlefshëm për pastrim, për sa kohë që mungon uji, dhe mbetet i vlefshëm përderisa kushtet për përdorimin e tij nuk kanë ndryshuar.

NAMAZI DHE LEXIMI I KURANIT PA UJË E PA DHE PËR TEJEMUM

Nëse një person që është në gjendje papastërtie të madhe (xhunub) nuk gjen as ujë dhe as tokë të pastër (dhe) për të marrë tejemum, dhe koha e namazit është duke përfunduar, atëherë i lejohet ta falë namazin në atë gjendje, për shkak të nevojës dhe ngushtimit të kohës.

Megjithatë, në këtë situatë ai nuk lejohet të recitojë Kuran jashtë namazit.

Sa i përket recitimit të Kuranit gjatë namazit, lejohet vetëm kaptina El Fatiha, e cila është shtyllë e domosdoshme e namazit. Mirëpo, këtu shtrohet pyetja: A është e ndaluar për të edhe leximi i Fatihasë në atë gjendje?

Lidhur me këtë çështje, dijetarët kanë shprehur dy mendime:

- Mendimi më i saktë dhe më i zgjedhur është se në këtë rast nuk është i ndaluar leximi i Fatihasë. Përkundrazi, është i detyrueshëm, pasi namazi është i pavlefshëm pa të. Ashtu siç lejohet falja e namazit në gjendje xhunubllëku, për shkak të mungesës së ujit dhe dheut për pastrim, po ashtu lejohet edhe lexim i Fatihasë, si shtyllë bazë e namazit.
- Ndërkaq, mendimi i dytë është se nuk lejohet recitimi i saj në këtë gjendje. Sipas këtij mendimi, personi duhet të thotë lutje të zakonshme, ashtu siç do të vepronte një njeri që nuk ka mësuar përmendsh asgjë nga Kurani. Pra, një i tillë krahasohet me dikë që është i paaftë për recitim në mënyrë ligjore.

Megjithatë, mendimi më i saktë dhe më i mbështetur është ai i pari, se leximi i Fatihasë lejohet dhe është i domosdoshëm në këtë rrethanë.

Këto sqarime janë të nevojshme, prandaj i përmenda me shprehje të përmbledhura. Për të gjitha këto ekzistojnë argumente të shumta dhe shpjegime të hollësishme në librat e fikhut.

Dhe, Allahu e di më së miri.

VENDI I RECITIMIT TË KURANIT

Leximi i Kuranit rekomandohet që të bëhet në një vend të pastër dhe të zgjedhur me kujdes, duke e nderuar kështu fjalën e Allahut të Lartë. Për këtë arsye një grup dijetarësh kanë vlerësuar se xhamiat përbëjnë ambientin më të përshtatshëm për recitimin e Kuranit, pasi ato përbashkojnë pastërtinë fizike dhe shpirtërore, dinjitetin e vendit të adhurimit dhe qetësinë që i nevojitet një veprimi kaq të madhërishtë.

Çdo person që hyn në xhami, qoftë edhe për një qëndrim të shkurtër, është e pëlqyer që të bëjë nijet për itikaf, një përkushtim shpirtëror në vendin e adhurimit. Ky nijet duhet të bëhet menjëherë, që në momentin e hyrjes në xhami, me qëllimin që ajo kohë mos të kalojë thjesht si prani fizike, por të shndërrohet në një akt adhurimi dhe afrimi me Allahun e Lartë.

Kjo traditë e bukur islame meriton vëmendje të veçantë, dhe është e nevojshme të promovohet dhe të përhapet në mesin e të rinjve dhe

besimtarëve në përgjithësi, sepse fatkeqësisht sot është mjaft e shpërfillur dhe pothuajse e harruar.

LEXIMI I KURANIT NË BANJË¹

Sa i përket leximit të Kuranit në banjë, dijetarët e gjeneratës së parë (selefët) kanë pasur mospajtime lidhur me këtë çështje: a është mekruh (e papëlqyer), apo jo?

Dijetarët e medhhebit shafii kanë thënë se nuk është mekruh recitimi i Kuranit në banjë, edhe pse është më e preferuar që të shmanget, për sa kohë që mundësia ekziston.

Imam Ebu Bekër bin El Mundhiri, në veprën e tij *El Ishraf*, transmeton këtë qëndrim prej Ibrahim Nehaiut dhe Imam Malikut, të cilët e kanë lejuar recitimin e Kuranit në banjë. Ky është gjithashtu edhe mendimi i Atasë, njërit prej dijetarëve të njohur të tabiinjeve.

Megjithëse disa dijetarë e kanë lejuar recitimin e Kuranit në banjë, një grup tjetër dijetarësh kanë qenë të mendimit se kjo është mekruh (e papëlqyer), për shkak të mungesës së respektit që i takon Fjalës së Allahut në një vend të tillë.

Ky është edhe mendimi i sahabiut të nderuar Ali bin Ebi Talibit, *radi-jallahu anhu*, siç na e përcjell Ibën Ebi Davudi në transmetimet e tij.

Po ashtu, Imam Ibën Mundhiri e ka përmendur këtë qëndrim si të mbështetur edhe prej shumë prej tabiinjeve, ndër të cilët:

- Ebu Vail Shekik bin Seleme
- Shabiu
- Hasen El Basriu
- Mekhuli

¹ Recitimi i Kuranit në “banjë” i referohet banjove publike tradicionale, të cilat në botën arabe dhe në disa vende të Lindjes së Mesme dhe Turqi përdoren si ambiente për larje trupore dhe përkujdesje personale. Këto vende nuk janë të njëjta me WC-të (toaletet) moderne, të cilat konsiderohen vende të papastra për leximin e Kuranit. Pra, kur flitet për recitimin e Kuranit në banjë, nënkuptohet përdorimi i hapësirave të veçanta për larje, pjesë e traditës kulturore, që nuk kanë të njëjtën rregullsi fetare si WC-ja. (Sqarimi i redaktorit).

- Kabisa bin Dhuejb
- Si dhe prej Ibrahim Nehaiu, në një transmetim tjetër prej tij.

Ky grup dijetarësh e ka parë të papëlqyeshme recitimin në banjë, me arsyetimin se vendi nuk është i denjë për përmendjen e Allahut dhe për recitimin e Kuranit, për shkak të natyrës së tij fizike dhe shpirtërore.

Dijetarët e medhhebit shafii kanë transmetuar se këtë qëndrim e ka mbajtur edhe Ebu Hanifja, *Allahu e mëshiroftë*, i cili ka pohuar se është mekruh të lexohet Kurani në vende të tilla, për shkak të mungesës së respektit që mund të shfaqet ndaj shenjtërisë së Fjalës së Allahut.

Në këtë kontekst, Shabiu ka thënë: “Mekruh (tahrime) është të lexohet Kurani në tre vende: në banjë, në nevojtoare dhe në mulli përderisa guri i tij është duke u rrotulluar.”

Ndërsa, Ebi Mejsere është shprehur me fjalë të thjeshta, mirëpo me domethënie të thellë: “Allahu i Madhërishëm përmendet vetëm në vend të pastër.”

Këto qëndrime pasqyrojnë ndjeshmërinë e thellë të dijetarëve ndaj ndershmërisë së vendit kur përmendet Fjala e Allahut. Ato na mësojnë që ta nderojmë Kuranin, jo vetëm përmes fjalëve dhe qëllimeve tona, por edhe përmes mjedisit dhe rrethanave në të cilat e recitojmë atë.

Dhe, Allahu e di më së miri.

RECITIMI I KURANIT NË RRUGË

Sa i përket recitimit të Kuranit në rrugë, mendimi më i saktë dhe më i preferuar është se lejohet dhe nuk është mekruh (i papëlqyer), përderisa recituesi është i përqendruar dhe nuk shpërqëndrohet nga çfarë ndodh përreth tij.

Megjithatë, nëse recituesi shpërqëndrohet, atëherë recitimi është mekruh, pasi mund të çojë në mungesë përqendrimi, mospërkushtim apo gabime në lexim, gjë që bie ndesh me respektin që i takon Fjalës së Allahut.

Kjo gjendje është e ngjashme me atë që transmetohet për pejgamberin Muhamed *sal-lAllahu alejhi ve selem*, i cili nuk e pëlqente që dikush të lexonte Kuranin kur ishte i lodhur, nga frika se mund të gabonin në recitim, duke mos ia dhënë hakun e duhur Fjalës Hyjnore.

Prej Ibën Ebi Davudit transmetohet se Ebu Derdai, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, e lexonte Kuranin edhe gjatë ecjes në rrugë. Po ashtu, Omer bin Abdul Azizi, *Allahu e mëshiroftë*, ka thënë se kjo është e lejuar (xhaiz).

Ibën Ebi Davudi transmeton: “Ebu Rebiu më ka treguar, të cilit i kishte treguar Ibën Vehbi, se ai e kishte pyetur Imam Malikun në lidhje me një njeri që falet gjatë pjesës së fundit të natës, e më pas del për në xhami, mirëpo i ka mbetur pa përfunduar leximi i një sureje, dhe pjesën e mbetur e reciton gjatë rrugës.”

Imam Maliku, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ishte përgjigjur: “Unë nuk di për recitimin në rrugë”, - dhe nuk e kishte pëlqyer një veprim të tillë.

Zinxhiri i transmetimit (senedi) prej Imam Malikut është i saktë (sahih), çka i jep këtij qëndrimi një bazë të fortë në traditën e fikhut.

Ky transmetim tregon rezervën e disa dijetarëve të mëdhenj ndaj recitimit të Kuranit në lëvizje, veçanërisht kur kjo mund të ndikojë në cilësinë dhe përqendrimin gjatë leximit, apo në respektin e duhur ndaj Fjalës së Allahut.

KTHIMI KAH KIBLA GJATË RECITIMIT TË KURANIT

Rekomandohet që gjatë recitimit të Kuranit, edhe jashtë namazit, personi të jetë i kthyer me fytyrë kah Kibla. Kjo është forma më e plotë dhe më e ndershme e qëndrimit në raport me Fjalën e Allahut.

Në një hadith thuhet: “*Mënyra më e mirë për t’u ulur është me fytyrë kah Kibla.*”

Recituesi duhet të ulet me përulësi, qetësi dhe dinjitet, me kokën ulur në shenjë respekti e përkushtimi, sikur të ishte përballë mësuesit të tij. Ky qëndrim përforcon etikën dhe madhështinë e aktit të leximit të Kuranit dhe përfaqëson mënyrën më të plotë për ta bërë këtë adhurim.

Megjithatë, nëse dikush lexon Kuranin duke qëndruar në këmbë, i shtrirë anash, në shtrat apo në ndonjë gjendje tjetër, kjo është e lejuar, dhe ai prapë merr shpërblim, edhe pse shpërblimi është më i vogël, krahasuar me formën më të plotë dhe më të nderuar të recitimit.

Këtë e konfirmon edhe vetë Kurani, në fjalën e Allahut të Lartë: **“Në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente për njerëzit me arsye. Ata që e përmendin Allahun kur janë në këmbë, ulur dhe të shtrirë...”** (Ali Imran, 190–191)

Në një hadith autentik, të transmetuar prej zonjës Aishe, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, është vërtetuar se ka thënë: *“I Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, shtrihej në prehrin tim dhe recitonte Kuran, ndërsa unë isha me menstruacione.”*¹

Në një transmetim tjetër po prej Buhariut, thuhet: *“...duke e recituar Kuranin, ndërsa koka e tij ishte në prehrin tim.”*

Ky hadith dëshmon qartë se prania e një gruaje me menstruacione nuk e pengon leximin apo recitimin e Kuranit prej të tjerëve. Ai gjithashtu tregon butësinë dhe natyrshmërinë e marrëdhënies së Pejgamberit *alejhi selam* me familjen e tij, si dhe mirësinë e sjelljes së tij ndaj gruas, pa paragjykime apo ngurtësi të panevojshme.

Kjo është një dëshmi e mëshirës, e urtësisë dhe e balancës së Islamit, i cili gjithmonë ruan nderin dhe pastërtinë shpirtërore, pa e ngarkuar njeriun përtej mundësive të tij.

Ebu Musa El Eshariu, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ka thënë: “Unë e recitoj Kuranin si në namazin tim, ashtu edhe në shtratin tim.”

Zonja Aishe, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ka thënë: “Unë e recitoj hizbin² tim edhe gjersa jam e shtrirë në shtrat.”³

SHQIPTIMI I ISTIADHES

Kur dikush synon të fillojë recitimin e Kuranit, së pari duhet të kërkojë mbrojtjen dhe ndihmën e Allahut nga shejtani i mallkuar, duke thënë: *“Eudhu bilahi mine shejtani rraxhim”* (Po i kërkoj mbrojtje Allahut nga shejtani i mallkuar!).

1 Transmetuar prej Buhariut dhe Muslimit.

2 Fjala “hizb” në këtë kontekst i referohet pjesës ditore të Kuranit që një person ka zakon ta recitojë rregullisht. Në ndarjen tradicionale të mushafit, një xhuz (nga 30 gjithsej) ndahet në dy hizbe, dhe çdo hizb ndahet më tej në katër pjesë më të vogla, të quajtura çerekë. Megjithatë, këtu qëllimi është pjesa e veçantë e Kuranit që Aishja (radijallahu anha) e recitonte rregullisht si pjesë e adhurimit të saj personal. (Sqarim i përkthyesit).

3 Ebu Ubejde, *Fedailu El Kuran*; Ibën Shejbe, *Musannef*, bot. Abd El Hattab, vëll. 2, f. 380.

Ky është veprim i miratuar prej shumicës së dijetarëve, të cilët bazohen në ajetin e Kuranit: ***“Kur të dëshirosh ta lexosh Kuranin, kërko mbrojtjen e Allahut nga shejtani i mallkuar”*** (En Nahël, 98)

Istiadhja shqiptohet përpara fillimit të recitimit të Kuranit, si një përgatitje shpirtërore dhe një mbrojtje e menjëhershme ndaj ndikimeve të liga që mund të pengojnë përqendrimin dhe devocionin në leximin e Fjalës së Zotit.

PËRSHKRIMI I ISTIADHES

Forma më e zakonshme dhe e përzgjedhur e istiadhës (kërkesa për mbrojtjen e Allahut kundër shejtanit të mallkuar, i cili ngjall lutim dhe dyshime) është ajo që kemi përmendur më parë: *Eudhu bilahi mine shejtani rraxhim*.

Megjithatë, disa nga gjenerata e parë (selefëve) kanë përdorur edhe një formë tjetër: *Eudhu bilahi semiil alimi mine shejtani rraxhim*, që do të thotë: Kërkoj mbrojtje tek Allahu, i Cili dëgjon gjithçka dhe di gjithçka, ndaj shejtanit të mallkuar.

Kjo formë është e vlefshme dhe e pranueshme, dhe nuk ka asgjë të keqe në përdorimin e saj. Megjithatë, forma e parë mbetet më e preferuara dhe më e përhapura ndër myslimanët.

HUKMI (VENDIMI) I ISTIADHES

Shqiptimi i istiadhës para fillimit të këndimit të Kuranit është mustehab (i rekomanduar) dhe jo i detyrueshëm.¹ Kjo praktikë këshillohet për çdo këndues, pa dallim nëse ndodhet në namaz apo jashtë tij.

Brenda namazit, istiadhja është e rekomanduar në çdo rekat, sipas mendimit më të saktë të dijetarëve të medhhebit shafii. Sipas një mendimi tjetër, ajo thuhet vetëm në rekatën e parë, dhe nëse lihet pa u shqiptuar në atë rekat, kompensohet në të dytin.

¹ Sipas shumicës së dijetarëve të tre medhhebeve – hanefi, maliki dhe shafi – shqiptimi i istiadhës para leximit të Kuranit është i pëlqyeshëm (mustehab) ose sunet. Ndërkaq, dijetarët e medhhebit hanbeli e konsiderojnë atë të detyrueshme (vaxhib). (Plotësimi i përkthyesit.)

Gjithashtu, sipas mendimit më të qëndrueshëm, është e pëlqyeshme që istiadhja të shqiptohet edhe në namazin e xhenazes, pas shqiptimit të fjalës *Allahu ekber*.¹

LEXIMI I BESMELES

Duhet treguar kujdes që të shqiptohet **“Bismilahi Rrahmani Rrahim”** (*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit*) në fillim të çdo kaptine të Kuranit, me përjashtim të sures *Et Tevbeh* (ose *El Beraeh*).

Shumica e dijetarëve e konsiderojnë besmelen si ajet kuranor, pasi ajo është e shkruar në mus’haf, në fillim të çdo sureje, përveç *Et Tevbes*. Për rrjedhojë, nëse dikush e lexon atë, konsiderohet se e ka plotësuar leximin e një kaptine apo të vetë Kuranit. Ndërsa, nëse lihet pa u shqiptuar, atëherë, sipas shumicës së dijetarëve, konsiderohet se është lënë pa u lexuar një pjesë e Kuranit.²

Në rastet kur leximi i Kuranit është pjesë e një shërbimi me pagesë, sikurse, p.sh.: kur lexohet një e shtata (subu) apo një e tridhjeta (*xhuzi*), kur zakonisht përfshihen dhurata dhe shpërblime materiale, duhet treguar kujdes i veçantë për ta lexuar besmelen. Kjo për arsye të sigurimit që recituesi e meriton shpërblimin dhe pagesën që merr, pasi, nëse ai e lë pa e lexuar besmelen, sipas atyre që e konsiderojnë atë ajet në fillim të sureve, atëherë nuk do të meritonte asnjë shpërblim për leximin.

Ky detaj i rëndësishëm meriton vëmendje të veçantë dhe thekson përgjegjësinë shpirtërore dhe etike të atyre që e recitojnë Librin e Shenjtë në emër të shpërblimit.

1 Kjo është sipas medhhebit shafii. (Sqarim i përkthyesit.)

2 Jo të gjithë dijetarët bien dakord se besmelja është pjesë përbërëse e çdo sureje. Shkolla e medhhebit hanefi dhe disa nga sahabët e hershëm mendojnë se ajo nuk përbën pjesë të sures, por shërben si një shenjë ndarëse mes sureve, përveç surës *En Neml* (ku ajo përmendet qartësisht si ajet 27:30). (Sqarim i përkthyesit.)

PËRSIATJA DHE PËRULËSIA GJATË LEXIMIT TË KURANIT

Kur njeriu e fillon leximin e Kuranit, gjendja e tij shpirtërore duhet të jetë ajo e përlësisë dhe e përsiatjes së thellë. Kjo është gjendja e kërkuar dhe e dëshiruar, përmes së cilës hapen gjokset, ndriçohen zemrat dhe zbuten shpirtrat. Ky nuk është thjesht një qëndrim i rekomanduar, por një qëllim i vetë shpalljes hyjnore. Allahu i Madhërishëm thotë: **“Vallë, a nuk përsiatin ata për Kuranin?”** (Muhammed, 24)

Dhe, gjithashtu: **“Ky (Kuran) është një Libër i bekuar që Ne ta kemi zbritur ty (Muhammed), për të përsiatur mbi vargjet e tij dhe për t’u këshilluar me atë të mençurit.”** (Sad, 29)

Hadithet që flasin për vlerën e përsiatjes janë shumë, ndërsa thëniet dhe shembujt nga gjeneratat e para të myslimanëve janë të njohura. Disa prej tyre kalonin net të tëra duke recituar vetëm një ajet, duke e përsëritur me përkushtim dhe duke reflektuar mbi të deri në agim. Disa binin në gjendje alivanosjeje nga madhështia e Fjalës së Allahut, madje ka edhe raste kur e kanë përjetuar vdekjen gjatë leximit të Kuranit.

Prej Behz bin Hakimit transmetohet se Zurare bin Eufa, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, nga gjenerata e tabiinëve, një mëngjes, gjatë namazit të sabahut, duke qenë imam, recitoi deri kur arriti tek ajetet: **“E kur të fryhet në Sur, ajo do të jetë një ditë e rëndë.”** (El Muddethir, 8–9)

Në atë çast ai ra përtokë dhe ndërroi jetë. Behzi thotë: “Unë isha njëri prej atyre që e bartën trupin e tij.”

Po ashtu, prej dijetarëve dhe asketëve të devotshëm përmendet Ahmed bin Ebi El Havari, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, i njohur si shkëlqimi i Sirisë. Për të thuhet se, kur dëgjonte leximin e Kuranit, bërtiste me zë të lartë nga ndjenja e frikës dhe dashurisë ndaj Allahut, dhe binte në gjendje alivanosjeje.

Ibën Ebi Davudi rrëfen se El Kasim bin Uthman El Xhuiu, *Allahu e mëshiroftë*, dijetar i njohur i haditheve në Damask dhe më i përparuar në dituri se Ahmed bin Ebi El Havari, e qortonte këtë të fundit për sjelljen e tij gjatë leximit të Kuranit. Ai përmendte se edhe dijetarë të

tjerë si Ebu El Xhevza, Kajs bin Habter dhe të tjerë e kishin kritikuar, ndërsa vetë transmetuesi shton: “Unë mendoj se nuk ka arsye për ta qortuar dikë, përveç nëse ai e pranon se e bën këtë me qëllim shtirjeje (për t’u dukur).”

Dhe, Allahu e di më së miri.

Sejid Ibrahim El Havas, një prej mjeshtërve të thellë të botës shpirtërore, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ka thënë: “Zemra ka pesë ilaçe: leximi i Kuranit me përsiatje, zbrazja e stomakut, namazi gjatë natës, lutja në pjesën e fundit të natës dhe shoqërimi me njerëz të mirë.”

PËRSËRITJA E NJË AJETI PËR MEDITIM

Siç është përmendur më parë, meditimimi për Kuranin (tedebbur) përbën një nga shtyllat më thelbësore të përjetimit të tij të drejtë. Ky reflektim i thellë mbi fjalët e Allahut, jo vetëm që pasqyron madhështinë e Librit Hyjnor, por edhe dëshmon ndjeshmërinë dhe përkushtimin e gjeneratës së parë të myslimanëve ndaj tij.

Një dëshmi prekëse për këtë gjendje vjen prej Ebu Dherrit, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, i cili transmeton se pejgamberi Muhamed, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, e kaloi një natë të tërë në këmbë, duke e përsëritur vazhdimisht vetëm një ajet, deri në agim. Ajeti që ai e recitonte ishte: “**Nëse i dënon ata, në të vërtetë ata janë robërit Tu; e nëse i fal, Ti me të vërtetë je i Plotfuqishëm dhe i Urtë.**” (El Maide, 118)

Ky transmetim është përcjellë prej Nesaiut dhe Ibën Maxhes, dhe pasqyron thellësinë shpirtërore dhe ndjeshmërinë e Pejgamberit ndaj Fjalës së Zotit. Ai nuk e shihte Kuranin si një tekst për t’u kaluar shpejt me lexim, por si një shpallje që kërkon ndalim, përsiatje dhe përvetësim të plotë.

Prej Temim Ed Dari, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, transmetohet se një natë, deri në agim, ai e përsëriti vazhdimisht këtë ajet: “**A mos mendojnë ata që bëjnë vepra të këqija se Ne do t’i bëjmë të njëjtë me ata që kanë besuar dhe që kanë bërë vepra të mira, si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në jetën tjetër?! Sa keq që gjykojnë!**” (El Xhathije, 21)

Shembujt e gjeneratës së parë të myslimanëve tregojnë në mënyrë të gjallë se si Kuranin nuk e trajtonin thjesht si lexim, por si një përjetim që ngjizej në zemër dhe shpirt.

Prej Abad bin Hamza transmetohet të ketë thënë: “Esmanë, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, e vizitova dhe e gjeta duke lexuar ajetin: **“Mirëpo Allahu na ka dhuruar mëshirë dhe na ka ruajtur nga era përcëlluese (e Zjarrit).”** (Et Tur, 27)

Qëndrova pranë saj, dhe ajo e përsëriste vazhdimisht këtë ajet, duke u lutur dhe përgjëruar. Dhe, kaloi shumë kohë ashtu, saqë shkova në treg dhe u mora me punët e mia. Kur u ktheva, ajo ende e përsëriste të njëjtin ajet, duke u lutur me përlësi dhe mall.”

I njëjti përjetim dhe përkushtim është transmetuar edhe prej zonjës Aishe, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, e cila gjithashtu kalonte kohë të gjatë duke u ndalur në një ajet të vetëm, duke medituar dhe duke u përgjëruar para Allahut.

Ibën Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, transmetohet se e përsëriste shpesh ajetin: **“Zoti im, më shto dituri!”** (Taha, 114)

Për Seid bin Xhubejrin, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, njërin prej dijetarëve të njohur të tabiinjeve, transmetohet se ndalej gjatë dhe i përsëriste disa ajete të caktuara, që përmbanin paralajmërim, ndër-gjegjësim dhe thirrje për pendim. Ai përsëriste: **“Dhe ruajuni asaj Dite që do të ktheheni tek Allahu...”** (El Bekare, 281)

Dhe gjithashtu: **“Do ta marrin vesh të vërtetën kur t’u vihen prangat dhe zinxhirët rreth qafës së tyre.”** (Gafir, 70–71)

Dhe shpesh ndalej te fjala e Allahut: **“O njeri, ç’të mashtroi ty që nuk i besove Zotit tënd Bujar?!”** (El Infitar, 6)

Dahaku, *Allahu e mëshiroftë*, njëri prej komentuesve të hershëm të Kuranit, kur e lexonte ajetin: **“Ata do të mbulohen me shtresa zjarri nga sipër dhe nga poshtë...”** (Ez Zumer, 16), ndalej gjatë dhe e përsëriste atë deri në fund të natës, i përfshirë në frikë dhe përlësi para madhësisë së Fjalës së Allahut.

TË QARËT GJATË LEXIMIT TË KURANIT

Të qarët gjatë leximit të Kuranit është një shenjë e ndjeshmërisë së lartë shpirtërore dhe e ndër-gjegjes së zgjuar për Fjalën e Allahut. Siç është përmendur edhe më herët, kjo gjendje buron nga përsiatja e thellë (tedebbur) dhe nga lidhja intime që besimtari krijon me Shpalljen Hyjnore.

Të qarët nuk është thjesht emocion i jashtëm, por një reflektim i njohjes së vërtetë të Zotit, një cilësi e atyre që janë të vetëdijshëm për madhësinë e Tij dhe për dobësinë e vetes. Kjo është cilësi e *arifëve*, atyre që kanë arritur njohuri të thella për Allahun, si dhe një tipar dallues i robërve të mirë e të devotshëm.

Allahu i Lartmadhërishtëm thotë: ***“Ata bien me fytyrë përtokë, duke qarë, dhe ai (leximi i Kuranit) ua rrit përuljen.”*** (El Isra, 109)

Shumë hadithe të Pejgamberit, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, janë transmetuar, si dhe thënie të shumta nga gjeneratat e para të myslimanëve (selefët), e që dëshmojnë për përjetimin e thellë emocional gjatë leximit të Kuranit.

Ndër hadithet më të njohura në këtë drejtim është fjala e Pejgamberit, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*: *“Lexojeni Kuranin dhe qani! E nëse nuk qani, atëherë bëhuni sikur po qani!”*¹

Omer bin Hattabi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, e fali një ditë namazin e sabahut me xhemat dhe e lexoi suren Jusuf. Gjatë leximit ai qau aq shumë, sa që lotët i rridhnin poshtë në qafë. Sipas një transmetimi tjetër, kjo ndodhi gjatë namazit të jacisë, duke treguar se kjo ndjeshmëri shpirtërore ishte pjesë e përhershme e karakterit të tij. Në një version tjetër thuhet se ai qau me zë, aq sa të të qarat e tij dëgjoreshin edhe tek ata që ndodheshin në safat e pasëm.

Ebu Rexha transmeton: “Unë e kam parë Ibën Abbasin, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, dhe poshtë syve të tij shiheshin shenjat e lotëve.”

Po ashtu, Ebu Salihu tregon një skenë prekëse nga koha e Ebu Bekrit, *Allahu qoftë i kënaqur me të*: “Një grup njerëzish nga Jemeni erdhën tek Ebu Bekri dhe filluan të lexojnë Kuranin. Gjatë leximit ata qanin. Ebu Bekri, i prekur thellë nga kjo gjendje, tha: “Kështu ishim edhe ne.”

Hishami rrëfen një moment prekës nga jeta e të parëve tanë të devotshëm: “Ndonjëherë e dëgjoja Muhamed bin Sirinin duke qarë gjatë natës, teksa ishte në namaz.”

1 Prej Ibën Maxhes shënohet; El Bezzari në *Musned*-in e tij; El Kadai në *Musned Esh Shihab*; dhe, Ed Devrekiu në *Musned Sad*, prej zotërisë sonë, Sad bin Ebi Vekkasit, *Allahu qoftë i kënaqur me të*.

Transmetimet për këtë janë të shumta dhe të pamundura për t'u përmbledhur. Ajo që u përmend më sipër është e mjaftueshme për këdo që dëshiron të udhëzohet dhe të frymëzohet. E, në fund, Allahu e di më së miri.

Imam Ebu Hamid El Gazali, *Allahu e mëshiroftë*, ka theksuar rëndësinë e ndjeshmërisë gjatë leximit të Kuranit. Ai thotë: “Gjatë leximit të Kuranit rekomandohet që njeriu të qajë. Mënyra për ta arritur këtë është që lexuesi të ndiejë pikëllim të thellë, duke medituuar mbi kërcënimet dhe paralajmërimet që përmban Kurani, mbi besëlidhjet dhe marrëveshjet hyjnore që përmenden në të, dhe më pas të reflektojë mbi lëshimet dhe të metat e tij personale.”

Dhe, nëse kjo gjendje shpirtërore nuk e përfshin, siç ndodh me një zemër të gjallë dhe të ndjeshme, atëherë thotë Gazali¹: “Le të qajë për shkak se nuk është në gjendje të qajë, sepse mungesa e ndjeshmërisë ndaj Fjalës së Allahut është ndër fatkeqësitë më të mëdha.”²

LEXIMI I KURANIT NGADALË DHE QARTË (ME TERTIL)

Një nga rregullat më të rëndësishme të leximit të Kuranit është që ai të lexohet me tertil, domethënë, ngadalë, me qartësi, bukuri dhe përsiatje.

Besimtari duhet ta shqiptojë Kuranin saktë, pa gabime, duke ia dhënë çdo shkronjë dhe fjale hakun e saj. Kjo mënyrë leximi është ajo që i përshtatet më shumë madhështisë së Fjalës së Allahut, dhe që ndihmon në thellimin e kuptimit dhe të përjetimit të saj.

1 Imam Gazali, *Ihjaw Ulumi Ed Din*, vëll. 1, f. 277.

2 Ndjeshmëria ndaj Fjalës së Allahut dhe emocionet që lindin gjatë leximit të Kuranit kanë qenë një karakteristikë dalluese e sahabëve dhe tabi'inëve. Fatkeqësisht, kjo kulturë shpirtërore është rralluar mes nesh. Si muslimanë shqiptarë, veçanërisht si hoxhallarë dhe edukatorë të ummetit, na takon të punojmë me përkushtim për të ringjallur dhe kultivuar këtë ndjeshmëri, duke e mësuar dhe transmetuar atë edhe brezave të rinj. Ky përkushtim mund të mbështetet nga ajete të ndryshme kuranore që flasin për fuqinë e zemrës që dridhet para Fjalës së Allahut, si p.sh. ajeti: **“Besimtarë të vërtetë janë ata, zemrat e të cilëve dridhen kur përmendet Allahu, dhe kur u lexohen atyre ajetet e Tij, që u shtohet imani...”** (*El Enfal*, 2). (Vërejtje e redaktorit.)

Dijetarët janë unanimisht të mendimit se është e rekomanduar (*mustehab*) që Kurani të lexohet me tertil.

Allahu i Lartë thotë: **“Dhe Kuranin lexoje ngadalë, bukur dhe qartë (me tertil)!”** (El Muzzemmil, 4)

Një dëshmi e qartë për rëndësinë e leximit të Kuranit me tertil vjen nga Umu Seleme, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, e cila ka përshkruar mënyrën se si e lexonte Kuranin i Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*. Ajo tregon: “Ai e shqiptonte tekstin e Kuranit ngadalë dhe qartë, aq sa mund të dallohej qartë çdo shkronjë.”¹

Muavije bin Kurra transmeton se Abdullah bin Mugafeli, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ka thënë: “Në ditën e çlirimit të Mekës e pashë të Dërguarin e Allahut mbi devenë e tij, duke kënduar suren El Fet’h. Ai e këndonte qartë, me një zë të gjallë dhe të bukur.”²

Edhe Ibën Abbasi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ka shprehur rëndësinë e thellimit dhe të kuptimit përmes leximit të ngadalë dhe të qartë. Ai ka thënë: “Për mua është më e dashur ta lexoj një sure ngadalë dhe qartë, sesa ta lexoj gjithë Kuranin shpejt e shpejt.”

Muxhahidi³ është pyetur për dy burra që falën të njëjtin namaz. Njëri prej tyre e lexoi suren El Bekare dhe Ali Imran, ndërsa tjetri e lexoi vetëm suren El Bekare. Megjithëse koha që ata kaluan në ruku, sexhde dhe qëndrim ulur ishte saktësisht e barabartë, Muxhahidi u përgjigj: “Ai që lexoi vetëm suren El Bekare është më i mirë.”

Leximi i shpejtë dhe me nguti të tepruar, i njohur në terminologjinë klasike si *hedhdhe*, është i ndaluar, sepse shkel etikën e respektit ndaj Fjalës së Allahut dhe nuk lejon përjetimin e saj të vërtetë.

Për një burrë është transmetuar se i tha Abdullah bin Mesudit, *Allahu qoftë i kënaqur me të*: “I këndova suret e shkurtra (mufassal) në një rekat të vetëm.”

1 Ky hadith është transmetuar prej Ebu Davudit, Tirmidhiut dhe Nesaiut, dhe Imam Tirmidhiu e ka cilësuar atë si *hasen sahih*, që nënkupton se është një hadith i besueshëm dhe me zinxhir transmetimi të qëndrueshëm.

2 Transmetuar prej Buhariut dhe Muslimit.

3 Dijetar i njohur prej radhës së tabiinjeve.

Ibën Mesudi iu përgjigj: “Kjo është si një poezi e recituar me shpejtësi. Ka njerëz që e lexojnë Kuranin, mirëpo ai nuk u shkon përtej fytit. Kurani është i dobishëm vetëm kur futet në zemër dhe rrënjohet thellë në të.”¹

Ky transmetim, që është një nga versionet e Muslimit, tregon qartë se leximi i Kuranit pa përqendrim dhe pa përsiatje është i mangët dhe i privuar nga ndikimi i vërtetë shpirtëror. Leximi i nxituar, i cili bëhet për sasi dhe jo për përmbajtje, është i krahasueshëm me një recitim të shpejtë poezie, pa kuptim dhe pa ndjenjë.

Dijetarët kanë theksuar se leximi ngadalë është i rekomanduar edhe për shkak se e lehtëson kuptimin dhe e nxit meditimin mbi ajetet. Madje, ata kanë shtuar se edhe një person që nuk i kupton domethëniet e Kuranit, si një i huaj që nuk e njeh mirë gjuhën arabe, këshillohet të lexojë ngadalë. Kjo për shkak se leximi i qetë dhe i përlur është më i afërt me qëndrimin e nderimit dhe të respektit ndaj Fjalës së Zotit, dhe ndikon më thellë në zemër.

PËRGJËRIMI GJATË LEXIMIT TË KURANIT

Gjatë leximit të Kuranit është e rekomandueshme që lexuesi të reagojë me zemër dhe lutje ndaj përmbajtjes së ajeteve. Kur kalon pranë një ajeti ku përmendet mëshira e Allahut, le të lutet me përlurësi dhe shpresë: të kërkojë nga bujaria dhe mëshira e Tij. Kur has në ajete që flasin për dënim apo kërcënim, le t’i drejtohet Zotit me frikë dhe mbështetje, duke thënë: “*O Zot, më ruaj nga çdo e keqe*”, ose lutje të ngjashme që shprehin kërkesën për mbrojtje.

Po ashtu, kur ndeshet me ajete që e lavdërojnë dhe e madhërojnë Allahun, i përshtatet që edhe vetë ta lavdërojë dhe ta madhërojë Zotin, duke thënë: “*I Lartmadhërishëm është Ai*”, “*Pa të meta është Ai*”, “*I Lartë qoftë*”, dhe të ngjashme. Kjo sjellje e shton përjetimin shpirtëror dhe e thellon lidhjen me Fjalën e Allahut.

Hudhejfe bin El Jemani, *Allahu qoftë i kënaqur me të dhe me babain e tij*, rrëfen: “Një natë u fala në namaz me Pejgamberin, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*. Ai e nisi namazin me suren El

¹ Transmetuar prej Buhariut dhe Muslimit.

Bekare. Unë mendova se do të binte në ruku tek ajeti i njëqindtë, mirëpo ai vazhdoi më tej. Me vete thashë: “Ndoshta do ta përfundojë suren, dhe pastaj do të përkulet.” Mirëpo, edhe pas mbarimit të saj, ai vazhdoi. Dhe e filloi suren En Nisa, dhe e lexoi të gjithën. Mendova sërish se tani do të përkulej, mirëpo ai vazhdoi dhe e filloi suren Ali Imran, të cilën gjithashtu e lexoi të plotë. Ai lexonte ngadalë dhe me përqendrim. Sa herë kalonte pranë një ajeti që e madhëronte Allahun, thoshte: *Subhanallah* (i Pastër dhe i Lartë është Allahu nga çdo e metë). Kur kalonte pranë një ajeti ku bëhej lutje apo kërkesë, ai vetë lutej. Kur kalonte pranë një ajeti ku kërkohej mbrojtje nga e keqja apo nga shejtani, kërkonte mbrojtjen e Allahut.”¹

Shënim: Në atë kohë, në renditjen e ajeteve që kishte Hudhejfe, *radijallahu anhu*, surja En Nisa vinte përpara sures Ali Imran.

Dijetarët e medhhebit tonë, *Allahu i mëshiroftë*, kanë theksuar se është e rekomanduar që gjatë leximit të Kuranit të bëhet lutje, të kërkohej mbrojtje (istiadhe), si dhe të thuhet *subhanallah*, pavarësisht nëse lexuesi është në namaz apo jashtë tij.

Ky rekomandim vlen për të gjithë: për imamin, për atë që e ndjek imamin (muktediun), si dhe për atë që falet individualisht. Kjo për arsye se lutjet janë forma adhurimi, dhe në këtë aspekt të gjithë besimtarët janë të barabartë. Po ashtu, kjo praktikë është e ngjashme me thënien e *amin* pas leximit të sures El Fatiha, e cila po ashtu është e preferuar për të gjithë, si në namaz, ashtu edhe jashtë tij.

Ajo që u përmend më sipër lidhur me natyrën e rekomanduar të përgjërimit, kërkit të mëshirës dhe mbrojtjes (istiadhes) gjatë leximit të Kuranit, përfaqëson mendimin e medhhebit të Imam Shafiut dhe të shumicës së dijetarëve, Allahu i mëshiroftë. Sipas tyre, këto janë veprime të pëlqyera, si brenda, ashtu edhe jashtë namazit. Megjithatë, sipas Imam Ebu Hanifes, *Allahu e mëshiroftë*, kjo nuk është e rekomanduar gjatë namazit; madje, ai e konsideron të papëlqyeshme (mekruh) që të bëhen lutje të tilla në këtë kontekst.² Qëndrimi më i

¹ Transmetuar prej Muslimit.

² Shënim: Imami hanefi El Merginani, në veprën e tij *El-Hidaje*, thotë: “Muktediu (ai që falet pas imamit) dëgjon leximin e imamit dhe qëndron i heshtur, edhe nëse imami lexon ajete që flasin për inkurajim dhe frikësim (tergib dhe terhib).”. Ndërsa dijetari

saktë është ai i shumicës së dijetarëve, bazuar në argumentet e përmendura më sipër.

RESPEKTI NDAJ KURANIT DHE PAKUJDESIA E DISA LEXUESVE

Ndër çështjet që meritojnë të theksohen është edhe kujdesi gjatë leximit të Kuranit, veçanërisht kur njerëzit mbledhen për ta dëgjuar ose për ta lexuar së bashku. Fatkeqësisht, disa lexues tregohen të pakujdesshëm ndaj etikës së leximit, duke harruar rregullat që lidhen me respektin ndaj Fjalës së Allahut.

Nga normat themelore të etikës janë shmangia e qeshjeve, e zhurmës dhe e bisedave gjatë leximit apo këndimit të Kuranit, me përjashtim të fjalëve absolutisht të domosdoshme. Kjo përputhet me urdhrin e drejtpërdrejtë të Allahut të Lartë: ***“Kur të lexohet Kurani, dëgjoni dhe heshtni, në mënyrë që të mëshiroheni!”*** (El Araf, 204)

Lexuesi i Kuranit duhet ta ndjekë shembullin e transmetuar prej Ibën Ebi Davudit për Abdullah bin Omerin, *Allahu qoftë i kënaqur me të dhe me babanë e tij*, ku thuhet: *“Sa herë që ai lexonte Kuran (jashtë namazit), nuk fliste derisa të përfundonte leximin që kishte ndërmend.”* Ky transmetim përmendet prej Imam Buhariut në *Sahihun* e tij, ku ai shton: *“Ai nuk foli derisa mbaroi leximin e tij.”* Ky citim gjendet në Librin e Tefsirit, gjatë komentimit të ajetit: ***“Gratë tuaja janë “ara” për ju...”*** (El Bekare, 223)

Gjithashtu, duhet shmangur çdo lëkundje apo lojë me duar gjatë leximit të Kuranit. Duke qenë se lexuesi i drejtohet Zotit të tij me përulësi dhe respekt, nuk është e përshtatshme të luajë me duar apo të bëjë lëvizje të kota gjatë këtij akti adhurimi.

hanefi Kemal bin El Humam, Allahu e mëshiroftë, në veprën e tij *Fet’hu El Kadir*, shënon: “Pasi Allahu i Lartë ka premtuar mëshirë për ata që e dëgjojnë Kuranin, kur thotë: “Kur të lexohet Kurani, dëgjoni dhe heshtni, në mënyrë që të mëshiroheni” (El-A’raf, 204), dhe premtimi i Tij është i vërtetë, atëherë të preokupohesh me lutje dhe kërkesa në këtë moment nuk është e detyrueshme. Prandaj, as imami nuk preokupohet me diçka tjetër përveç leximit të Kuranit, qoftë në namazet farz apo nafile. Ndërsa ai që falet individualisht, në namazet nafile mund të kërkojë Xhenetin dhe të kërkojë mbrojtje nga Zjarri, kur përmenden këto në ajete gjatë leximit të Kuranit.”.

Një tjetër çështje që duhet shmangur gjatë leximit të Kuranit është shikimi i gjërave që shpërqëndrojnë vëmendjen dhe që e largojnë përkushtimin shpirtëror. Ndër më të papranueshmet është shikimi i asaj që në vetvete është e ndaluar për t'u parë, pasi kjo bie ndesh me edukatën (etikën) dhe seriozitetin që kërkon leximi i Fjalës së Allahut.

Megjithatë, në raste të nevojshme dhe të justifikuara, si në blerje dhe shitje, në marrëdhënie të përkohshme të dhënies dhe marrjes, në fushën mjekësore, arsimore apo në situata të tjera të domosdoshme, lejohet shikimi i kufizuar dhe i matur vetëm brenda asaj që është absolutisht e nevojshme dhe pa i tejkaluar kufijtë e lejuar.

Në çdo rrethanë është rreptësisht i ndaluar shikimi me epsh, qoftë ndaj burrave apo grave, pavarësisht nëse gruaja është mahrem (me të cilën ndalohet martesë) apo jo, me përjashtim të bashkëshortes, për të cilën kjo çështje ka rregulla të veçanta.

Allahu është më i Dijshmi dhe më i Urti.

Kushdo që merr pjesë në një mexhlis ku lexohet Kurani dhe vëren ndonjë nga veprimet e pahijshme që përmendëm më sipër, ose të ngjashme, duhet t'i ndalojë ato me çdo mjet të mundshëm: me dorë, nëse ka mundësi; me fjalë, nëse nuk mund të veprohet fizikisht; e nëse as me dorë dhe as me fjalë nuk mund të ndalohet, atëherë duhet të urrehet me zemër. Allahu e di më së miri.

LEXIMI I KURANIT NË NJË GJUHË TJETËR PËRVEÇ ARABISHTES

Nuk lejohet të lexohet Kurani në një gjuhë tjetër përveç arabishtes, pavarësisht nëse personi e zotëron gjuhën arabe apo jo, si gjatë namazit ashtu edhe jashtë tij. Nëse dikush reciton Kuranin në një gjuhë tjetër gjatë faljes, namazi i tij konsiderohet i pavlefshëm. Ky është qëndrimi i medhhebit tonë (shafii), ashtu si edhe i medhhebit të Imam Malikut, Imam Ahmedit, Davudit dhe Ebu Bekër bin Mundhirit.

Nga ana tjetër, Imam Ebu Hanife ka dhënë mendimin se lejohet leximi i Kuranit në një gjuhë tjetër përveç arabishtes, dhe në këtë rast, sipas tij, namazi mbetet i vlefshëm. Sidoqoftë, dy nxënësit e tij, Ebu

Jusufi dhe Muhamedi, kanë sqaruar se kjo leje vlen vetëm për ata që nuk e zotërojnë gjuhën arabe, ndërsa për ata që e dinë arabishten, leximi në gjuhë tjetër nuk lejohet.

LEXIMI I KURANIT ME KIRAETET MUTEVATIR DHE SHADH¹

Leximi i Kuranit lejohet me cilindo nga shtatë kiraetet mutevatir (leximet e miratuara me transmetim të shumanshëm e kolektiv). Leximi me ndonjë kiraet tjetër nuk lejohet, si dhe as përdorimi i rivajeteve *shadhdheh* (të parregullta), edhe nëse ato janë transmetuar prej ndonjërit prej shtatë kurrave (lexuesve të mirënjohur).

Kjo çështje do të trajtohet më në hollësi në kapitullin e shtatë, me vullnetin e Allahut, ku do të sqarojmë qëndrimin e juristëve islamë (fukahave), të cilët janë unanimisht të mendimit se ai që e lexon Kuranin me kiraetet *shadh*, duhet të kërkojë pendim.

Dijetarët tanë të medhhebit shafii, si edhe dijetarë të tjerë, kanë thënë se, nëse dikush e lexon Kuranin me një kiraet *shadh* gjatë namazit, namazi i tij është i pavlefshëm, nëse ai është i vetëdijshëm për ndalesën e një leximi të tillë. Mirëpo, nëse personi nuk ka pasur dijeni për këtë rregull, atëherë namazi i tij është i vlefshëm; megjithatë, lexuesi nuk shpërblehet për atë lexim.

Imam Ebu Amër bin Abdulberr, një prej autoriteteve të mëdha në Hadith, transmeton se në mesin e myslimanëve ekziston konsensus që leximi i Kuranit me një kiraet *shadh* nuk lejohet, dhe se nuk lejohet të falet namazi pas dikujt që lexon me një lexim të tillë.

1 Kiraeti është leximi i Kuranit që transmetohet drejtpërdrejt nga një imam i njohur i leximit, si, p.sh.: Imam Asim, Imam Nafiu, Ibën Kethiri etj. Rivajeti është leximi i nxënësit të tij, si Hafsi prej Asimit, Varshi prej Nafiut, e të ngjashëm. Tariqi është zinxhiri i transmetimit nga nxënësi i nxënësit. Një kiraet mutevatir (i vërtetuar dhe i saktë) pranohet kur plotëson këto tri kushte: 1) ka zinxhir të saktë transmetimi; 2) përputhet me shkrimin e mushafit të Uthmanit (Resm El Uthmani); dhe 3) kuptimi i tij është në përputhje me rregullat e gjuhës arabe. Kiraeti shadh (jo i rregullt) është ai në të cilin mungon një nga këto tri kushte. Ky nuk lexohet në namaz, por mund të ketë vlerë në fusha të tjera studimore, si fikh apo gramatikë. Kiraetet shadhdha janë trajtuar në literaturë të veçantë të kësaj fushe. (Shënim i rëndësishëm prej redaktorit.)

Dijetarët kanë thënë se kushdo që lexon me një kiraet *shadh*, pa e ditur se është i tillë apo pa qenë në dijeni se një lexim i tillë është i ndaluar, dhe më pas informohet siç duhet, por vazhdon ta përsëritë atë me vetëdije, duhet të qortohet ashpër derisa të heqë dorë nga ajo praktikë. Çdokush që ka mundësi ta ndalojë ose ta raportojë një veprim të tillë, është i detyruar ta bëjë këtë, për ta ruajtur korrektësinë e leximit të Kuranit dhe rregullat e fesë.

KALIMI NGA NJË KIRAET NË NJË TJETËR

Nëse dikush e fillon leximin e Kuranit duke ndjekur një nga kiraetet e pranura dhe të transmetuara me zinxhir të saktë (mutevativ), nuk i lejohet të kalojë në një kiraet tjetër për aq kohë sa fjalët janë të lidhura në një lexim të njëpasnjëshëm. Megjithatë, kalimi në një tjetër kiraet prej atyre të miratuar lejohet në një pikë ku ka ndodhur një ndalesë natyrale (pauzë e shkurtër ose përfundim ajeti). Sidoqoftë, më e mira është që lexuesi të vazhdojë me të njëjtin kiraet gjatë gjithë leximit, për hir të qëndrueshmërisë dhe rregullsisë.

TË LEXUARIT SIPAS RENDITJES SË MUS'HAFIT

Dijetarët kanë thënë se është e preferuar që Kurani të lexohet sipas renditjes së ajeteve dhe sureve në mus'haf. Për shembull, të fillohet me suren El Fatiha, pastaj El Bekare, më pas Ali Imran, dhe kështu me radhë, sipas rendit të vendosur në mus'haf, qoftë ky lexim brenda namazit, apo jashtë tij.

Madje, disa dijetarë të medhhebit shafii kanë thënë se, nëse dikush e lexon në rekatin e parë suren En Nas, atëherë në rekatin e dytë duhet ta lexojë suren El Bekare (Elif Lam Mim), në mënyrë që mos të përmbysset rendi i leximit në brendësi të namazit.

Disa prej dijetarëve tanë kanë theksuar se është e rekomanduar që kur dikush ta lexojë një sure, të vazhdojë menjëherë me atë që vjen pas saj në renditjen e mus'hafit. Ky rekomandim mbështetet në faktin se renditja e sureve në mus'haf është vendosur me urtësinë hyjnore dhe, si e tillë, meriton të respektohet. Prandaj, lexuesi duhet ta ruajë këtë renditje, përveç në rastet ku Sheriati ka përjashtuar dhe përcaktuar lexime të veçanta.

Për shembull, në namazin e sabahut të ditës së xhuma lexohet surja Es Sexhde në rekatën e parë, dhe surja El Insan në të dytin. Në namazin e Bajramit lexohet surja Kaf në rekatën e parë, dhe surja El Kamer në të dytin. Në dy rekatet sunete të sabahut lexohet surja El Kafirun, në rekatën e parë, dhe surja El Ihlas, në të dytin. Ndërsa, në namazin e vitrit zakonisht lexohet surja El Ala në rekatën e parë, El Kafirun në të dytin dhe, në të tretin, surja El Ihlas, El Felek dhe En Nas.

Renditja e sureve gjatë leximit lejohet që mos të respektohet, duke lexuar një sure që nuk pason menjëherë pas asaj të mëparshmes, apo edhe duke lexuar një sure që vjen para asaj që është lexuar më parë. Për këtë çështje kanë ardhur shumë transmetime të sakta, pra, që e lejojnë një praktikë të tillë.

Për shembull, është transmetuar se Omer bin Hattabi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, kishte lexuar suren El Kehf në rekatën e parë të namazit të sabahut, dhe suren Jusuf në rekatën e dytë, megjithëse në mus'haf surja Jusuf vjen përpara surës El Kehf.

Disa prej dijetarëve nuk e kanë pëlqyer leximin e Kuranit jashtë renditjes së tij në mus'haf. Ibën Ebi Davudi transmeton se Hasani e urrente leximin e Kuranit pa e respektuar rendin e tij të rregulluar në mus'haf.

Me një zinxhir të saktë transmetimi, ai gjithashtu tregon se kur Abdullah bin Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, u informua për një njeri që e lexonte Kuranin duke filluar nga fundi drejt fillimit, tha: “Kjo do ta përmbytë zemrën e tij.”

Sa i përket leximit të një sureje nga fundi drejt fillimit, kjo është e ndaluar në mënyrë kategorike. Një veprim i tillë cenon disa prej aspekteve të ixhazit (përkryerjes hyjnore të Kuranit) dhe e përmbyt urtësinë e renditjes së ajeteve, e cila është pjesë e shpalljes.

Ibën Ebi Davudi transmeton prej Imam Ibrahim Nehaiut, njërit prej tabiinjeve të njohur, dhe Imam Malikut, *Allahu i mëshiroftë*, se të dy nuk e pëlqenin një praktikë të tillë. Madje, është transmetuar se Imam Maliku e qortoi ashpër këtë mënyrë leximi, dhe e konsideroi atë shumë të urryer.

Ndërkaq, sa i përket mësimin të Kuranit për fëmijët, duke filluar nga fundi i mus'hafit drejt fillimit, kjo konsiderohet një praktikë e

mirë dhe nuk hyn në kategorinë e diskutimeve të përmendura më sipër. Kjo sepse bëhet si një lexim i pandërprerë gjatë ditëve të caktuara, dhe ndihmon në lehtësimin e procesit të mësimit përmendsh për fëmijët.

Për më tepër, kjo metodë ndihmon që fëmijët ta përvetësojnë Kuranin më lehtë dhe me përqendrim më të madh. Allahu e di më së miri.

PËRPARËSIA E LEXIMIT TË KURANIT NGA MUS'HAFI

Leximi i Kuranit nga mus'hafi është më i lavdërueshëm dhe më i bukur sesa recitimi përmendsh, pasi ai përfshin një formë të veçantë adhurimi: shikimin në faqet e Kuranit. Ky akt jo vetëm që bashkon leximin me shikimin, por edhe forcon lidhjen shpirtërore me Fjalën e Allahut. Këtë mendim e kanë mbështetur dijetarë të njohur si El Kadi Husejni, prej dijetarëve tanë, Imam Ebu Hamid El Gazali, si dhe shumë prej paraardhësve të devotshëm (selefëve).

Imam Gazali, në veprën e tij madhështore *Ihjau Ulumi Din*, përmend se shumë prej sahabëve, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*, e lexonin Kuranin nga mus'hafi dhe e konsideronin të papëlqyeshme (mekruh) që të kalonte një ditë pa e shikuar atë. Po ashtu, Ibën Ebi Davudi transmeton shumë rrëfime të paraardhësve të drejtë (selefëve), të cilët ishin të përkushtuar në leximin e Kuranit nga mus'hafi. Personalisht, nuk shoh ndonjë mospajtim ndërmjet dijetarëve lidhur me këtë praktikë.

Nëse thuhet se përparësia e leximit ndryshon sipas gjendjes së individit, atëherë mund të thuhet se leximi nga mus'hafi është më i vlefshëm për atë që ndien se përkushtimi dhe meditimi i tij janë njëjtë, qoftë kur lexon nga mus'hafi apo nga kujtesa. Në anën tjetër, për atë që e ndien më të madh respektin dhe përsiatjen kur lexon nga zemra dhe kujtesa e tij, atëherë leximi përmendsh mund të jetë më i preferuar. Një qasje e tillë është e arsyeshme dhe e pranueshme.

Kjo qartazi përputhet me fjalët dhe veprimet e paraardhësve të drejtë (selefëve), të cilët, në praktikën e tyre, pasqyronin një kuptim të thellë dhe të matur të adhurimit dhe të përkushtimit ndaj Fjalës së Allahut.

LEXIMI NË GRUP I KURANIT

Duhet ditur se leximi i Kuranit në grup është një veprim i rekomanduar (mustehab), veprim ky i mbështetur si në argumente të qarta fetare, ashtu edhe në traditën e qëndrueshme të paraardhësve të drejtë (selefëve) dhe pasuesve të tyre. Ky lloj leximi jo vetëm që nxit bashkësinë dhe përkushtimin kolektiv, por gjithashtu është i përmendur edhe në tekstet pejgamberike, si një vepër që sjell bereqet dhe mëshirë.

Në një hadith autentik, të transmetuar prej Ebu Hurejres dhe Ebu Seid El Hudrit, *Allahu qoftë i kënaqur me të dy*, pejgamberi Muhamed, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, ka thënë: “*Sa herë që mblidhen njerëzit (myslimanët) për ta përmendur Allahun, ata do të rrethohen me melekë, do t’i mbulojë mëshira, do të zbresë qetësia mbi ta, dhe Allahu do t’i përmendë ata pranë atyre që janë tek Ai.*”¹

Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, transmeton se Pejgamberi, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, ka thënë: “*Sa herë që mblidhet një grup njerëzish në ndonjë prej shtëpive të Allahut të Lartë për ta lexuar Librin e Allahut dhe për ta studiuar atë ndërmjet tyre, mbi ta zbret qetësia (sekine), i mbulon mëshira, i rrethojnë melekët dhe Allahu i përmend pranë atyre që janë afër Tij.*”²

Muaviu, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, transmeton se i Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, doli një ditë dhe hasi në një grup sahabësh të tubuar. Ai i pyeti: “*Për çfarë jeni tubuar?*”

Ata u përgjigjën: “*Jemi mbledhur për ta përmendur Allahun dhe për ta falënderuar që na udhëzoi në Islam dhe na e dha këtë mirësi.*”

Atëherë i Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, tha: “*Xhibrili (paqja qoftë mbi të) më erdhi dhe më njoftoi se Allahu i Lartmadhërishëm mburret me ju para melekëve.*”³

Hadithet që flasin për vlerën e tubimeve të tilla janë shumë.

1 Transmetuar prej Muslimit; Tirmidhiu e cilëson si hadith hasen sahih.

2 Muslimi dhe Ebu Davudi e transmetojnë, me zinxhir transmetimi të saktë sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit.

3 Muslimi, Tirmidhiu dhe Nesaiu e transmetojnë; e, Tirmidhiu e cilëson si hadith hasen.

Darimiu transmeton prej Ibën Abbasit, *Allahu qoftë i kënaqur me të dhe me babanë e tij*, se ka thënë: “*Kushdo që dëgjon një ajet nga Libri i Allahut, ai do të jetë dritë për të.*”

Ibën Ebi Davudi përmend se Ebu Derdai, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, e studionte Kuranin me një grup njerëzish, dhe të gjithë lexonin së bashku.

Vlera dhe dobite e studimit të përbashkët të Kuranit janë përmendur prej shumë dijetarëve të mëdhenj, si të brezave të hershëm (selef), ashtu edhe të mëvonshëm (halef), përfshirë edhe kaditë dhe imamët më të njohur të jurisprudencës.

Hassan bin Atije dhe Imam Evzaiu kanë thënë: “*I pari që themeloi rregullisht mësimet e organizuara në xhaminë e Damaskut ishte Hisham bin Ismaili.*”¹

PYETJE DHE PËRGJIGJE RRETH KËSAJ TEME

Ibën Ebi Davudi transmeton prej Dahak bin Abdurrahman bin Arzebit, i cili kundërshtoi praktikat e leximit në grup dhe tha: “Unë nuk kam parë dhe nuk kam dëgjuar për një gjë të tillë, megjithëse i kam takuar sahabët e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të.” Me këtë ai donte të thoshte se nuk kishte vërejtur dikë të vepronte në këtë mënyrë, gjatë asaj kohe.

Po ashtu, Ibën Vehbi rrëfen: “Imam Malikut i thashë: “A ke parë ndonjë grup njerëzish që mblidhen dhe lexojnë një sure së bashku derisa ta përfundojnë?” Ai e mohoi një praktikë të tillë, dhe e qortoi atë. Tha: “Kështu nuk kanë vepruar njerëzit; përkundrazi, zakonisht një person lexonte për dikë tjetër.”

Këto qëndrime individuale, megjithatë, janë në kundërshtim me shumë prej veprimeve të dijetarëve të brezave të hershëm dhe të mëvonshëm, si dhe me argumentet e shumta të transmetuara në lidhje me vlerën e leximit dhe të studimit të përbashkët të Kuranit. Prandaj,

1 Ky fakt historik tregon se studimi i përbashkët i Kuranit dhe i diturisë islame është një traditë e lavdëruar dhe thellësisht e rrënjësuar në jetën fetare të myslimanëve, e cila ka vazhduar brez pas brezi nëpër qendra të dijes dhe xhami. (Shënim i përkthyesit.)

ato nuk duhet të merren si standard i vetëm, por të vlerësohen në kontekst dhe me kujdes të veçantë.

Leximi në grup mbetet një praktikë e rekomanduar, nëse kryhet në mënyrë të rregullt dhe brenda kufijve të adhurimit të miratuar. Gjithsesi, ky lloj leximi ka disa kushte dhe rregulla që janë përmendur më parë, e të cilave duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë, në mënyrë që qëllimi dhe forma e adhurimit të jenë në përputhje me parimet islame. Allahu e di më së miri.

Shumë tekste të qarta dhe të besueshme janë të atillë që flasin për vlerën dhe shpërblimin e atij që i mbledh dhe i udhëzon të tjerët për të lexuar Librin e Allahut. Ndër to është fjala e pejgamberit Muhamed, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*: “Ai që udhëzon në një vepër të mirë, ka shpërblimin sikurse ai që e kryen atë.”¹

Gjithashtu, në një hadith tjetër të njohur, Pejgamberi, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, ka thënë: “Nëse Allahu bën që përmes teje të udhëzohet një njeri, kjo është më e mirë për ty se devetë e kuqe.”²

Hadithet në lidhje me këtë janë të shumta.

Allahu i Lartë gjithashtu urdhëron në Librin e Tij: “**Ndihmojeni njëri-tjetrin në vepra të mira dhe në devotshmëri.**” (El Maide, 2). Prandaj, nuk ka dyshim se ai që përpiqet me sinqeritet për të organizuar lexime të Kuranit, për të bashkuar zemra në përmendjen e Allahut dhe për t'i nxitur të tjerët në të mira, është në rrugë të bekuar dhe të shpërblyer. Ai merr një pjesë nga shpërblimi i të gjithë atyre që marrin pjesë në këtë vepër, pa u pakësuar asgjë nga shpërblimi i atyre që e bëjnë veprën.

LEXIMI ME RADHË (NË GRUP)

Ky lloj leximi nënkupton një tubim ku disa persona e lexojnë Kuranin në mënyrë të ndarë. Për shembull, njëri lexon një pjesë, si një të dhjetën (ushër) ose një të tridhjetën (xhuz), më pas hesht, ndërsa tjetri vazhdon leximin nga aty ku e la i pari, dhe kështu me radhë, derisa të përfundohet ajo që është synuar të lexohet.

1 Hadithin e transmeton Muslimi.

2 Transmetuar prej Buhariut dhe Muslimit.

Ky lloj leximi është i lejuar dhe i mirë. Imam Maliku, *Zoti qoftë i kënaqur me të*, u pyet për një praktikë të tillë, dhe ai u përgjigj: “Nuk ka asnjë problem me këtë.”

LEXIMI I KURANIT ME ZË

Ky kapitull është me rëndësi të veçantë dhe meriton vëmendje të shtuar. Duhet ditur se në shumë hadithe autentike, të përfshira në koleksionet më të besueshme të transmetimeve pejgamberike, theksohet se është e rekomanduar (mustehab) që Kurani të lexohet me zë.

Megjithatë, ekzistojnë gjithashtu disa transmetime që tregojnë se, në rrethana të caktuara, është më i preferuar leximi në heshtje, në mënyrë të përqendruar dhe pa e ngritur zërin. Me vullnetin e Allahut, në vijim do t’i përmendim disa nga këto transmetime.

Imam Ebu Hamid El Gazali dhe dijetarë të tjerë kanë sqaruar se mënyra më e drejtë për t’i kuptuar transmetimet që në dukje mund të ngjajnë kontradiktore mbi leximin e Kuranit me zë apo në heshtje është kjo: Për atë që i frikësohet sprovës së lavdërimit prej njerëzve, rënies në mendjemadhësi ose dëshirës për t’u dukur (për publicitet), atëherë për të është më mirë të lexojë në heshtje, në vetvete. Kjo ndihmon në ruajtjen e sinqeritetit, si dhe e largon rrezikun e prishjes së nijetit.

Mirëpo, nëse personi nuk frikësohet nga këto pasoja, dhe ndien siguri në qëllimin e tij, atëherë është e lavdërueshme që të lexojë me zë. Leximi me zë ka ndikim të dobishëm si për vetë lexuesin, ashtu edhe për ata që e dëgjojnë. Përfitimi që u shtrihet të tjerëve shpesh është më i vlefshëm sesa përfitimi i kufizuar vetjak.

Ndër përfitimet e leximit me zë janë:

- Zgjon zemrën e vetë lexuesit dhe e forcon përqendrimin e tij;
- E ndihmon të përsiatet më thellë mbi atë që lexon;
- E përqendron dëgjimin dhe e largon përgjumjen;
- E aktivizon trupin dhe mendjen;
- Ndikon te të tjerët përreth – i zgjon, i ndërgjegjëson dhe i motivon.

Nëse lexuesi i Kuranit i ka këto qëllime të pastra dhe nijetin për të përfutur vetë dhe për t'i ndihmuar të tjerët, atëherë leximi me zë është më i lavdëruar. Dhe, nëse kombinohen të dy këto qëllime, vetëpërmirësimi dhe ndikimi pozitiv ndaj të tjerëve, atëherë shpërblimi, me lejen e Allahut, është edhe më i madh dhe i shumëfishtë.

Imam Gazaliu thotë: “Për këtë arsye ne themi se leximi nga mus’hafi është më i lavdërueshëm, dhe ky është përfundimi (vendimi) i çështjes.”

Sa u përket transmetimeve që e mbështesin këtë mendim, ato janë shumë, ndërsa më poshtë do t'i përmendim disa prej tyre, me lejen e Allahut, për të treguar bazën e kësaj preference në fjalët dhe veprimet e paraardhësve të drejtë.

Në koleksionet autentike të haditheve është transmetuar se Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ka thënë: “Të Dërguarin e Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, e kam dëgjuar duke thënë: “*Allahu nuk dëgjon me kaq vëmendje askënd tjetër, ashtu siç e dëgjon një peygamber me zë të bukur duke kënduar Kuranin me zë të lartë.*”¹

Ebu Musa El Eshariu, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, tregon se i Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, i tha: “*Ty të është dhënë një prej mizmareve (melodive të bukura) të familjes së Davudit.*”

Në një version tjetër të këtij hadithi, të transmetuar prej Muslimit, Pejgamberi, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, i tha: “*Sikur të më kishe parë teksa të dëgjoja duke lexuar dje!*”

Prej Fadale bin Ubejdit, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, transmetohet se i Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, ka thënë: “*Allahu vërtet e dëgjon më me vëmendje një burrë me zë të bukur duke lexuar Kuranin, sesa një njeri që dëgjon me kujdes këngëtarin e tij.*”²

Ebu Musa, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, transmeton se i Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, ka thënë: “*Unë*

1 Transmetuar prej Buhariut dhe Muslimit.

2 Transmetuar prej Ibën Maxhes.

e dalloj zërin e grupit të esharinjve kur e këndojnë Kuranin teksa hyjnë në shtëpitë e tyre në mbrëmje. I njoh edhe shtëpitë e tyre nga zërat e tyre që lexojnë Kuran natën, edhe pse nuk i kam parë se ku qëndrojnë gjatë ditës.”¹

El Bera bin Azib, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, transmeton se i Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, ka thënë: “*Zbukurojeni Kuranin me zërat tuaj!*”²

Gjithashtu, Ibën Ebi Davudi transmeton se Aliu, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, i dëgjoi disa njerëz duke lexuar Kuranin në xhami, dhe tha: “*Lum për këta njerëz! Këta ishin më të dashurit tek i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*”

Ka shumë hadithe që e përforcojnë këtë kuptim dhe që dëshmojnë qartë për vlerën e leximit të Kuranit me zë të bukur dhe të përkushtuar.

Sa u përket rrëfimeve, thënieve dhe veprimeve të sahabëve dhe të tabiinëve lidhur me leximin e Kuranit me zë, ato janë më shumë sesa mund të numërohen, dhe aq të njohura sa nuk kanë nevojë të përmenden një e nga një. Gjithë këto transmetime e mbështesin dhe e lavdërojnë këtë praktikë, mirëpo me një kusht thelbësor: që lexuesi mos të frikësohet nga sprova e syfaqësisë (rija), vetëkënaqësisë (uxhb) apo ndonjë sëmundjeje tjetër të zemrës, e që e prish sinqeritetin e veprës.

Gjithashtu, leximi me zë nuk duhet t’i shqetësojë të tjerët, veçanërisht ata që janë në adhurim, siç janë ata që falen në xhami. Nëse leximi bëhet në atë mënyrë që ndikon negativisht te përqendrimi i të tjerëve, atëherë ai duhet të shmanget në atë kontekst.

Nga ana tjetër, parapëlqimi për ta fshehur leximin dhe për ta bërë atë në heshtje është transmetuar nga një grup i paraardhësve të devotshëm, për shkak të frikës së tyre ndaj rënies në vetëlavdërim apo hipokrizi.

1 Transmetuar prej Buhariut dhe Muslimit. Ky hadith dëshmon virtytin dhe lavdërimin e atyre që e lexojnë Kuranin me zë të bukur dhe përkushtim, sidomos gjatë natës, një kohë e veçantë për adhurim dhe përkushtim shpirtëror. Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) jo vetëm që i ka vlerësuar zërat e tyre, por edhe i ka njohur shtëpitë e tyre nga mënyra e leximit të Kuranit, çka tregon fuqinë shpirtërore dhe ndikimin e leximit të sinqertë me zë të lartë në jetën individuale dhe shoqërore.

2 Transmetuar prej Ebu Davudit, Nesaiut dhe të tjerëve.

Ameshi tregon: “E vizitova Ibrahimin¹, ndërsa ai po lexonte nga mus’hafi. Kur një burrë i kërkoi leje për t’u futur, ai e mbylli mus’hafin, dhe tha: “Veprua kështu, që mos të duket se unë lexoj Kuran çdo orë.”

Ebu Alja rrëfen: “Unë isha duke qëndruar me shokët e të Dërguarit të Zotit, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe Zoti qoftë i kënaqur me shokët e tij*, dhe njëri prej tyre tha: “Gjatë natës lexova filan suren.” Ata i thanë: “Kjo është pjesa jote e shpërblimit nga ajo.”

Ata që parapëlqejnë leximin e Kuranit në heshtje, e mbështesin mendimin e tyre në një hadith të Ukbe bin Amir, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, i cili thotë: “Të Dërguarin e Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, e kam dëgjuar duke thënë: “*Ai që e lexon Kuranin haptas, është si ai që jep sadaka publikisht. Ndërsa, ai që e lexon në heshtje, është si ai që jep sadaka në fshehtësi.*”²

Tirmidhiu, në komentimin e tij mbi hadithin, shton se kuptimi i tij, sipas dijetarëve, është se leximi i Kuranit në mënyrë të fshehtë, pa u parë prej të tjerëve, është më i lavdërueshëm sesa leximi publikisht. Kjo është e ngjashme me rastin e sadakasë: dhënia e saj në fshehtësi është më me vlerë sesa ajo që bëhet haptas. Qëllimi i kësaj është të ruhet sinqeriteti dhe të shmanget rreziku i mburrjes apo vetëlavdërimit. Sepse ai që e kryen adhurimin në fshehtësi, ai është më i mbrojtur nga lavdërimi dhe hipokrizia, për dallim prej atij që e tregon veprën hapur, e i cili mund të bjerë në rrezik më të madh për sëmundjet e zemrës.

PËRMBLEDHJE

Nga të gjitha ato që u përmendën më sipër, del në pah se çështja e leximit të Kuranit me zë apo në heshtje varet nga gjendja e zemrës së njeriut dhe nga rrethanat përkatëse. Nëse një person ka frikë se leximi me zë mund ta çojë drejt mendjemadhësisë, vetëlavdërimit apo dukjes përpara njerëzve (rija), atëherë më e përshtatshme për të është të lexojë në heshtje, për të ruajtur sinqeritetin dhe pastërtinë e qëllimit.

Nëse, nga ana tjetër, një person është i sigurt në sinqeritetin e tij dhe nuk frikësohet nga sprova e dukjes, atëherë leximi me zë është më

1 Fjala është për Ibrahim Nehaiun. (Sqarim i përkthyesit.)

2 Transmetuar prej Ebu Davudit, Tirmidhiut dhe Nesaiut. Tirmidhiu thotë se është hadith hasen.

i lavdëruar, për shkak të ndikimit që ka te vetë lexuesi dhe tek ata që e dëgjojnë. Veçanërisht në rastin kur leximi bëhet në grup, leximi me zë është i rekomanduar, siç është sqaruar më herët, sepse sjell përfitim të përbashkët dhe nxit përkujtim të përbashkët të Fjalës së Allahut.

Dhe, Allahu e di më së miri.

ZBUKURIMI I ZËRIT GJATË KËNDIMIT TË KURANIT

Dijetarët e gjeneratave të para, përfshirë sahabët, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*, tabiinjtë dhe imamët e mëvonshëm në vende të ndryshme të botës islame, janë unanimisht të mendimit se zbukurimi i zërit gjatë këndimit të Kuranit është i rekomanduar (mustehab).

Qëndrimet e tyre mbi këtë çështje janë të shumta dhe të njohura gjerësisht, në atë masë sa nuk ka nevojë të citojmë shembuj të veçantë.

Për këtë ekziston mbështetje e qartë në hadithet autentike të të Dërguarit të Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, e që njihen si në mesin e dijetarëve, ashtu edhe në mesin e masës së gjerë të myslimanëve. Ndër këto hadithe mund t'i përmendim:

- “*Zbukurojeni Kuranin me zërat tuaj!*”
- “*Atij (Ebu Musa El Eshariut) i është dhënë një nga mizmaret (zërat melodikë) e familjes së Davudit.*”
- “*Allahu nuk e dëgjon me më shumë vëmendje askënd, sesa një pejgamber që e këndon Kuranin me zë të bukur.*”

Këto dhe hadithe të tjera, që i përmendëm edhe më herët, përbëjnë dëshmi të qarta për vlerën e zbukurimit të zërit gjatë leximit të Kuranit, për aq sa qëllimi mbetet singleriteti dhe përkushtimi ndaj Fjalës së Allahut.

Në kapitullin që trajton leximin e Kuranit me tertil (me zë të qartë, të ngadaltë dhe të shqiptuar bukur), përmendëm hadithin e Abdullah bin Mugafelit *Allahu qoftë i kënaqur me të*, i cili e dëgjoji të Dërguarin e Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, duke e recituar Kuranin me një ton të gjallë dhe të përjetuar.

Në të njëjtën frymë qëndrojnë edhe hadithet që janë transmetuar prej Sa'd bin Ebi Vekkasit dhe Ebu Lubabes, *Allahu qoftë i kënaqur*

me ta, të cilët përcjellin fjalët e Pejgamberit, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*: “Nuk është prej nesh ai që nuk e zbukuron zërin e tij gjatë këndimit të Kuranit.”¹

El Bera bin Azib, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, tregon: “Të Dërguarin e Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, e kam dëgjuar duke lexuar suren Et Tin në namazin e jacisë, dhe nuk kam dëgjuar askënd që ta ketë pasur zërin më të bukur se ai.”²

Dijetarët, *Allahu i mëshiroftë*, kanë thënë se është e rekomanduar (*mustehab*) që lexuesi të zbukurojë zërin e tij dhe ta stolisë atë me një këndim të bukur, përderisa ky zbukurim mbetet brenda kufijve të pranueshëm të recitimit dhe nuk çon në shkelje të rregullave të shqiptimit.

Nëse zbukurimi kalon në teprim, duke çuar në ndryshime të shqiptimit të shkronjave, sikurse ndodh, për shembull, me zgjatje të panevojshme, shtim të një tingull të ri ose fshehje të atij që duhet shqiptuar, atëherë një lexim i tillë nuk është më i lejuar, dhe kështu konsiderohet i ndaluar (*haram*), sepse bie ndesh me mënyrën e saktë të leximit të Kuranit, siç është përcjellë prej Pejgamberit, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, dhe gjeneratave të para.

Imam Shafi'u, *Allahu e mëshiroftë*, ka shprehur dy qëndrime lidhur me këndimin e Kuranit me melodi: në një vend ai e konsideron si të papëlqyeshëm (*mekruh*), ndërsa në një tjetër vend e lejon atë. Në shikim të parë mund të duket sikur këto dy mendime kanë kontradiktë, por dijetarët e medhhebit shafii kanë sqaruar se nuk kemi të bëjmë me kundërshtim të vërtetë, por me dallim rreth rrethanave dhe mënyrës së këndimit.

Ata kanë sqaruar se, nëse një person e këndon Kuranin me melodi të bukur, mirëpo duke respektuar plotësisht rregullat e texhvidit dhe pa e tejkaluar kufirin e lejuar të zgjatimeve (medit), atëherë ky lloj këndimi është i pranueshëm, dhe nuk është mekruh. Madje mund të

1 Transmetuar prej Ebu Davudit, me zinxhir transmetimi të mirë; ndonëse në zinxhirin e transmetimit të hadithit të Sad-it ka një ndryshim të vogël, ai nuk dëmton besueshmërinë e përmbajtjes.

2 Transmetuar prej Buhariut dhe Muslimit.

jetë i lavdërueshëm, nëse përforcon përqëndrimin dhe përsiatjen. Mirëpo, nëse zbukurimi me melodi çon në tejkalim të kufijve të përcaktuar, sikurse, për shembull zgjatje të tepërta, të cilat ndryshojnë shqiptimin e shkronjave, apo në stil të ngjashëm me këngët apo muzikalitetin e pavend, atëherë kjo formë e leximit është ajo që Imam Shafiu e ka cilësuar si të papëlqyeshme. Kjo sepse, në këtë rast, melodia kthehet në pengesë për kuptimin dhe përkushtimin, dhe bie ndesh me respektin e duhur që i takon Fjalës së Allahut.

Gjykatësi i shquar dhe dijetari i madh, kadiu El Maverdi, në veprën e tij *El Havi*, ka thënë: “Leximi i Kuranit duke përdorur forma melodike që çojnë në shtrembërim të formulimit të tij origjinal, siç janë: shtimi ose heqja e zanoreve, zgjatja e tepruar e atyre që duhet të jenë të shkurtra apo shkurtimi i atyre që kërkojnë zgjatje, si dhe çdo zbukurim që e fsheh fjalën apo e ngatërron kuptimin e saj, është i ndaluar (*haram*). Një lexim i tillë jo vetëm që është i papranueshëm, por e bën lexuesin fajtor për prishje të moralit fetar, po gjithashtu e ngarkon me mëkat edhe dëgjuesin e tij, pasi edhe ai ka devijuar nga udha e drejtë në diçka të shtrembër dhe të deformuar.”

Për ta përforcuar këtë qëndrim, ai sjell fjalën e Allahut të Lartë: ***“(Ky është) Kurani në gjuhën arabe, pa asnjë shtrembërim (devijim).”*** (Zumer, 28)

Megjithatë, El Maverdiu bën dallimin e nevojshëm, duke sqaruar se: “Nëse melodia nuk e cenon formulimin e saktë të Kuranit dhe as nuk ndikon negativisht në rrjedhshmërinë, qartësinë dhe kuptueshmërinë e recitimit, atëherë një lexim i tillë është i lejuar. Në këtë rast, melodia shërben për ta zbukuruar leximin dhe për ta thelluar ndikimin shpirtëror të tij.”

Ky lloj i leximit të Kuranit me melodi të ndaluara është një dukuri shqetësuese, e që, për fat të keq, ka prekur disa njerëz të thjeshtë dhe të paarsimuar, si dhe disa persona të papërgjegjshëm që edhe e përdorin leximin e Kuranit në raste si funeralet apo manifestimet publike, në mënyra që bien ndesh me rregullat e shenjta të recitimit. Ky është një veprim që konsiderohet risi e ndaluar (bidat i keq), siç e ka theksuar edhe kryegjykatësi i mirënjohur.

Kushdo që dëgjon këtë lloj leximi, duke e ditur natyrën e tij të devijuar, merr pjesë në mëkat. E, nëse dikush ka mundësi dhe aftësi ta ndalojë këtë praktikë, mirëpo nuk e bën, edhe ai mban përgjegjësi para Allahut.

Pikërisht për këtë arsye e ndjeva të domosdoshme t'i përfshij aftësitë dhe përpjekjet e mia në trajtimin e kësaj çështjeje, me shpresën që Allahu i Lartë t'u japë sukses atyre që janë të aftë, të kualifikuar dhe që përpiqen me sinqeritet për ta mbrojtur Kuranin nga shtrembërimi dhe për ta ruajtur nga përdorimet e pahijshme.

Zotit i lutem për mirëqenien, suksesin dhe shpërblimin e tyre.

Në veprën e njohur *Muhtesar El Muzenij*, Imam Shafiu, *Allahu e mëshiroftë*, ka thënë: “Lexuesi le ta zbukurojë zërin e tij në çfarëdo mënyre që të jetë!”

Dhe më pas shton: “Leximi më i pëlqyer është ai që bëhet me një ritëm të shpejtë, gjithnjë duke respektuar rregullat e texhvidit, dhe me përulësi e ndjeshmëri, në mënyrë që zëri të jetë i zbutur dhe i përshkuar nga frika ndaj Allahut, xh.sh.”

Ibën Ebi Davudi ka transmetuar me zinxhirin e tij, se Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, e lexoi suren Et Tekvir me një zë të dridhshëm nga ngashërimi, e që i ngjante një elegjie prekëse.

Në *Sunenin* e Ebu Davudit shënon se Ibën Ebi Mulejke u pyet: “Çfarë mendimi keni nëse zëri i dikujt nuk është i bukur?”, - e ai u përgjigj: “Duhet ta zbukurojë zërin aq sa ka mundësi.”

DËSHIRA PËR TË DËGJUAR LEXIM TË BUKUR TË KURANIT PREJ ATYRE QË KANË ZË TË MIRË

Dije se shumë prej selefëve (paraardhësve të drejtë) kërkonin prej atyre që kishin zë të bukur që ta recitonin Kuranin, ndërsa vetë ata e dëgjonin me përkushtim. Dijetarët janë unanimsisht të mendimit se një veprim i tillë është i dëshirueshëm (*mustehab*) dhe përfaqëson një zakon të njerëzve të devotshëm, elitës së dijes dhe adhuruesve të përkushtuar ndaj Allahut. Ky është gjithashtu një sunet i vërtetuar prej të Dërguarit të Allahut, *paqja dhe bekimet e Tij qofshin mbi të*.

Me besueshmëri është transmetuar prej Abdullah bin Mesudit, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, se ka thënë: “Një ditë i Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, më tha: “*Ma lexo Kurantin!*” I thashë: “O i Dërguari i Allahut, a do të lexoj unë për ty, kur ty të është shpallur?” Ai u përgjigj: “Unë dëshiroj ta dëgjoj prej dikujt tjetër.” Atëherë fillova të lexoj suren En Nisa, dhe kur arrita tek ajeti: “*E si do të jetë atëherë kur prej çdo populli të sjellim dëshmitar, dhe ty (o Muhamed) të sjellim dëshmitar mbi këta?*” (En Nisa: 41),

Ai tha: “*Mjaft!*”

“U ktheva kah ai, dhe pashë se nga sytë e tij rridhnin lot.”¹

Ed Darimiu dhe të tjerë kanë shënuar, me zinxhirë autentikë të transmetimit, se Omer bin Hattabi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, i thoshte Ebu Musa El Eshariut: “Na e kujto Zotin tonë!” Dhe Ebu Musa i recitonte pjesë nga Kurani me zërin e tij të bukur.

Transmetime të ngjashme janë të shumta dhe të njohura ndër dije-tarët e hershëm. Madje, nga përjetimi i thellë shpirtëror dhe mallëngjimi i madh që shkaktonte dëgjimi i këndimit të Kuranit, disa prej selefëve kanë ndërruar jetë nga ndikimi i leximit të bukur të dikujt që vetë e kishin ftuar të lexonte për ta.

Kjo dëshmon për ndikimin e thellë që ka Fjala e Allahut në zemrat e atyre që e dëgjojnë me sinqeritet dhe përkushtim.

Dhe, Allahu e di më së miri.

Disa dijetarë kanë preferuar që një tubim i mbledhur për t’i dëgjuar apo studiuar hadithet e Pejgamberit, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, të hapet dhe të përfundohet me një recitim të shkurtër nga Kurani, i lexuar nga dikush me zë të bukur.

Ky recitim duhet të jetë i përzgjedhur me kujdes, në përputhje me natyrën dhe qëllimin e mexhlisit. Rekomandohet që të përfshijë ajete që nxisin shpresën dhe frikën ndaj Allahut, që përmbajnë këshilla, udhëzime për largim nga kjo botë, inkurajim për punë të mira dhe përgatitje për jetën e përtejme, që shkurtojnë lakminë dhe frymëzojnë moral të lartë dhe fisnikëri.

¹ Transmetuar prej Buhariut dhe Muslimit.

MARRJA PARASYSH E KUPTIMIT GJATË FILLIMIT DHE NDËRPRERJES SË LEXIMIT

Kur lexuesi fillon të recitojë nga mesi i një sureje ose ndalon pa e përfunduar atë, është e këshillueshme që të fillojë dhe të ndalet në vende ku fjalia ose pasazhi ka një kuptim të plotë.¹ Duhet të ketë kujdes që mos ta fillojë leximin nga një ajet që është i lidhur kuptimisht me ajetet e mëparshme pa i përfshirë edhe ato, sepse kjo mund të çojë në keqkuptim të mesazhit hyjnor.

Gjithashtu, nuk është e domosdoshme që leximi të kufizohet sipas ndarjes në të dhjetat (ushër) apo të tridhjetat (xhuz), pasi këto ndarje janë teknike dhe nuk marrin gjithmonë parasysh vazhdimësinë tematike apo kuptimore të tekstit. Prandaj, leximi duhet të nisë dhe të mbarojë në pika që kanë lidhje logjike dhe gjuhësore.

Shembuj:

- **Xhuzi i 5-të:** “*(Ju ndalohet martesja) Edhe me gratë që gjenden nën kurorë...*” (En Nisa, 24);
- **Xhuzi i 13-të:** “*Unë nuk e shfajësoj veten...*” (Jusuf, 53);
- **Xhuzi i 20-të:** “*Përgjigjja e vetme e popullit të tij ishte...*” (En Neml, 56);
- **Xhuzi i 22-të:** “*Ndërsa atyre prej jush që binden ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij...*” (El Ahzab, 31);
- **Xhuzi i 23-të:** “*Por pas (vdekjes së tij) Ne nuk i dërguam kurrfarë ushtrie nga qielli (si dënim) popullit të tij...*” (Jasin, 28);
- **Xhuzi i 25-të:** “*Vetëm Allahu e di se kur do të vijë Ora...*” (Fussilet, 47);
- **Xhuzi i 26-të:** “*Natyrisht se atyre do t’u dalin në shesh të këqijat që kanë bërë...*” (El Xhathije, 33);
- **Xhuzi i 27-të:** “*Ai i pyeti: “Cili është qëllimi juaj, o të dërguar?...”* (Edh Dharijat, 31).

¹ Imam Ibën Xhezeri, në poemën e tij të njohur *El Mukaddime*, thotë: “Pas shqiptimit të saktë të shkronjave, është e domosdoshme njohja e ndalesave në lexim.” Gjithashtu, Imam Ibën Enbari (rahimehullah) ka thënë: “Një pjesë e plotësimit të njohjes së Kuranit është edhe njohja e ndalesave dhe fillimeve në lexim, sepse askush nuk mund t’i kuptojë saktë domethëniet e Kuranit përveçse nëse i njeh këto ndalesa. Ky është argumenti më i fortë për domosdoshmërinë e mësimimit dhe mësimdhënies së tyre.” (Shënim i redaktorit.)

E njëjta gjë vlen edhe për ndarjen në të gjashtëdhjetat (*hizb*). Edhe pse këto ndarje janë praktike dhe të dobishme për qëllime memorizimi apo rregullim të leximit ditor, ato nuk janë vendosur në bazë të kuptimeve tematike apo gjuhësore. Prandaj, edhe në këtë rast, është e rëndësishme të kihet kujdes që fillimi dhe ndalimi i leximit mos të ndodhë në një ajet që është i lidhur ngushtë me atë që i paraprin apo që pason.

Shembuj që ilustrojnë këtë janë:

- Ajeti: ***“Allahun përmendeni në ditët e caktuara...”*** (El Bekare, 203), i cili përbën fillimin e *hizbit të 4-të*, por në të vërtetë është vazhdim i temës së haxhit, e që trajtohet në ajetet e mëparshme.
- Ajeti: ***“Thuaj (o Muhamed!): A doni t’ju tregoj për gjëra më të mira se ato?!”...*** (Ali Imran, 15), që është në fillim të *hizbit të 6-të*, mirëpo që, në fakt, lidhet drejtpërdrejt me ajetet e mëparshme, e që përmendin pasionet dhe gjërat që i janë zbukuruar njeriut në këtë botë.

Prandaj, lexuesi nuk duhet të fillojë apo të ndalet në vende të tilla (siç janë ato që përmendëm më parë), apo në vende të ngjashme me to, pasi ato janë të lidhura ngushtë në kuptim me ajetet që i paraprijnë ose që vijnë pas tyre. Lexuesi duhet të ketë kujdes që mos të ndërpresë kuptimin e ajetit, pasi një ndalesë e tillë jo vetëm që cenon rrjedhën e kuptimit, por edhe mund të keqinterpretojë mesazhin hyjnor.

Njerëzit nuk duhet të mashtrohen nga shumë recitues që nuk i kushtojnë vëmendje këtyre rregullave dhe lexojnë pa menduar për kuptimin e ajeteve! Kjo është një mungesë respekti ndaj Fjalës së Allahut.

Lexuesi i vërtetë duhet ta ndjekë udhëzimin dhe shembullin e të devotshmëve, siç transmeton Hakim Ebu Abdullahu, me zinxhirin e tij prej Fudajl bin Ijadit, *Allahu e mëshiroftë*, i cili ka thënë: “Mos u largoni nga rruga e së drejtës për shkak të numrit të vogël të ndjekësve të saj, dhe mos u mashtroni nga numri i madh i atyre që janë në shkatërrim!”

Për këtë arsye dijetarët kanë thënë se është më e lavdëruar të recitohet një sure e shkurtër e plotë, sesa një pjesë nga një sure e gjatë, sepse ndërlidhja e kuptimeve në një sure të gjatë mund të mos jetë e dukshme për disa njerëz, në rrethana të caktuara.

Ibën Ebi Davudi ka transmetuar, me zinxhirin e tij të transmetimit, se Abdullah bin Ebi El Hudhejli, tabiini i njohur, ka thënë se sahabët, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*, nuk e pëlqenin që të lexoheshin disa ajete dhe të liheshin disa pa u lexuar.

DISA RRETHANA KUR LEXIMI ËSHTË I PAPËLQYER (MEKRUH)

Dije se leximi i Kuranit, në përgjithësi, është një vepër shumë e lavdëruar dhe e dëshirueshme në çdo kohë! Megjithatë, ka disa raste të veçanta e të përcaktuara nga Sheriati, në të cilat leximi bëhet i papëlqyer (*mekruh*). Më poshtë do t'i përmend disa nga ato situata që më vijnë ndër mend, pa hyrë në detaje të argumenteve përkatëse, pasi ato janë të njohura për dijetarët dhe praktikuesit e fesë.

- *Mekruh* është të lexohet Kurani gjatë rukusë, sexhdes, teshehudit dhe pjesëve të tjera të namazit, përveç qëndrimit në këmbë (*kijam*), i cili është vendi i përshkruar për recitimin.¹
- Po ashtu, *mekruh* është që muktediu (ai që falet pas imamit) të lexojë diçka tjetër përveç sures El Fatiha gjatë namazeve që recitohen me zë (si sabahu, akshami dhe jacia), kur ai mund ta dëgjojë qartë leximin e imamit.²
- Nuk lejohet leximi i Kuranit në tualet apo në vende të ngjashme të përgatitura për kryerjen e nevojave fiziologjike, për shkak të papastërtisë dhe mungesës së respektit për Fjalën e Allahut.
- E papëlqyeshme (*mekruh*) është të lexohet Kurani në gjendje përgjumjeje apo në ndonjë gjendje të ngjashme, kur fjalët e tij mund të shqiptohen në mënyrë të pasaktë ose të pakuptueshme.
- Po ashtu, *mekruh* është leximi i Kuranit gjatë hytbes së xhumasë, për ata që janë të pranishëm dhe e dëgjojnë hytben. Ndërsa, për

1 Bazuar në hadithin që e transmetojnë Muslimi (nr. 480), Ibën Hibani (nr. 1895), Bejhekiu (1/217) dhe të tjerë, prej zotërisë sonë, Ali bin Ebi Talibit, *Allahu ia nderoftë fytyrën*, i cili ka thënë: "I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) më ndaloi të lexoj Kuran gjatë rukusë dhe sexhdes."

2 Kjo është sipas shafiive, ndërsa sipas hanefive, muktediu nuk lexon asgjë nga Kurani gjatë namazit pas imamit, përveç *Subhanekes* në fillim të namazit. (Sqarim i përkthyesit.)

atë që nuk e dëgjon hytben, nuk është mekruh, madje konsiderohet e rekomanduar (*mustehab*). Ky është mendimi më i saktë dhe më i përzgjedhur prej dijetarëve.

Prej Tavusit është transmetuar se leximi i Kuranit gjatë hytbes është mekruh, ndërsa prej Ibrahim En Nehaiut se nuk është. Megjithatë, dijetarët kanë thënë se këto dy mendime mund të harmonizohen si në vijim: nëse personi e dëgjon hutben, është mekruh të lexojë; nëse nuk e dëgjon, nuk është mekruh dhe lejohet të lexojë.

Recitimi i Kuranit gjatë tavafit (rrotullimit rreth Qabes) nuk konsiderohet mekruh. Ky është qëndrimi i medhhebit tonë dhe mendimi i shumicës së dijetarëve. Ibën Mundhiri e përcjell këtë qëndrim prej Atait, Muxhahidit, Ibën Mubarekut, Ebu Thevriut dhe dijetarëve të Ehli Rejit (dijetarëve racionalistë).

Ndërkohë, Hasan El Basriu, Urve bin Zubejri dhe Imam Maliku kanë thënë se është mekruh të recitohet Kurani gjatë tavafit.

Megjithatë, mendimi i parë është më i saktë dhe më i mbështetur në argument. Më parë kemi sqaruar gjithashtu dallimin ndërmjet recitimit në banjë dhe gjatë ecjes në rrugë, si dhe rreth gjykimit të recitimit prej dikujt që e ka gojën të papastër.

DISA BIDATE (RISI) QË DUHEN REFUZUAR

Ndër risitë që duhen refuzuar në lidhje me leximin e Kuranit është një praktikë e përhapur te disa persona të padijshëm që udhëheqin namazin e teravive gjatë muajit Ramazan. Këta persona lexojnë suren El Enam në rekatën e fundit të natës së shtatë të Ramazanit, duke besuar në mënyrë të pabazë se ky veprim është i rekomanduar.

Ky veprim përmban disa aspekte problematike, e që bien ndesh me praktikën e shëndoshë të fesë, si:

1. **Besimi i pavërtetë** se një veprim i tillë është i rekomanduar në mënyrë të veçantë, ndonëse nuk ka asnjë argument të vlefshëm që e mbështet këtë.

2. **Krijimi i një iluzioni te njerëzit e thjeshtë**, të cilët mund të mendojnë gabimisht se ky veprim është sunet apo vepër e miratuar, dhe ta përsërisin atë pa dije.

3. **Zgjatja e rekatit të dytë më shumë se i pari**, ndërsa, sipas Sunetit, është e kundërta.

4. **Ngarkimi dhe vështirësimi i xhematit**, për shkak të gjatësisë së panevojshme të leximit, gjë që bie ndesh me parimin e lehtësimit në adhurim, sidomos kur namazi falet me xhemat.

Ndër bidatet e ngjashme që duhen refuzuar është edhe praktika e disa lexuesve të padijshëm që, gjatë namazit të sabahut të ditës së xhuma, recitojnë qëllimisht një fragment kuranor që përmban sexhde të tjera përveç asaj të sures Es Sexhde. Ata e bëjnë këtë me bindjen e gabuar se është e vlefshme apo e veçantë për këtë ditë.

Ky veprim përbën një shmangie nga suneti i qartë dhe i mirënjohur, sipas të cilit:

- Në rekatën e parë të namazit të sabahut të ditës së xhuma, Pejgamberi, *paqja qoftë mbi të*, zakonisht e lexonte suren Es Sexhde.
- Në rekatën e dytë ai e lexonte suren El Insan.

DISA ÇËSHTJE TË NDRYSHME (MESELE)

Nëse dikujt i ndodh lëshimi i ajrit (gazrave) gjatë kohës që është duke lexuar Kuran (jashtë namazit), ai duhet ta ndërpresë leximin derisa të largohet plotësisht era, e më pas të rikthehet në lexim.¹

Kjo është transmetuar prej Ibën Ebi Davudit dhe të tjerëve prej dijetarëve, prej Atait, njërit prej dijetarëve të mëdhenj të tabiinëve.

¹ Megjithëse, nga pikëpamja juridike islame (fikhu), nuk është kusht abdesi për të lexuar Kuran jashtë namazit, është shumë më e përshtatshme dhe e denjë që, nëse dikujt i prishet abdesi gjatë leximit, ai të ndërpresë leximin, të ngrihet, të lëvizë, të pastrohet dhe të rifillojë leximin në gjendje të plotë pastërtie. Vazhdimi i leximit pa abdes, veçanërisht në prani të erës së pakëndshme ose pas një veprimi që tregon neglizhencë ndaj adhurimit, mund të perceptohet si mungesë serioziteti dhe respekti ndaj Fjalës së Allahut (xh.sh.). Të gjitha kushtet për ta bërë këtë sot i kemi: qasje në banjo, ujë të pastër dhe rehati. Prandaj, për respekt dhe edukatë ndaj Kuranit, veprimi më i mirë është ndërprerja e leximit dhe rikthimi në të pasi të jetë rifituar pastërtia. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kohën tonë, duke pasur parasysh se jetojmë gati 800 vjet pas kohës dhe rrethanave të Imam Neveviut, dhe shumë gjëra kanë ndryshuar në aspektin e mundësive dhe kushteve të jetesës. Allahu e di më së miri. (Vërejtje e redaktorit.)

Kjo sjellje është konsideruar si shenjë e mirësjelljes dhe e respektit ndaj Fjalës së Allahut, dhe pasqyron ndjeshmërinë që duhet të ketë një mysliman kur merret me Librin e Shenjtë.

Nëse dikujt i hapet goja gjatë leximit të Kuranit, si pasojë e pagjumësisë, lodhjes ose arsyeve të ngjashme, duhet që ta ndërpresë leximin deri kur të përfundojë ajo gjendje, e pastaj të vazhdojë me respekt e përqendrim.

Këtë mendim e ka shprehur dijetari i njohur Muxhahid, dhe është një qëndrim i pranuar prej dijetarëve. Ky veprim mbështetet në hadithin e saktë të transmetuar prej Ebu Seid El Hudrit, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ku thuhet se i Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, ka thënë: “Kur ndonjërit prej jush i hapet goja (hapësitje), le ta mbulojë me dorën e tij, sepse aty hyn shejtani!”¹

Kur dikush lexon fjalët e Allahut të Lartë, si për shembull: **“Hebrenjtë thanë: “Uzejri është biri i Allahut”, të krishterët thanë: “Mesihu është biri i Allahut”...”** (Et Tevbe, 30);

“Hebrenjtë thanë: “Dora e Allahut është e shtrënguar”...” (El Maide, 64);

“Ata thanë: “I Gjithëmëshirshmi ka fëmijë”...” (Merjem, 88),

si dhe ajete të tjera të ngjashme, *duhet ulur zërin e tij*.

Kështu vepronte Ibrahim En Nehaiu, *Allahu qoftë i kënaqur me të*.

Ibën Ebi Davudi transmeton, me zinxhir transmetimi të dobët, se njëherë Shabiut iu bë kjo pyetje: “Nëse dikush lexon fjalën e Allahut: **“E vërtetë është se Allahu dhe melekët e Tij e bekojnë dhe e madhërojnë Pejgamberin. O ju që besuat, dërgoni salavate për të, dhe përshëndeteni me paqe e respekt!”** (El Ahzab, 56), - a duhet t’i dërgojë salavate Pejgamberit, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të?*”

Ai u përgjigj: “Po!”

Rekomandohet (është mustehab) që lexuesi, pas recitimit të fundit të sures *Et Tin*, të thotë atë që transmetohet prej Ebu Hurejres, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, i cili rrëfen se Pejgamberi, *paqja dhe bekimet e*

1 Transmetuar prej Buhariut dhe të tjerëve.

Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Kush e lexon suren Et Tin dhe, pas ajetit: “A nuk është Allahu Gjykatësi më i drejtë?”, - le të thotë: “Bela ve ene ala dhalike minesh-shahidin” - (Gjithsesi, dhe unë jam prej atyre që dëshmojnë për këtë)!”¹

Ibën Ebi Davudi dhe dijetarë të tjerë e kanë shënuar këtë hadith, duke shtuar nga transmetimet e Ebu Davudit dhe të Tirmidhiut: *“Kushdo që e reciton fundin e sures El Kijame, ku thuhet: “Vallë, Ai Krijues, a nuk ka fuqi që t’i ngjallë të vdekurit?!”, - le të thotë: “Bela, ve ene eshhed” - (Gjithsesi, dhe unë jam dëshmitar)!”* Po ashtu, kush reciton ajetin: *“Në çfarë shpalljeje tjetër do të besojnë ata pas këtij (Kurani)?!”* (El Murselat, 50), - *le të thotë: “Amentubilah” - (Unë besoj në Allahun)!”*

Se sa herë që Ibën Abbasi, Ibën Zubejri dhe Ebu Musa El Eshariu, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*, e lexonin suren El Eala, tregohet se thoshin me përlulësi: “Subhane Rabbijel Eala” - (I Pastër nga çdo e metë është Zoti im i Lartë).

Po ashtu, Omer bin Hattabi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, kur e dëgjonte fillimin e sures El Eala, e përsëriste këtë thënie tri herë: “Subhane Rabbijel Eala.”

Gjithashtu transmetohet se Abdullah bin Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, pasi falte namazin dhe lexonte fundin e sures Beni Israil (El Isra), thoshte: *“El Hamdu lilahil ledhi lem jettehidh veleden”* - “Falënderimi i takon Allahut, i Cili nuk ka lindur fëmijë!”²

Disa prej dijetarëve tanë kanë thënë se është e dëshirueshme që gjatë namazit të thuhet ato lutje dhe fjalë që përmenden në hadithin e Ebu Hurejres, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, lidhur me tri suret e përmendura më parë.

Gjithashtu, rekomandohet të përsëriten edhe lutjet e tjera që kemi përmendur, si dhe fjalë të ngjashme me to.

Dhe, vetëm Zoti i Madhëruar e di më së miri!

1 Ky hadith është transmetuar prej Ebu Davudit dhe Tirmidhiut, me një sened të dobët, përmes një beduini të panjohur, që e transmeton prej Ebu Hurejres, *Allahu qoftë i kënaqur me të*.

2 Hadithin e shënon Ibën Ebi Shejbe, në *Musanef* (403/1).

LEXIMI I DIÇKAJE NGA KURANI ME SYNIMIN E TË FOLURIT

Ibën Ebi Davudi ka shënuar se në lidhje me këtë çështje ka mospajtim (*ihtilaf*) mes dijetarëve.

Prej Ibrahim En Nehaiut, *Allahu e mëshiroftë*, është transmetuar se ai e urrente përdorimin e fjalëve të Kuranit për qëllime që lidhen me çështje të dynjasë (jetës së kësaj bote), qofshin ato në formë shpjegimi, apo edhe të folur të zakonshëm.

Nga ana tjetër, tregohet se Omer bin Hattabi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, gjatë një faljeje të namazit të akshamit në Mekë, recitoi: **“Pasha fikun dhe ullaqin. Dhe kodrën e Sinait”**, dhe pastaj kur arriti te pjesa: **“Dhe këtë qytet të sigurt (Mekën)”**, e ngriti zërin në shenjë nderimi për Qytetin e Shenjtë. (Et Tin, 1–3).

Hukejm bin Sadi tregon se një anëtar i sektit *Muhakimija* erdhi tek Aliu, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ndërsa ai ishte në namazin e sabahut, dhe e recitoi këtë ajet: **“Nëse bën shirk (i bën ortak Allahut), veprat e tua do të asgjësohen...”** (Ez Zumer, 65).

Aliu, *Allahu ia ndriçoftë fytyrën*, iu përgjigj gjatë namazit me fjalët e Allahut: **“Duro, sepse premtimi i Allahut është i vërtetë. Dhe mos lejo që ata që nuk besojnë të të lëkundin në vendosmërinë tënde!”** (Er Rum, 60).

Disa prej dijetarëve tanë kanë thënë: “Nëse një person që është në namaz, ndodhet në një vend të mbyllur dhe dikush i kërkon leje për të hyrë, dhe ai përgjigjet duke recituar ajetin: **“Hyni në to me paqe dhe siguri”** (El Hixhër, 46), atëherë, nëse ai e bën këtë me njetin e leximit të Kuranit, apo me dy qëllime njëkohësisht, lexim dhe njoftim për personin që kërkon të hyjë, namazi i tij mbetet i vlefshëm dhe nuk priset. Mirëpo, nëse ai e shqipton ajetin me qëllimin e vetëm të komunikimit, pa pasur për qëllim leximin si adhurim, atëherë namazi i tij është i pavlefshëm.”¹

Allahu i Lartë e di më së miri.

1 Këto mesele vlejnjë më së shumti për arabët, ose për ata që e kanë gjuhën arabe si gjuhë të përditshme, dhe nuk janë rrethana që prekin drejtpërdrejt realitetin e besimtarëve shqiptarë. (Sqarim i redaktorit.)

PËRSHËNDETJA GJATË LEXIMIT TË KURANIT

Nëse një person është duke recituar Kuranin, dhe në ndërkohë kalon pranë disa njerëzve, qoftë në ecje apo në një vend të ulur, rekomandohet që ai ta ndërpresë recitimin përkohësisht, t'i përshëndetë ata me “selam”, dhe më pas të vazhdojë me leximin.

Kur e rifillon recitimin, është e pëlqyeshme që ta përsëritë “*istiadhën*”. E njëjta gjë vlen edhe nëse është ulur dhe dikush kalon pranë tij.

Imam Ebu El Hasan El Vahidi ka thënë: “Më mirë është mos të përshëndetet ai që po reciton, sepse është i zënë me adhurim. Mirëpo nëse dikush e përshëndet, mjafton që ai t'i përgjigjet me isharet (shenjë të lehtë). Nëse dëshiron të përgjigjet me fjalë, le të përgjigjet, por më pas duhet ta përsëritë *istiadhen* dhe ta rifillojë recitimin.”

Megjithatë, ky mendim i Vahidiut është i dobët, sipas shumicës së dijetarëve.¹

1 Mendimi i Imam Ebu El Hasan El Vahidiut, se ai që është duke recituar Kuranin nuk ka nevojë ta kthejë selamin me fjalë, por mjafton një ishare e lehtë, është një mendim që, edhe pse nga shumica e dijetarëve është vlerësuar si më i dobët, në të vërtetë meriton vëmendje më të thelluar dhe një rishqyrtim të matur, për arsye të shumta. Së pari, siç njihet në literaturën klasike të fikhut, ka vende dhe situata ku dhënia e selamit është e papërshtatshme, madje e konsideruar mekruh (e pëlqyeshme të shmanget). Disa prej këtyre rasteve janë:

- Kur dikush është në banjo;
- Kur dikush është duke ngrënë;
- Kur është duke u falur;
- Kur është duke dhënë hutbe apo mësim;
- Kur është duke e lexuar Kuranin me përkushtim;
- Kur është në gjumë ose në gjendje që nuk i jepet përgjigje;
- Kur është në xhami, ku kërkohet qetësi e përkushtim.

Sipas kësaj logjike, vetë selami në disa raste del i papërshtatshëm, prandaj nuk ka kuptim të kërkohet kthimi i një përshëndetjeje që, në fakt, nuk është dashur të bëhet në radhë të parë. Së dyti, nga aspekti i adabit dhe përkushtimit shpirtëror, leximi i Kuranit është një akt adhurimi që kërkon përqendrim dhe qetësi. Ndërprerja e tij për të kthyer selamin me fjalë, ndonëse nuk është haram, mund të ndikojë në përkushtimin dhe rrjedhshmërinë e recitimit, sidomos kur lexuesi është në thellësi të meditimit mbi ajetet. Së treti, mendimi se mjafton kthimi i selamit me një shenjë (ishare) është në përputhje me disa veprime të sahabëve dhe me parimet e fikhut që lejojnë alternativa në situata ku adhurimi ka përparësi ndaj komunikimit shoqëror. Prandaj, edhe pse mendimi i shumicës është që selami duhet kthyer me fjalë, në këtë rast mendimi i Vahidiut mund të shihet si më i përshtatshëm dhe më i qëndrueshëm

Mendimi më i saktë dhe më i fortë është se është vaxhib (e detyrueshme) të kthehet përshëndetja me fjalë. Dijetarët tanë kanë thënë: “Nëse dikush hyn në xhami dhe jep selam në kohën kur mbahet hutbeja e xhumasë, edhe pse heshtja në atë moment është sunet, është e detyrueshme t’i kthehet përshëndetja, dhe kjo sipas dy mendimeve më të sakta.”

Nëse kthimi i selamit është i detyrueshëm edhe gjatë hutbes, kur është urdhëruar heshtja dhe ndalohet të flitet, atëherë akoma më e parësishme është që selami të kthehet gjatë leximit të Kuranit, kur nuk ka ndalim për të folur.

Në çdo rast, kthimi i selamit është vaxhib në përgjithësi, dhe Allahu i Lartë e di më së miri.

Nëse një person teshtin gjatë leximit të Kuranit, rekomandohet që të thotë *elhamdulilah* (falënderimi i takon Allahut). Kjo vlen edhe në namaz, sipas mendimit të disa dijetarëve. Teshtima është e natyrshme, dhe falënderimi ndaj Allahut në këtë rast nuk bie ndesh me adhurimin.¹

Nëse një person që reciton jashtë namazit e dëgjon dikë tjetër që teshtin dhe thotë *elhamdulilah*, atëherë rekomandohet që recituesi t’i përgjigjet duke thënë *jerhamukellah* (Allahu të mëshiroftë!).²

për realitetin tonë, ku shpesh selami jepet pa kujdes për rrethanat fetare. (Plotësim i redaktorit.)

- 1 Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një ndërhyrje në strukturën e namazit. Personalisht nuk e shoh të arsyeshme të thuhet “*elhamdulilah*” pas teshtimës gjatë namazit. Namazi është farz, dhe brenda këtij farzi nuk lejohen fjalë të jashtme, qoftë edhe kur lidhen me një veprim natyror si teshtima. Nëse teshtin – një herë apo më shumë – kryeje teshtimën me qetësi, pastro hundën nëse e kërkon nevoja dhe vazhdo namazin pa shqiptuar asgjë. Përndryshe, i hapim rrugë ndërprerjeve të panevojshme dhe futjes së fjalëve të tepërta në një ibadet që kërkon përqendrim dhe përlulësi të plotë. Namazi nuk është vend për të reaguar me fjalë ndaj çdo gjëje që ndodh, por për t’u shkëputur nga e përditshmja dhe për t’u lidhur me Allahun. Vallahu alem. (Vërejtje e redaktorit.)
- 2 Në këtë rast, nuk pajtohem me mendimin se leximi i Kuranit duhet të ndërpritet sa herë që dikush teshtin, apo kur teshtijnë disa persona njëkohësisht. Leximi i Kuranit nuk ka arsye të ndërpritet për shkak të teshtimave të tjerëve. Teshtima është një veprim natyror, që mund të ndodhë në çdo moment, dhe lexuesi duhet ta vazhdojë recitimin me përqendrim, pa u shqetësuar nga këto ndërhyrje të vogla të jashtme. (Vërejtje e redaktorit.)

Po ashtu, kur një person që po lexon Kuran e dëgjon muezinin duke e kënduar ezanin ose ikametin, ai duhet ta ndërpresë recitimin dhe t'i përgjigjet thirrjes sipas formës së përcaktuar në Sunet, pra, duke përsëritur fjalët e ezanit dhe të ikametit. Pasi të përfundojë ezani ose ikameti, mund të vazhdojë me leximin e tij.

Për këtë çështje dijetarët tanë janë unikë (ixhma) në qëndrimin se përgjigjja ndaj ezanit dhe ikametit ka përparësi ndaj leximit të Kuranit.

Nëse një person që është duke lexuar Kuran pyetet ose i kërkohet diçka, dhe ai ka mundësi të përgjigjet me një gjest (isharet) të qartë dhe të kuptueshëm, dhe në të njëjtën kohë beson se kjo nuk do t'i lëndojë ndjenjat e tjetrit, nuk do ta dëmtojë miqësinë apo marrëdhëniet mes tyre, dhe nuk do të krijojë keqkuptim, atëherë është më mirë që ai të përgjigjet me isharet, pa e ndërprerë leximin e tij.

Megjithatë, lejohet gjithashtu që ai ta ndërpresë përkohësisht recitimin, për t'iu përgjigjur me fjalë, nëse e sheh të nevojshme.

Allahu i Lartë e di më së miri.

NGRITJA NË KËMBË PËR DIJETARËT DHE NJERËZIT E MIRË

Nëse një person që është duke lexuar Kuranin ndeshet me dikë që dallohet për dije, drejtësi, fisnikëri, moshë të shtyrë apo ndonjë pozitë që meriton nderim, qofshin këto për shkak të autoritetit, prejardhjes, apo për ndonjë arsye tjetër që e bën atë të denjë për respekt, nuk ka të keqe që lexuesi të ngrihet në këmbë për ta përshëndetur me nderim dhe mirësjellje. Kjo duhet të bëhet jo nga shtirja apo për lavdërim, por nga respekti i sinqertë.

Madje, një veprim i tillë është i dëshirueshëm (*mustehab*), sipas dijetarëve.

Në të vërtetë, ngritja në këmbë për dikë nga respekti është një veprim që është vërtetuar në praktikën e të Dërguarit të Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*. Ky gjest i nderimit u praktikua prej sahabëve, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*, në praninë e Pejgamberit, *alejhi selam*, dhe me miratimin apo urdhrin e tij.

Po ashtu, kjo ishte edhe praktikë e tabiinëve, dhe ka vazhduar ndër brezat e mëvonshëm të dijetarëve dhe njerëzve të devotshëm, të cilët

e kanë parë ngritjen në këmbë si shprehje respekti, mirësjelljeje dhe nderimi.

Unë kam shkruar një monografi të veçantë (në njërën nga veprat e mia) lidhur me çështjen e ngritjes në këmbë për dikë nga respekti. Në atë punim kam përmbledhur dhe analizuar hadithet dhe transmetimet që përmenden për të rekomanduar apo ndaluar një gjë të tillë.

Brenda atij libri kam sqaruar në mënyrë të detajuar se cilat transmetime janë të sakta (autentike) dhe cilat janë të dobëta apo të pasakta. Po ashtu kam argumentuar me qartësi se ajo që është përmendur si ndalim, në të vërtetë nuk përbën ndalim të mirëfilltë.

Elhamdulillah, gjithçka është trajtuar me kujdes dhe në mënyrë të bazuar. Prandaj, kushdo që ka ndonjë dyshim lidhur me ndonjë nga këto hadithe, le t'i referohet asaj veprë dhe, me lejen e Allahut, aty do t'i gjejë sqarimet e nevojshme që ia largojnë çdo paqartësi!

RREGULLA TË VLEFSHME LIDHUR ME LEXIMIN GJATË NAMAZIT

Këtu po përmendim disa rregulla në mënyrë të përmbledhur, pasi ato janë të njohura dhe të trajtuara gjerësisht në librat e fikhut.

- Së pari, leximi i Kuranit është i detyrueshëm në namazet farze, sipas ixhmasë (konsensusit) së dijetarëve.
- Së dyti, dijetarët si Maliku, Shafiu dhe Ahmedi, *Allahu i mëshiroftë*, së bashku me shumicën e dijetarëve, janë të mendimit se është obligim (vaxhib) të lexohet sureja El Fatiha në çdo rekat të namazit.

Ndërsa, Ebu Hanife dhe një grup dijetarësh janë të mendimit se leximi i Fatihës nuk është obligim në mënyrë specifike, dhe se nuk është e detyrueshme të lexohet ajo në dy rekatet e fundit të namazeve me katër rekate.

Megjithatë, mendimi i parë është më i saktë dhe më i mbështetur, pasi argumentet nga Suneti e vërtetojnë qartë detyrimin e leximit të Fatihës.

Ndër to është hadithi autentik ku i Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, ka thënë: “Nuk është i plotë namazi në të cilin nuk këndohet *Ummul-Kurani (d.m.th. sureja El Fatiha)*. ”

- Të gjithë dijetarët bien dakord se është e dëshirueshme që pas Fatihasë të lexohet një sure tjetër në namazin e sabahut dhe në dy rekatet e para të namazeve të tjera. Megjithatë, ka mospajtime lidhur me nevojën e leximit në rekatën e tretë dhe të katërt.
- Imam Shafiu, *Allahu e mëshiroftë*, ka shprehur dy mendime për këtë çështje: një mendim i ri që e konsideron këtë veprim si *mustehab* (të dëshirueshëm), dhe një mendim të mëparshëm, sipas të cilit kjo nuk është *mustehab*.

Dijetarët tanë thonë se, në rast se e pranojmë se është *mustehab*, atëherë nuk ka mospajtime për faktin se leximi në rekatën e tretë dhe të katërt duhet të jetë më i shkurtër se në dy rekatet e para. Gjithashtu, ata theksojnë se leximi në rekatën e tretë dhe të katërt duhet të ketë gjatësi të përafërt mes tyre.

- A duhet që leximi në rekatën e parë të jetë më i gjatë se në rekatën e dytë? Në lidhje me këtë çështje ekzistojnë dy mendime. Mendimi i parë, që është edhe qëndrimi i shumicës së dijetarëve tanë, është se leximi në rekatën e parë nuk duhet të jetë më i gjatë se në rekatën e dytë.
- Ndërsa mendimi i dytë, i mbështetur prej ekspertëve (*muhakikë*), është se leximi në rekatën e parë duhet të jetë më i gjatë se në të dytin. Ky është mendimi më i saktë dhe më i preferuar, bazuar në hadithin autentik (sahih) ku thuhet: *“I Dërguari i Zotit, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, lexonte më gjatë në rekatën e parë, sesa në të dytin.”*

Një nga dobritë e kësaj praktike është që, ata që vijnë vonë në namaz, të kenë mundësi ta arrijnë rekatën e parë dhe mos ta humbasin atë.

Allahu e di më së miri.

- Imam Shafiu, *Zoti e mëshiroftë*, thotë: “Nëse një person që vjen me vonesë në namaz i arrin dy rekatet e fundit të namazit të drekës, ose të ndonjë namazi tjetër me imam, dhe më pas ngrihet për ta plotësuar rekatën e mbetur, është e rekomandueshme që të lexojë një sure (pas Fatihas).”
- Shumica e dijetarëve tanë kanë dy mendime për këtë çështje.
- Disa prej tyre, duke u mbështetur në fjalën e Imam Shafiut, janë

të mendimit se duhet të lexohet një sure pas Fatihasë edhe në dy rekatet e fundit, nëse ato për individin janë në të vërtetë rekatet e tij të para.

- Të tjerët janë të mendimit se nuk është e rekomanduar, duke u bazuar në faktin se për imamin ato janë rekatet e fundit, ku zakonisht nuk lexohet sure pas Fatihas.

Mendimi më i saktë është ai i pari, sepse në këtë mënyrë namazi i atij që ka ardhur me vonesë nuk mbetet pa lexim të ndonjë sureje përveç Fatihas, gjë që përputhet më mirë me frymën e Sunetit.

Kjo dispozitë vlen edhe për imamin, e edhe për atë që falet vetëm (*munferid*).

Allahu i Lartë e di më së miri.

Sa i përket muktediut (personit që falet pas imamit), dispozitat ndryshojnë varësisht nga lloji i namazit:

- Në namazet që falen pa zë (si dreka dhe ikindia), ai është i obliguar ta lexojë Fatihanë, dhe është e rekomanduar që pas saj të lexojë edhe një sure tjetër.
- Në namazet që falen me zë (si sabahu, akshami dhe jacia), nëse e dëgjon qartë recitimin e imamit, atëherë është mekruh që të lexojë ndonjë sure tjetër, sipas shumicës së dijetarëve.

Sa i përket leximit të Fatihasë, në këtë rast (kur namazi është me zë dhe ai e dëgjon imamin), ka dy mendime:

1. Sipas një mendimi (dhe ky është më i saktë), leximi i Fatihasë është i detyrueshëm.
2. Sipas mendimit tjetër, nuk është i detyrueshëm.

Nëse muktediu nuk e dëgjon recitimin e imamit, atëherë mendimi më i saktë është se:

- Fatihaja është obligim,
- Edhe leximi i një sureje tjetër pas saj është i rekomanduar,
- Ndërsa, disa dijetarë kanë thënë se në këtë rast Fatihaja nuk është obligim, po edhe të tjerë kanë thënë se ajo është obligim, por nuk është e pëlqyeshme të lexohet ndonjë sure tjetër pas saj.

Allahu i Lartë e di më së miri.

- Në tekbinin e parë të namazit të xhenazes është obligim të lexohet sureja El Fatiha.
- Gjithashtu, në të gjitha namazet *nafile* (vullnetare), leximi i Fatihës është i domosdoshëm.
- Megjithatë, dijetarët tanë kanë mospajtime në lidhje me emërtimin e kësaj domosdoshmërie (hukmit):
- El Kafali ka thënë se leximi i Fatihës është obligim (vaxhib).
- El Kadi Husejni, shoku i tij, ka thënë se është kusht (shart) për vlefshmërinë e namazit.
- Ndërsa të tjerë prej dijetarëve tanë kanë thënë se është pjesë përbërëse e namazit (*rukni*), dhe ky është mendimi më i mbështetur dhe më i përhapur.

Allahu i Lartë e di më së miri.

Nëse një person është i paaftë për ta lexuar suren El Fatiha në ndonjë nga rastet kur ajo është e domosdoshme, atëherë ai vepron sipas mundësive të tij në mënyrën vijuese:

1. Nëse nuk është në gjendje ta lexojë Fatihanë, atëherë le t'i lexojë ajetet e tjera nga Kurani, në një gjatësi të përafërt me Fatihanë.
2. Nëse nuk mund të lexojë asnjë ajet nga Kurani, atëherë le të përsërisë ndonjë dhikër (lutje), sikurse, për shembull: “Subhanallah”, “Elhamdulillah”, “La ilahe il-Allah”, ose lutje të tjera të ngjashme, për aq kohë sa zgjat leximi i Fatihës.
3. Nëse nuk mund ta bëjë as këtë, atëherë le të qëndrojë në këmbë për aq kohë sa zakonisht nevojitet për ta lexuar Fatihanë, pastaj shkon në ruku.

Allahu i Lartë e di më së miri.

RECITIMI I DISA SUREVE NË NJË REKAT

Nuk ka asnjë të keqe të lexohen disa sure në një rekat të vetëm. Kjo praktikë është e lejuar dhe e vërtetuar nga Suneti. Në dy Sahihët (të Buhariut dhe të Muslimit) është shënuar hadithi i Abdullah bin Mes-

udit, *Zoti qoftë i kënaqur me të*, i cili ka thënë: “*Unë e di mënyrën se si i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) i lexoi dy sure në një rekat*”, dhe përmendi njëzet sure nga suret e *mufassalit*,¹ duke lexuar dy në çdo rekat. Siç përmendëm më parë, disa prej paraardhësve të devotshëm (selefëve) e lexonin tërë Kuranin në një rekat të vetëm, gjë që tregon për lejueshmërinë e grumbullimit të sureve në një rekat dhe për vlerën e madhe të përkushtimit të tyre në ibadet.

Allahu e di më së miri.

LEXIMI ME ZË DHE NË HESHTJE GJATË NAMAZIT

Ekziston konsensus (*ixhma*) mes dijetarëve myslimanë, se është e pëlqyeshme (*mustehab*) që të lexohet me zë në:

- Namazin e sabahut,
- Namazin e xhumasë,
- Dy namazet e bajrameve,
- Dy rekatet e para të namazit të akshamit,
- Namazin e jacisë,
- Namazet e teravive dhe të vitrit që vjen pas tyre (gjatë muajit Ramazan).

Kjo dispozitë vlen si për imamin, ashtu edhe për personin që falet vetëm (munferid).²

Sa i përket pasuesit në namaz (muktediut), ai nuk lexon me zë, dhe për këtë ekziston konsensus i plotë (*ixhma*).

Në medhhebin shafii konsiderohet sunet që:

- Të lexohet me zë në namazin e eklipsit hënor (khusuf el kamer);

1 Suret nga Kaf (nr. 50) ose El Huxhuratë (nr. 49), e deri në fund të Kuranit, njihen si “suret e mufassalit.”

2 Sipas medhhebit hanefi, leximi me zë në disa namaze, si ai i sabahut, xhumasë, bajrameve, dy rekatet e para të akshamit dhe jacisë, si dhe namazet e teravive dhe vitrit gjatë Ramazanit, është vaxhib dhe jo vetëm mustehab. Kjo është e vendosur për t’i mundësuar xhematit dëgjimin dhe përqendrimin në leximin e Kuranit. (Sqarim i redaktorit.)

- Mos të lexohet me zë në namazin e eklipsit diellor (khususesh shems);
- Leximi me zë të bëhet në namazin e shiut (istiska), dhe;
- Në namazin e xhenazes nuk lexohet me zë, as nëse falet ditën dhe as nëse falet natën, sipas mendimit më të saktë dhe më të preferuar në medhhebin shafii.

Sa u përket namazeve vullnetare (nafile) të ditës, në përgjithësi nuk lexohet me zë, përveç namazeve të bajrameve dhe namazit të shiut, siç u përmend më sipër. Ndërsa, për namazet nafile të natës, dijetarët tanë kanë tri mendime:

1. Mendimi më i përhapur: nuk lexohet me zë.
2. Mendimi i dytë: lexohet me zë.
3. Mendimi i tretë: lexohet me zë të ulët (midis leximit të zëshëm dhe të heshtur), dhe ky është mendimi i përzgjedhur prej Imam Begaviut, *Allahu e mëshiroftë*.

Nëse dikujt i ka kaluar një namaz që normalisht falet me zë gjatë natës, dhe ai e fal kaza gjatë ditës, ose anasjelltas, pra i ka kaluar një namaz që zakonisht falet në heshtje gjatë ditës, dhe ai e fal kaza gjatë natës, cila kohë merret parasysh për të përcaktuar nëse duhet të lexojë me zë apo në heshtje?

Në lidhje me këtë çështje, shafiitë kanë dy mendime:

1. Mendimi i parë, i cili është edhe më i saktë dhe më i përhapur, është se merret parasysh koha kur falet kaza, jo koha kur ka qenë obligim fillestar namazi.
2. Mendimi i dytë thotë se duhet të merret parasysh koha kur ka qenë obligim fillimisht, domethënë koha kur është bërë farz.

Pra, sipas mendimit më të saktë:

- Nëse fal kaza të sabahut gjatë ditës, lexon me zë.
- Nëse fal kaza të drekës gjatë natës, lexon në heshtje.

Nëse dikush lexon me zë në një namaz kur duhet të lexojë në heshtje, ose lexon në heshtje në një namaz kur duhet të lexojë me zë, namazi i tij është i vlefshëm, mirëpo veprimi i tij konsiderohet *mekruh*

(i papëlqyeshëm). Megjithatë, nuk është e nevojshme të bëjë sexhden e harresës (sehvi sexhde).

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se ajo që nënkuptohet me “heshtje” ose recitim pa zë, kur bëhet fjalë për Kuranin, tekbirot (thënien “Allahu Ekber”) dhe lutjet e tjera të namazit, është që njeriu t’i shqiptojë ato me zë aq sa mund t’i dëgjojë vetë. Nëse ai ka dëgjim të shëndoshë dhe nuk ka ndonjë pengesë akustike, atëherë duhet t’i shqiptojë fjalët në një mënyrë që vetë i dëgjon ato. Ndërsa, nëse nuk i dëgjon fjalët që shqipton, atëherë, sipas mendimit unanim të dijetarëve, recitimi i Kuranit dhe i lutjeve të tjera konsiderohet i pavlefshëm.

PAUZAT E IMAMIT GJATË NAMAZIT ME ZË

Dijetarët tanë kanë thënë se është e dëshirueshme (*mustehab*) që imami të bëjë katër pauza të shkurtra gjatë qëndrimit në këmbë në një namaz që falet me zë:

1. **Pas tekbitit fillestar (iftitahu tekbit):** Një pauzë e shkurtër për të mundësuar recitimin në heshtje të duasë së hapjes (si “Subhaneke”) dhe që ata që falen pas imamit të kenë kohë të marrin tekbitin dhe të thonë “Allahu Ekber”.

2. **Pas përfundimit të Fatihasë:** Një pauzë shumë e shkurtër ndërmjet mbarimit të Fatihasë dhe shqiptimit të fjalës “amin”, në mënyrë që mos të krijohet përshtypja se “amin” është pjesë e vetë Fatihasë.

3. **Pas “amin”-it:** Një pauzë pak më e gjatë, për t’u dhënë mundësi atyre që falen pas imamit të lexojnë Fatihanë në heshtje.

4. **Pas leximit të sures (ose ajeteve) pas Fatihasë:** Një pauzë e shkurtër për të krijuar ndarje mes përfundimit të leximit dhe tekbitit që paraprin shkuarjen në ruku.

KUPTIMI I FJALËS “AMIN”

DHE RREGULLAT QË LIDHEN ME TË

E dëshirueshme (*mustehab*) është që çdo person që lexon Kuranin, qoftë në namaz apo jashtë tij, të thotë “amin” pas përfundimit të

leximit të sures El Fatiha. Për këtë praktikë ekzistojnë shumë hadithe autentike dhe të njohura.

Siç përmendëm edhe në kapitullin e mëparshëm, është e pëlqyeshme që ndërmjet përfundimit të Fatihës dhe shqiptimit të “amin”-it të bëhet një pauzë e shkurtër, në mënyrë që mos të krijohet përshtypja se “amin” është pjesë e Fatihës.

Fjala “*amin*” ka disa kuptime të afërta, ndër të cilat janë:

- “O Allah, përgjigjju (lutjes)! ”
- “Kështu qoftë!”
- “Bëje realitet atë që u tha!”
- “Askush përveç Teje nuk mund ta plotësojë këtë!”
- “Mos na lër pa përgjigje!”
- “O Allah, na jep siguri dhe mirësi!”

Këto kuptime reflektojnë qëllimin e singertë të lutësit dhe shpresën e tij në mëshirën dhe përgjigjen e Allahut.

Gjithashtu thuhet se “amin” është vula e Allahut mbi robërit e Tij, me të cilën Ai i largon fatkeqësitë prej tyre. Sipas një mendimi tjetër, ajo përfaqëson një gradë të veçantë në Xhenet, të cilën e fiton ai që e shqipton me bindje dhe përkushtim.

Disa kanë pohuar se “amin” është një nga emrat e Allahut, por ky mendim është refuzuar prej shumicës së dijetarëve dhe ekspertëve të fushës. Ka edhe prej atyre që kanë thënë se është një fjalë me prejardhje hebraike që është arabizuar në përdorim.

Ebu Bekër El Verrak ka dhënë një interpretim kuptimplotë, duke thënë se “amin” është fuqia e lutjes që sjell zbritjen e mëshirës hyjnore.

Ekzistojnë edhe mendime të tjera lidhur me kuptimin dhe natyrën e kësaj fjale, e të cilat tregojnë thellësinë dhe pasurinë shpirtërore që mbart kjo fjalë.

Ka disa mënyra të ndryshme të shqiptimit të fjalës *amin*. Sipas gjuhëtarëve, shqiptimi më i pastër dhe më i saktë nga ana gjuhësore është kur zgjatet zanorja *a*, ndërsa shkronja *m* shqiptohet butë dhe lehtë. Një mendim tjetër, gjithashtu i njohur, është që *a*-ja të lexohet shkurt.

Një variant i tretë i shqiptimit përfshin një ngjyrosje të *a*-së drejt tingullit *e*, duke e shtrirë në mënyrë të lehtë dhe të ndërmjetme (gjysmë të gjatë – *imale*). Ky mendim përcillet prej Vahidiut, i cili e transmeton prej dijetarëve Hamzait dhe Kisaiut.

Ndërsa, mendimi i katërt, më i veçanti ndër të gjithë, është ai kur *m*-ja zgjatet dhe shqiptohet me teshdid (dmth. e përforcuar: *ammin*). Edhe ky qëndrim përcillet prej Vahidiut, që e transmeton prej Hasan dhe Husejn bin El Fadlit. Këtë e mbështet edhe një thënie e transmetuar prej Imam Xhafer Es Sadikut, *Zoti qoftë i kënaqur me të*, i cili ka thënë se kuptimi i saj është: *Te Ti drejtohem i dhe Ti je tepër bujar për ta zhgënjyer këdo që përpiket për te Ti*.

Megjithatë, ky qëndrim i katërt është konsideruar i pazakontë dhe është cilësuar si i gabuar prej shumicës së leksikografëve, të cilët mendojnë se si mendim ka lindur nga interpretimet e gabuara të njerëzve të thjeshtë.

Disa prej dijetarëve tanë madje kanë deklaruar: “Kushdo që e shqipton “amin”-in në namaz duke e përforcuar *m*-në (me teshdid), namazi i tij është i pavlefshëm.”

Gjuhëtarët kanë theksuar se, sipas rregullave të gjuhës arabe, pas shqiptimit të fjalës *amin* duhet bërë një ndalesë e shkurtër, pasi ajo trajtohet si një tingull i veçantë dhe i pavarur. Megjithatë, nëse *amin* lidhet me fjalët që pasojnë, atëherë *nun*-i në fund merr një *fet’ha* (pra një *e* të shkurtër në fund), për të shmangur takimin e dy bashkëtingëlloreve që mbajnë *sukun*. Në këtë rast fjala shqiptohet *amine*, ngjashëm me fjalët *ejne* dhe *kejfe*.

Kësaj nuk i jepet *kesre* (pra *i* e shkurtër), pasi një shqiptim i tillë do ta bënte fjalën më të vështirë për t’u artikuluar në mënyrë të rrjedhshme dhe të natyrshme.

Kjo përbën një përmbledhje të shkurtër mbi çështjen e shqiptimit të *amin*-it. Një trajtim më të detajuar, së bashku me dëshmi dhe citime të zgjeruara, e kam paraqitur në librin *Tehdhibu El Esmāi ve El Lugat*.

Dijetarët janë të një mendjeje se shqiptimi i *amin*-it në namaz është i rekomanduar (*mustehab*) për të gjithë: për imamin, për atë që falet vetëm dhe për atë që falet pas imamit. Imami dhe ai që falet vetëm e shqiptojnë *amin*-in me zë në namazet që falen me zë, si namazi i

sabahut, i akshamit dhe i jacisë.

Megjithatë, ekzistojnë mendime të ndryshme në lidhje me çështjen nëse ai që falet pas imamit duhet ta thotë *amin*-in me zë apo jo.

Tri mendimet kryesore janë si më poshtë:

1. **Mendimi më i saktë** është se personi që falet pas imamit duhet ta thotë *amin*-in me zë.

2. **Mendimi i dytë** është se ai nuk duhet ta shqiptojë *amin*-in me zë.

3. **Mendimi i tretë** sugjeron që *amin*-i thuhet me zë vetëm nëse njeriu falet në një xhemat të madh; përndryshe, kur falet në një rreth të ngushtë, ai nuk e shqipton me zë.

Ai që falet pas imamit duhet ta shqiptojë fjalën *amin* njëkohësisht me imamin, dhe jo para apo pas tij. Kjo bazohet në hadithin autentik të pejgamberit Muhamed, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, i cili ka thënë: “*Kur imami thotë “ve led-dal-lin”, ju thoni **amin**, sepse nëse kjo fjalë përkon me atë që thonë melekët, personit që e thotë do t’i falen mëkatet e mëparshme.*”¹

Sa i përket hadithit të Pejgamberit, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*: “*Kur imami thotë **amin**, atëherë thoni edhe ju **amin**”, dijetarët kanë shpjeguar se kjo nënkupton që fjala *amin* duhet të shqiptohet nga xhemati në të njëjtën kohë kur imami është gati ta thotë atë, pra në mënyrë të sinkronizuar me të.*

Ulematë tanë theksojnë se nuk ka asnjë moment tjetër gjatë namazit në të cilin është e rekomanduar që shqiptimi i ndonjë fjale nga ai që falet pas imamit të ndodhë njëkohësisht me shqiptimin e saj nga ana e imamit përveç fjalës *amin*. Të gjitha fjalët e tjera thuhet pas imamit.

1 Transmetuar prej Buhariut dhe Muslimit.

SEXHDEJA E LEXIMIT TË KURANIT

– SEXHDE TILAVETI

Kjo temë pa dyshim se meriton vëmendje të veçantë, pasi lidhet drejtpërdrejt me respektin dhe përlësinë ndaj Fjalës së Allahut. Dijetarët janë të një mendjeje se sexhdeja e leximit të Kuranit (*sexhde tilaveti*) është një urdhër fetar i konfirmuar. Megjithatë, ata kanë pasur mendime të ndryshme në lidhje me shkallën e detyrueshmërisë së saj: a është ajo *vaxhib*, apo *sunet*?

Shumica e dijetarëve kanë thënë se sexhdeja e leximit është *sunet*, dhe jo *vaxhib*. Këtij mendimi i përmbahen shumë prej sahabëve dhe dijetarëve të mëdhenj të Islamit, përfshirë: Omer bin Hattabin, Ibën Abbasin, Selman Farisiun, Imran bin Husajnin, si dhe prej imamëve: Malikun, Evzaiun, Shafiun, Ahmedin, Is'hakun, Ebu Thevrin, Davudin dhe të tjerë, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*.

Në anën tjetër, Imam Ebu Hanife, *Allahu e mëshiroftë*, mendon se sexhdeja e leximit është *vaxhib* (obligim), duke u mbështetur në ajetin kuranor: **“Çfarë kanë ata që nuk duan të besojnë?! E përse, kur u lexohet Kurani, nuk përulen në sexhde?!”** (El Inshikak, 20–21)

Ndërsa, shumica e dijetarëve qëndrojnë në mendimin se sexhdeja e leximit (*sexhde tilaveti*) është *sunet*, dhe jo *vaxhib*. Ata e mbështesin këtë qëndrim në një hadith autentik, i cili transmetohet prej Hz. Omerit, *Allahu qoftë i kënaqur me të*.

Në këtë hadith thuhet se Omeri, gjatë një hytbeje në ditën e xhuma, e lexoi suren *En Nahël* nga minberi. Kur arriti tek ajeti i sexhdes, ai zbriti nga minberi dhe ra në sexhde, dhe me të bashkë edhe njerëzit që ishin të pranishëm. Në xhumanë pasuese ai lexoi sërish të njëjtën sure dhe, kur arriti tek ajeti i sexhdes, tha: **“O njerëz! Ne jemi urdhëruar të bëjmë sexhde. Kush bën sexhde, ka vepruar mirë, dhe kush nuk e bën, nuk ka mëkat.”** Më pas, Omeri, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, nuk e bëri sexhden atë ditë.¹

Fakti që Omeri, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, e sqaroi hapur se sexhdeja e leximit nuk është detyrim dhe vetë nuk e kreu atë në një tubim publik, është një dëshmi e qartë dhe e fortë që tregon se kjo sexhde nuk është *vaxhib*, por një vepër e pëlqyeshme (*sunet*).

¹ Transmetuar prej Buhariut.

Sa i përket ajetit që Imam Ebu Hanife, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, e merr si argument për detyrueshmërinë e sexhdes: **“Çfarë kanë ata që nuk duan të besojnë?! E përse, kur u lexohet Kurani, nuk përulen në sexhde?!”,** - përgjigjja është e qartë.

Ajeti në fjalë nuk ka të bëjë me urdhërin për besimtarët që të bëjnë sexhde të leximit, por është një qortim drejtuar jobesimtarëve për refuzimin dhe mospërkuljen e tyre ndaj Fjalës së Allahut. Kjo kuptohet më së miri nga vazhdimi i ajetit, kur Zoti i Lartë thotë: **“Përkundrazi, ata që nuk besojnë e quajnë atë gënjeshtër.”** (El Inshikak, 22)

Në librat autentikë të Buhariut dhe të Muslimit transmetohet se Zejd bin Thabiti, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, kishte lexuar suren *En Nexhm* para të Dërguarit të Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, dhe Pejgamberi, *alejhi selam*, nuk bëri sexhde pas leximit të saj.¹

Ndërkohë, në të njëjtat koleksione të besueshme të haditheve është shënuar se Pejgamberi, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, në raste të tjera ka bërë sexhde pas leximit të po kësaj sureje.

Këto dy transmetime, të sakta dhe të verifikuara, tregojnë qartë se sexhdeja e leximit (*sexhdetu et tilaveti*) nuk është detyrim (*vaxhib*), sepse sikur të ishte e tillë, Pejgamberi, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, nuk do ta kishte lënë pa e kryer edhe në ndonjë rast të vetëm. Veprimi dhe mosveprimi i tij në raste të ndryshme shërben si provë e fortë se kjo sexhde është e pëlqyeshme (*sunet*), por jo e detyrueshme.

NUMRI DHE VENDET E SEXHDEVE TË LEXIMIT

Sa i përket numrit të ajeteve ku ndodhet sexhdeja e leximit (*sexhde tilaveti*), mendimi më i saktë dhe më i mbështetur prej shumicës së dijetarëve, përfshirë Imam Shafiun, është se ato janë katërmbëdhjetë.

Vendndodhjet e tyre në Kuran janë si më poshtë:

1. Surja El Araf, ajeti 206
2. Surja Er Ra’d, ajeti 15
3. Surja En Nahël, ajeti 50

¹ Buhariu (1072), Muslimi (577).

4. Surja El Isra, ajeti 109
5. Surja Merjem, ajeti 58
6. Surja El Haxhxxh, ajeti 18
7. Surja El Haxhxxh, ajeti 77
8. Surja El Furkan, ajeti 60
9. Surja En Neml, ajeti 26
10. Surja Es Sexhde, ajeti 15
11. Surja Fussilet, ajeti 38
12. Surja En Nexhm, ajeti 62
13. Surja El Inshikak, ajeti 21
14. Surja El Alek, ajeti 19

Sa i përket sexhdes që ndodhet në suren *Sad*, ajo konsiderohet si e rekomanduar (*mustehab*), dhe nuk përfshihet në mesin e sexhdeve të njohura të leximit, e që janë katërmbëdhjetë.

Kjo bazohet në një transmetim të saktë nga Sahihu i Buhariut, ku Abdullah bin Abbasi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ka thënë: “*Surja Sad nuk përmban një sexhde të detyrueshme të leximit, por unë e kam parë të Dërguarin e Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, duke bërë sexhde kur e lexonte atë.*”¹

Ky veprim i Pejgamberit, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, tregon se sexhdeja në këtë rast është e lejuar dhe e lavdëruar, por jo e detyrueshme. Ky është mendimi i Imam Shafiut dhe i dijetarëve të tjerë që e ndjekin të njëjtin drejtim juridik.

Imam Ebu Hanife, *Allahu e mëshiroftë*, gjithashtu pajtohet se janë katërmbëdhjetë sexhde, por me një ndryshim: Ai nuk e pranon sexhden e dytë në suren El Haxh si pjesë të sexhdeve të kërkuara, ndërsa e përfshin sexhden e sures *Sad*, të cilën e konsideron ndër sexhdet e obliguara.

Sa i përket Imam Ahmed bin Hanbelit, prej tij janë transmetuar dy mendime (rivajete):

1. **Mendimi i parë** përputhet me atë të Imam Shafiut, katërmbëdhjetë sexhde, duke mos përfshirë sexhden e sures *Sad*.

¹ Buhariu (1069).

2. **Mendimi i dytë** është se numri i sexhdeve është **pesëmbëdhjetë**, përfshirë edhe sexhden e *Sad*-it si një sexhde të kërkuar (*tilavet*).

Ky mendim i dytë është përkrahur gjithashtu edhe prej dijetarëve të tjerë si Ebu El Abas bin Surejxhi dhe Ebu Is'hak El Mervezi, të dy prej shokëve të shquar të Shafiut, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*.

Edhe në medhhebin e Imam Malikut ekzistojnë dy rivajete (transmetime) lidhur me numrin e sexhdeve të leximit:

- **Rivajeti i parë** përputhet me qëndrimin e Imam Shafiut, duke pranuar katërmëdhjetë sexhde.
- **Rivajeti i dytë**, që është më i njohuri dhe më i përhapur në medhhebin maliki, thotë se numri i sexhdeve është vetëm njëmbëdhjetë, duke përjashtuar sexhdet e sures *En Nexhm*, *El Inshikak* dhe *El Alek*.

Ky qëndrim i dytë është gjithashtu një mendim i vjetër, e që në të kaluarën ka qenë i përhapur edhe në medhhebin e Shafiut.

Megjithatë, mendimi më i saktë dhe i përforcuar nga hadithet autentike mbetet ai që e pranon ekzistencën e katërmëdhjetë sexhdeve, siç përmendëm më parë.

Midis dijetarëve nuk ka kundërthënie të theksuar për vendndodhjen e përgjithshme të sexhdeve të leximit, përveç në rastin e sexhdes së sures *Fussilet*, ku ekzistojnë dy mendime kryesore.

Sipas Imam Shafiut dhe shokëve të tij, sexhdeja në suren *Fussilet* është e vendosur pas fjalës *“la jese mune”*. Ky qëndrim përputhet me mendimin e dijetarëve të mëdhenj si Seid bin Musejib, Muhamed bin Sirin, Ebu Vaili, Sufjan Eth Thevriu, Ebu Hanife, Ahmed bin Hanbeli dhe Is'hak bin Rahevejh.

Nga ana tjetër, një grup tjetër dijetarësh mendojnë se sexhdeja në këtë sure duhet të bëhet pas fjalës së Zotit: *“in kuntum ijjahu tabudune”*. Këtë qëndrim e transmeton Ibën Mundhiri, duke e marrë prej dijetarëve të njohur si Omer bin Hattabi, Hasan El Basriu, nxënësit e Abdullah bin Mesudit, Ibrahim En Nehaiu, Ebu Salihut, Talha bin Musarifit, Zubejd bin Harithit, Malik bin Enesit dhe Lejth bin Sadit. Po ashtu, disa shokë të Shafiut e mbështesin këtë mendim, siç transmetohet prej Begaviut, në librin *Tehdhib*.

Ebu El Hasan Ali bin Seid El Abderi, njëri prej dijetarëve tanë, në librin e tij *El Kifajeh*, trajton kundërshtimet midis juristëve (fukahave) lidhur me vendndodhjen e sexhdes në suren *En Neml*. Ai mendon se sexhdeja duhet të bëhet pas fjalës së Allahut: “*Ve jalemu ma tuhfune ve ma tulinune*”, dhe deklaroi se ky është qëndrimi i medhhebit shafii dhe i shumicës së fukahave.

Nga ana tjetër, Imam Maliku e vendos sexhden pas fjalës së Allahut: “*Rabbul Arshil Adhim*”.

Megjithatë, ajo që Ebu El Hasan Ali pretendon si mendim të medhhebit shafii dhe të shumicës së juristëve, nuk është njohur asnjëherë apo pranuar në mënyrë të gjerë. Përkundrazi, ky është një gabim i qartë. Librat e dijetarëve tanë janë të qartë dhe të pakundërshtueshëm në konstatimin se vendndodhja e vërtetë e ajetit të sexhdes në këtë sure është te Fjala e Allahut të Madhëruar: “*Rabbul Arshil Adhim*.”

KUSHTET PËR VLEFSHMËRINË E SEXHDES SË LEXIMIT (*SEXHDE TILAVET*)

Sexhdeja e leximit të Kuranit, ose sexhdeja e *tilavetit*, ndjek të njëjtat rregulla me namazin nafile (vullnetar). Kushtet kryesore për vlefshmërinë e saj janë si më poshtë:

1. **Pastërtia (abdesi):** Personi duhet të jetë në gjendje të pastër, pra, të ketë abdes. Dhe, është e ndaluar që të bëjë sexhde ai që ka në trup apo në rroba papastërti të pafalshme ligjërisht. Nëse nuk ka abdes, nuk lejohet të bëjë sexhde, përveç në rastet kur mund të marrë tejemum, në situata të lejuara.
2. **Drejtimi:** Sexhdeja duhet të bëhet duke u kthyer kah kibla. Nuk lejohet të bëhet sexhde në drejtim tjetër, përveç rasteve të udhëtimit, kur edhe namazet nafile lejohen të falen në drejtim tjetër përveç kibles.
3. **Mbulesa e avretit:** Gjatë sexhdes duhet të jenë të mbuluara pjesët intime (avreti).

Për këto kushte ka unanimitet mes dijetarëve, të cilët pajtohen se janë të domosdoshme për vlefshmërinë e sexhdes së leximit.

SEXHDEJA E SURES SAD

Lidhur me sexhden në suren *Sad*, ekzistojnë dy qëndrime kryesore mes dijetarëve:

- Ata që e konsiderojnë sexhden në këtë sure të detyrueshme, mendojnë se ajo duhet kryer pavarësisht nëse sureja lexohet gjatë namazit, apo jashtë tij, duke e trajtuar si çdo ajet tjetër që kërkon sexhde.
- Ndërkaq, Imam Shafiu dhe disa dijetarë të tjerë, të cilët mendojnë se surja *Sad* nuk përfshihet në grupin e ajeteve që kërkojnë sexhde, shpjegojnë se, kur dikush e lexon këtë sure jashtë namazit, është e rekomanduar të kryejë sexhden, sepse Pejgamberi, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, ka bërë sexhde gjatë leximit të saj, siç e përmendëm më parë. Mirëpo, nëse ajo lexohet brenda namazit, atëherë sexhdeja nuk duhet të kryhet.

Megjithatë, nëse dikush kryen sexhde gjatë namazit, nga injoranca ose harresa, duke menduar se ajo kërkohet, kjo nuk e prish namazin e tij. Megjithatë, ai duhet të kryejë edhe sexhden e harresës (sehvi sexhden), për ta përmirësuar veprimin.

Ndryshe qëndron rasti kur personi e di me siguri se sexhdeja nuk është e nevojshme, por përsëri e bën atë gjatë namazit. Sipas mendimit më të saktë, namazi i tillë konsiderohet i pavlefshëm, sepse ai i ka shtuar namazit një veprim që nuk i takon, dhe kjo është e njëjtë me situatën kur dikush bën sexhde falënderimi brenda namazit dhe, në këtë rast, namazi prishet.

Ekziston edhe një mendim i dytë, i cili thotë se namazi nuk prishet, pasi sexhdeja ka lidhje me vetë namazin dhe nuk konsiderohet një veprim i jashtëm i ndaluar.

Nëse imami bën sexhde gjatë leximit të ajetit të 24-të të sures *Sad*, duke besuar se kjo sexhde është e detyrueshme, mirëpo dikush që fallet pas tij nuk e ndan këtë mendim, ai nuk duhet ta ndjekë imamin në këtë veprim. Në vend të kësaj falësi duhet të qëndrojë në këmbë ose të tërhiqet lehtë, duke pritur që imami ta përfundojë sexhden.

Sa i përket pyetjes nëse ai që qëndron në pritje¹ duhet ta kryejë sexhden e harresës (*sehvi sexhde*), ekzistojnë dy mendime në këtë çështje. Megjithatë, qëndrimi mbizotërues mes dijetarëve është se në këtë rast nuk ka nevojë për sexhden e harresës.

PËR KË ËSHTË SUNET SEXHDEJA E LEXIMIT

Sexhdeja e leximit (kur lexohet një ajet ku kërkohet sexhde) është sunet për çdo person që e reciton atë, me kusht që të jetë në gjendje të pastërtisë rituale, qoftë përmes abdesit apo tejemumit, kur ky i fundit është i lejuar. Kjo vlen si për rastet kur recitimi bëhet gjatë namazit, ashtu edhe jashtë tij.

Gjithashtu, është sunet edhe për dëgjuesin që i kushton vëmendje recitimit, po edhe për atë që e dëgjon pa qëllim. Megjithatë, Imam Shafiu, *Zoti qoftë i kënaqur me të*, bën dallim mes atij që e dëgjon me përqëndrim dhe atij që e dëgjon rastësisht, duke theksuar se nuk janë në të njëjtin nivel. Ky mendim konsiderohet i saktë te dijetarët e medhhebit shafii.

Ndërkohë, Imam El Haremejni, njëri prej dijetarëve të shquar të medhhebit shafii, ka thënë se, ai që e dëgjon ajetin e sexhdes pa qëllim, nuk ka detyrim të bëjë sexhde. Megjithatë, mendimi më i pranuar ndër dijetarët është që sexhdeja është sunet edhe për këtë kategori dëgjuesish.

Nëse dikush reciton një ajet sexhdeje, qoftë brenda apo jashtë namazit, është sunet që, ata që e dëgjojnë, me vëmendje apo pa qëllim, të bëjnë sexhde, pavarësisht nëse vetë recituesi e bën apo jo sexhden. Ky është mendimi më i përhapur dhe i pranuar në mesin e nxënësve të Imam Shafiut, *Zoti qoftë i kënaqur me ta*. Gjithashtu, ky është mendimi edhe i Ebu Hanifes, *Zoti qoftë i kënaqur me të*.

Nga ana tjetër, autori i librit *Bejan*, njëri ndër nxënësit e Imam Shafiut, *Zoti qoftë i kënaqur me të*, shprehet se dëgjuesi rastësor, si një kalimtar që e dëgjon recitimin e një ajeti të sexhdes gjatë namazit, nuk detyrohet të bëjë sexhde. Gjithashtu, Sajdalani, një tjetër nxënës i Shafiut, thotë se nuk është sunet që dëgjuesi të bëjë sexhde, përveç nëse edhe vetë recituesi e kryen sexhden.

1 Do të thotë: personi që nuk e bëri sexhden me imamin (sepse nuk e konsideron të detyrueshme), dhe qëndroi në këmbë, duke pritur që imami ta përfundonte sexhden. (Sqarim i përkthyesit.)

Megjithatë, mendimi më i saktë dhe më i pranuar në shkollën tonë juridike është mendimi i parë: sexhdeja është sunet për dëgjuesin, pavarësisht nëse recituesi e bën apo jo.

Sa u përket cilësive të recituesit, nuk ka asnjë dallim nëse ai është mysliman apo jomusliman, i moshës madhore apo i mitur, në gjendje të pastërtisë rituale apo jo (pra, edhe pa abdes), mashkull apo femër. Ky është mendimi i saktë dhe i njohur në shkollën tonë, dhe ky qëndrim është ndarë gjithashtu edhe prej Ebu Hanifes, *Zoti qoftë i kënaqur me të*.

Disa prej dijetarëve tanë kanë shprehur mendimin se nuk duhet bërë sexhde kur ajeti i sexhdes recitohet prej një jomuslimani, një fëmije, një person që është pa abdes apo një njeriu në gjendje dehjeje.

Gjithashtu, një grup prej dijetarëve të hershëm janë të mendimit se nuk është e rekomanduar të bëhet sexhde kur recituesi është grua. Këtë qëndrim e kanë transmetuar Katade, Imam Maliku dhe Is'haku, prej Imam Ibën Mundhirit.

Megjithatë, mendimi më i saktë dhe më i qëlluar, sipas medhhebit tonë, është ai që kemi përmendur më herët: sexhdeja është sunet, pavarësisht nga gjendja apo karakteristikat e recituesit, qofshin ato fetare, fizike apo gjinore.

SEXHDEJA NË MËNYRË TË PËRGJITHSHME

Ka raste kur dikush reciton një ose dy ajete të Kuranit, dhe më pas bie në sexhde, një veprim që njihet si sexhdeja e leximit në mënyrë të përgjithshme. Në lidhje me këtë praktikë, Imam Ibën Mundhiri transmeton se dijetarë si Shabiu, Hasan El Basriu, Muhamed bin Sirini, Nehaiu, Imam Ahmedi dhe Is'haku nuk e kanë pëlqyer një veprim të tillë.

Në anën tjetër, Ebu Hanife, Muhamed bin Hasani dhe Ebu Thevriu përcjellin se ata nuk shohin asgjë të keqe në këtë veprim. Ky qëndrim përputhet me mendimin e medhhebit tonë, i cili e konsideron të lejuar dhe të vlefshme një sexhde të tillë edhe kur ajo bazohet në recitim të një apo dy ajeteve.

RREGULLA QË KANË TË BËJNË ME SEXHDEN E LEXIMIT GJATË NAMAZIT

1. Gjatë namazit individual: Personi që falet vetëm (pra, nuk është pjesë e një xhemati), nëse gjatë namazit reciton një ajet ku kërkohet sexhde, është i detyruar ta bëjë sexhden e leximit. Nëse ai e lë sexhden dhe përkulet drejt rukusë, mirëpo pastaj dëshiron të kthehet për të bërë sexhden e leximit, kjo nuk lejohet. Nëse e bën këtë me vetëdije se është e ndaluar, namazi i tij bëhet i pavlefshëm. Nëse, megjithatë, personi ka nisur të përkulet për në ruku, por ende nuk e ka arritur pozicionin përfundimtar të rukusë, i lejohet ta bëjë sexhden e leximit.

Gjithashtu, nëse personi ka nisur të shkojë në sexhden e leximit, mirëpo në mes të lëvizjes ndryshon mendje dhe kthehet në qëndrimin në këmbë (kijam), edhe kjo lejohet.

Nuk është e lejuar që një person që falet vetë të bëjë sexhde për shkak të recitimit të dikuajt tjetër, pavarësisht nëse ai recitim ndodh brenda një namazi apo jashtë tij. Nëse ai bën sexhde me vetëdije se kjo nuk lejohet, atëherë namazi i tij prishet dhe bëhet i pavlefshëm.

2. Gjatë namazit me xhemat: Nëse dikush është imam, rregullat që zbatohen për të janë të njëjta si për atë që falet individualisht. Nëse imami bie në sexhde për shkak të recitimit të një ajeti të sexhdes, atëherë është obligim që muktediu (ai që falet pas imamit) ta ndjekë dhe ta bëjë sexhden bashkë me të. Nëse muktediu nuk e bën sexhden ndërkohë që imami e bën, namazi i tij bëhet i pavlefshëm.

Në rast se imami nuk e bën sexhden e leximit, atëherë muktediut nuk i lejohet të bëjë sexhde. Nëse ai e bën sexhden pa e ndjekur imamin, namazi i tij gjithashtu bëhet i pavlefshëm. Megjithatë, nëse imami nuk ka bërë sexhde gjatë namazit, është e dëshirueshme (mustehab) që muktediu ta bëjë sexhden pas përfundimit të namazit, mirëpo kjo nuk është detyrim.

Nëse imami bie në sexhde dhe muktediu nuk e kupton këtë derisa imami ta çojë kokën nga sexhdeja, atëherë muktediu nuk lejohet të bëjë sexhde, pasi ndarja momentale e tij nga imami është e arsyetuar, dhe nuk e prish namazin. Mirëpo, nëse muktediu e kupton gjatë kohës që imami është ende në sexhde, atëherë ai është i detyruar ta ndjekë dhe të bëjë sexhde me të.

Nëse muktediu ka nisur të përkulet për të bërë sexhde, dhe imami ngrihet para se ai ta arrijë sexhden, atëherë muktediu duhet të ngrihet menjëherë me imamin, dhe nuk i lejohet ta vazhdojë sexhden. E njëjta gjë vlen edhe për një muktedi fizikisht të dobët, i cili përpiqet të bëjë sexhde me imamin, mirëpo që, për shkak të lëvizjes së shpejtë të imamit dhe ngadalësisë së tij, nuk arrin në sexhde përpara se imami të ngrihet. Në këtë rast ai duhet të ngrihet me imamin dhe mos ta bëjë sexhden.

Një muktediu nuk i lejohet të bëjë sexhde të leximit për ndonjë recitim që ai bën vetë në heshtje, apo për ndonjë recitim tjetër që nuk është i imamit. Nëse ai bie në sexhde në këto rrethana, namazi i tij prishet dhe bëhet i pavlefshëm.

Për më tepër, është *mekruh* (e papëlqyer) që muktediu të lexojë pjesë nga Kurani që përmbajnë ajete të sexhdes gjatë namazit me xhemat, si dhe është mekruh të dëgjojë recitime të tjera përveç recitimit të imamit.

KOHA E SEXHDES SË LEXIMIT

Lidhur me kohën se kur duhet bërë sexhdeja e leximit, dijetarët kanë theksuar se ajo duhet kryer menjëherë pas recitimit ose dëgjimit të ajetit që kërkon sexhde. Lejohet të shtyhet për pak kohë, për sa kohë vonesa nuk është e gjatë. Mirëpo, nëse ndërprerja zgjat shumë, atëherë koha e sexhdes kalon, dhe ajo nuk kompensohet më (nuk bëhet kaza), ashtu siç nuk kompensohet namazi i eklipsit të diellit. Ky është mendimi më i saktë dhe më i njohur ndër dijetarët e medhhebit.

Disa prej dijetarëve tanë kanë thënë se sexhdeja mund të bëhet edhe më vonë, ashtu siç falen sunetet pas namazeve farze, për shembull, suneti i sabahut apo i drekës. Mirëpo, ky mendim është konsideruar i dobët dhe nuk është i mbështetur gjerësisht.

Në rast se personi që lexon apo dëgjon ajetin e sexhdes nuk ka abdes, ai duhet të nxitojë për të marrë abdes, e më pas ta bëjë sexhden. Mirëpo, nëse ai e vonon marrjen e abdesit aq sa ndarja kohore konsiderohet e gjatë, atëherë nuk e bën më sexhden. Ky është mendimi më i shëndoshë dhe më i pranuar te shumica e dijetarëve të medhhebit.

Megjithatë, sipas një mendimi tjetër, i cili përkrahet prej Begaviut, personi duhet ta bëjë sexhden edhe në këtë rast, edhe nëse vonesa

është e gjatë. Ky mendim e sheh sexhden si të krahasueshme me përgjigjen ndaj ezanit, edhe kur njeriu e bën këtë pas përfundimit të namazit që ka qenë duke u falur gjatë ezanit.

Sipas mendimit më të saktë dhe të preferuar, për ta përcaktuar nëse një vonesë është “e gjatë” apo “e shkurtër”, merret parasysh zakoni dhe perceptimi i zakonshëm i njerëzve (urfi).

Dhe, Allahu e di më së miri.

PËRSËRITJA E AJETIT TË SEXHDES

Nëse dikush lexon disa ose të gjitha ajetet e sexhdes në të njëjtin kuvend (mexhlis), ai duhet të bëjë sexhde veçmas për secilin ajet. Lidhur me këtë çështje nuk ka mospajtim (ihtilaf) mes dijetarëve.

Gjithashtu, nëse një ajet sexhdeje përsëritet në kuvende të ndryshme, sipas mendimit unanim, për çdo herë që ai lexohet, për çdo herë edhe bëhet sexhde. Megjithatë, nëse i njëjti ajet përsëritet në të njëjtin kuvend, atëherë çështja kërkon detajim:

1. **Nëse nuk e ka bërë sexhden në leximin e parë:** Atëherë i mjafton një sexhde e vetme për të gjitha përsëritjet e mëvonshme në të njëjtin mexhlis.
2. **Nëse e ka bërë sexhden pas herës së parë:** Atëherë ka tri mendime të ndryshme në mesin e dijetarëve:

a. Duhet të bëhet sexhde për çdo përsëritje. Ky mendim bazohet në faktin se shkakua ripërtërihet pas përmbushjes së sexhdes së parë. Ky është mendimi më i shëndoshë.

b. Mjafton sexhdeja e parë për të gjitha përsëritjet. Ky është mendimi i Ibën Surejxhit dhe i Ebu Hanifes, *Zoti i mëshiroftë*. Gjithashtu, autori i *Uddes* e konsideron këtë mendim si bazë për fetvanë. Edhe Shejh Nasër El Makdisiu, prej asketëve dhe dijetarëve tanë, e ka preferuar këtë qëndrim.

c. Bëhet sexhde për çdo përsëritje vetëm nëse ndërprerja është e gjatë. Sipas këtij mendimi, nëse përsëritja ndodh pas një ndërprerjeje të gjatë, atëherë sexhdeja duhet përsëritur. Mirëpo, nëse përsëritja ndodh pa ndërprerje të ndjeshme, mjafton sexhdeja e parë.

Nëse ajeti përsëritet brenda të njëjtit rekat, kjo është e njëjtë si përsëritja brenda të njëjtit kuvend, prandaj zbatohen tri mendimet e përmendura më sipër. Nëse përsëritja ndodh në dy rekate të ndryshme, atëherë kjo është e njëjtë me përsëritjen në dy mexhlise të ndryshme, dhe në këtë rast bëhet sexhde për secilën përsëritje, sipas mendimit unanimit të dijetarëve.

SEXHDEJA E LEXIMIT GJATË KALËRIMIT

Nëse një person reciton një ajet të sexhdes ndërkohë që është i hipur mbi një kafshë (si kalë, deve etj.) gjatë udhëtimit, ai bën sexhde me anë të gjesteve (duke u përkulur në drejtim të sexhdes, sipas mundësisë). Ky është mendimi i mbështetur te shumica e dijetarëve klasikë, përfshirë: Imam Shafiun, Imam Malikun, Ebu Hanifen, Ebu Jusufin, Muhamedin, Ahmedin, Zuferin, Davudin dhe të tjerë.

Megjithatë, disa nxënës të Ebu Hanifes kanë thënë se në këtë rast nuk duhet të bëhet sexhde. Mirëpo, mendimi i shumicës së dijetarëve është më i saktë dhe më i pranuar.

Sa i përket personit që është i hipur mbi kafshë, mirëpo që nuk është në udhëtim, atij nuk i lejohet ta bëjë sexhden e leximit me anë të gjesteve. Në këtë rast, ai duhet të zbresë dhe ta kryejë sexhden në mënyrën e zakonshme.

RECITIMI I AJETIT TË SEXHDES PARA FATIHASË

Nëse një person gjatë namazit lexon një ajet të sexhdes para se ta lexojë Fatihanë, ai duhet të bëjë sexhde menjëherë pas recitimit të ajetit.

Nëse, nga ana tjetër, ajeti i sexhdes lexohet gjatë rukusë apo sexhdes, nuk kërkohet të bëhet sexhde, pasi leximi i Kuranit në namaz është i vlefshëm vetëm në këmbë (kijam), dhe rukuja apo sexhdeja nuk konsiderohen vende të përshtatshme për këtë qëllim.

Në rast se pas leximit të ajetit të sexhdes personi dyshon nëse e ka lexuar apo jo suren El Fatiha, ai fillimisht e bën sexhden e leximit, e pastaj ngrihet në këmbë dhe e lexon Fatihanë. Arsyeja është se sexhdeja e leximit nuk duhet të vonohet, dhe duhet përmbyllur menjëherë sapo të lindë shkaku (leximi i ajetit).

LEXIMI I AJETIT TË SEXHDES NË PERSISHT (OSE NË GJUHË TJETËR)

Nëse dikush reciton një ajet të sexhdes në gjuhën persishte (ose në çfarëdo gjuhe tjetër përveç arabishtes), sipas mendimit tonë (shafii), nuk është e detyrueshme të bëhet sexhde. E njëjta gjë vlen edhe nëse personi e përkthen ose e interpreton kuptimin e ajetit në ndonjë gjuhë tjetër.

Ndryshe nga ky qëndrim, Imam Ebu Hanife është i mendimit se duhet bërë sexhde edhe në rastin kur ajeti recitohet apo interpretohet në çfarëdo gjuhe tjetër përveç arabishtes.

SEXHDEJA E DËGJUESIT NUK LIDHET ME SEXHDEN E RECITUESIT

Kur një dëgjues bën sexhde së bashku me recituesin e ajetit të sexhdes, nuk ka nevojë të bëjë nijet që të udhëhiqet prej tij (si në rastin e imamit dhe të muktediut në namaz).

Për pasojë, dëgjuesi nuk është i detyruar të qëndrojë në sexhde derisa të ngrihet recituesi; ai mund të ngrihet para tij, pasi sexhdeja e leximit në këtë rast është një veprim i pavarur.

VENDIMI PËR RECITIMIN E AJETIT TË SEXHDES NGA ANA E IMAMIT

Sipas mendimit tonë (medhhebit shafii), nuk konsiderohet mekruh që imami të recitojë një ajet që përmban sexhde, si në namazin që falet me zë, ashtu edhe në atë që falet në heshtje. Po ashtu, lejohet që ai të bëjë sexhde kur e reciton këtë ajet gjatë namazit.

Ndërkohë, Imam Maliku është i mendimit se recitimi i ajetit të sexhdes nga ana e imamit është mekruh në çdo rast, pa dallim nëse namazi është me zë apo i heshtur.

Sipas Imam Ebu Hanifes dhe Imam Ahmedit, recitimi i ajetit të sexhdes nga ana e imamit është mekruh vetëm në namazet e heshtura, mirëpo jo edhe në ato që falen me zë.

SEXHDEJA GJATË KOHËVE KUR NAMAZI ËSHTË I NDALUAR

Sipas mendimit tonë, nuk është mekruh të bëhet sexhdeja e tilavetit (sexhdeja e leximit) gjatë periudhave kur namazi është i ndaluar, sikurse, për shembull, gjatë momentit të lindjes ose gjatë perëndimit të diellit.

Ky qëndrim mbështetet prej shumë dijetarëve të njohur si: Shabiu, Hasan El Basriu, Salim bin Abdullah, Kasimi, Atai, Ikreme, Ebu Hanife, njerëzit e arsyes (ehli er reji) dhe gjithashtu Imam Maliku, sipas njërës prej dy rivajeteve të transmetuara prej tij.

Nga ana tjetër, një grup tjetër dijetarësh e konsiderojnë këtë veprim mekruh, përfshirë: Abdullah bin Omerin, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, Seid bin Musejibin, Imam Malikun, sipas rivajetit të dytë, Is'hak bin Rahevejhin dhe Ebu Thevrin.

RUKUJA NË VEND TË SEXHDES SË TILAVETIT

Në rregullat e përgjithshme, rukuja nuk zëvendëson sexhden e leximit (sexhde-i tilavet). Ky është mendimi ynë dhe i shumicës së dijetarëve, si të hershëm ashtu edhe të mëvonshëm (selefë dhe halefë).

Nga ana tjetër, Imam Ebu Hanife, *Zoti e mëshiroftë*, mban qëndrimin se rukuja mund të zërë vendin e sexhdes së leximit.

Argumenti kryesor i shumicës është analogjia me sexhden e namazit, mirëpo përkulja (rukuja) dhe sexhdeja janë dy pozicione të veçanta. Prandaj, kushdo që nuk mund ta kryejë sexhden e leximit në mënyrën e zakonshme, e kryen atë me anë të gjesteve, ashtu siç ndodh me sexhden e namazit kur kryhet me gjeste, për shkak të pamundësisë.

PËRSHKRIMI I SEXHDES SË LEXIMIT

Dije se personi që bën sexhde për shkak të leximit të një ajeti të sexhdes (sexhde-i tilavet), ka dy gjendje të mundshme:

1. Jashtë namazit,
2. Brenda namazit.

Nëse dikush është jashtë namazit dhe dëshiron të bëjë sexhden e *tilavetit*, ai vepron si më poshtë:

- Bën nijetin për sexhden e *tilavetit*.
- Ngre duart paralelisht me shpatullat (ashtu si në tekbirin fillestar të namazit).
- Thotë tekbirin: *Allahu Ekber*. Ky është tekbiri me të cilin hyn në aktin e sexhdes.
- Pastaj, pa i ngritur më duart, thotë një tekbir të dytë, dhe bie në sexhde.

Ky tekbiri i dytë është i rekomanduar (mustehab), dhe nuk është kusht për vlefshmërinë e sexhdes, njësoj si tekbiri kur shkohet në sexhde gjatë namazit.

MENDIMET E DIJETARËVE SHAFIITË MBI TEKBIRIN FILLESTAR

Shkolla jonë ka tri mendime lidhur me natyrën e tekbirit të parë (fillestar) në sexhden e *tilavetit*:

1. **Mendimi i parë** dhe më i njohuri: Tekbiri fillestar është rukn (pjesë përbërëse) e sexhdes. Nëse lihet pa u thënë, sexhdeja nuk është e vlefshme. Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve shafiitë dhe më i mbështeturi në literaturën standarde.
2. **Mendimi i dytë** sipas Shejh Ebu Muhamed El Xhujejniut: Tekbiri është i rekomanduar (mustehab). Nëse lihet, sexhdeja mbetet e vlefshme, megjithëse është më e plotë me të.
3. **Mendimi i tretë** më pak i përhapur: Tekbiri nuk është as rukn, as mustehab, nuk ka ndonjë vlerë të veçantë. Ky është mendimi më pak i përkrahur dhe jo i zakonshëm në tekstet standarde të medhhebit. Allahu e di më së miri.

TEKBIRI DHE POZICIONI TRUPOR NË SEXHDEN E LEXIMIT

Nëse personi që ka për qëllim të bëjë sexhden e *tilavetit* është në këmbë, ai duhet të:

- Thotë tekbirin (*Allahu Ekber*) duke qëndruar në këmbë, dhe;
- Pastaj, derisa shkon në sexhde, të thotë një tekbir të dytë (i cili është i rekomanduar, jo i detyrueshëm).
- Nëse personi është i ulur, një grup prej dijetarëve tanë kanë thënë se:

- E dëshirueshme është që ai të ngrihet në këmbë dhe ta thotë tekbinin në pozicionin në këmbë,
- E, më pas të shkojë në sexhde, njësoj sikurse ai që ishte në këmbë që në fillim.

Ky qëndrim bazohet në analogjinë me namazin, kur tekbiro fillestar (tekbiretul ihram) bëhet në këmbë, dhe pastaj ndiqet me sexhde ose ruku. Kjo tregon rëndësinë e qëndrimit në këmbë gjatë hyrjes në një akt adhurimi si sexhdeja.

Prej autoriteteve tona të medhhebit që mbajnë mendimin se është e dëshirueshme të ngrihesh në këmbë për të dhënë tekbinin e ihramit në sexhden e leximit janë: Shejh Ebu Muhamed El Xhujeni, Kadi Husejni dhe dy shokët e tij, autorët e veprave *Tetimme* dhe *Tehdhib*, si dhe imami verifikues Ebu El Kasim Er Rafii.

Ndërkaq, Imam El Haramejni (El Xhujeni), e transmeton këtë mendim prej babait të tij, Shejh Ebu Muhamedi, mirëpo më vonë e refuzon qartë këtë qëndrim, duke thënë: “Unë nuk shoh ndonjë burim apo referencë të qartë për këtë.”

Ky refuzim është i qartë dhe i argumentuar, pasi nuk ka ndonjë transmetim të saktë të Pejgamberit, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, as të sahabëve apo të tabiinëve që e mbështet një praktikë të tillë. Për më tepër, shumica e dijetarëve tanë nuk e kanë trajtuar fare këtë çështje, gjë që tregon se ajo nuk ka qenë objekt i thelluar shqyrtimi në traditën e hershme.

Allahu e di më së miri.

FORMA DHE ETIKA E SEXHDES SË LEXIMIT

Kur personi bie në sexhde për ajetin e tilavetit, duhet t’i respektojë adabet (rregullat etike) që kanë të bëjnë me formën e sexhdes dhe lutjet (tesbihët) që bëhen gjatë saj.

Forma e sexhdes është si më poshtë:

- Duart vendosen në tokë, në mënyrë paralele me shpatullat.
- Gishtat qëndrojnë të bashkuar, dhe drejtohen kah kibla.
- Duart nxirren jashtë nga mëngët e rrobës, dhe vendosen drejtpërdrejt mbi vendin e sexhdes.

- Bërrylat mbahen të shtrirë anash, larg trupit, dhe barku ngrihet nga kofshët, nëse personi është mashkull.
- Në rastin e një gruaje apo të një personi hermafrodit, nuk i shtrin bërrylat, dhe qëndrimi i saj është më i përmbledhur dhe më modest.
- Pjesa e pasme e trupit mbahet më lart se koka, në përputhje me mënyrën e sexhdes së namazit.
- Balli dhe hunda vendosen fort në tokë, mbi vendin e sexhdes.
- Në këtë pozicion personi qëndron i qetë dhe i përulur, duke e jetësuar kuptimin dhe madhësinë e aktit të sexhdes.

TESBIHËT DHE LUTJET NË SEXHDEN E KËNDIMIT (TILAVETIT)

Sa u përket tesbihëve dhe lutjeve që thuhën në sexhden e tilavetit, dijetarët tanë kanë thënë se ato janë të njëjta me ato që thuhën në sexhden e zakonshme të namazit.

DHIKRI BAZË:

- Personi thotë tri herë ***Subhane Rabbijel Eala*** (I Pastër nga çdo e metë është Zoti im i Lartë).

Lutje të tjera të rekomanduara janë: ***Allahumme leke sexhedtu, ve bike amentu, ve leke eslemtu, sexhede vexhhije lil-ledhi halekahu ve savverahu, ve shekka sem'ahu ve besarehu bi-havlihi ve kuvvetihi. TebarekAllahu ahsenul halikin.***

(O Zot, për Ty bëj sexhde, në Ty besoj dhe Ty të dorëzohem! Fytyra ime i bëri sexhde Atij që e krijoi dhe e formësoi, që i hapi dëgjimin dhe shikimin me Fuqinë dhe Fuqiplotësinë e Tij. Qoftë i Lartë Allahu, Krijuesi më i përsosur).

Ose: ***Subbuhun, Kuddusun, Rabbul melaiketi ver-ruh.*** (I Dëlirë nga çdo e metë, i Shenjtë, Zoti i melekëve dhe i Xhibrilit).

Këto lutje janë të rekomanduara të thuhën gjatë sexhdes edhe brenda namazit, nëse sexhdeja ndodh në namaz për shkak të leximit të një ajeti që përmban sexhde.

Dijetarët tanë kanë thënë se, përveç tesbihëve të zakonshëm që thuhën në sexhdet e namazit, rekomandohet të thuhet edhe kjo lutje specifike për sexhden e leximit: ***Allahummektub li biha indeke exh-ran, vexh'alha li indeke dhukhran, ve da'anni biha vizran, ve teka-belha minni kema kabilteha min abdike Davude (alejhi selam).***

(O Zot, ma shkruaj me këtë sexhde një shpërblim te Ti, mbaje atë si një thesar për mua pranë Teje, ma fshij një gjynah me të dhe pranoje prej meje, ashtu siç e pranove prej robit Tënd, Davudit *alejhi selam*!)

Kjo lutje është e veçantë për sexhden e tilavetit, prandaj është e udhës që njeriu ta mbajë mend dhe ta shqiptojë me përkushtim kur bie në sexhde, për shkak të leximit të një ajeti që përmban sexhde.

Studiuesi i dalluar, Ismail Ed Darir, në veprën e tij *Et Tefsir*, përmend se lutja e parapëlqyer e Imam Shafiut në sexhden e tilavetit ishte: ***Subhane Rabbina in kane vadu Rabbina lemefula.*** (El Isra, 108) - (I Lavdëruar qoftë Zoti ynë! Me të vërtetë premtimi i Zotit tonë është i realizueshëm).

Edhe pse atribuimi i lutjes së përmendur ndaj Imam Shafiut, *Allahu e mëshiroftë*, mund të duket disi i pazakontë, ai është gjithsesi i pranueshëm, pasi teksti i jashtëm i ajetit të Kuranit e mbështet këtë: ai që e reciton këtë ajet gjatë sexhdes, meriton vetëm lavdërim dhe madhërim të Allahut. Kjo e bën të arsyeshëm dhe të vlefshëm përdorimin e tij në këtë kontekst.

Prandaj, në sexhden e tilavetit rekomandohet që të kombinohen të gjitha lutjet e transmetuara, duke u lutur me to për të mirat e dynjasë dhe të ahiretit.

Megjithatë, nëse dikush zgjedh të kufizohet vetëm në disa prej tyre, ai sërish e ka përmbushur themelin e sexhdes dhe është brenda kufijve të ligjit islam. Madje, edhe nëse nuk shqipton asnjë lutje fare gjatë sexhdes, sexhdeja mbetet e vlefshme, ashtu siç ndodh me sexhdet e namazit, kur nuk është kusht të thuash ndonjë tesbih apo lutje specifike për vlefshmërinë, edhe pse ato janë shumë të rekomanduara.

Pasi personi ka përfunduar tesbihët dhe lutjet e tij në sexhden e tilavetit, ngrihet në këmbë duke thënë tekbinin (Allahu Ekber).

Pyetja që shtrohet është: A është e nevojshme dhënia e *selamit* pas kësaj sexhdeje, siç ndodh në përfundim të një namazi?

Në lidhje me këtë çështje, në shkollën e Imam Shafiut ekzistojnë dy mendime të njohura:

Mendimi më i saktë dhe më i përhapur, sipas shumicës së pasuesve të medhhebit, është se duhet dhënë selam, pasi sexhdeja e *tilavetit* konsiderohet një akt i veçantë adhurimi që fillon me tekbir të ihramit dhe, si i tillë, ngjan me namazin e xhenazes, i cili gjithashtu përbëhet nga elementë të kufizuar, por përmbillet me selam. Ky qëndrim përforcohet nga ajo që ka transmetuar Ibën Ebi Davudi, me zinxhir të saktë prej Abdullah bin Mesudit, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, se ai, pas recitimit të një ajeti të sexhdes, binte në sexhde dhe më pas jepte selam.

Mendimi i dytë është se dhënia e selamit nuk kërkohet, sepse sexhdeja e *tilavetit* nuk është një namaz i plotë, dhe për këtë arsye nuk i përmban të gjitha rregullat formale të tij. Po ashtu, nuk është transmetuar ndonjë hadith autentik i Pejgamberit, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, që ai të ketë dhënë selam pas sexhdes së *tilavetit*. Sipas këtij qëndrimi, sexhdeja trajtohet njësoj si sexhdeja që bëhet gjatë namazit, e cila nuk kërkon selam më vete.

Sipas mendimit të parë, që e konsideron të rekomanduar dhënien e selamit pas sexhdes së *tilavetit*, shtrohet pyetja: A duhet të lexohet edhe teshehudi (etehijatu) para selamit, ashtu si në namaz?

Në këtë çështje ekzistojnë dy mendime midis dijetarëve të shkollës shafiite:

1. **Mendimi më i saktë dhe më i qëndrueshëm** është se nuk ka nevojë për teshehud, sepse sexhdeja e *tilavetit* nuk e ka statusin e një namazi të plotë, dhe për këtë arsye nuk përfshin as qëndrimin në këmbë (kijamin), as ndonjë lexim specifik si teshehudi. Ky mendim është mbështetur gjerësisht prej shumicës së dijetarëve të medhhebit.
2. **Mendimi tjetër**, më pak i përhapur, është se rekomandohet të lexohet teshehudi para selamit, duke bërë analogji me përfundimin e çdo adhurimi që ka tekbir të ihramit dhe përmbillet me selam. Megjithatë, ky mendim nuk ka bazë të fortë në praktikën pejgamberike, dhe shumica e dijetarëve nuk e mbështesin.

Disa prej juristëve të medhhebit shafii bashkojnë çështjen e teshehudit dhe të selamit pas sexhdes së *tilavetit* jashtë namazit, dhe thonë se në këtë pikë ekzistojnë tri mendime kryesore:

1. **Mendimi më i fortë** dhe i preferuar është se selami është i domosdoshëm, ndërsa teshehudi nuk është i detyrueshëm.
2. Mendimi i dytë thotë se as teshehudi dhe as selami nuk janë të nevojshëm pas sexhdes së leximit.
3. Mendimi i tretë është se të dyja, si teshehudi ashtu edhe selami, janë domosdo obligim.

Në mesin e paraardhësve të drejtë që kanë mbrojtur domosdoshmërinë e dhënies së selamit janë:

- Muhamed bin Sirin,
- Ebu Abdurrahman Es Sulemij,
- Ebu El Ahves,
- Ebu Kilabeh,
- dhe Is'hak bin Rahevejh.

Nga ana tjetër, ata që kanë argumentuar se nuk duhet dhënë selam janë:

- Hasan El Basri;
- Seid bin Xhubejr;
- Ibrahim Nehai;
- Jahja bin Vetthab, dhe;
- Ahmed bin Hanbel.

Të gjitha këto mendime janë lidhur kryesisht me situatën kur sexhdeja bëhet jashtë namazit.

SITUATA E DYTË: SEXHDEJA E LEXIMIT GJATË NAMAZIT

Kur sexhdeja e *tilavetit* bëhet gjatë namazit, nuk merret tekbiri fillestar (tekbiri i ihramit), pasi personi është tashmë në namaz. Megjithatë, rekomandohet që të thuhet tekbir, si gjatë rënies në sexhde, ashtu edhe gjatë ngritjes nga ajo, pa i ngritur duart në asnjërin rast. Ky është mendimi i saktë dhe më i përhapur mes dijetarëve të medhhebit shafii, dhe mbështetet prej shumicës së tyre.

Në anën tjetër, Ebu Ali bin Ebi Hurejra, njëri prej dijetarëve të njohur të kësaj shkolle juridike, është i mendimit se nuk thuhet fare tekbir, as në rënie në sexhde, si dhe as në ngritje nga ajo.

Megjithatë, mendimi i njohur dhe i pranuar në medhheb është ai i shumicës: që tekbiri të shqiptohet në të dy lëvizjet, si formë e adhurimit dhe e pasimit të sunetit pejgamberik.

Rregullat e mirësjelljes dhe forma e sexhdes, si dhe lutjet (tesbihatet) që shqiptohen gjatë saj, janë të njëjta me ato që u përmendën më herët për sexhden e leximit jashtë namazit. Kjo përfshin mënyrën e vendosjes së trupit, drejtimin kah kibla, përlulen dhe fjalët që thuhet në sexhde.

Megjithatë, nëse personi që bie në sexhde është imam, atëherë nuk është e pëlqyeshme që ai ta zgjatë sexhden me lutje të gjata, përveç nëse e di me siguri se xhemati që e ndjek e dëshiron këtë. Ky rregull vjen si shprehje e kujdesit dhe dhembshurisë ndaj xhematit, në përputhje me udhëzimet e Pejgamberit, *paqja qoftë mbi të*, i cili i këshillonte imamët që mos ta vështirësonin adhurimin për njerëzit.

Pasi të ngrihet nga sexhdeja e leximit (*tilavetit*), personi duhet të ngrihet në këmbë, pa u ndalur për një pushim të shkurtër në pozicionin ulur, sipas konsensusit të dijetarëve. Ky veprim nuk është si ndalesa që bëhet ndërmjet dy sexhdeve apo pas sexhdes së dytë në rekatin e parë dhe të tretë të namazit.

Kjo çështje është përmendur rrallë në literaturën e fikhut, mirëpo disa prej dijetarëve që e kanë trajtuar janë Kadi Husejni, Bagaviu dhe Rafiiu, *Zoti qoftë i kënaqur me ta*.

Ky rregull ndryshon nga sexhdeja brenda namazit, ku, sipas mendimit të fortë dhe të preferuar të Imam Shafiut, i mbështetur në hadithe të qarta e të transmetuara në Sahihun e Buhariut, po edhe në tekste të tjera, rekomandohet një ndalesë e shkurtër ulur pas sexhdes së dytë në rekatin e parë të të gjitha namazeve dhe pas rekatit të tretë në namazet me katër rekate.

Në rastin e sexhdes së leximit, pasi personi të ngrihet në këmbë, duhet të qëndrojë drejt. Rekomandohet që të lexojë një pjesë nga Kurani, dhe më pas të përkulet në ruku, si zakonisht. Mirëpo, nëse ngrihet drejt dhe bie menjëherë në ruku, pa lexuar diçka më parë, edhe kjo është e lejuar dhe e vlefshme.

KOHËT MË TË ZGJEDHURA PËR LEXIMIN E KURANIT

LEXIMI GJATË NAMAZIT

Leximi i Kuranit brenda namazit është forma më e lavdëruar e leximit. Sipas Imam Shafiut dhe shumë të tjerëve, zgjatja e qëndrimit në këmbë (kijam) për lexim është më e vlefshme se zgjatja e sexhdes në namaz.

LEXIMI JASHTË NAMAZIT

- **Gjatë natës:** Leximi i Kuranit natën është më i dashur tek Allahu. Më i vlefshmi është në gjysmën e dytë e natës, edhe pse e para është gjithashtu e lavdëruar.
- **Ndërmjet akshamit dhe jacisë:** Një tjetër kohë me vlerë për lexim.
- **Pas sabahut:** Është koha më e mirë për lexim gjatë ditës.
- **Nuk ka kohë të ndaluara për lexim**

Nuk ekziston ndonjë kohë e papëlqyeshme (*mekruh*) për leximin e Kuranit për shkak të vetë kohës. Ajo që është përmendur nga ana e disave (siç transmeton Ibën Ebi Davudi), se pas ikindisë nuk duhet lexuar, sepse thuhet se është koha e studimit të çifutëve, nuk ka bazë të saktë në fe, dhe është e refuzuar.

DITËT MË TË MIRA PËR LEXIM

Ditët e zgjedhura për lexim, janë:

- Dita e Xhuma
- E hëna dhe e enjtja
- Dita e Arafatit
- Dhjetë netët e fundit të Ramazanit
- Dhjetë ditët e para të Dhul Hixhes

MUAJI MË I LAVDËRUAR PËR LEXIM

Muaji Ramazan është muaji më i bekuar dhe më i preferuar për

leximin e Kuranit. Në këtë muaj edhe vetë Xhibrili *alejhi selam* ia dëgjonte Kuranin Pejgamberit *alejhi selam* çdo natë.

HUTIMI GJATË RECITIMIT TË KURANIT

Nëse recituesi hutohet dhe nuk e di se cili ajet i rradhës pason, dhe e pyet dikë tjetër, ai duhet t'i ndjekë rregullat e mirësjelljes, siç kanë treguar Abdullah bin Mesudi, Ibrahim Nehaiu dhe Beshir bin Ebi Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*. Ata kanë thënë: “Nëse dikush hutohet gjatë leximit, dhe e pyet vëllanë e tij për një ajet, le ta lexojë ajetin e mëparshëm dhe le të heshtë. Ai nuk duhet të bëjë pyetje të panevojshme, sepse do të ngatërrojë edhe më shumë.”

FORMA E REFERIMEVE ME AJETE KURANORE

Nëse dikush dëshiron të citojë një ajet si provë (argument), mund të thotë: “Allahu i Lartë ka thënë kështu”, ose “Allahu i Lartë thotë kështu”. Pra, nuk ka asnjë të keqe në këtë, dhe ky është mendimi i saktë, e i cili edhe është në përputhje me praktikën e të gjithë dijetarëve të gjeneratave të hershme dhe të mëvonshme (selef dhe halef).

Ibën Ebi Davudi tregon se Mutarrif bin Abdullah bin Shihir, tabiini i njohur, ka thënë: “Mos thoni se Zoti i Lartë *thotë!*” Në vend të kësaj thoni: “Zoti i Lartë ka *thënë.*”

Megjithatë, fakti që Mutarrifi, *Allahu e mëshiroftë*, nuk e pranon këtë formë, bie ndesh me atë që gjendet në vetë Kuranin dhe Sunetin, si edhe me veprimet e sahabëve dhe të pasardhësve të tyre, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*. Kjo për arsye se vetë Allahu i Lartë ka thënë: “***Allahu thotë të vërtetën...***”. (El Ahzab, ajeti 4)

Në Sahihun e Muslimit, Ebu Dherri, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, transmeton se i Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, ka thënë: “***Allahu i Madhërishëm thotë: “Kush bën një vepër të mirë, do të shpërblehte dhjetëfish.”***” (El Enam, 160)

Në Sahihun e Buhariut, në komentimin e ajetit: “***Nuk do ta arrini devotshmërinë (mirësinë e plotë), derisa të jepni nga ato që i doni.***” (Ali Imran, 3:92).

Ebu Talha (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë: “O i Dërguari i Allahut! Allahu i Lartë thotë: “***Nuk do ta arrini devotshmërinë, derisa të jepni nga ato që i doni.***”

Këto janë fjalët e Ebu Talhasë, në praninë e Pejgamberit, *paqja qoftë mbi të*.

Mesruku, *Allahu e mëshiroftë*, sipas një zinxhiri të saktë transmetimi, ka thënë: “I thashë zonjës Aishe, *Allahu qoftë i kënaqur me të*: A nuk ka thënë Allahu i Lartë: **“Ai (Muhamedi) e ka parë atë (Xhibrilin) në horizontin e qartë.”** (Et Tekvir, 23)?”

Ajo tha: “A nuk e ke dëgjuar që Allahu i Lartë thotë: **“Shikimet njerëzore nuk mund ta arrijnë Atë, ndërkohë që Ai i arrin shikimet e të gjithëve.”** (El Enam, 103)?! Dhe, a nuk e ke dëgjuar që Allahu i Lartë thotë: **“Asnjë njeriu nuk i është dhënë t’i flasë Allahu, përveçse me anë të Frymëzimit ose pas perdes.”** (Esh Shura, 51)?”

Pastaj ajo tha në këtë hadith: “Dhe Allahu i Lartë thotë: **“O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur prej Zotit tënd!”** (El Maide, 67).”

Mandej ajo tha: “Dhe Allahu i Lartë thotë: **“Thuaj: Askush përveç Allahut, në qiej apo në Tokë, nuk i di të fshehtat”** (En Neml, 65).”

Shembuj të këtillë nga gjeneratat e para dhe të mëvonshme janë të panumërt.

Dhe, Allahu e di më së miri.

RRETH ETIKËS DHE RREGULLAVE QË LIDHEN ME PËRFUNDIMIN E LEXIMIT TË KURANIT

Lidhur me përfundimin e leximit të Kuranit (hatmes), ekzistojnë disa çështje të rëndësishme që janë diskutuar prej dijetarëve. Këto përfshijnë rregulla dhe sjellje të veçanta që lidhen me kohën, mënyrën dhe atmosferën në të cilën përmbillet hatmeja.

KOHA E PËRFUNDIMIT TË HATMES

Ndër aspektet e mirësjelljes dhe të respektit ndaj Kuranit është edhe zgjedhja e kohës së përfundimit të leximit të tij. Siç është përmendur më parë, është e preferueshme që, ai që e lexon Kuranin individualisht, po ai ta përmbyllë hatmen gjatë namazit.

Përfundimi i leximit të Kuranit (hatmeja) është e pëlqyeshme që të ndodhë gjatë namazit, veçanërisht në dy rekatet sunet të sabahut ose në dy rekatet sunet të akshamit. Megjithatë, përfundimi në rekatet

sunet të sabahut konsiderohet më i vlefshëm dhe më i preferuar. Tradita islame gjithashtu e inkurajon që një hatme të përfundohet në fillim të ditës, dhe një tjetër në fund të ditës, duke mbuluar kështu të dy kohët me këtë vepër të begatë.

Nëse hatmeja përmbillet jashtë namazit, qoftë individualisht apo në një grup të mbledhur bashkë, është gjithashtu e rekomanduar që ajo të ndodhë në fillim të ditës ose në fillim të natës. Sipas një numri dijetarësh, përfundimi në mëngjes mbart vlerë më të madhe dhe është më i bekuar.

AGJËRIMI NË DITËN E HATMES

Në ditën kur përfundon leximi i plotë i Kuranit famëlartë (hatmeja), është e rekomanduar të agjërohet, përveç në rastet kur kjo ditë përkon me një datë kur agjërimi është i ndaluar sipas ligjit islam (Sheriatit).

Imam Ibën Ebi Davudi ka transmetuar, me zinxhir të saktë, se disa prej dijetarëve të mëdhenj të tabiinëve të Kufes, si Talha bin Musarraf, Habib bin Ebi Thabit dhe Musejib bin Rafi'u, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*, e fillonin ditën e përfundimit të Kuranit duke qenë agjërueshëm.

PJESËMARRJA NË HATME

Pjesëmarrja në tubimet ku përmbillet leximi i plotë i Kuranit (*hatme*) është fuqimisht e rekomanduar.

- Në hadithet autentike të transmetuara prej Buhariut dhe Muslimit, thuhet se i Dërguari i Allahut, *paqja qoftë mbi të*, i urdhëroi edhe gratë gjatë periudhës së menstruacioneve të merrnin pjesë në faljen e Bajramit, jo për ta falur namazin, por për ta përjetuar mirësinë, lutjet dhe atmosferën e begatë të myslimanëve.
- Darimiu dhe Ibën Ebi Davudi transmetojnë, me zinxhirët e tyre të transmetimit, se Ibën Abbasi, *Allahu qoftë i kënaqur me të dy*, e caktonte dikë që ta vëzhgonte një person që ishte duke e përfunduar leximin e Kuranit. Kur ai afrohej nga përfundimi, vëzhguesi e njoftonte Ibën Abbasin, në mënyrë që ai të merrte pjesë në atë moment të përfundimit.

- Ibën Ebi Davudi transmeton me dy zinxhirë të saktë transmetimi, se Katadeja, tabiini i shquar dhe shoku i Enes bin Malikut, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ka thënë: “Kur Enes bin Maliku e përfundonte leximin e Kuranit, ai i mblidhte familjarët e tij dhe bënte dua (lutje) drejtuar Allahut.”
- Ai gjithashtu transmeton, me zinxhir të saktë transmetimi, se Hakem bin Utejbe, tabiini i shquar, ka thënë: “Muxhahidi dhe Abdetu bin Lubabe më ftuan duke thënë: “Ne të ftuam sepse duam ta përfundojmë Kuranin, dhe lutja kur përfundohet Kurani pranohet.”
- Në disa nga transmetimet e vërtetuara, ai thoshte: “Me të vërtetë mëshira zbret kur përfundohet Kurani.”
- Po ashtu, me zinxhir të saktë transmetimi prej Muxhahidit, është treguar se: “Ata mblidheshin kur e përfundonin Kuranin, duke thënë se Mëshira zbret tani.”

LUTJA PAS PËRFUNDIMIT TË HATMES

Shumë e preferuar është të bëhet lutje menjëherë pas përfundimit të hatmes, për shkak të asaj që përmendëm më parë. Darimiu transmeton, me zinxhirin e tij të transmetuesve, se Humejd El Arexhi ka thënë: “Kushdo që e lexon Kuranin dhe pastaj lutet, katër mijë melekë thonë “Amin!” për lutjen e tij.”

Duhet që njeriu të këmbëngulë në lutjet e tij dhe të kërkojë me përkushtim për çështje të rëndësishme. Ai duhet të lutet shumë për mirëqenien e myslimanëve, për udhëheqësit e tyre dhe për të gjithë ata që kujdesen për punët e tyre.

Hakim Ebu Abdullah Nisaburi ka transmetuar, me zinxhirin e tij të transmetuesve, se kur Abdullah bin Mubaraku, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, e përfundonte leximin e Kuranit, ai bënte lutje të shumta për myslimanët dhe besimtarët, meshkuj e femra. Të tjerë kanë thënë diçka të ngjashme.

AI QË LUTET DUHET TË ZGJEDHË LUTJE GJITHËPËRFSHIRËSE, SIÇ JANË KËTO MË POSHTË

O Allah! Përmirësoji zemrat tona, na i largo mangësitë dhe dobësitë tona, dhuroje për ne më të mirën në të gjitha çështjet, na zbukuro me takvallëk, bashkoje për ne më të mirën e kësaj bote dhe të ahiretit, dhe na mbaj të përkushtuar dhe të bindur ndaj Teje për sa të na jepësh jetë!

O Allah! Na e bëj të lehtë atë që është e lehtë për ne dhe na largo nga ajo që është e vështirë!

Na mbro nga dënimi i Zjarrit të Xhehenemit, nga dënimi i varrit, nga sprovat e jetës dhe të vdekjes, si dhe nga sprovat e Mesihut të Rremë (Dexhallit)!

O Allah! Të kërkojmë udhëzim, mbrojtje, virtyt dhe begati!

O Allah! Ty t'i lëmë në besim fenë dhe trupat tana, përfundimin e veprave tona dhe të jetëve tona, familjet tona, të dashurit tanë dhe të gjithë myslimanët! Ty t'i lëmë në besim gjithashtu të gjitha çështjet e dynjasë dhe të ahiretit, ato që Ti na i ke dhënë neve dhe atyre!

O Allah! Të kërkojmë falje dhe siguri (shëndet e mirëqenie) në fe, në këtë botë dhe në botën tjetër! Na bashko me të dashurit tanë, me mirësinë dhe mëshirën Tëndë, në vendin e nderit dhe bujarisë Sate (në Xhenet)!

O Allah! Udhëzoji dhe përmirësoji ata që i udhëheqin myslimanët, jepu sukses në zbatimin e drejtësisë ndaj atyre që kanë në përgjegjësi, që të jenë bamirës, të dhembshur dhe të sjellshëm me ta, dhe të kujdesshëm për mirëqenien e tyre! Bëji që t'i duan ata që kanë nën kujdesin e tyre, dhe që edhe ata t'i duan udhëheqësit e tyre! Jepu sukses në ndjekjen e rrugës Sate të drejtë dhe në përmbushjen e detyrave të fesë Sate të pastër dhe të vërtetë!

O Allah! Ji i butë me robin Tënd, udhëheqësin tonë, dhe jepi sukses në të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër! Bëje të dashur për ata që ka nën kujdesin e tij, dhe bëji ata të dashur për të!

Lexuesi thotë pjesën tjetër të lutjeve të përmendura, të cilat kanë të bëjnë me ata që janë përgjegjës për çështjet e myslimanëve, dhe shton:

O Allah! Mbroje jetën dhe vendin e udhëheqësit tanë! Ruaji ndjekësit dhe ushtritë e tij! Jepu fitore përballë armiqve të fesë dhe të gjithë atyre që e kundërshtojnë të vërtetën! Jepi sukses në largimin e së keqes dhe në shfaqjen e së mirës dhe të çdo lloj mirësie! Nëpërmjet tij, lartësoje Islamin dhe forcoje atë, si dhe ata që janë nën mbrojtjen dhe kujdesin e Tij!

O Allah! Përmirësoje gjendjen e myslimanëve, lehtësoje barrën e jetesës së tyre dhe dhuroju siguri e paqe në vendet ku jetojnë! Shlyeji borxhet e tyre, shëroji të sëmurët dhe jepu fitore ushtrive që mbrojnë të drejtën dhe drejtësinë! Ktheji të humburit dhe liroji robërit e luftës! Shëroji zemrat e tyre, pastroji nga zemërimi dhe mosmarrëveshjet, dhe bashkoji në dashuri, mirëkuptim dhe vëllazëri! Mbille besimin dhe urtësinë në zemrat e tyre, dhe forcoji në besimin ndaj të Dërguarit Tënd, *paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të!* Frymëzoji që ta mbajnë besëlidhjen që kanë bërë me Ty, dhe jepu fitore ndaj armiqve Tu dhe të tyre, o Zot i së Vërtetës! Na bëj edhe ne prej tyre!

O Allah! Bëji ata prej atyre që urdhërojnë për të mirën dhe të veprojnë sipas saj, që ndalojnë nga e keqja dhe largohen nga ajo, që i respektojnë kufijtë e Tu, të jenë të qëndrueshëm në bindje ndaj Teje, të sillen drejtësisht me njëri-tjetrin dhe ta këshillojnë njëri-tjetrin sinqerisht!

O Allah! Ruaji ata në fjalët dhe veprat e tyre, dhe bekoji në çdo gjendje të tyre!

Ai e nis dhe e përmbyll lutjen e tij me fjalët: “Të gjitha lavdërimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve”, një lavdërim i denjë për madhështinë e mirësive të Tij dhe në përputhje me furnizimin e Tij të pakufishëm.


O Allah! Dërgo salavate dhe paqe mbi Muhamedin dhe mbi familjen e Muhamedit, ashtu siç dërgove mbi Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Dhe bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, ashtu siç i bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit, në të gjitha botët! Ti vërtet je i Lavdëruari, i Lavdishmi.

FILLIMI I NJË LEXIMI TË RI PAS PËRFUNDIMIT TË HATMES


E preferuar është që menjëherë pas përfundimit të hatmes të fillohet me një lexim të ri të krejt Kuranit. Të parët e devotshëm e kanë rekomanduar këtë. Ata e kanë mbështetur këtë qëndrim në një hadith të Enesit, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ku i Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të*, ka thënë: “*Veprat më të mira janë el hal-lu dhe er rihletu.*”

U pyet: “Çfarë janë ato?” Ai tha: “*Fillimi i leximit të Kuranit dhe përfundimi i tij.*”¹

¹ Këtë hadith e përmend Imam Nveviu, në *El Edhkar* (322).



KAPITULLI I SHTATË





ETIKA E TË GJITHË NJERËZVE NË RAPORT ME KURANIN

Në Sahihun e Muslimit është transmetuar se Temim Ed Dari, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ka treguar: “I Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, ka thënë: “*Feja është këshillë (e singertë).*”

Ne e pyetëm: “Për kë?”. Ai u përgjigj: “*Për Allahun, Librin e Tij, të Dërguarin e Tij, udhëheqësit e myslimanëve dhe njerëzit e thjeshtë prej tyre.*”

Dijetarët, *Allahu i mëshiroftë*, kanë thënë: “Sinjeriteti ndaj Librit të Allahut qëndron në besimin e plotë se Kurani është Fjala e Allahut të Lartë dhe Shpallja e Tij; se ai nuk ngjan me asgjë nga fjalët e njerëzve; dhe se njerëzit janë të paaftë të sjellin diçka si ai, edhe sikur të gjithë të bashkoheshin për ta bërë këtë. Pastaj, sinjeriteti ndaj Kuranit qëndron në nderimin e tij dhe leximin ashtu siç i takon; që recitimi të jetë i bukur dhe të dëgjohet me përkushtim; që shkronjat të shqiptohen saktë gjatë leximit; që ai (Kurani) të mbrohet nga shtrembërimet e devijuesve dhe kundërshtimet e tiranëve; të besohet në çdo gjë që përmban ai; mos të tejkalohen kufijt e tij; të kuptohen dijet dhe shembujt që ai përmban etj. Sinjeriteti është gjithashtu t’i kushtohet vëmendje këshillave të tij; të mendohet mbi mrekullitë e tij të mahnitshme; të veprohet sipas ajeteve të qarta (muhkem); të pranohen ajetet jo të qarta (muteshabih); të kuptohen ajetet e përgjithshme dhe ato të specifikuar; të njihen ajetet që shfuqizojnë dhe ato që janë shfuqizuar; të përhapen dijet e tij dhe të ftohen të tjerët drejt tyre dhe këshillave që përmendëm.”

DETYRIMI PËR TA MADHËRUAR KURANIN

Myslimanët janë unanimit të pajtimit se madhërimi i Kuranit famëlartë është një detyrë e domosdoshme, pa asnjë përjashtim. Ata bien dakord se Kurani duhet të mbrohet, të nderohet dhe të shpallet i pastër nga çdo e metë.

Gjithashtu, ekziston konsensus i plotë në mesin e dijetarëve se, kushdo që me vetëdije mohon qoftë edhe një shkronjë të vetme nga Kurani, për të cilën ka pajtim unanimit se është pjesë e tij, ose qëllimisht shton një shkronjë që nuk është transmetuar prej asnjërit prej lexuesve të njohur dhe të pranuar të Kuranit, konsiderohet të ketë dalë nga feja (*kafir*).

Imami dhe dijetari i njohur, Ebu El Fadël El Kadi Ijad (Allahu e mëshiroftë), ka thënë: “Dije se kushdo që me vetëdije e nënvlerëson Kurantin famëlartë, qoftë në përmbajtjen e tij apo në tekstin e shkruar (mus’hafin), apo fyen ndonjë pjesë të tij; mohon qoftë edhe një shkronjë të vetme të tij; nuk beson në diçka që është e qartë në të, siç janë gjykimet apo tregimet hyjnore, ose pohon diçka që Kurani e mohon, apo mohon atë që Kurani e pohon, konsiderohet mohues (*kafir*), sipas konsensusit të dijetarëve myslimanë.

E njëjta gjë vlen edhe për atë që mohon, fyen ose nënvlerëson librat e tjerë të shpallur prej Allahut, siç janë Tevrati, Inxhili apo çdo tjetër prej librave hyjnorë të shpallur para Kuranit. Kushdo që shfaq përçmim ndaj tyre, nuk beson në autenticitetin e tyre në kohën e shpalljes apo i trajton me mosrespekt, konsiderohet jobesimtar (*kafir*).

Myslimanët janë në konsensus të plotë se Kurani që lexohet në të gjitha vendet e botës dhe që është i shkruar në mus’hafin që ndodhet në duart e tyre, i përmbledhur mes dy kapakëve, duke filluar me fjalët: **“Falënderimi i qoftë Allahut, Zotit të botëve”** (El Fatiha, 2), dhe duke përfunduar me: **“...nga xhinët dhe njerëzit”** (En Nas, 6), është fjala e Allahut dhe shpallja e Tij hyjnore, e zbritur te peygamberi Muhamed, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*. Ata janë njëzëri se çdo gjë që përmban Kurani është e vërtetë, pa asnjë dyshim apo shtesë njerëzore.

Kushdo që me qëllim heq një shkronjë të vetme nga ai, ndërron një shkronjë me një tjetër, apo shton një shkronjë për të cilën ekziston

konsensus se nuk është pjesë e Kuranit, dhe e bën këtë me qëllim të qartë, është mohues (kafir).

Ebu Othman bin El Hadad ka thënë: “Të gjithë ata që i përkasin Islamit janë të një mendimi se mohimi i një shkronje të vetme nga Kurani është kufër (mosbesim).”

Juristët (fukahatë) e Bagdadit qenë unanimes në mendimin se duhej t’i kërkohej Ibën Shenbudhit, njërit prej recituesve të Kuranit që kishte pozitë të lartë në recitim së bashku me Ibën Muxhahid-in, që të pendohej, sepse ai recitonte dhe lejonte të recitoheshin leximet që nuk gjendeshin në Kuranin e njohur zyrtarisht (lexonte rivajete që ishin jo të rregullta).¹

Ata vendosën që ta detyronin të tërhiqej nga qëndrimi i tij dhe ta nxisnin të bënte pendim të sinqertë. Ata hartuan një dokument zyrtar për të, ku ai dëshmonte kundër vetes, në praninë e vezirit Ebu Ali bin Mukla, në vitin 323 hixhrij / 935 pas Isait.

Ebu Muhamed bin Ebi Zejd dha një fetva lidhur me dikë që i kishte thënë një të riu: “Allahu e mallkoftë mësuesin tënd dhe çfarë të ka mësuar!”, e pastaj i akuzuari ishte përgjigjur: “Me këtë kam pasur për qëllim vetëm sjelljen e keqe, e jo Kuranin.” Ebu Muhamedi tha: “Personi që e ka thënë këtë duhet të ndëshkohet, ndërsa ai që fyen mus’hafin, duhet të marrë fund.”

Kjo është fjala e fundit e Kadi Ijadit, Allahu e pastë mëshiruar.

INTERPRETIMI I KURANIT

Të interpretohet Kurani pa dije dhe të flitet mbi kuptimet e tij pa dije është e ndaluar për këdo që nuk është i kualifikuar për këtë. Hadithet lidhur me këtë janë të shumta, dhe mbi këtë çështje ekziston konsensus. Ndërsa, interpretimi i Kuranit (tefsiri) nga ana e dijetarëve është i lejuar dhe i pranueshëm, dhe për këtë gjithashtu ka konsensus.

Kur dikush është i kualifikuar për ta shpjeguar Kuranin, pra, që zotëron kushtet (kualifikimet) e nevojshme për ta kuptuar domethënien

¹ Për detaje profesionale rreth këtyre temave shih librin e hfz. Hajredin Hoxhës me titull “Kiraetet e Kuranit nga perspektiva islame dhe çifute”, përkthyer prej Dr. Sedat Islamit, botuar nga Fokus-Shkup, 2004!

e tij dhe i afrohet asaj që është synuar (prej Allahut), atëherë i lejohet ta shpjegojë atë, nëse është nga ato gjëra që mund të kuptohen përmes ixhtihadit (përpyjekjes së tij personale shkencore intelektuale), si kuptimet, dispozitat e qarta dhe të fshehta, pohimet e përgjithshme dhe të veçanta, analizat gramatikore dhe të ngjashme. Mirëpo, nëse është nga ato që nuk mund të kuptohen përmes ixhtihadit, siç janë çështjet që rrjedhin vetëm nga transmetimi (nass), ose komentimi i shprehjeve gjuhësore, atëherë nuk lejohet të flitet për to, përveçse nëpërmjet transmetimeve të verifikuara rreptësisht nga ana e ekspertëve të kualifikuar.

Sa i përket atij që nuk është i kualifikuar për komentimin e Kuranit, për shkak se nuk i përmbush kriteret, kualifikimet shkencore, atij i ndalohet të japë shpjegime (të bëjë komentim – tefsir). Mirëpo, atij i lejohet të transmetojë shpjegime prej atyre që janë ekspertë të kualifikuar.¹

Pastaj, komentuesit e Kuranit, që shprehin mendimet e tyre pa ndonjë argument të vlefshëm, mund të ndahen në disa kategori:

1. Ka prej atyre që argumentojnë me një ajet të Kuranit, për ta paraqitur medhhebin e tyre si të drejtë dhe për ta mbështetur mendimin e tyre, edhe pse e dinë se ky nuk është kuptimi i vërtetë i ajetit. Në të vërtetë, qëllimi i tyre është ta mposhtin kundërshtarin;
2. Ka prej atyre që synojnë të thërrasin në diçka të mirë dhe argumentojnë me një ajet të Kuranit, megjithëse nuk u shfaqet asnjë lidhje e vërtetë ndërmjet ajetit dhe asaj që ata po thonë;
3. Ka prej tyre që interpretojnë shprehjet arabe të Kuranit pa u ndalur te kuptimet e tyre, ashtu siç janë dhënë nga ana e dijetarëve të kualifikuar. Ky kuptim mund të merret vetëm përmes dëgjimit dhe mësimi nga njohësit e gjuhës arabe dhe dijetarët e tefsirit, si, për shembull, shpjegimi i kuptimit të fjalëve të veçanta dhe i lidhjeve të tyre sintaksore, rastet kur diçka është

¹ Rreth këtyre temave të rëndësishme profesionale shih punimet e hfz. Hajredin Hoxhës: “Tefsiri dhe mufesirët shqiptarë”; “Kushtet e mufesirit”; “Etika e tede-bburit” etj., në www.drhafezi.net!

lënë jashtë ose është përmbledhur, kur ka elipsë (mungesë të qëllimshme), kuptime të drejtpërdrejta dhe metaforike, domethënie të përgjithshme dhe të veçanta, aspekte të paqarta dhe të detajuara, çështje të vendosjes së rendit (si ajo që vjen më herët apo më vonë në fjali) si dhe gjëra të tjera që nuk janë të qarta për këdo. Nuk mjafton thjesht ta njohësh gjuhën arabe. Përkundrazi, duhet gjithashtu të njihen të gjitha ato që dijetarët e kualifikuar të tefsirit kanë thënë lidhur me një pjesë të caktuar të Kuranit, sepse mund të ketë konsensus mes tyre që kuptimi i jashtëm (i një ajeti, për shembull) mos të merret parasysht, dhe që kuptimi i synuar të jetë një kuptim i veçantë ose i nënkuptuar, apo diçka tjetër që bie ndesh me të dukshmen. Po ashtu, mund të ndodhë që një fjalë e Kuranit të ketë disa kuptime, dhe komentuesi ta dijë që në një vend të caktuar synohet vetëm njëri prej tyre, e pastaj ai e përdor këtë kuptim në të gjitha vendet e tjera ku ajo fjalë përmendet. Ky është komentim i Kuranit sipas mendimit personal, gjë që është e ndaluar.

Allahu e di më së miri.

RRETH NDALIMIT TË POLEMIKËS DHE DEBATIT NË LIDHJE ME KURANIN

Rreth Kuranit është e ndaluar të bëhen debate dhe polemika. Në këtë përfshihet edhe rasti kur dikush përdor një ajet për të argumentuar diçka që bie ndesh me medhhebin e tij, ndërkohë që ekziston vetëm një mundësi e vogël që ai ajet të përputhet me medhhebin e tij. Megjithatë, polemizuesi e përdor atë ajet për ta mbështetur mendimin dhe debaton mbi atë bazë, edhe pse është e qartë për të se ai ajet, në fakt, bie në kundërshtim me atë që ai pretendon. Dhe, ai është i justifikuar vetëm nëse kjo nuk është e qartë për të.

Me zinxhir të saktë (të sigurt) është transmetuar se i Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të*, ka thënë: “*Debati (i kotë) rreth Kuranit konsiderohet mosbesim (kufër).*”¹

¹ Hadithin e transmetojnë Ibën Hibani (1464), Ebu Davudi (4603), dhe Hakimi (223/2), prej Ebu Hurejres, *radijallahu anhu*.

Hattabiu ka thënë: “Ajo që nënkuptohet me “debate” në këtë kontekst është “dyshimi”. Mendime të tjera thonë se bëhet fjalë për “debatimin” në vetvete, i cili mbjell dyshim, ose për “debatet” e njerëzve të udhëhequr nga epshet, lidhur me ajetet që flasin për kaderin (përcaktimin hyjnor) dhe të ngjashme me to.”

ETIKA E PYETJES PËR ÇËSHTJET QË JANË TË PËRCAKTUARA NË KURAN

Dikush që dëshiron të bëjë një pyetje, për shembull, pse një ajet i paraprin një tjetri, ose përse një ajet i caktuar është vendosur pikërisht në atë vend, apo për çështje të ngjashme, duhet të shprehet duke thënë: “Cila është urtësia në këtë?”

MEKRUH (E PAPËLQYESHME) ËSHTË TË THUHET: “E KAM HARRUAR FILAN AJETIN”

Gjithashtu është e papërshtatshme të thuhet: “E kam harruar filan ajetin.” Në vend të kësaj më mirë është të thuhet: “Jam shtyrë ta harroj atë”, ose “M’u bë ta lë pas dore”, sepse është transmetuar në dy Sahihët (të Buhariut dhe Muslimit) se Abdullah bin Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ka treguar se i Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, ka thënë: “Askush prej jush mos të thotë: “E kam harruar filan ajetin”, por të thotë: “Më është bërë ta harroj (prej Allahut)!”

Dhe, në një version tjetër, po ashtu në përmbledhjet e dy Sahihëve, thuhet: “Sa e keqe është për ndonjërin prej jush të thotë: “E harrova filan ajetin”, sepse, në fakt, atij iu bë ta harrojë.”

Gjithashtu, në dy Sahihët është e transmetuar se zonja Aishe, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ka thënë se Pejgamberi, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, e dëgjoi një burrë duke recituar (Kuranin), dhe tha: “*Allahu e mëshiroftë! Ai ma kujtoi një ajet që m’u bë ta lë pas dore.*”

Dhe, në një transmetim tjetër të Buhariut dhe Muslimit: “M’u bë ta harroj.”

Mirëpo, ajo që transmeton Ibën Ebi Davudi, se Ebu Abdurahman Es Sulemij, tabiini i shquar, ka thënë: “Mos thoni: “E kam lënë pas

dore filan ajetin”, por thoni: “E neglizhova atë”, bie ndesh me atë që është e saktësuar në hadithin e transmetuar me zinxhir të saktë.

Ajo që duhet të merret për bazë është hadithi që e lejon përdorimin e shprehjes: “*E lash pas dore (apo: m’u bë ta lë pas dore)*”, dhe kjo nuk është mekruh (e papëlqyeshme).

PËR VENDIMIN (HUKMIN) LIDHUR ME EMËRTIMIN E SUREVE

Është e lejueshme dhe jo e papëlqyeshme (mekruh) të thuhet: “Surja El Bekare (Lopa)”, “Surja Ali Imran (Familja e Imranit)”, “Surja En Nisa (Gratë)”, “Surja El Maide (Tryeza)”... dhe kështu me radhë.

Disa prej dijetarëve të brezave të hershëm e kanë konsideruar të papëlqyeshme këtë shprehje. Ata kanë qenë të mendimit se duhet thënë: “Surja në të cilën përmendet lopa (El Bekare)”, “surja në të cilën përmendet Familja e Imranit”, “surja në të cilën përmenden gratë”, e kështu me radhë.

Mendimi i saktë është ai i pari, sepse në dy Sahihët (të Buhariut dhe të Muslimit) është vërtetuar se vetë i Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, ka thënë: “*Surja El Bekare*”, “*Surja El Kehf*”, dhe e ka përdorur këtë formë në shumë raste të tjera të ngjashme.

E njëjta mënyrë shprehjeje është transmetuar edhe prej shokëve të Pejgamberit, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*. Abdullah bin Mesudi ka thënë: “Ky është vendi ku u shpall Surja El Bekare.”

Po ashtu, prej tij është transmetuar në dy Sahihët: “Ia recitova Suren En Nisa të Dërguarit të Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*.”

Hadithet dhe thëniet e paraardhësve të drejtë (selefëve të ndershëm) në lidhje me këtë çështje janë të shumta dhe të pamohueshme.

TË THUASH: LEXIMI (KIRAETI) I FILANIT

Nuk është e papëlqyeshme (mekruh) të thuhet: “Ky është leximi (kiraeti) i Ebu Amrit”, “leximi i Nafiut”, “i Hamzës”, “i Kisaiut” apo

i ndonjë tjetri. Ky është mendimi më i saktë dhe i preferuar, pasi përputhet me praktikën e brezave të hershëm të umetit, pa ndonjë kundërshtim të njohur prej tyre.

Megjithatë, Ibën Ebi Davudi transmeton se Ibrahim En Nehaiu, *Allahu e mëshiroftë*, ka thënë: “Ata e konsideronin të papëlqyeshme kur thuhej: “suneti i filanit” dhe “leximi i filanit.”

Mirëpo, mendimi më i qëndrueshëm dhe i saktë mbetet ai që përmendëm më sipër.

KURANI DHE JOBESIMTARËT

Jobesimtari nuk duhet të ndalohet (pengohet) nga dëgjimi i Kuranit. Kjo bazohet në fjalët e Allahut të Lartë: ***“E nëse ndokush prej idhujtarëve kërkon mbrojtje prej teje (o Muhamed), mbroje, në mënyrë që të dëgjojë Fjalën e Allahut”*** (Et Tevbe, 6).

Mirëpo, atij i ndalohet ta prekë mus’hafin (tekstin fizik të Kuranit).

A lejohet t’i mësohet Kurani? Dijetarët tanë mendojnë se nuk lejohet t’i mësohet Kurani, nëse nuk pritet që ai të hyjë në Islam.

Nëse shpresohet se të hyjë në Islam, ka dy mendime:

1. Mendimi më i saktë është se lejohet, për shkak të shpresës që ta pranojë Islamin.
2. Mendimi tjetër është se nuk lejohet, njësoj siç nuk lejohet t’i shitet mus’hafi, edhe nëse pritet që ta pranojë Islamin.

Nëse e shohim një jobesimtar duke e mësuar Kuranin, a duhet ta ndalojmë?! Edhe për këtë ka dy mendime.

PËRDORIMI I TEKSTIT TË KURANIT PËR SHËRIM (RUKJE)¹

Dijetarët kanë mendime të ndryshme lidhur me shkrimin e Kuranit në një enë, e pastaj të lahet dhe t'i jepet një të sëmuri për ta pirë.

Hasan El Basriu, Muxhahidi, Ebu Kilabe dhe Evzaiu kanë thënë se nuk ka asnjë problem me këtë.

En Nehaiu e ka konsideruar të papëlqyeshme.

Kadi Husejni, Bagaviu dhe dijetarë të tjerë të medhhebit tonë kanë thënë se, nëse tekste nga Kurani shkruhen mbi ëmbëlsira ose ushqime të tjera, nuk ka asgjë të keqe nëse ato konsumohen.

Kadi Husejni gjithashtu mendon se, nëse ajetet janë shkruar mbi një copë druri, është e papëlqyeshme (*mekruh*) që ajo të digjet.

LIDHUR ME SHKRIMIN E KURANIT NËPËR MURE DHE RROBA

Sipas medhhebit tonë, është e papëlqyeshme të zbukurohen muret dhe rrobat me tekstet e Kuranit dhe me emrat e Allahut të Lartë.

Atai ka thënë se nuk ka ndonjë problem në shkrimin e Kuranit në kiblen e xhamisë.

Sa i përket hajmalive që përmbajnë tekste nga Kurani, Imam Maliku thotë se nuk ka asgjë të keqe në to, nëse ndodhen brenda një tubthi ose në një copë lëkure të qepur.

1 Me këtë rast, është e udhës të bëhet një vërejtje kritike mbi praktikën e rukjes dhe shtrirjen e saj në trojet shqiptare në dekadat e fundit. Burimet themelore islame dëshmojnë se rukja, në kohën e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të), është praktikuar në mënyrë individuale dhe familjare, si akt adhurimi dhe lutjeje, pa elemente institucionalizimi apo përfitimi material. Në kontekstin bashkëkohor, vërehet një transformim problematik i saj në veprimtari gjysmë-klinike dhe komerciale, shpesh i shoqëruar me keqinterpretime teologjike dhe shfrytëzim ekonomik, çka kërkon rishqyrtim kritik nga perspektiva akademike, fetare dhe historike, në dritën e parimeve burimore të Islamit dhe qëllimeve të sheriatit (mekasid esh sheriah). Për një pasqyrim publik dhe kritik të kësaj dukurie në kontekstin bashkëkohor shqiptar, shih gjithashtu materialin e Prof. Dr. Hfz. Hajredin Hoxhës: Shpirti i Sheriatit Islam – Rukja në Islam (YouTube, rreth viteve 2020–2021), i cili shërben si burim dytësor orientues dhe jo si referencë akademike primare. (Vërejtje e redaktorit).

Disa prej shokëve tanë shafiitë kanë thënë se nuk është e ndaluar nëse Kurani shkruhet në një hajmali të vogël së bashku me diçka tjetër. Megjithatë, është më mirë që mos të bëhet, pasi do të bartet edhe në gjendje të papastërtisë rituale, e cila është e pashmangshme.

Nëse shkruhet, atëherë duhet të mbrohet, ashtu siç ka thënë Imam Maliku, *Allahu e mëshiroftë*.

Shejh Ebu Amr bin Salah, *Allahu e mëshiroftë*, ka dhënë fetva në përputhje me këtë mendim të fundit.

FRYRJA GJATË RECITIMI TË KURANIT PËR SHËRIM (RUKJE)

Ibën Ebi Davudi transmeton prej sahabiut Ebu Xhuhajfe, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, emri i të cilit, sipas një mendimi, është Vehb bin Abdullah, si edhe prej Hasen El Basriut dhe Ibrahim En Nehaiut, se ata e konsideronin të papëlqyeshme (mekruh) këtë praktikë.

Mendimi i preferuar është se kjo nuk është e papëlqyeshme (*mekruh*); përkundrazi, është sunet i rekomanduar. Kjo mbështetet në një transmetim të saktë të zonjës Aishe, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, e cila ka thënë: “Çdo natë kur i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, shkonte për të fjetur, ai i bashkonte duart, frynte në to dhe recitonte suren El Ihlas, Suren El Felek dhe Suren En Nas. Pastaj ai e fshinte trupin e tij me të dy duart aq sa mundte, duke filluar me kokën, më pas fytyrën dhe pjesën e përparme të trupit. Ai e përsëriste këtë tri herë.”¹

Zonja Aishe, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, tregon gjithashtu: “Kur ai ishte i sëmurë dhe vuante nga sëmundja e tij e fundit, më porosiste mua që ta bëja këtë për të.”²

Dhe në një version tjetër, ajo thotë: “Gjatë sëmundjes nga e cila vdiq, i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve selem, zakonisht frynte mbi veten dy suret mbrojtëse (El Felek dhe En Nas). Mirëpo, kur ai nuk ishte më në gjendje ta bënte vetë, unë i fryva ato sure mbi të dhe fshiva mbi trupin e tij me dorën e tij, për shkak të begatisë që kishte ajo (dora e tij).”³

1 Transmetuar prej Buhariut (nr. 5017) dhe Muslimit (nr. 50/ 2192).


2 Transmetuar prej Buhariut (nr. 5748).

3 Transmetuar prej Buhariut (nr. 5735).


Po ashtu, në një version tjetër thuhet: *“I Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, kur vuante nga sëmundja e tij, zakonisht recitonte mbi veten e tij suret mbrojtëse (El Felek dhe En Nas) dhe frynte gjatë recitimit.”*¹

Gjuhëtarët (linguistët) kanë thënë se fjala “nefth” (fryrje) nënkupton një frymë të lehtë pa pështymë.

¹ Transmetuar prej Muslimit (nr. 50/2192).



KAPITULLI I TETË





KOHËT DHE SITUATAT E REKOMANDUARA PËR RECITIMIN E KURANIT

Dije se ky kapitull është shumë i gjerë, dhe për shkak të numrit të madh të çështjeve që trajtohen në të, është e pamundur të përmenden të gjitha! Megjithatë, do ta flasim shumicën ose një pjesë të madhe të tyre, në një formë të përmbledhur. Pjesa më e madhe e asaj që do të trajtojmë është e njohur si nga elita, ashtu edhe nga masa e thjeshtë, prandaj në shumicën e rasteve nuk do të sjellim referenca të veçanta.

Sunet është që t'i kushtohet vëmendje e veçantë recitimit të Kuranit gjatë muajit Ramazan, veçanërisht gjatë dhjetë ditëve të fundit, kur netët kanë rëndësi të veçantë. Po ashtu, kjo vlen edhe gjatë dhjetë ditëve të para të muajit Dhul Hixhe, në Ditën e Arafatit, në Ditën e Xhuma, pas namazit të sabahut dhe gjatë natës. Duhet të jesh veçanërisht i përkushtuar në mësimin përmendsh të sureve: Jasin, El Vakia dhe El Mulk.

LEXIMI I IMAMIT NË DITËN E XHUMA DHE GJATË DY FESTAVE (BAJRAMEVE)

Sunet është që imami, në namazin e sabahut të ditës së xhuma, pas recitimit të sures El Fatiha, të lexojë tërë suren Es Sexhde në rekatin e parë, dhe tërë suren El Insan në rekatin e dytë.¹

¹ Ashtu siç transmeton Muslimi (nr.879).

Nuk duhet vepruar siç bëjnë shumë imamë të xhamive, të cilët mjaftohen me leximin e disa ajeteve nga secila sure, dhe më pas e zgjasin recitimin në mënyrë të panevojshme. Përkundrazi, të dy këto sure duhet të lexohen të plota, me një recitim të qartë, të rrjedhshëm, të përshpejtuar dhe pa ndërprerje.

Sunet është që në namazin e xhumasë imami të recitojë tërë suren El Xhumua në rekatën e parë, dhe tërë suren El Mynafikun në rekatën e dytë. Nëse dëshiron, mund të recitojë suren El Eala në rekatën e parë, dhe suren El Gashije në të dytin. Të dy këto praktika janë transmetuar në mënyrë autentike prej të Dërguarit të Allahut, *paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të*, prandaj është e preferuar të veprohet sipas tyre. Duhet shmangur recitimi i pjesshëm i këtyre sureve, pasi nuk përputhet me praktikën peygamberike të transmetuar.

Gjithashtu, është sunet që në namazin e Bajramit imami të recitojë në rekatën e parë tërë suren Kaf, dhe në rekatën e dytë tërë suren El Kamer. Nëse dëshiron, mund ta recitojë suren El Eala në rekatën e parë, dhe suren El Gashije në të dytin. Të dy këto mënyra të recitimit janë transmetuar në mënyrë autentike prej të Dërguarit të Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*. Prandaj, duhet të shmangët recitimi i vetëm një pjese nga këto sure, në mënyrë që t'i përmbahemi sa më plotësisht praktikës peygamberike.

ÇFARË LEXOHEM NË SUNETET E SABAHUT DHE TË AKSHAMIT, SI DHE NË NAMAZIN E ISTIHARËS DHE TË VITRIT

Në dy rekatet sunet të namazit të sabahut, pas recitimit të sures El Fatiha në rekatën e parë, recitohet surja El Kafirun, ndërsa në rekatën e dytë surja El Ihlas (Kul huvallahu ehad). Nëse dëshiron, mund të recitosh në rekatën e parë ajetin e 126-të nga surja El Bekare (Ve idh kale Ibrahimu...) dhe në rekatën e dytë ajetin e 64-të nga surja Ali Imran (Kul ja Ehlel Kitabi...). Të dy veprimet konsiderohen si veprime të sakta dhe të vërtetuara prej të Dërguarit të Allahut, *paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të*.

Në dy rekatet sunete të namazit të akshamit, në rekatën e parë recitohet surja El Kafirun, ndërsa në rekatën e dytë surja El Ihlas. Këto

dy sure recitohen gjithashtu në dy rekatet e tavafit, si dhe në dy rekatet e namazit të istiharës, që është namazi i lutjes për udhëzim në marrjen e vendimit të drejtë.

Në namazin e vitrit, në rekatën e parë recitohet surja El Eala, në rekatën e dytë surja El Kafirun, dhe në rekatën e tretë surja El Ihlas, së bashku me dy suret mbrojtëse, El Felek dhe En Nas.

ÇFARË ËSHTË E PREFERUAR TË LEXOHE TË DITËN E XHUMA

Në ditën e xhuma është e pëlqyeshme të recitohet surja El Kehf, në bazë të hadithit të njohur të transmetuar prej Ebu Seid El Hudrit, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, dhe të tjerëve.

Imami Shafiu, në veprën e tij *El Umm*, ka theksuar se është e rekomanduar që kjo sure të recitohet edhe në natën e së premtes.

Dëshmia për këtë gjendet në atë që Ebu Muhamed Ed Darimi ka transmetuar me zinxhirin e tij, prej Ebu Seid El Hudrit, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, i cili ka thënë: “Kush e lexon suren El Kehf në natën e së premtes, atij do t’i ndriçojë një dritë në distancën ndërmjet tij dhe Shtëpisë së Lashtë (Qabes).”¹

Darimi ka përmendur një hadith, në të cilin thuhet se, në ditën e premte është e rekomanduar të recitohet surja Hud. Ai gjithashtu transmeton prej Mekhulit, tabiiut të njohur, se është e rekomanduar të recitohet surja Ali Imran në ditën e premte.

Darimi ka përmendur një hadith, e në të cilin theksohet se në ditën e xhuma është e rekomanduar të recitohet surja Hud.² Po ashtu, ai transmeton prej Mekhulit, tabiiut të njohur, se është e pëlqyeshme që në ditën e premte të lexohet edhe surja Ali Imran.³

1 Musnedi i Darimiut (nr. 3450).

2 Musnedi i Darimiut (nr. 3446).

3 Transmetuar prej Darimiut (nr. 3440).

RECITIMI I AJETI KURSISË DHE I DY SUREVE MBROJTËSE (EL FELEK DHE EN NAS)

Recitimi i shpeshtë i Ajeti Kursisë rekomandohet të bëhet në çdo kohë, veçanërisht në mbrëmje, para se të shkohet në gjumë.

Po ashtu, është e pëlqyeshme të recitohen dy suret mbrojtëse, El Felek dhe En Nas, menjëherë pas çdo namazi farz.

Në mënyrë të saktë dhe të fortë transmetohet se Ukbe bin Amir, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ka thënë: “*I Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, më urdhëroi që t’i recitoj dy suret mbrojtëse (El Felek dhe En Nas) pas çdo namazi.*”

Hadithin e kanë transmetuar Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Nesaiu, ndërsa Tirmidhiu e ka cilësuar atë si hadith hasen sahih, pra, të saktë dhe të besueshëm.

AJO QË LEXOHEM PARA GJUMIT

E këshillueshme (mustehab) është që para gjumit të recitohen: Ajeti Kursija, suret El Ihlas, El Felek, En Nas, si dhe dy ajetet e fundit të sures El Bekare (Amenerrresuli...). Këto janë recitime të cilave duhet t’u kushtohet vëmendje dhe kujdes i veçantë, pasi janë përmendur në hadithe të sakta.

Prej Ebu Mesud El Bedri, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, transmetohet se i Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, ka thënë: “*Kush i reciton natën dy ajetet e fundit të sures El Bekare, ato i mjaftojnë.*”¹

Dijetarët kanë dhënë disa shpjegime për këtë hadith. Disa prej tyre thonë se këto ajete mjaftojnë në vend të faljes vullnetare të namazit të natës, ndërsa të tjerë mendojnë se ato mjaftojnë si mbrojtje nga të këqijat dhe vështirësitë e natës.

Zonja Aishe, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ka transmetuar: “*Pejgamberi, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, çdo natë recitonte suret El Ihlas, El Felek dhe En Nas.*” (Këtë e kemi përmendur tashmë në pjesën ku flitet për “fryrjen” me fjalët e Kuranit).

1 Transmetuar prej Buhariut (nr. 5009) dhe Muslimit (807).

Ibën Ebi Davudi transmeton, me zinxhirin e tij të transmetuesve, se Ali bin Ebi Talibi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ka thënë: “*Nuk kam parë asnjë njeri të arsyeshëm (me mend) që ka hyrë në Islam e të shkojë të bjerë në gjumë pa e recituar Ajetin Kursij.*”

Gjithashtu, Aliu, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ka thënë: “*Nuk kam parë asnjë person të arsyeshëm (me mend) të shkojë të bjerë në gjumë pa i lexuar tri ajetet e fundit të sures El Bekare.*”

Zinxhiri i këtij transmetimi është i saktë (sahih) sipas kriterëve të Buhariut dhe Muslimit.

Ukbe bin Amir, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ka thënë: “I Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të*, më tha: “*Mos e lër të kalojë asnjë natë pa i recituar suret: El Ihlas, El Felek dhe En Nas!*” Pas kësaj nuk më kaloi asnjë natë pa i recituar ato.”

Ibrahim En Nehai ka thënë: “Ata (të parët e drejtë) e shihnin të pëlqyeshme që këto tri sure të recitohen çdo natë nga tri herë: El Ihlas, El Felek dhe En Nas.”¹

Gjithashtu është transmetuar prej Ibrahimit, se ata i mësonin (të tjerët) që, kur të shkonin për të fjetur, t’i recitonin dy suret mbrojtëse (El Felek dhe En Nas).

Prej zonjës Aishe, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, transmetohet: “*Pejgamberi, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, nuk flinte pa i recituar suret Ez Zumer dhe Benu Israil.*”²

ÇFARË LEXOHEM PAS ZGJIMIT NGA GJUMI

Kur dikush zgjohet nga gjumi çdo natë, rekomandohet t’i recitojë ajetet e fundit të sures Ali Imran, duke filluar me fjalët e Allahut të Lartë: “*Në krijimin e qiejve dhe të tokës vërtet...*”, deri në fundi të sures (ajetet 190–200).

Në dy Sahihët (Buhari dhe Muslim) është vërtetuar se i Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, i recitonte këto ajete të fundit të sures Ali Imran kur zgjohej nga gjumi.

¹ Sipas kushteve të Muslimit, zinxhiri i transmetimit është autentik.

² Këtë e ka transmetuar Tirmidhiu, dhe ka thënë se është hadith hasen.

ÇFARË LEXOHEM PRANË TË SËMURIT

Sipas fjalëve të të Dërguarit të Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, është e dëshirueshme që pranë një personi të sëmurë të recitohet surja El Fatiha, bazuar në një hadith të fortë dhe autentik (sahih): “Si e dite ti se ajo (El Fatiha) bën pjesë në fjalët shëruese (rukje)?”¹

Gjithashtu është e pëlqyeshme që pranë të sëmurit të recitohen tri suret mbrojtëse (El Ihlas, El Felek dhe En Nas), duke fryrë lehtë në duar dhe më pas duke ia kaluar mbi trupin e të sëmurit. Kjo praktikë është transmetuar si veprim i qëndrueshëm i të Dërguarit të Allahut, *paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të*, dhe gjendet në të dy koleksionet sahih të haditheve: Buhari dhe Muslim. Kjo çështje është trajtuar edhe më herët në kapitullin për “fryrjen” pas recitimit të Kuranit.

Talha bin Musarraf ka thënë: “Thuhet se një i sëmurë ndien lehtësim kur pranë tij recitohet Kurani.”

Ai gjithashtu tregon një përjetim personal: “Njëherë hyra te Hajthemeh, ndërsa ai ishte i sëmurë, dhe i thashë: “Po të shoh që je më mirë sot.” Ai u përgjigj: “Kurani u recitua para meje.”

Hatib Ebu Bekër El Bagdadi, *Allahu e mëshiroftë*, transmeton me zinxhirin e tij se, kur Ramadi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ankohej për ndonjë sëmundje, ai thoshte: “M’i sillni dijetarët e Hadithit.” Kur ata vinin, u thoshte: “Më lexoni hadithe!” Nëse kjo vlen për hadithet, atëherë aq më tepër vlen për Kuranin.

RECITIMI I KURANIT PRANË DIKUJT QË ËSHTË NË PRAG TË VDEKJES


Dijetarët tanë dhe të tjerë kanë thënë se është e rekomandueshme të recitohet surja Jasin pranë dikujt që është në prag të vdekjes, bazuar në hadithin e transmetuar prej Makil bin Jesarit, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, kur Pejgamberi, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, ka thënë: “Recitoni Jasinin për të vdekurit tuaj!”

¹ Transmetuar prej Buhariut (nr. 5736) dhe Muslimit (nr. 2201), prej Ebu Seid El Hudrit (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*).


Ky hadith është transmetuar prej: Ebu Davudit, Nesaiut në librin *“Veprat gjatë ditës dhe natës”*, dhe Ibën Maxhes, me një zinxhir të dobët transmetuesish.

Dhe, Muxhalidi transmeton prej Shabiut, i cili ka thënë: “Kur ensarët ishin të pranishëm pranë një të vdekuri, ata e recitonin suren El Bekare.”

Megjithatë, Muxhalidi konsiderohet si transmetues i dobët (daif) në zinxhirët e transmetimit.



KAPITULLI I NËNTË





SHKRIMI I KURANIT DHE RESPEKTI NDAJ MUS'HAFIT

Duhet ditur se Kurani famëlartë është shpallur dhe përpiluar që në kohën e të Dërguarit të Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, ashtu siç e gjejmë edhe sot në mus'hafët që kemi në dorë. Megjithatë, ai ende nuk ishte mbledhur në një mus'haf të vetëm, në formën e librit të plotë, siç e njohim sot. Në vend të kësaj, Kurani ruhej kryesisht në zemrat e besimtarëve. Një numër i konsiderueshëm i shokëve të Pejgamberit, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*, e kishin mësuar tërësisht përmendsh, ndërsa të tjerë kishin përvetësuar pjesë të ndryshme të tij.

Gjatë kohës së kalifatit të Ebu Bekrit, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, shumë prej atyre që e mbanin Kuranin në zemrat e tyre ranë dëshmorë. Kjo e shqetësoi kalifin, i cili u frikësua se nëse numri i hafizëve do të vazhdonte të pakësohej, mund të ekzistonte rreziku që të shfaqeshin mospajtime lidhur me përmbajtjen e Kuranit. Për këtë arsye ai kërkoi këshillën e sahabëve të tjerë, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*, nëse duhej që Kurani të mblidhej dhe të shkruhej në një mus'haf të vetëm. Ata e përkrahën këtë nismë, dhe e rekomanduan me bindje. Si rezultat, Kurani u shkrua dhe u përmbledh në një vëllim të vetëm. Kjo përmbledhje u ruajt në shtëpinë e Hafsës - Nënës së Besimtarëve, *Allahu qoftë i kënaqur me të*.¹

Gjatë kalifatit të Othmanit, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, Islami u përhap gjerësisht në troje të ndryshme dhe me shpejtësi. Me rritjen e

¹ Shih: Sahihu i Buhariut (nr. 4986)!

numrit të myslimanëve dhe përhapjen e gjuhëve dhe të dialekteve të ndryshme, Othmani u shqetësua se mund të lindnin mospajtime në lidhje me leximin dhe recitimin e Kuranit. Ai kishte frikë se këto dallime mund të çonin në shtrembërime, humbje të ndonjë pjese të shpallur ose në shtesa që nuk i përkisnin Kuranit. Për ta parandaluar këtë, ai urdhëroi përgatitjen e disa kopjeve zyrtare të Kuranit, të bazuara në mus'hafin që ndodhej nën kujdesin e Hafses, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, mus'haf ky që sahabët e kishin pranuar unanimisht si autentik. Këto kopje u dërguan në rajone të ndryshme islame, ndërsa Othmani urdhëroi asgjësimin e të gjitha versioneve të tjera që ndryshonin nga ky standard. Ky veprim u ndërmor me pëlqimin dhe mbështetjen e Ali bin Ebi Talibit dhe të gjithë sahabëve të tjerë, *Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë*.

Arsyeja pse Kurani nuk u përmbledh në një mus'haf të vetëm gjatë jetës së Pejgamberit, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, ishte sepse shpallja hyjnore vazhdonte ende, dhe ndodhte që disa ajete të mëparshme të shfuqizoheshin apo të zëvendësoheshin. Kjo gjendje vazhdoi deri në momentin e ndërrimit jetë të Pejgamberit, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, kur shpallja përfundimisht u ndërpre. Vetëm pasi Ebu Bekri dhe sahabët, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*, u bindën se shpallja kishte përfunduar, dhe se ekzistonte një nevojë e domosdoshme për ta ruajtur Kuranin në një përmbledhje të vetme, ata morën iniciativën për ta mbledhur dhe për ta shkruar atë në formën e një mus'hafi të plotë.

Në mesin e dijetarëve ekzistojnë mospajtime lidhur me numrin e ekzemplarëve të Kuranit (mus'hafëve) që kalifi Othman, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, urdhëroi të shpërndareshin. Sipas Imam Ebu Amr Danit, shumica e dijetarëve janë të mendimit se Othmani bëri që të shkruheshin katër kopje zyrtare të Kuranit. Njëra nga ato u dërgua në Basra, tjetra në Kufe, një në Siri, ndërsa e katërta mbeti pranë vetë kalifit.

Sipas mendimit të Ebu Hatim Sixhistanit, kalifi Othman, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, urdhëroi për përgatitjen e shtatë ekzemplarëve të Kuranit. Njëri prej tyre u dërgua në Mekë, tjetri në Sham (Siri), një në Jemen, një në Bahrejn, një në Basra, një në Kufe, ndërsa i shtati mbeti në Medinë, pranë vetë kalifit.

Kjo është një përmbledhje e shkurtër mbi mënyrën dhe fazat e përpilimit të Kuranit në formën e mus'hafit. Lidhur me këtë çështje, ekziston një numër i madh hadithesh autentike dhe të mirëvërtetuara, e që e mbështesin dhe e sqarojnë këtë proces historik të rëndësishëm në mbrojtjen e shpalljes hyjnore.

Ekzistojnë tri mënyra të njohura të shqiptimit të fjalës *mus'haf*:

- mus'haf,
- mis'haf dhe
- mas'haf.

Dy të parat, *mus'hafë* dhe *mis'hafë*, janë më të njohura. Ndërsa, shqiptimi *mas'haf* është përmendur prej Ebu Xhafer Nehasit dhe disa dijetarëve të tjerë, si një variant më pak i zakonshëm.

VLERA E SHKRIMIT TË KOPJEVE (EKZEMPLARËVE) TË KURANIT

Dijetarët janë unanimisht të mendimit se është i lavdërueshëm shkrimi i ekzemplarëve të Kuranit me kujdes dhe përkushtim, duke përdorur një kaligrafi të bukur, të qartë dhe lehtësisht të lexueshme. Po ashtu ata theksojnë rëndësinë e saktësisë dhe të elegancës në formësimin e shkronjave. Sipas tyre, është e rekomanduar që shkronjat të pajisen me pika dalluese dhe shenja të vokalizimit (zanoreve), me qëllim që të parandalohet shqiptimi i gabuar dhe të shmangen gabimet në lexim apo në kuptim.¹

Sa i përket mospëlqimit të dijetarëve të hershëm, si Shabiu dhe Nehaiu, lidhur me vendosjen e pikave dhe shenjave të zanoreve në mus'haf, ky

¹ Kurani shkruhet me përkujdesje të madhe dhe nën kushte të caktuara që respektojnë shenjtërinë. Janë disa mënyra se si shkruhet Kurani:

1. **Me dorë (kaligrafi):** Në mënyrë tradicionale, Kurani është shkruar me dorë nga kaligrafë të specializuar në kaligrafinë arabe, duke përdorur rregulla strikte për bukurinë dhe saktësinë e shkrimit.
2. **Me shtyp dhe teknologji moderne:** Shumica e ekzemplarëve sot prodhohen me mjete moderne printimi, duke përdorur standarde të miratuara nga autoritetet islame për ruajtjen e saktësisë së tekstit.
3. **Me kontrollim të rreptë:** Përpara publikimit, çdo kopje e Kuranit kontrollohet nga një ekip dijetarësh, ekspertësh dhe gjuhëtarësh, për të garantuar që nuk ka asnjë gabim në tekst, pikësim apo vokalizim. (Sqarim i përkthyesit).

qëndrim i tyre ishte i motivuar nga frika se një ndërhyrje e tillë mund të sillte ndryshime në vetë tekstin e Kuranit. Megjithatë, kjo frikë nuk ekziston më sot, pasi kufijtë mes tekstit origjinal dhe shenjave ndihmëse janë të qarta dhe të ndara. Për rrjedhojë, nuk ka asgjë që e ndalon një veprim të tillë. Ky veprim nuk mund të refuzohet as mbi bazën se përbën një risi (bidat), pasi bëhet fjalë për një risi të mirë, nga ato që shërbejnë për ruajtjen dhe përhapjen e fesë, dhe që nuk kundërshtojnë asnjë parim të saj. E njëjta gjë vlen edhe për veprime të tjera të dobishme siç janë: shënimi i dijes, ndërtimi i shkollave, themelimi i institucioneve bamirëse dhe iniciativa të ngjashme me to. Allahu e di më së miri.

SHKRIMI I KURANIT ME MATERIALE TË PAPAstra DHE MBI MURE

Kurani nuk lejohet të shkruhet me ndonjë substancë të papastër, pasi kjo bie ndesh me nderimin dhe respektin që i takon Fjalës së Allahut. Dijetarët e medhhebit shafii janë të mendimit se është e papëlqyeshme (mekruh) që Kurani të shkruhet mbi mure. Në lidhje me këtë çështje, më parë kemi përmendur edhe mendimin e Atasë.

Gjithashtu është thënë se, nëse ndonjë pjesë e Kuranit shkruhet mbi një ushqim apo diçka që hahet, nuk ka ndonjë ndalesë që ajo të konsumohet. Megjithatë, nëse shkruhet mbi dru, djegia e tij konsiderohet e papëlqyeshme (mekruh), për shkak të shenjtërisë që mbart Fjala hyjnore.

RUAJTJA DHE RESPEKTIMI I MUS'HAFIT

Të gjithë dijetarët myslimanë janë të një mendimi se është detyrim (farz) të mbrohet, të nderohet dhe të respektohet mus'hafi, Libri i Shenjtë i Allahut. Dijetarët e medhhebit shafii dhe të tjerë, kanë theksuar se, nëse një mysliman – *Allahu na ruajttë* – e hedh ose e vendos mus'hafin në një vend ku hidhen mbeturinat (papastërtitë), ai bëhet mohues (jobesimtar).

Gjithashtu, ata kanë sqaruar se është e ndaluar (haram) që mus'hafi të përdoret si jastëk apo si mbështetëse për kokën. Ky ndalim shtrihet jo vetëm për mus'hafin, por edhe për çdo libër tjetër që përmban dije fetare, për shkak të shenjtërisë dhe respektit që kërkohet ndaj diturisë së fesë.

Nëse dikujt i jepet një mus'haf, është e pëlqyeshme (mustehab) që ai të ngrihet në këmbë, në shenjë nderimi. Meqë është e pëlqyeshme të ngrihesh për njerëzit e devotshëm dhe dijetarët e sinqertë, atëherë ky veprim është edhe më i përshtatshëm kur bëhet fjalë për Librin e Allahut, Kuranin famëlartë. Argumentet që dëshmojnë se është e rekomanduar të ngrihesh për njerëz të devotshëm i kam sqaruar në një trajtesë të veçantë.

Në *Musnedin* e Darimiut transmetohet me një zinxhir të saktë (isnad sahih) prej Ibën Ebi Mulejkes, se Ikreme bin Ebi Xhehli, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, e vendoste mus'hafin mbi fytyrën e tij, dhe thoshte: "Libri i Zotit tim, Libri i Zotit tim."¹ Kjo dëshmon për shkallën e lartë të dashurisë dhe të nderimit që sahabët kishin ndaj Kuranit.

KUFIZIMET JURIDIKO-FETARE PËR UDHËTIMIN ME MUS'HAF NË VENDE ARMIQËSORE

- Nuk lejohet të udhëtohet me mus'haf në territoret e armiqve, nëse ekziston frikë se ai mund të bjerë në duart e tyre dhe të keqpërdoret. Ky ndalim bazohet në hadithin e njohur të transmetuar në dy koleksionet më autentike, *Sahihul Buhari* dhe *Sahihul Muslim*, ku i Dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*, e ndaloj hyrjen në vendin e armikut me Kuranin, nga frika se mos e përbuzin apo e përdhosin atë.²
- Nuk lejohet që një mus'haf t'i shitet një jomyslimani që jeton nën mbrojtjen e shtetit islam (dhimmi), për shkak të frikës se mund të mos e trajtojë atë me respektin e duhur. Megjithatë, nëse një shitje e tillë ndodh, Imam Shafi'u ka shprehur dy mendime:

a-mendimi më i fortë është se kjo shitje është e pavlefshme,

b-ndërsa, sipas mendimit tjetër, kjo është e vlefshme në vetvete, mirëpo jomyslimanit duhet t'i kërkohet të dorëzojë mus'hafin, për ta mbrojtur shenjtërinë e tij.³

1 Musnedi i Darimiut (nr. 3393).

2 Transmetuar prej Buhariut (nr. 2990) dhe Muslimit (nr. 1869), prej Abdullah bin Amrit, radijallahu anhu.

3 Nuk konsiderohet e arsyeshme që, në kontekste bashkëkohore, një individ që shfaq

- Gjithashtu, është e domosdoshme që personat me çrregullime mendore dhe fëmijët që ende nuk e dallojnë të mirën nga e keqja të pengohen nga mbajtja e mus'hafit, për shkak të rrezikut që të cenohet paprekshmëria dhe nderi i Kuranit. Kujdestarët e tyre, si dhe çdo person tjetër që është dëshmitar i një rasti të tillë, janë të obliguar t'i ndalojnë ata nga mbajtja apo përdorimi i mus'hafit në mënyrë të papërshtatshme.

PREKJA DHE MBAJTJA E MUS'HAFIT PREJ PERSONIT PA ABDES

- Personit që gjendet në gjendje të papastër ritualisht (pa abdes) i ndalohet ta prekë apo ta mbajë mus'hafin, edhe nëse e kap përmes rripit, një cepi apo ndonjë pjese tjetër të tij. Ky ndalim vlen si për shkrimin e drejtpërdrejtë, ashtu edhe për kopertinën ose skajet e mus'hafit.
- Madje, sipas mendimit më të saktë dhe më të përzgjedhur, ndalohet edhe prekja e çantës së stofit, mbështjellësit ose kutisë në të cilën ndodhet mus'hafi.
- Ka dijetarë që kanë thënë se prekja e këtyre tri gjërave (çantës, mbështjellësit apo kutisë) nuk është e ndaluar, por ky konsiderohet një mendim i dobët. Nëse pjesë nga Kurani janë të shkruara mbi një dërrasë, atëherë ajo trajtohet sipas të njëjtave rregulla si mus'hafi, pa marrë parasysh nëse teksti është i gjatë apo i shkurtër. Madje, edhe nëse është shkruar vetëm një fragment i një ajeti për qëllime mësimore, është e ndaluar të preket ajo dërrasë pa abdes.

interes të sinqertë për të kuptuar besimin islam t'i ndalohet blerja ose konsultimi i përkthimeve të Kuranit. Qasja në tekstet themelore fetare përbën një element të rëndësishëm të dialogut ndërkulturor dhe të njohjes reciproke. Megjithatë, në rastet kur ekziston indikacion i qartë se marrja e tekstit synon përdorimin e tij për akte nënçmuese, provokuese ose për dëmtim simbolik, komunitetet fetare kanë të drejtë të vendosin kufizime etike në shpërndarjen e tij. (Vërejtje e redaktorit)..

PREKJA DHE MBAJTJA E MUS'HAFIT PËRMES NJË MJETI NDIHMËS

- Nëse një person që ndodhet në gjendje të papastër rituale, qoftë e vogël apo e madhe, ose një grua me menstruacione i prekin faqet e mus'hafit me anë të një mjeti ndihmës, sikurse, për shembull: me një shkop, apo me ndonjë pengesë tjetër të ngjashme, dijetarët kanë shprehur dy mendime për këtë çështje.

a-Mendimi më i qartë dhe më i përkrahur është se kjo është e lejuar, pasi personi në fjalë as nuk e prek drejtpërdrejt dhe as nuk e mban mus'hafin. Këtë qëndrim e kanë mbështetur posaçërisht dijetarët e medhhebit shafii nga Iraku.

b-Ndërsa, sipas një mendimi tjetër, kjo nuk lejohet, sepse konsiderohet sikur personi po e mban faqen e mus'hafit dhe, si rrjedhojë, kjo trajtohet me të njëjtat rregulla sikurse mbajtja e tërë librit.

- Nëse një person që ndodhet në gjendje të papastër e mbështjell dorën me mëngën e vet dhe në këtë mënyrë i shfleton faqet e mus'hafit, atëherë një veprim i tillë është i ndaluar, sipas mendimit unanimit të dijetarëve.
- Disa dijetarë kanë gabuar kur kanë transmetuar se për këtë çështje ekzistojnë dy mendime. Mirëpo, mendimi i saktë dhe i pranuar gjerësisht është se kjo është e ndaluar, sepse kontakti me faqet nuk ndodh përmes mëngës, por përmes dorës që vepron dhe kontrollon lëvizjen, pra, është vetë dora ajo që konsiderohet si mjet i drejtpërdrejtë i shfletimit.

SHKRIMI I KURANIT GJATË GJENDJES SË PAPASTËRTISË RITUALE

Nëse një person që ndodhet në gjendje papastërtie, qoftë e vogël apo e madhe rituale, shkruan një mus'haf, dhe gjatë këtij procesi prek ose mban letrën, kjo është e ndaluar. Mirëpo, nëse ai nuk e prek dhe as nuk e mban letrën, pra, nuk ka kontakt të drejtpërdrejtë me të, dijetarët kanë shprehur tri mendime lidhur me këtë çështje:

1. **Mendimi më i fortë:** Lejohet shkrimi i Kuranit në këtë mënyrë, nëse nuk ka kontakt me letrën;
2. **Mendimi i dytë:** Nuk lejohet në asnjë rast, pavarësisht nëse letra preket ose jo;
3. **Mendimi i tretë:** Lejohet për personin në papastërti të vogël (pa abdes), mirëpo ndalohet për atë që ndodhet në papastërti të madhe rituale (xhunub, pas menstruacioneve etj.).

PREKJA E SENDEVE QË PËRMBAJNË AJETE KURANORE, MIRËPO QË NUK JANË MUS'HAF

Mendimi më i saktë ndër dijetarët është se lejohet që një person në gjendje papastërtie, qoftë ajo gjendje e vogël apo e madhe, si dhe një grua me menstruacione, të prekë ose të mbajë sende që përmbajnë ajete kuranore, mirëpo që nuk janë vetë mus'haf. Kjo sepse këto objekte nuk marrin statusin e mus'hafit në kuptimin juridik. Ndër to përfshihen:

1. **Libra** të fikhut apo të shkencave të tjera islame, e që përmbajnë ajete nga Kurani;
2. **Veshje** të qëndisura me ajete kuranore;
3. **Monedha** që kanë të gdhendura ajete nga Kurani;
4. **Valixhe ose bagazhe** që përmbajnë një mus'haf (pa e prekur atë direkt);
5. **Objekte si mure, ushqime apo ëmbëlsira**, mbi të cilat është shkruar apo gdhendur ndonjë ajet.

Megjithatë, ekziston edhe një mendim tjetër ndër disa dijetarë, sipas të cilit prekja e këtyre sendeve në gjendje papastërtie nuk lejohet. Mirëpo, mendimi më i pranuar dhe më i mbështetur është ai i lejimit.

Kryegjyqtari Ebu El Hasen El Maverdi, në veprën e tij *El Havi*, shprehet: “(Për një person në gjendje papastërtie rituale apo për një grua me menstruacione) është e lejueshme që t'i prekë rrobat e qëndisura me ajete nga Kurani, mirëpo, sipas mendimit unanim, nuk lejohet që ato të vishen, pasi qëllimi i veshjes së tyre është përfitimi i begatisë nga Kurani.”

Megjithatë, ky qëndrim konsiderohet i dobët dhe, nga sa kam parë, nuk ka mbështetje të gjerë. Përkundrazi, dijetarë si shejhu Ebu Muhammed El Xhujejni dhe të tjerë kanë pohuar qartë se është e lejueshme të vishen veshje të tilla, dhe ky është mendimi më i saktë.

Dhe, Allahu e di më së miri.

Lidhur me komentet e Kuranit (tefsirin), rregullat për prekjen apo mbajtjen e tyre prej personave në gjendje papastërtie rituale (të vogël apo të madhe), ose prej grave me menstruacione, varen nga raporti mes tekstit kuranor dhe komentimit:

- Nëse pjesa e tekstit kuranor në libër është më e madhe se pjesa e komentimit, atëherë prekja dhe mbajtja e librit është e ndaluar për personat në gjendje papastërtie.
 - Nëse pjesa e komentimit (tefsirit) është më e madhe, siç është zakonisht në shumicën e librave të tefsirit, atëherë dijetarët kanë dhënë tri mendime:
1. **Prekja nuk është e ndaluar**, dhe ky është mendimi më i saktë dhe më i përkrahur;
 2. **Prekja është e ndaluar**, pavarësisht nga përqindja e përmbajtjes kuranore;
 3. **Prekja ndalohe vetëm** nëse teksti kuranor dallohet qartë, sikurse, për shembull, përmes shkronjave të trasha, më të mëdha, me ngjyrë të kuqe ose të ndryshme. Nëse nuk dallohet, nuk është e ndaluar.

Unë (autori) mendoj se është e ndaluar të preket një libër i tillë, kur teksti kuranor dhe pjesa tjetër janë në përmasa të barabarta.

Autori i veprës *Et Tetimme*, njëri prej dijetarëve tanë, është i mendimit se edhe nëse themi se nuk është e ndaluar, atëherë të paktën është e papëlqyeshme (mekruh).

Sa u përket librave të hadithit, nuk është e ndaluar që ato të preken, për sa kohë që nuk përmbajnë ajete kuranore. Megjithatë, më e përshtatshme dhe më me respekt është që të preken vetëm kur personi gjendet në gjendje të pastrimit ritual.

Nëse librat e Hadithit përmbajnë ajete nga Kurani, atëherë, sipas medh'hebit tonë (shafii), kjo nuk është e ndaluar, por konsiderohet e

papëlqyeshme (mekruh). Megjithatë, në literaturën e fikhut ekziston edhe një mendim që e cilëson këtë si të ndaluar.

Po ashtu nuk është e ndaluar të preken ose të mbahen tekste të Kuranit, recitimi i të cilave është abroguar (shfuqizuar), sikurse, për shembull: *“Nëse plaku dhe plaka kryejnë amoralitet, atëherë gurëzoni të dy me vendosmëri”*, si dhe tekste të tjera të ngjashme. Dijetarët tanë kanë sqaruar se kjo lejohet edhe për tekstet e Tevratit dhe Inxhilit.

PREKJA E MUS’HAFIT NË GJENDJE PAPASTËRTIE TË PAJUSTIFIKUAR

Nëse në ndonjë pjesë të trupit të një personi që ndodhet në gjendje të pastërtisë rituale (me abdes) gjendet një njollë papastërtie (*nexhase*) me përmasa të konsiderueshme, dhe që nuk është e justifikuar ligjërisht, atëherë, sipas mendimit unanim dhe në përputhje me medhhebin më të fuqishëm dhe të njohur, i mbështetur prej shumicës së dijetarëve islamë, ndalohet që mus’hafi të preket me atë pjesë të trupit që është e ndotur.

Megjithatë, lejohet që mus’hafi të preket me pjesë të tjera të trupit që janë të pastra.

Imam Ebu El Kasim Sajmeri, njëri prej dijetarëve tanë të medhhebit shafii, ka thënë se është e ndaluar të bartet mus’hafi, mirëpo dijetarët tanë e kanë konsideruar këtë qëndrim të tij si të pasaktë. Kadi Ebu Et Tajib ka thënë se ky mendim është hedhur poshtë me konsensus (*ixhma*). Prandaj, në përputhje me mendimin më të njohur dhe më të saktë, disa prej dijetarëve tanë kanë thënë se është e papëlqyer (ta bartësh mus’hafin në këtë rast), mirëpo mendimi më i përzgjedhur është se nuk është as e ndaluar dhe as e papëlqyer.

PREKJA E MUS’HAFIT PREJ PERSONIT QË NUK DISPONON UJË PËR PASTRIM (ABDES)

Nëse një person nuk gjen ujë për pastrim (abdes), atëherë ai merr tejemum, dhe me këtë rast lejohet ta prekë mus’hafin, qoftë të ketë marrë tejemum për namaz, apo për ndonjë qëllim tjetër për të cilin lejohet tejemumi. Ndërkaq, ai që nuk gjen as ujë e as dhe (për tejemum),

atëherë ai falet në çdo gjendje në të cilën ndodhet, por nuk i lejohet që ta prekë mus'hafin, për shkak të papastërtisë së tij, ndonëse i lejohet ta falë namazin, për shkak të domosdoshmërisë.

Nëse një person ka me vete një mus'haf dhe nuk gjen askënd që t'ia lërë amanet (ta ruajë), ndërsa vetë është i paaftë për të marrë abdes, atëherë i lejohet ta mbajë mus'hafin me vete, për shkak të domosdoshmërisë për ta ruajtur.

Nëse dikush ka frikë se mus'hafi mund të digjet, të fundoset në ujë, të bjerë në papastërti ose të përfundojë në duart e një jobesimtari, atëherë lejohet që ai ta marrë në posedim, edhe nëse është në gjendje papastërtie rituale (pa abdes), për shkak të domosdoshmërisë.

Kadi Ebu Et Tajib ka thënë se nuk është e domosdoshme që një person të marrë tejemum vetëm për qëllimin e bartjes së mus'hafit. Megjithatë, ky mendim kërkon shqyrtim, pasi ajo që konsiderohet më e drejtë dhe më e saktë është se personi duhet të marrë tejemum në një rast të tillë.

Ndërkaq, nëse dikush ka frikë se mus'hafi mund të digjet, të fundoset në ujë, të bjerë në papastërti ose të përfundojë në duart e një jobesimtari, atëherë lejohet që ai ta marrë mus'hafin në posedim, edhe nëse është në gjendje papastërtie rituale. Ky përjashtim bazohet në parimin e domosdoshmërisë (darura), i cili lejon tejkalimin e ndalesave në rrethana të jashtëzakonshme, me qëllim mbrojtjen e diçkaje të shenjtë dhe të çmuar siç është mus'hafi.

PASTËRTIA RITUALE E FËMIJËS

KUR E PREK MUS'HAFIN

A është obligim që kujdestari apo mësuesi i një fëmije që ka arritur moshën e dallimit (rreth moshës 7-vjeçare) t'i kërkojë atij të jetë me abdes para se ta mbajë mus'hafin apo tabelën (pllakën) mësimore nga e cila mëson?

Dijetarët e medhhebit tonë kanë dhënë dy mendime të njohura në lidhje me këtë çështje. Megjithatë, mendimi më i saktë dhe më i përqafuar të shumica është se kjo nuk është obligim, për shkak të vështirësisë së zbatimit që do të sillte një kërkesë e tillë për fëmijët në atë moshë.

SHITBLERJA E MUS'HAFIT

Shitja dhe blerja e mus'hafit, pra e ekzemplarit fizik të Kuranit, konsiderohet e vlefshme. Blerja e tij nuk përbën mëkat, dhe në këtë aspekt nuk ka kundërshtim në mesin e dijetarëve.

Megjithatë, sa i përket shitjes së tij, dijetarët e medhhebit shafii kanë dy mendime të njohura. Mendimi më i saktë, dhe njëherazi ai që është shprehur qartë prej vetë Imam Shafiu, është se shitja e mus'hafit është e papëlqyer (mekruh), por jo e ndaluar.¹

Ndër dijetarët që nuk e kanë konsideruar as blerjen dhe as shitjen e mus'hafit si të papëlqyer janë Hasan El Basriu, Ikrima dhe Hakem bin Utejbe, dhe ky qëndrim është transmetuar gjithashtu prej Ibën Abbasit, *Allahu qoftë i kënaqur me të*.

Një grup tjetër dijetarësh kanë mbajtur mendimin se shitblerja e mus'hafit është e papëlqyer. Këtë mendim e ka transmetuar Ibën Mundhiri, prej dijetarëve të hershëm si: Alkame, Ibën Sirini, Nehaiu, Shurejhi, Mesruki dhe Abdullah bin Jezidi.

Një qëndrim më i rreptë, i cili e ndalon qartazi shitjen e Kuranit, është transmetuar prej sahabëve të nderuar Abdullah bin Omer dhe Ebu Musa El Eshari, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*.

Ndërkaq, një grup dijetarësh kanë bërë dallim ndërmjet blerjes dhe shitjes së mus'hafit: ata e kanë lejuar blerjen si një lehtësim ligjor, ndërsa shitjen e kanë konsideruar të papëlqyer (mekruh). Këtë mendim e ka transmetuar po ashtu Ibën Mundhiri, prej Ibën Abbasit, Seid bin Xhubejrit, Imam Ahmed bin Hanbelit dhe Is'hak bin Rahevejhut, *Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata*.

1 Megjithëse shumë çështje që lidhen me shitjen, blerjen apo dhënien e mus'hafit janë trajtuar gjerësisht në literaturën klasike të fikhut, bëhet e domosdoshme që këto mendime të rishikohen në dritën e zhvillimeve të reja shoqërore, politike dhe ndërfetare. Parimi themelor i jurisprudencës islame: “*Nuk mohohet ndryshimi i fetvasë me ndryshimin e kohës dhe vendit*”, e mbështet fuqimisht këtë nevojë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në vendet perëndimore, ku ndalimi i qasjes së jomyslimanëve të mus'hafi apo të përkthimit të tij mund të pengojë dialogun ndërfetar, përhapjen e dijes dhe udhëzimin.. (Vërejtje e redaktorit).



PËRMBYLLJE

Kjo shënon përfundimin e asaj që Allahu i Madhëruar më ka lehtësuar të shkruaj në këtë libër. Ai mbetet një përmbledhje e shkurtër dhe përmbledhëse, krahasuar me gjithçka që mund të thuhet rreth etikës dhe sjelljes së lexuesve të Kuranit Famëlartë. Megjithatë, siç e përmenda edhe në hyrje të këtij punimi, arsyeja që më shtyu ta paraqes në këtë formë të përmbledhur ishte për të lehtësuar përfitimin nga thelbi i çështjes.

Lus Allahun e Lartë dhe të Madhëruar që ky libër të bëhet burim dobie të gjithanshme për mua, për të dashurit e mi, për këdo që e lexon apo përfiton prej tij, dhe për gjithë pjesën tjetër të myslimanëve, në të dy vendqëndrimet: në këtë botë dhe në botën tjetër.

Falënderimi i përket vetëm Allahut, Zotit të botëve, një falënderim që i përkon pafundësisë së mirësive të Tij dhe që është në përputhje me begatitë e furnizimit që Ai shpërndan. Paqja dhe bekimet e plota qofshin mbi zotërinë tonë Muhamedin, mbi familjen e tij fisnike, dhe mbi të gjithë shokët e tij të ndershëm, pa asnjë përjashtim.

Dhe përfundimisht, i tërë falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.

Autori, Imam Neveviu (Allahu e mëshiroftë), shkruan: E fillova përpilimin e këtij punimi ditën e enjte, më 12 Rebiul Evvel – ditëlindja e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) – dhe e përfundova në mëngjesin e ditës së enjte, më 3 Rebiu Eth Thani, në vitin 666 pas Hixhretit.

Fund



PASQYRA E LËNDËS

FJALA E PËRKTHYESIT	7
DASHAMIRËT DHE SHËRBYESIT E KURANIT	9
BIOGRAFIA E IMAM NEVEVIUT (1233-1277)	17
Emri, lindja dhe formimi i hershëm	17
Programi mësimor dhe rutina ditore	20
Mësuesit e tij	21
Nxënësit e tij	22
Veprat dhe shkrimet e tij	23
Vdekja e Imam Neveviut	25
PARATHËNIA E AUTORIT	27
Kapitulli i parë	33
VIRTYTET E LEXIMIT TË KURANIT DHE TË ATYRE QË E MËSOJNË ATË	35
Kapitulli i dytë	39
PËRPARËSIA E LEXIMIT TË KURANIT DHE VLERËSIMI I LEXUESVE TË TIJ	41
Kapitulli i tretë	43
RESPEKTIMI I LEXUESVE TË KURANIT DHE NDALIMI I OFENDIMIT TË TYRE	45
Kapitulli i katërt	47
SJELLJA E MËSUESIT DHE E NXËNËSIT TË KURANIT	49
RREGULLA ETIKE PËR NXËNËSIN	59

Kapitulli i pestë	65
ETIKA E BARTËSIT TË KURANIT	67
Nënkapitull	69
QORTIM PËR ATA QË E PËRDORIN KURANIN SI MJET JETESE DHE DISPOZITA E MARRJES SË SHPËRBLIMIT PËR MËSIMDHËNIEN E TIJ	71
Vërejtja e Pejgamberit, sal-Allahu alejhi ve selem kundër shfrytëzimit të Kuranit për përfitime materiale	72
Mendimet e dijetarëve rreth lejueshmërisë së marrjes së shpërblimit për mësimin e Kuranit	73
Argumentet e atyre që e ndalojnë marrjen e shpërblimit për mësimin e Kuranit	74
Sa kohë duhet për ta përfunduar leximin e plotë të Kuranit?	75
Cila është mënyra më e mirë për leximin e Kuranit?	78
A është e pëlqyeshme të përfundohet hatmeja brenda një dite?	78
Kur duhet filluar dhe përfunduar hatmeja javore?	79
Rregullat dhe kohët më të mira për përfundimin e hatmes, sipas Imam Gazaliut	79
Kohët më të vlefshme për përfundimin e hatmes së Kuranit	79
Lutjet e melekëve për ata që e përfundojnë hatmen	80
Leximi i Kuranit gjatë natës	81
Shembuj frymëzues prej të devotshmëve për leximin e Kuranit natën	82
Edhe pak adhurim ka shpërblim të madh	83
Domosdoshmëria e përsëritjes së Kuranit dhe rreziku i harresës së tij	83
Rëndësia e ruajtjes së Kuranit dhe tërheqja e vërejtjes për humbjen e tij	84
Kapitulli i gjashtë	85
ETIKA E LEXIMIT TË KURANIT	87
Përdorimi i Misvakut	87
Leximi i Kuranit pa abdes	89
Tejemumi në mungesë të ujit	91
Tejemumi i xhunubit – në udhëtim apo në vendbanim	91
Tejemumi dhe rikthimi i detyrimit për gusul	92
Namazi dhe leximi i Kuranit pa ujë e pa dhe për tejemum	92

Vendi i recitimit të Kuranit	93
Leximi i Kuranit në banjë	94
Recitimi i Kuranit në rrugë	95
Kthimi kah Kibla gjatë recitimit të Kuranit	96
Shqiptimi i Istiadhes	97
Përshkrimi i Istiadhes	98
Hukmi (vendimi) i Istiadhes	98
Leximi i Besmeles	99
Përsiatja dhe përlësia gjatë leximit të Kuranit	100
Përsëritja e një ajeti për meditim	101
Të qarët gjatë leximit të Kuranit	102
Leximi i Kuranit ngadalë dhe qartë (me tertil)	104
Përgjërimi gjatë leximit të Kuranit	106
Respekti ndaj Kuranit dhe pakujdesia e disa lexuesve	108
Leximi i Kuranit në një gjuhë tjetër përveç arabishtes	109
Leximi i Kuranit me kiraetet mutevatir dhe shadh	110
Kalimi nga një kiraet në një tjetër	111
Të lexuarit sipas renditjes së mus'hafit	111
Përparësia e leximit të Kuranit nga mus'hafi	113
Leximi në grup i Kuranit	114
Pyetje dhe përgjigje rreth kësaj teme	115
Leximi me radhë (në grup)	116
Leximi i Kuranit me zë	117
Përmbledhje	120
Zbukurimi i zërit gjatë këndimit të Kuranit	121
Dëshira për të dëgjuar lexim të bukur të Kuranit prej atyre që kanë zë të mirë	124
Marrja parasysh e kuptimit gjatë fillimit dhe ndërprerjes së leximit	126
Disa rrethana kur leximi është i papëlqyer (mekruh)	128
Disa bidate (risi) që duhen refuzuar	129
Disa çështje të ndryshme (mesele)	130
Leximi i diçkaje nga Kurani me synimin e të folurit	133
Përshëndetja gjatë leximit të Kuranit	134

Ngritja në këmbë për dijetarët dhe njerëzit e mirë	136
Rregulla të vlefshme lidhur me leximin gjatë namazit	137
Recitimi i disa sureve në një rekat	140
Leximi me zë dhe në heshtje gjatë namazit	141
Pauzat e imamet gjatë namazit me zë	143
Kuptimi i fjalës “Amin” dhe rregullat që lidhen me të	143
Sexhdeja e leximit të Kuranit – Sexhde Tilaveti	147
Numri dhe vendet e sexhdeve të leximit	148
Kushtet për vlefshmërinë e sexhdes së leximit (sexhde tilavet)	151
Sexhdeja e sures Sad	152
Për kë është sunet sexhdeja e leximit	153
Sexhdeja në mënyrë të përgjithshme	154
Rregulla që kanë të bëjnë me sexhden e leximit gjatë namazit	155
Koha e sexhdes së leximit	156
Përsëritja e ajetit të sexhdes	157
Sexhdeja e leximit gjatë kalërimit	158
Recitimi i ajetit të sexhdes para Fatihasë	158
Leximi i ajetit të sexhdes në persisht (ose në gjuhë tjetër)	159
Sexhdeja e dëgjuesit nuk lidhet me sexhden e recituesit	159
Vendimi për recitimin e ajetit të sexhdes nga ana e imamet	159
Sexhdeja gjatë kohëve kur namazi është i ndaluar	160
Rukuja në vend të sexhdes së tilavetit	160
Përshkrimi i sexhdes së leximit	160
Mendimet e dijetarëve shafiitë mbi tekbinin fillestar	161
Tekbiri dhe pozicioni trupor në sexhden e leximit	161
Forma dhe etika e sexhdes së leximit	162
Tesbihët dhe lutjet në sexhden e këndimit (tilavetit)	163
Situata e dytë: Sexhdeja e leximit gjatë namazit	166
Kohët më të zgjedhura për leximin e Kuranit	168
Hutimi gjatë recitimit të Kuranit	169
Forma e referimeve me ajete kuranore	169
Rreth etikës dhe rregullave që lidhen me përfundimin e leximit të Kuranit	170

Koha e përfundimit të hatmes	170
Agjërimi në ditën e hatmes	171
Pjesëmarrja në hatme	171
Lutja pas përfundimit të hatmes	172
Ai që lutet duhet të zgjedhë lutje gjithëpërfshirëse, siç janë këto më poshtë	173
Fillimi i një leximi të ri pas përfundimit të hatmes	175
Kapitulli i shtatë	177
ETIKA E TË GJITHË NJERËZVE NË RAPORT ME KURANIN	179
Detyrimi për ta madhëruar Kuranin	180
Interpretimi i Kuranit	181
Rreth ndalimit të polemikës dhe debatit në lidhje me Kuranin	183
Etika e pyetjes për çështjet që janë të përcaktuara në Kuran	184
Mekruh (e papëlqyeshme) është të thuhet: “E kam harruar filan ajetin”	184
Për vendimin (hukmin) lidhur me emërtimin e sureve	185
Të thuash: leximi (kiraeti) i filanit	185
Kurani dhe jobesimtarët	186
Përdorimi i tekstit të Kuranit për shërim (rukje)	187
Lidhur me shkrimin e Kuranit nëpër mure dhe rroba	187
Fryrja gjatë recitimi të Kuranit për shërim (rukje)	188
Kapitulli i tetë	191
KOHËT DHE SITUATAT E REKOMANDUARA PËR RECITIMIN E KURANIT	193
Leximi i imamit në ditën e xhuma dhe gjatë dy festave (Bajrameve)	193
Çfarë lexohet në sunetet e sabahut dhe të akshamit, si dhe në namazin e istihaarës dhe të vitrit	194
Çfarë është e preferuar të lexohet në ditën e xhuma	195
Recitimi i Ajeti Kursisë dhe i dy sureve mbrojtëse (El Felek dhe En Nas)	196
Ajo që lexohet para gjumit	196
Çfarë lexohet pas zgjimit nga gjumi	197
Çfarë lexohet pranë të sëmurit	198
Recitimi i Kuranit pranë dikujt që është në prag të vdekjes	198

Kapitulli i nëntë	201
SHKRIMI I KURANIT DHE RESPEKTI NDAJ MUS'HAFIT	203
Vlera e shkrimit të kopjeve (ekzemplarëve) të Kuranit	205
Shkrimi i Kuranit me materiale të papastra dhe mbi mure	206
Ruajtja dhe respektimi i mus'hafit	206
Kufizimet juridiko-fetare për udhëtimin me mus'haf në vende armiqësore	207
Prekja dhe mbajtja e mus'hafit prej personit pa abdes	208
Prekja dhe mbajtja e mus'hafit përmes një mjeti ndihmës	209
Shkrimi i Kuranit gjatë gjendjes së papastërtisë rituale	209
Prekja e sendeve që përmbajnë ajete kuranore, mirëpo që nuk janë mus'haf	210
Prekja e mus'hafit në gjendje papastërtie të pajustificuar	212
Prekja e mus'hafit prej personit që nuk disponon ujë për pastrim (abdes)	212
Pastërtia rituale e fëmijës kur e prek mus'hafin	213
Shitblerja e mus'hafit	214
PËRMBYLLJE	215

EDUKATA E BARTËSVE TË KURANIT

IMAM NEVEVIU

Titulli original:



Përktheu dhe përshtati nga arabishtja në shqip:

Enes Koshi

Botues:

Komuniteti Musliman Shqiptar në Zvicër - DAIGS
Departamenti për veprimtari botuese*Për botuesin:*

Hfz. Mehas Alija

Redaktor profesional & recensent:

Prof. Dr. Hfz. Hajredin Hoxha

Konsulentë:

Mr. Bekim Alimi

Mr. Nehat Ismaili

Redaktor letrar:

Mr. Besnik JAHA

Redaktor teknik

Mr. Bashkim MEHANI

Shtypi: >

Tirazhi: >

Prishtinë?